



BASHKIA
TIRANË

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM TË BASHKISË TIRANË 2018 - 2022

**DREJTORIA E PËRGJITSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE
BURIMEVE NJERËZORE
BASHKIA TIRANË**

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive.....	11
1. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA.....	12
1.1 QËLLIMI.....	12
1.2 METODOLOGJIA.....	12
1.3 PARIMET UDHËHEQËSE.....	14
2. TIRANA NË KONTEKSTIN KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR.....	15
2.1 BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT DHE PLANET KOMBËTARE.....	15
2.2 KONKURUESHMËRIA DHE INDIKATORËT E SAJ.....	13
2.2.1 Burimet njerëzore dhe cilësia e jetës.....	13
2.2.2 Mundësitë tregtare dhe potenciali prodhues.....	14
2.2.3 Transporti.....	15
2.2.4 Inovacioni dhe markat.....	15
2.2.5 Integrimi në Bashkimin Europian.....	15
3 . TIRANA NË KONTEKSTIN RAJONAL.....	18
3.1 POZICIONI GJEOGRAFIK.....	18
3.2 HISTORIKU DHE TENDENCAT E ZHVILLIMIT URBAN.....	20
3.3 RAJONALIZIMI DHE POTENCIALET.....	21
4 ANALIZA E SITUATËS AKTUALE.....	24
4.1 DEMOGRAFIA DHE TENDENCAT.....	24
4.1.1 Demografia e Tiranës.....	25
4.1.2 Projektioni i popullsisë 2011-2031.....	29
4.2 PUNËSIMI DHE TRENDET.....	30
4.2.1 Punësimi në Tiranë.....	31
4.2.2 Papunësia në Tiranë.....	33
4.2.3 Programet e Nxitjes së Punësimit.....	34
4.3 STREHIMI.....	35
4.3.1 Strehimi Social dhe Programet.....	38
4.4 KUJDESI SOCIAL.....	39

4.4.1 Ndhimja Ekonomike.....	40
4.4.2 Shërbime të tjera të kujdesit social.....	41
4.5 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KLIMA E BIZNESIT.....	44
4.5.1 Biznesi në Tiranë.....	46
4.5.2 Zonat ekonomike dhe Klasterat.....	49
4.5.2.1 Zona Ekonomike në Tiranë (TEDA Kashar).....	49
4.6.2.2 Klasterat.....	53
4.5.2.3 Tregjet Publike.....	53
4.6 ZHVILLIMI RURAL.....	57
4.6.1 Bujqësia.....	59
4.6.2 Blegtoria.....	62
4.6.3 Sistemi i Ujitjes dhe Kullimit.....	63
4.6.4 Pyjet dhe Kullotat.....	65
4.7 TURIZMI.....	66
4.7.1 Turizmi në Tiranë.....	67
4.7.2 Llojet e Turizmit.....	68
4.8 EDUKIMI.....	70
4.9 KULTURA, RINIA DHE SPORTET.....	72
4.9.1 Kultura.....	72
4.9.2 Rinia.....	73
4.9.3 Sportet.....	74
4.10 ADMINISTRIMI I PRONAVE DHE ASETIVE TË BASHKISË TIRANË.....	76
4.10.1 Situata në NJA Rurale të Bashkisë Tiranë.....	76
4.10.2 Pronat në përdorim.....	77
4.11 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE.....	78
4.11.1 Rrjetet dhe Transporti Publik në Shqipëri.....	78
5.11.1.1 Rrjeti dhe Transporti Rrugor.....	79
5.11.1.2 Rrjeti dhe Transporti Hekurudhor.....	80
5.11.1.3 Transporti Ajror.....	81
.....	81

5.11.1.4 Transporti Detar.....	81
4.11.2 Rrjeti rrugor dhe Transporti në Tiranë.....	82
4.11.2.1 Rrjeti Rrugor Urban.....	82
4.11.2.2 Transporti Publik.....	85
4.11.2.3 Trafiku Rrugor.....	87
4.11.2.4 Parkimi Publik.....	89
4.11.2.5 Terminalet Multimodale.....	94
4.11.2.6 Këmbësorët dhe çiklistët.....	95
4.12 UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË.....	96
4.12.2 Impianti i Trajtimit të Ujit.....	98
4.12.3 Sistemi i kanalizimeve.....	99
4.13 HAPËSIRAT PUBLIKE.....	100
4.13.1 Administrimi i Objekteve në Bashkëpronësi.....	102
4.14 INFRASTRUKTURA ARSIMORE.....	102
4.15 PASTRIMI DHE SISTEMI I MANAXHIMIT TË MBETJEVE.....	106
4.15.1 Diferencimi i Mbetjeve dhe Riciklimi.....	110
4.16 SIGURIA PUBLIKE.....	111
4.16.1 Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH).....	111
4.16.2 Policia Bashkiake.....	112
4.16.3 Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.....	113
4.16.4 Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Tiranë (IMT).....	114
4.16.5 Emergjencat Civile.....	114
4.16.6 Agjencia e Shërbimit Funeral.....	116
4.16.7 Shërbimet administrative.....	118
4.16.8 Infrastruktura Shëndetësore.....	120
4.17 TERRITORI DHE MJEDISI.....	122
4.17.1 Kushtet fizike dhe Klimaterike.....	122
4.17.2 Planifikimi i Territorit.....	123
4.17.3 Mjedisi dhe Ekosistemet.....	124
4.17.4 Ndotja industriale dhe Hot-spotet.....	126

4.17.5 Ajri.....	127
4.17.6 Uji.....	128
4.17.7 Ndotja Akustike.....	130
5. ANALIZA SëOT.....	133
6. QEVERISJA VENDORE DHE FINANCAT PUBLIKE.....	143
6.1 DECENTRALIZIMI DHE FUNKSIONET VENDORE.....	143
6.2 TREGUESIT EKONOMIKË DHE FINANCIARË TË BASHKISË TIRANË.....	145
6.2.1 Analiza e trendit të të ardhurave.....	147
6.2.2 Analiza e trendit të shpenzimeve.....	151
7. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	153
7.1 VIZIONI I BASHKISË TIRANË.....	153
7.2 OBJEKTIVAT, PROGRAMET DHE INDIKATORËT E STRATEGJISË.....	154
8. MONITORIMI DHE ZBATIMI I STRATEGJISË.....	159

Lista e Tabelave

Tabela Nr.1	Renditja e vendeve sipas lehtësisë së të berit biznes
Tabela Nr.2	Raporti i varësisë moshore për Shqipërinë
Tabela Nr.3	Raporti i varësisë moshore për Tiranën
Tabela Nr. 4	Çmimet e shitjes/qerasë në zonat me përqendrimin më të lartë të ndërtimeve
Tabela Nr. 5	Mbjellja dhe prodhimi në Bujqësi Qarku Tiranë (2017)
Tabela Nr. 6	Numri i krerëve për qarkun e Tiranës (000)
Tabela Nr. 7	Sipërfaqja bujqësore për Qarkun Tiranë me aftësi ujitëse (ha)
Tabela Nr. 8	Të dhëna mbi potencialet dhe aftësitë e sistemit ujitës 2017
Tabela Nr. 9	Të dhëna mbi ndërhyrjet në sistemit ujitësi dhe kullimit 2016 – 2017
Tabela Nr 10	Sipërfaqja e fondit të pyjeve dhe kullotave sipas NJA-ve
Tabela Nr. 11	Turistët sipas origjinës / kontinenteve
Tabela Nr. 12	Të dhëna mbi institucionet arsimore publike dhe private 2017 - 2018
Tabela Nr.13	Profillet e studentëve sipas fakulteteve në Universitetet Publike (Viti akademik 2017-2018)
Tabela Nr.14	Gjendja e Rrjetit Rrugor në NJA rurale
Tabela Nr 15	Të dhëna mbi vendparkimet fizike të automjeteve në Tiranë 2017
Tabela Nr.16	Përqindja e shfrytëzimit sipas zonave
Tabela Nr.17	Të dhëna mbi vendparkimet e rezervuara 2017
Tabela Nr.18.	Vendparkimet në sheshe
Tabela Nr.19	Kapaciteti i shesh parkimeve nëntokësore
Tabela Nr 20.	Të dhëna mbi parkimin vetëm për rezident
Tabela Nr. 21.	Të dhëna mbi performancën e terminaleve
Tabela Nr. 22.	Karakteristikat e burimeve të ujit
Tabela Nr.23	Numri i nxënësve për klasë mësimore
Tabela Nr.24	Sasia e mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Tiranë
Tabela Nr.25	Sasia në % e mbetjeve të depozituara në Landfillin e Sharrës sipas kategorive
Tabela Nr.26	Volumi i mbetjeve të depozituara në Sharrë sipas zonave 2017
Tabela Nr.27	Treguesit ekonomik dhe financiar të Bashkisë Tiranë (2012 – 2017)
Tabela Nr.28	Taksat vendore për periudhën 2012 - 2017
Tabela Nr.29	Të dhëna mbi tarifat e Bashkisë Tiranë 2012 – 2017
Tabela Nr.30	Plani i Veprimit për Ndërtimin dhe Rikonstruksionin e Institucioneve Arsimore në BT
Tabela Nr. 31	Shkolla si Qendra Komunitare
Tabela Nr.32	Plani i Veprimit për Rehabilitimin e Bllloqeve të Banimit
Tabela Nr. 33	Kalendari i monitorimit të strategjisë
Tabela Nr 34	Agjentët monitorues dhe indikatorët e raportimit
Tabela Nr. 35	Plani i Veprimit të SZHQBT 2018 – 2022

Lista e Figurave

Figura Nr.1	Hirearkia e Objektivave të SKZHI
Figura Nr.2	Harta e re territoriale e Bashkisë Tiranë
Figura Nr. 3	Lidhjet e Tiranës në kontekstin gjeografik
Figura Nr. 4	Shpërndarja demografike e Bashkisë Tiranë
Figura Nr. 5	Banesa vakante si % e totalit të stokut të banimit
Figura Nr. 6	Harta e shpërndarjes së qendrave sociale/ditore dhe e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike
Figura Nr. 7	Harta e zonës së identifikuar TEDA
Figura Nr. 8.	Harta e tregjeve publike ekzistuese në qytetin e Tiranës
Figura Nr.9.	Plan vendosja e TID Pazari i RI
Figura Nr 10.	Harta e sistemit bujqësor në Bashkinë e Tiranës
Figura Nr. 11	Korridoret ndërkombëtare që përshkojnë Shqipërinë
Figura Nr.12	Rrjeti Rrugor Urban
Figura Nr.13	Harta e periferialitetit
Figura Nr.14	Linjat e transportit publik në Bashkinë e Tiranës
Figura Nr.15	Trafiku në Bashkinë e Tiranës
Figura Nr.16	Harta e nën-zonave të parkimit në rrugë (sipas zonave tarifore)
Figura Nr.17	Shesh parkimet dhe terminallet në Bashkinë Tiranë
Figura Nr.18	Harta e rrjetit aktual të biçikletave
Figura Nr.19	Zona e re e shërbimit të UKT-së
Figura Nr.20	Hapësirat e gjelbra në Tiranë
Figura Nr.21	Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9-vjecare (2016)
Figura Nr.22	Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të mesme (2016)
Figura Nr.23	Pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane
Figura Nr.24	Vendndodhja e landfillit të Sharrës
Figura Nr.25	Vendepozitimet e paligjshme të mbetjeve urbane në Tiranë
Figura Nr.26	Stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi
Figura Nr.27	Harta e pikave të nxehta
Figura Nr.28	Harta e varrezave publike
Figura Nr.29	Harta e qendrave shëndetësore në Bashkinë Tiranë
Figura Nr.30	Harta e parqeve
Figura Nr.31	Harta e zonave të mbrojtura
Figura Nr.32	Harta e zonave sipas ndotjes së ajërimit
Figura Nr.33	Harta e nivelit të ndotjes akustike në Tiranë
Figura Nr.34	Organigrama e Bashkisë Tiranë
Figura Nr.35	Harta e Bllloqeve të Banimit
Figura Nr.36	Harta e Këndeve të Lojrave

Lista e Grafikëve

Grafiku Nr.1	Popullsia mesatare vjetore sipas 3 - grupmoshave në Shqipëri
Grafiku Nr.2	Shtesa natyrore në Shqipëri
Grafiku Nr.3	Trendi i rritjes së popullsisë në vite (%)
Grafiku Nr.4	Popullsia në Tiranë sipas gjinisë 2010 – 2017
Grafiku Nr.5	Piramida e grupmoshave 2017
Grafiku Nr.6	Ndryshimi i popullsisë në NJA urbane 2010-2017
Grafiku Nr.7	Ndryshimi I popullsisë në NJA Rurale 2017
Grafiku Nr.8	Projeksioni i popullsisë 2011 - 2031
Grafiku Nr. 9	Të punësuarit për Qarkun Tiranë sipas sektorëve
Grafiku Nr.10	Shkalla e punësimit në Bashkinë Tiranë (%)
Grafiku Nr.11	Punësimi sipas nivelit arsimor në Bashkinë Tiranë
Grafiku Nr.12	Punësimi sipas degëve të ekonomisë
Grafiku Nr. 13	Shkalla e papunësisë (Meshkuj – Femra) %
Grafiku Nr.14	Ndërtesa banimi ndaj ndërtimeve të reja 2001 – 2011 (%)
Grafiku Nr. 15	Banesa boshe ndaj ndërtesave për qëllime banimi
Grafiku Nr. 16	Familje përfituese të ndihmës ekonomike në zonat urbane (%)
Grafiku Nr. 17	Familje përfituese të ndihmës ekonomike në zonat rurale (%)
Grafiku Nr. 18	Përfitues nga përkujdesja e qendrave sociale dhe ditore 2017
Grafiku Nr. 19	% e Qarkut Tiranë në VSHB me çmimet bazë siaps degëve të ekonomisë
Grafiku Nr. 20	Bizneset në Bashkinë e Tiranës 2010 - 2017
Grafiku Nr. 21	Bizneset sipas kategorive 2010 - 2017
Grafiku Nr. 22	Bizneset sipas llojit të aktivitetit 2012 – 2017
Grafiku Nr.23	Struktura e burimeve të të ardhurave të BT-së
Grafiku Nr.24	Ndryshimet në strukturën e të ardhurave të veta të BT-së
Grafiku Nr.25	Trendi i shpenzimeve në Bashkinë Tiranë
Grafiku Nr. 26	Shpenzimet sipas programeve buxhetore 2012 – 2017
Grafiku Nr. 27	Trendi i shpenzimeve sipas kategorive (%) 2012-2017

Lista e Akronimeve

AITPP	Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AMK	Agjencia e Mbrojtjes Konsumatore
AMTP	Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi
APR	Agjencia e Parqeve dhe e Rekreacionit
APU	Arsimi Parauniversitar
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqipëtar
ASHF	Agjencia e Shërbimeve Funerale
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronave
BE	Bashkimi European
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BKE	Banka e Këshillit European
BRT	Bus Rapid Transport
BT	Bashkia Tiranë
DMPS	Drejtoria e Mbrojtjes dhe e Përfshirjes Sociale
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile
DPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike
DPTTV	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
DSKPT	Draft Strategjia Kombëtare për Turizmin
DSNM	Draft Strategjia Ndërsëktoriale e Mjedisit
DSZHBI	Draft Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve
DTTRR	Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor
EC	Emergenca Civile
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
FGE	Forumi Global I Ekonomisë
FSHAZH	Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit
GCAP	Green City Action Plan
ICT	Information and Communications Technology
IFBZ	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
IKG	Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale
IKMT	Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IMT	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ITU	Impianti i Trajtimit të Ujit
IZHGR	Indeksi Zhvillimit Global të Rinisë
JICA	Japan International Cooperation Agency
KBT	Këshilli Bashkiak Tiranë
KBUT	Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit
MM	Ministria e Mjedisit
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
NE	Ndihmë Ekonomike

NJA	Njësia Administrative
NJAR	Njësia Administrative Rurale
NJAU	Njësia Administrative Urbane
NJQV	Njësia e Qeverisjes Vendore
NJVV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
PAK	Persona me aftësi të kufizuar
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PBUKT	Plani i Biznesit Ujësjetllës Kanalizime Tiranë
PDV	Plani Detajuar Vendor
PINS	Plani i Integruar Ndër Sektorial “Durana”
PIABTSF	Përmirësimi i Infrastrukturave Arsimore në Bashkinë Tiranë- Studim Fizibiliteti
PKMM	Plani Kombëtar i Manaxhimit të Mbetjeve
PKR	Plani Kombëtar i Transportit
PKR	Plani Kombëtar për Rininë
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
PPP	Partneritet Publik Privat
PPV	Plani Përgjithshëm Vendor
PPVBT	Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë TR030
PSNB	Plani Sektorial në Nivel Bashkie
PVQGJ	Plani i Veprimt “Qyteti i Gjellbër”
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QKIPK	Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore
QKVF	Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike
QKVF	Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike
QLT	Qendra e Licensimit Tiranë
QMDFSH	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri
R&D	Research and Development
RAT	Reforma Administrative Territoriale
RSU1	Rezidenca Studentore Universitare 1
SAPU	Strategjia për Arsimin Parauniversitar
SHBB	Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor
SKM	Strategjia Kombëtare e Mbetjeve
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SMS	Strategjia e Mbrojtjes Sociale
SNDQV	Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe qeverisjen vendore
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike
SNZHRB	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
SNRFDP	Strategjia Ndërsektoriale Reforma në Fushën e të Drejtave të Pronësisë
SPVSHSHSQT	Strategjia dhe Plani i Veprimt për Shpërndarjen e Shërbimeve Sociale në Qytetin e Tiranës
SSS	Strategjia e Strehimit Social
SST	Strategjia Sektoriale e Transportit
Sha “TS Nr2”	Sha “Trajtimi i Studentëve Nr 2”
Sha “TS Nr3”	Sha “Trajtimi i Studentëve Nr 3”
SZHQBT	Strategjia e Zhvillimit të Qendrushëm të Bashkisë Tiranë
TEDA	Technological and Economic Development Area
TIA	Tirana International Airport
UK	Ujësjetllës Kanalizime
UKT	Ujësjetllës Kanalizime Tiranë
UNDP	United Nations Development Programme
UNICEF	United Nations International Children's Emergency Fund
UPNA	Uzina Përpunimit së Ndërtimit Automjeteve (Ish- uzina Autotraktorëve- Shkozë)
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VLT	Vizioni për Lëvizshmërinë në Tiranë
ë TO	ë orld Tourism Organization
ZIT	Zyra e Informacionit Turistik
ZQB	Zona Qendrore e Biznesit
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ZTZHE	Zona Të Zhvillimit Teknologjik Ekonomik
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Anekse

Aneksi 1

Raport mbi Sondazhin për Strategjine e Zhvillimit të Qendrushëm të Bashkisë 2018 – 2022 dhe Projekt Buxhetin 2019



FJALA E Z. ERION VELIAJ KRYETARI I BASHKISË TIRANË

Tirana është një qytet europian unik dhe me potenciale të jashtëzakonshme që befason me dinamizmin dhe vrullin e jetës së përditshme. Tirana është një metropol që po përjeton një transformim modernizues, dhe që është rikonceptualizuar nga aspekti urban si një qytet për të gjithë qytetarët. Tirana është e hapur dhe mirëpret të gjithë shqiptarët në rrethe dhe rajon, por edhe turistat dhe rezidentët e huaj.

Ndryshimi është bazuar në strategji të qarta si Plani i Pergjithshëm Vendore 2030 (Tirana 2030) që parashikon një qytet policentrik rrethuar nga Pylli Orbital i dy milion pemëve. Një qytet me zona për këmbësorë, kënde lojrash për fëmijët, dhe shërbime brenda një rrethi 500 metra. Apo si Plani i Veprimit për një Tiranë të Gjelbërt (GCAP), mbështetur nga BERZH, që adreson problemet kryesore mjedisore që qyteti ynë përballlet çdo ditë për shkak të trashëgimisë të zhvillimit urban kaotik nga vitet 90-të.

GCAP parashikon edhe lëvizshmërinë e qëndrueshme, si korsi biçikletash, Mobike, taxi dhe autobuza elektrik, etj. Strategji dhe politika të tilla ndihmojnë me lehtësimin e trafikut dhe e bëjnë transportin publik më tërheqës për qytetarët por edhe më të arritshëm dhe efektiv. Vetëm kështu mund të luftohet ndotja e ajrit që në Tiranë shkaktohet kryesisht nga makinat private.

Sot, Tirana është kryeqyteti i ngjyrave, i rinisë, i arsmi, i kulturës dhe i artit, i turizmit dhe kryeqendra ekonomike e Shqipërisë. Nëqoftëse punojmë përditë sëbashku dhe me vizion, nesër Tirana do të kthehet në kryeqendër europiane të rinisë, të kulturës, të inovacionit, të gjelbërimit, dhe të prodhimit të teknologjisë së lartë.

Po ndërtojmë një qytet që ofron mundësi shkollimi, punësimi dhe biznesi për të gjithë qytetarët. Një qytet i aksesueshëm nga të gjithë dhe që mendon për familjet, gratë, fëmijët, rininë e të moshuarit, dhe të pastrehët. Ky është vizioni ynë i cili kërkon shumë punë dhe investime, por kryesorja është të na mos mungojë të gjithëve optimizmi dhe aktivizmi për një qytet më të mirë.

Me këtë dokument po e kthejmë vizionin në Strategjinë afat mesme të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022 (SZHQBT), që është instrumenti më i lartë i planifikimit strategjik në nivel vendor. Zhvillimi i qëndrueshëm është projektuar si një qasje e sistemit aktual vendor drejt rritjes dhe zhvillimit urban dhe rural, duke siguruar një menaxhim të suksesshëm të kapitalit natyror, njerëzor dhe social për rritjen e mirëqënjes së qytetarëve.

Deri në vitin 2022 Tirana do të jetë integruar mirë në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Europian, do të jetë transformuar në një nyje intermodale konkurruese në hapësirën rajonale. Do të kemi rigjeneruar shumicën e zonave urbane bashkë me institucionet arsimore, dhe do të kemi investuar në transport publik. Do të arrihet një rritje e qëndrueshme ekonomike duke u bazuar tek turizmi, rinia, kultura, inovacioni dhe prodhimi.

Përmbledhje Ekzekutive

Bashkia Tiranë në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Kreu VI, neni 15 ka ndërmarrë nismën për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022 (SZHQBT) që është instrumenti më i lartë i planifikimit strategjik në nivel vendor. BT nëpërmjet kësaj strategjie synon të sigurojë një zhvillim të qendrueshëm, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit. Zhvillimi i qendrueshëm nga këndvështrimi i këtij dokumenti është projektuar si një qasje e sistemit aktual vendor drejt rritjes dhe zhvillimit urban dhe rural, duke siguruar një manaxhim të suksesshëm të kapitalit natyror, njerëzor dhe social për rritjen e mirëqënies së qytetarëve dhe gjeneratave të ardhshme.

Vizioni ynë për pesë vitet e ardhshme projekton Tiranën si një qendër të integruar më së miri në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Europian, një nyjë intermodale më konkurruese në hapësirën Ballkanike që synon barazi në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Konsolidimi dhe rigjenerimi urban, rritja e aksesit në arsim, i shoqëruar me një sistem të balancuar të shpërndarjes së transportit publik, me një përdorim më të zgjuar të ekosistemit urban dhe rural për të zhvilluar një ekonomi të gjelbër të qendrueshme do të jenë prioritetet e ardhshme të angazhimeve të BT-së.

Pesë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet SZHQBT janë pjesë integrale e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë 2015 – 2030 dhe në koordinim të plotë me të gjithë dokumentat strategjike në nivel qendror dhe vendor. Në evindentimin e këtyre shtyllave rol të rëndësishëm patën analiza e situatës aktuale dhe analiza Së OT e të gjithë fushave që janë kompetencë e BT-së. Potencialet dhe problematikat e evidentuara janë ndërthurur dhe kombinuar duke formuluar këto prioritetet:

Rivitalizim urban që harmonizon infrastrukturën, shërbimet publike dhe nxit zhvillimin ekonomik (Tirana Policentrike). Organizimi i Tiranës në disa qendra kryesore dhe dytësore do të ndihmojë procesin e dendësimit me anë të përdorimit të zgjuar të tokës dhe shpërndarjes së funksioneve të ndryshme. Ky prioritet ka në qendër krijimin e 5 epiqendrave urbane për kapërximin e dyzimit qendër-periferi dhe për të nxitur zhvillimin e balancuar të qytetit. Kinostudio, Kombinati, Farkë-Qytet Studenti, Bulevardi i Ri dhe Lapraka janë polet e parashikuara për t’u zhvilluar nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të Planeve të Detajuara Vendore që do të sigurojnë rivitalizimin dhe forcimin e identiteteve sipas karakterit të çdo poli. Përbushja e këtij objektivit do të sjellë një rikonceptim të strukturës urbane të qytetit, shtimin me pesë zonave atraktive të reja për qytetarët dhe vizitorët e huaj dhe një rritje me rreth 20% të investimeve në këto pole të reja.

Arsimi për të gjithë. Projektimi i rrjetit të hapësirave arsimore dhe rekreative është prioriteti i dytë i kësaj strategjie. Përmiresimi i kushteve dhe cilësisë së procesit arsimor është baza për një dialog mes arsimit dhe investimit të suksesshëm në brezat ardhshëm. Nëpërmjet investimeve në infrastrukturën e re dhe ekzistuese arsimore me qëllim përmirësimin e kushteve mësimorë BT synon të hedhë themelet për përbushjen e vizionit afatgjatë të edukimit të qytetarëve më të vegjël të Tiranës si investimi më i mirë për të ardhmen e vendit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe ndërhyrjeve në infrastrukturën e konvikteve, duke ofruar standarde dhe komoditetet gjatë qëndrimit të studentëve në to. Gjithashtu nëpërmjet aksesit universal në arsim për të gjitha shtresat dhe shfrytëzimit të ambienteve të shkollave si qendra komunitare synohet promovimi i vlerave familjare e qytetare duke krijuar një komuniteti më të konsoliduar dhe bashkëpunues.

Garanatimi i zhvillimit të qendrueshëm të ekonomisë. Ky prioritet projekton modele të qendrueshme në tre aspektet/kolonat e veprimtarisë njerëzore: ekonomike, sociale dhe ekologjike. Gjetja e një ekuilibri koherent dhe një harmonie afatgjatë në mes të këtyre tre kolonave do të jetë sfida e 5-vjeçarit të ardhshëm për BT. Duke qenë se zhvillimi i qendrueshëm i ekonomisë është një proces transformimi në të cilin shfrytëzimi i burimeve natyrore, përzgjedhja e investimeve, orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale realizohen duke garantuar qendrueshmëri në të ardhmen, duhet që këto aspekte të merren në konsideratë në përcaktimin dhe zbatimin e politikave duke përfshirë domosdoshmërisht pjesëmarrjen e vazhdueshme të të gjitha palëve të interesuara si formë e suksesshme e demokracisë pjesëmarrëse.

Tirana për të gjithë, qytet i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës, propozon një qytet ku të gjitha pasuritë e tij janë të aksesueshme dhe të dobishme për të gjithë banorët e tij pavarësisht nga aftësi, gjendjes fizike, moshës, gjinisë, etj. Nxitja e mobilitetit alternativ dhe të qendrueshëm, rigjenerimi urban, transport publik me efikasitet të lartë, rritje e kapacitetit të parkimit dhe shtimi i hapësirave të gjelbra dhe kreative janë objektivat specifike që do të përmbushen për lehtësuar dhe siguruar lëvizshmërinë në qytet dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve. Në përmirësim të vazhdueshëm do të jetë cilësia e ofrimit të shërbimeve publike nga BT.

Qeverisja e Mirë. Autoritetet e qeverisjes vendore kanë në pozicionin të favorshëm për të ndërmarrë veprime të suksesshme në nivel vendor dhe rajonal. Decentralizimi dhe vetëqeverisja vendore janë elementë thelbësorë të reformës së administratës publike në shumë vende dhe për të përmirësuar shërbimet publike dy janë elementë duhet të zbatohen: transparenca dhe përgjegjshmëria. Në këtë strategji synohet përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarit dhe biznesit nëpërmjet prezantimit të teknologjive të reja dhe lehtësisht të aksesueshme, rritja e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në vendimmarrje. Fokus të rëndësishëm do të ketë mirëadministrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve.

1. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

1.1 QËLLIMI

Dinamikat qeverisëse në Shqipëri po orientohen gjithnjë e më shumë drejt hartimit dhe zbatimit të politikave në nivel vendor, kjo në vrazhdën e decentralizimit të pushtetit qendror dhe mbështetjes së autonomisë së Njësisë të Qeverisjes Vendore (NJQV) për përmbushjen e funksioneve të përcaktuara me ligj.

Qëllimi i kësaj strategjie është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm të gjithë sektorëve nën përgjegjësinë e BT-së. Si motori ekonomik i vendit¹, Bashkia Tiranë ka nevojë të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm sa më të balancuar socio-ekonomik, kulturor dhe territorial për të udhëhequr gjithë Shqipërinë në rrugën e saj të integritit Evropian. SZHQBT synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha projektet e BT në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa fusha prioritare.

1.2 METODOLOGJIA

Nisur nga problematika e mungesës së koordinimit eficient mes politikave vendore dhe atyre qendrore por gjithashtu dhe mungesës së koordinimit brenda aparatit të vetë Bashkisë, kjo strategji është bazuar në një metodologji sistematike, prioritizuese dhe gjithëpërfshirëse.

Fillimisht hartimi i strategjisë ka nisur nëpërmjet konsultimit me kuadrin ligjor i cili rregullon funksionet, detyrat kryesore të NJQV-ve, kryesisht me Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Paralelisht me kuadrin ligjor, strategjia është mbështetur gjithashtu në objektivat e politikave dhe planeve kombëtare,

¹Qarku Tiranë përbën rreth 40.4% të PBB-së së vendit në dy vitet e fundit të publikuara nga INSTAT 2016 dhe 2015 dhe rreth 37.0 % para vitit 2015

rajonale dhe vendore për të krijuar një kuadër zhvillimor më koherent dhe të qëndrueshëm dhe sa më pranë standarteve të Bashkimit Evropian (BE). Mes tyre mund të veçohen: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI), Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë (PPVBT), Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës (PINZETD) dhe Programi i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin e parë. Veç këtyre dokumenteve kyçe, janë konsultuar gjithashtu materiale të tjera zyrtare të tilla si vjetarët statistikorë, studime, raportet zyrtare, etj.

Pas konsultimit fillestar me kuadrin ligjor dhe strategjik dhe evidentimin e funksioneve, fushave dhe sektorëve kryesorë që trajton SZHQBT, me Urdhër të Kryetarit të BT-së (Nr. 5647/1, datë 20.02.2017) nisi puna për hartimin e strategjisë duke ngritur një rrjet bashkëpunimi ndërmjet strukturave të BT-së, përgjatë gjithë procesit.

Puna filloi me mbledhjen e të dhënave nga gjithë strukturat e Bashkisë dhe analizën e situatës aktuale. U evidentuan pikat e forta dhe të dobëta për çdo sektor, të cilat janë përmbledhur shkurtimisht në fund të çdo kapitulli në formën e analizave SWOT. Në bazë të gjetjeve të analizës janë nxjerrë dhe objektivat kryesore të strategjisë për 5-vjeçarin e ardhshëm, të zbërthyer në programe, projekte dhe aktivitete të detajuara së bashku me indikatorët përkatës, të cilët do të ndihmojnë në thjeshtimin, por dhe në rritjen e efikasitetit të procesit të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë.

Për sa i përket analizës financiare, ajo është bazuar në Programet Buxhetore Afatmesme (PBA) të BT-së 2011-2016 duke analizuar trendin e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kësaj periudhe. Kjo ka ndihmuar për të parashikuar trendin e 5-vjeçarit të ardhshëm duke u bazuar në programet aktuale dhe objektivat e vendosura nga strategjia.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe procesit të monitorimit dhe vlerësimit të SZHQBT-së si edhe strukturave përgjegjëse për këtë detyrë, në mënyrë që të kemi koordinim dhe fokusim në përmbushjen e objektivave strategjike.

Strategjia është konsultuar me të gjitha strukturat e BT-së lidhur me objektivat dhe projektet e parashikuara në këtë dokument dhe sugjerimet e tyre janë pasqyruar më pas në draftin final. Përveç strukturave brenda BT-së dhe në varësi të saj drafti final u dërgua për konsultim tek Prefektura, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, pranë Ministrisë së Brendshme, Qarku Tiranë i cili ka qenë pjesë e procesit të evidentimit të problemeve, etj. Disa prej tyre kanë dhënë sugjerime të cilat janë marrë parasysh në SZHQBT 2018 -2022.

Një konsultim i vlefshëm është realizuar edhe me qytetarët të cilët janë përfituesit dhe testuesit më të mirë të performancës së punës së BT-së.

Qëllimi i këtij sondazhi ishte të garantonte harmonizimin e kërkesave të qytetarëve për investime me objektivat e përcaktuara në SZHQBT 2018 -2020. Sondazhi u fokusua në *target grup*-in e qytetarëve, të cilët ishin pjesëmarrës në dëgjesa në 24 Njësi Administrative, në territorin e Bashkisë së Tiranës. Metoda e përzgjedhur konsistoi në vjeljen e opinionit qytetar në dëgjesat publike. Nga ky anketim, i kryer për një periudhë 24-ditore (kohë kalendarike), u arrit një përfitim kampioni total prej 1858 të intervistuar. Mbledhja e të dhënave u realizua nëpërmjet metodave të intervistimit të drejtpërdrejtë (face to face) me individët që u bënë pjesëmarrjes në dëgjesa publike, duke plotësuar pyetësorin përkatës. Intervistat u kryen sipas një pyetësori të strukturuar me 2 pyetje të përziera, ku pyetja e parë kishte 5 pika secila me 5 alternativa dhe pyetja e dytë me 18 alternativa si edhe pyetje e hapur, ku qytetarit i ofrohej hapësira e nevojshme për të shprehur mendimin e tij të lirë rreth projektbuxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018. Zgjedhja e më shumë se një alternative nënkupton se qytetari mund të zgjidhte më tepër se një cilësor përcaktues. Analiza e të dhënave për secilën NJA u krye përmes përlllogaritjes së shumës së çdo cilësori të secilit zë/njësi në raport me totalin e intervistave e të gjithë qytetarëve. Lidhur me nevojat për investime nga Bashkia në çdo NJA rezultoi se nevojat më të mëdha ishin në fushat:

Nevojat për Investime

NJA URBANE	NJA RURALE
Infrastrukturë Rrugore (73%)	Infrastrukturë Rrugore (92%)
Ujësjiellës(64%)	Ujësjiellës (92%)
Gjelbërim (64%)	Kanalizime (85%)
Pastrim (54%)	Transport Publik (69%)
Parkim (36%)	Punësim (54%)

Duke iu referuar tabelës së mësipërme vihet re që nevojat kryesore kanë karakter infrastrukturor dhe ndryshojnë nga këndvështrimi territorial. Kjo lidhet me karakterin zhvillimor që kanë këto NJA. Pavarësisht divergjencave këto nevoja përputhen plotësisht me problematikat e evidentuara nga Strategjia dhe konfirmojnë se objektivat për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm do të sjellin investime serioze në këto fusha, me projekte ambicioze dhe me impakt të fuqishëm në cilësinë e jetës së qytetarëve pavarësisht ndarjes territoriale.

Objektivat strategjike

Qytetarët kanë mundur të shprehin opinion e tyre e të përgjithshëm lidhur me objektivat strategjike të përcaktuara nga SZHQBT 2018 – 2020, vihet re se:

- ◆ **Arsimi për të gjithë** që përfshin plotësimin e nevojës për institucione arsimore si edhe lehtësimin e aksesit në arsim për të gjitha grupet e shoqërisë është objektivi më i pëlqyeshëm (79%) duke konfirmuar edhe një herë nevojën për arsim më cilësor për qytetarët e ardhshëm të Tiranës
- ◆ **Tirana Policentrike** që në thelb parashikon krijimin e një qyteti me disa qendra, me më shumë shërbime dhe lehtësi të ofruara aty ku janë qytetarët ka pasur një pëlqyeshmëri të madhe (78.7), që konfirmon objektivin që duhet përmbushur nga BT në vitet e ardhshme.
- ◆ **Qeverisja e Mirë** renditet e treta për nga pëlqyeshmëria (77%), por konfirmon faktin se qytetarët kanë besim të vazhdueshëm se Bashkia Tiranë do të përmbushë me sukses të gjitha detyrimet që ka ndaj tyre duke siguruar cilësi dhe gjithpërfshirje.
- ◆ **Tirana për të gjithë dhe Garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm** kanë të njëjtin nivel pëlqyeshmërie (75%), që na përforcon vendosmërinë për të përmbushur të gjitha projektet që parashikon Strategjia.

1.3 PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet të cilat kanë udhëhequr procesin e hartimit të SZHQBT-së, janë edhe parimet mbi të cilat BT synon të ndërtojë të ardhmen e kryeqytetit me qytetarët. Më konkretisht këto parime konsistojnë në:

Zhvillimi i qëndrueshëm: Ky parim ka udhëhequr gjithë procesin e hartimit të SZHQBT-së dhe udhëheq njëherazi gjithë strategjitë kryesore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare. Zhvillimi i qëndrueshëm

është përfshirë gjithmonë e më shumë në politikat ndërkombëtare: në “Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm”² të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në strategjitë e zgjerimit apo zhvillimit të BE-së, strategjitë rajonale apo kombëtare etj. Pra është e rëndësishme që shfrytëzimi i burimeve të bëhet në një mënyrë sa më të balancuar dhe nëpërmjet një planifikimi të integruar për të arritur zhvillim ekonomik dhe social që garanton qëndrueshmëri në kohë dhe jetëgjatësi.

Subsidiariteti: Strategjia është hartuar duke pasur parasysh që ushtrimi i përgjegjësive publike duhet në mënyrë të përgjithshme, t’iu takojë më tepër autoriteteve të cilat janë më pranë qytetarëve ku dhe impakti është më i madh.

Bashkërendimi: Kjo strategji ka synuar të koordinohet me kuadrin strategjik të zhvillimit të Shqipërisë, duke ndjekur objektivat dhe parimet thelbësore të zhvillimit të përcaktuara në dokumentat strategjike rajonale dhe kombëtare. Në të njëjtën mënyrë, SZHQBT është përpjekur të jetë në harmoni me interesat e biznesit dhe shoqërisë civile duke promovuar forma të ndryshme bashkëqeverisjeje apo bashkëpunimi për një zhvillim të qëndrueshëm.

Llogaridhënia dhe Transparenca: Qëllimet dhe objektivat strategjike, të përcaktuara në këtë strategji janë përkthyer në projekte dhe aktivitete specifike të matshme nëpërmjet treguesve të performancës, duke i bërë këto objektiva lehtësisht të matshme dhe monitorueshme.

Gjithëpërfshirja: Strategjia ka patur në fokus kryesor filozofinë e gjithëpërfshirjes sociale duke u përpjekur në trajtimin e problematikave kryesore të çdo grupi social, me një vëmendje të lartë ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Kjo nënkupton, krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e Tiranës duke i ndihmuar ata në arritjen e mirëqënies së përbashkët.

Fleksibiliteti: Duke marrë në konsideratë reformat e shumta që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë gjatë pesë viteve të fundit dhe ndryshimet thelbësore që kanë prekur funksionet dhe kompetencat e NJQV-ve, strategjia është hartuar në mënyrë të tillë që të lejojë hapësirat e nevojshme për t’iu përshtatur kontekstit politik ende në ndryshim e sipër. Kjo do të thotë se objektivat strategjike dhe projektet janë hartuar duke marrë parasysh disa skenarë zhvillimi për të arritur përbushjen më optimale të tyre përgjatë kësaj periudhe tranzicioni.

2. TIRANA NË KONTEKSTIN KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

2.1 BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT DHE PLANET KOMBËTARE

Vizioni ynë për pesë vitet e ardhshme kërkon kthimin e Tiranës në një qëndër të integruar më së miri në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Evropian, në një njëj intermodale më konkurruese në hapësirën Ballkanike që synon barazi në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Konsolidimi dhe rigjenerimi urban, rritja e aksesit në arsim, i shoqëruar me një sistem të balancuar të shpërndarjes së transportit publik, me një përdorim më të zgjuar të ekosistemit urban dhe rural për të zhvilluar një ekonomi të gjelbër të qëndrueshme do të jenë prioritetet e ardhshme të punës së BT-së. Në mënyrë që të realizohet ky vizion afat-mesëm, është parësore që të bashkërendohet me planet kombëtare afat-mesme dhe afat-gjata dhe të ketë koordinim më efikas me qeverinë qendrore dhe brenda vetë aparatit të BT.

Në raport me kontekstin kombëtar, SZHQBT orientohet kryesisht nga SKZHI, që është edhe dokumenti fillestar që ka orientuar gjithë strategjitë dhe planet kombëtare të zhvillimit pas vitit 2014, vit në të cilin Shqipëria mori zyrtarisht edhe statusin e vendit kandidat për në BE. Fokusi kryesor i të gjitha këtyre strategjive ka qenë përgatitja e Shqipërisë si në nivel administrativ kombëtar dhe vendor ashtu edhe në nivel sektorial për të qenë pjesë e komunitetit Evropian.

²Sustainable Development Goals

Figura Nr 1: Hierarkia e Objektivave të “SKZHI-së 2014-2020”



Megjithatë, për të patur një zhvillim sa më harmonik, efektiv dhe të qëndrueshëm në kohë, kjo strategji është përpjekur të qëndrojë në një linjë jo vetëm me objektivat e përgjithshme të SKZHI-së por gjithashtu me objektivat më specifike të planeve sektoriale. Bashkërendimi i politikave vendore me ato qendrore është një ndër kushtet thelbësore për t'u plotësuar nga institucionet vendore gjatë hartimit të dokumentave strategjike. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet zhvillimi i qëndrueshëm i Shqipërisë.

Përveç kësaj, raportet e institucioneve të BE-së mbi progresin e Shqipërisë drejt integritit, evidentojnë në mënyrë konstante mungesën e theksuar të koordinimit mes administratës publike mbi zbatimin e integruar të politikave dhe planeve strategjike kombëtare me ato vendore. Mungesa e një linje të zbatimit të politikave nga lartë – poshtë dhe mospërputhja e objektivave të qeverisë me ato të bashkive krijojnë një politikë të fragmentarizuar e cila vonon në përmbushjen e objektivave madhore të të gjithë vendit.

Për këtë arsye, SZHQBT është hartuar nëpërmjet një konsultimi të gjerë dhe paralel me dokumentet strategjike të qeverisë për të siguruar që Tirana si kryeqyteti i Shqipërisë udhëheq rrugën drejt një bashkë-qeverisjeje më të mire-koordinuar dhe efektive për zhvillim.

Matrica e mëposhtme pasqyron vizualisht dhe në mënyrë të përmbledhur pikë takimet e objektivave specifike të Bashkisë së Tiranës me ato të planeve e strategjive kombëtare, vendore e sektoriale.

DOKUMENTET STRATEGJIKE KOMBËTARE DHE VENDORE	OBJEKTIVAT STRATEGJIKE																	
	TIRANA POLICENTRIKE	ARSIM PËR TË GJITHË		GARANTIMI I ZHVILLIMIT TË QENDURSHËM TË EKONOMISË			TIRANA PËR TË GJITHË									QEVERISJA E MIRË		
	Krijimi i 5 epiqendrave urbane për kapërcimin e dyzimit qendër - periferi dhe për të nxitur zhvillimin e balancuar të qytetit	Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor	Rritja e aksesit dhe gjithëpërfshirjes në Arsimin Parauniversitar	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset	Mbështetja financiare dhe incencivat fiskale për bizneset	Rritja e konkurrencës dhe thithja e investimeve të huaja	Nxitja e çiklizmit për udhëtime nën 5 km	Rritja e Kapacitetit të Parkimit	Shtimi i hapësirave të gjelbra	Transport publik me efience të lartë mbi 5 km	Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve	Sistem i përmësuar të mbetjeve në BT	Furnizimi i qytetit me ujë të pijshëm	Rritja e cilësisë së shërbimit të varëzave publike	Sigurimi i një qeverisjeje transparente dhe llogaridhënies	Forcimi i financave vendore	Rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në BT	
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZH) 2015-2020																		
Strategjia Ndërkombëtare për Decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020																		
Strategjia Ndërkombëtare e Reformës në Administratën Publike 2015-2020																		
Strategjia Ndërkombëtare për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020																		
Strategjia Sektoriale e Transportit 2016 – 2020																		
Strategjia Kombëtare e Mbetjeve (2010-2025)																		
Draft Strategjia Ndërkombëtare e Mjedisit 2015 - 2020																		
Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2014-2020																		
Përmirësimi i Infrastrukturave Arsimore në Bashkinë Tiranë - Studim Fizibiliteti 2016																		
"Plani i biznesit 2017 - 2021" Ujësjetës-Kanalizim Tiranë																		
Vizioni për Lëvizshmërinë në Tiranë 2030																		
Strategjia Ndërkombëtare Reforma në Fushën e të Drejtave të Pronësisë 2012- 2020																		
Draft Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2013 - 2020																		
Strategji dhe Plani i veprimit për Shpërndarjen e Shërbimeve Sociale në Qytetin e Tiranës																		
Strategjia e Strehimit Social 2016-2025																		
Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020																		
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020																		
Draft Strategjia Kombëtare për Turizmin 2014 - 2020																		
Plani i Përgjithshëm Vendor Tiranë 2030																		
Plani i Përgjithshëm Kombëtar Shqipëria 2030																		
Plani i Integruar Ndërkombëtar "Durana"																		
Plani Kombëtar për Rininë 2015-2020																		
Plani i Veprimit "Qyteti i Gjelbër" për Bashkinë Tiranë																		

2.2 KONKURUESHMËRIA DHE INDIKATORËT E SAJ

Qeveria qendrore është drejtuesi kryesor i politikave të zhvillimit dhe konkurrencës, por në vitet e fundit rëndësia e politikave të zhvillimit në nivel vendor është rritur ndjeshëm. Për të matur konkurueshmërinë e qyteteve në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, i referohemi një skeme indikatorësh/faktorësh të hartuar nga Forumi Global i Ekonomisë (FGE) dhe të publikuar periodikisht në “Indeksin e Konkurrueshmërisë Globale” (IKG). IKG përcakton se konkurueshmëria është bashkësia e institucioneve, politikave dhe faktorëve të tjerë që tregojnë nivelin e produktivitetit të një ekonomie, e cila për rrjedhojë mat nivelin e prosperitetit që një vend ka kapacitet të arrijë. Indikatorët që merren në konsideratë sipas IKG-së mund të klasifikohen në katër grupime në bazë të tematikave që trajtojnë (i) burimet njerëzore dhe cilësia e jetës; (ii) mundësitë tregtare dhe potenciali prodhues; (iii) lëvizshmëria; dhe (iv) inovacioni dhe markat. Raporti i IKG-së 2017-2018 merr në konsideratë 137 vende të ndryshme dhe i rendit ato në rend kronologjik (nga vendi që konsiderohet më i favorshëm për sa i përket indikatorit në fjalë tek vendi më pak i favorshëm). Në kontekstin e kësaj strategjie, Shqipëria ka lënë mbrapa të gjitha vendet e rajonit përveç Kroacisë duke zënë vendin e 75-të në këtë raport nga vendi i 80-të që zinte në raportin e 2016-2017. Krahasimi do të bëhet me vendet e rajonit si Greqia (Vendi 87), Maqedonia³, Mali i Zi (Vendi 77), Bosnja dhe Hercegovina (vendi 103), Serbia (Vendi 78) dhe Kroacia (vendi 74).

2.2.1 Burimet njerëzore dhe cilësia e jetës

Një nga faktorët më të rëndësishëm që e bën një qytet konkurues në tregun kombëtar por dhe atë ndërkombëtar është forca punëtore e kualifikuar. Në rang kombëtar Tirana, si kryeqytet i vendit dhe motori i ekonomisë kombëtare, por edhe për shkak të përqendrimit të institucioneve qeveritare ka tërhequr drejt saj forcat e punës më të kualifikuara të Shqipërisë. Tirana akomodon shumicën dërrmuese të universiteteve dhe rreth 75% të të gjithë studentëve të vendit. Për nga niveli i universiteteve dhe trajnimeve, sipas IKG-së, Shqipëria radhitet në vendin e 49-të, vetëm pesë vende pas Greqisë. Greqia (Vendi 44), Mali i Zi (Vendi 61), Bosnja dhe Hercegovina (vendi 91), Serbia (Vendi 59) dhe Kroacia (vendi 60).

Ky indeks, vlerëson edhe efikasitetin e forcave të punës në Shqipëri. Kjo e fundit është tepër e rëndësishme për t'u siguruar që punonjësit janë alokuar në pozicionin më të përshtatshëm për ta, në bazë të kualifikimit, dhe duhet t'ju sigurohen incentiva për të arritur produktivitet maksimal. Shqipëria radhitet në vendin e 91-të në këtë kategori, e renditur mbas Malit të Zi, por para të gjithë vendeve të tjera të rajonit, përfshi këtu edhe Greqinë, e cila radhitet e 110-ta për arsye edhe të krizave financiare të viteve të fundit. Megjithatë Ballkani ende përballet me sfidën për të thithur kapitalin njerëzor me aftësi të zhvilluara sektoriale dhe nivel të lartë specializimi që i përgjigjen nevojave të tregut.

Cilësia e jetës është një tjetër aspekt i rëndësishëm i një qyteti konkurues. Këtu përfshihen: cilësia e rrjetit të komunikimit dhe rrjetit elektrik, cilësia e ajrit, shëndetësia dhe cilësia e arsimit të detyrueshëm.

Lidhur me rrjetin elektrik Tirana dhe gjithë Shqipëria furnizohet kryesisht nga burime elektrike ujore (rrjet hidroenergjistik). Megjithatë rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike por edhe ai kultivues është pjesërisht i amortizuar dhe ka nevojë për investime. Ndërsa lidhur me komponentët e tjerë Tirana radhitet në vend të parafundit për cilësinë e ajrit vetëm para Shkupit në krahasim me kryeqytetet e tjera të rajonit por edhe në krahasim me të gjithë kryeqytetet e Evropës, ndërsa Shqipëria renditet në vend të 36 nga 137 vende për sa i përket shëndetësisë dhe cilësisë së arsimit të detyrueshëm, duke lënë mbrapa gjithë

³Maqedonia është përfshuar nga raporti 2017-2018 për mungesë të dhënash

vendet e rajonit. Renditja e vendeve të rajonit në këtë tregues është: Greqia (Vendi 48), Mali i Zi (Vendi 62), Bosnja dhe Hercegovina (vendi 56), Serbia (Vendi 52) dhe Kroacia (vendi 44).

2.2.2 Mundësitë tregtare dhe potenciali prodhues

Ky indikator analizon klimën e biznesit dhe ekonomisë në qytet duke marrë në konsideratë faktorë si: lehtësia e hyrjes në treg, zhvillimi i tregut financiar, eficienta e tregut të mirave, si dhe terreni makroekonomik.

Lehtësia e hyrjes në treg, tregon sa e lehtë është për një kompani të pajiset me lejet dhe licencat që i nevojiten për të nisur aktivitetin si dhe mundësitë që ajo kompani ka për të aksesuar klientët dhe konsumatorët e produktit/shërbimit që ato tregtojnë. “Qendra Kombëtare e Biznesit” (QKB) tashmë ka lehtësuar procedurat e regjistrimit (1 ditë) duke ofruar ndër të tjera aplikimin online, ndërkohë që procedura e plotë për marrjen e lejeve dhe licencave përkatëse, një kohëzgjatje të shkurtuar të procedurës (mesatarisht 41 ditë) me kosto 100 lekë. Raporti “Doing Business 2017” i Bankës Botërore rendit shtetet për nga lehtësia e të bërit biznes dhe hyrjes në treg. Kjo e fundit konsideron si faktor numrin e procedurave që duhen ndjekur, kohëzgjatja e regjistrimit, kostot e regjistrimit dhe kapitali minimal. Tabela e mëposhtme përcakton renditjen e vendeve të rajonit për 2017:

Tabela Nr 1: Renditja e vendeve sipas lehtësisë së të bërit biznes

	Lehtësia e hyrjes ne treg	Lehtësia e të bërit biznes
Maqedonia	4	10
Kosova	13	60
Shqipëria	46	58
Serbia	47	47
Mal i Zi	58	51
Kroacia	95	43

Burimi: Doing Bussiness 2017

Zhvillimi i tregut financiar është një komponent i rëndësishëm në sistemin ekonomik, që tregon eficienten e tregut dhe besimin tek qëndrueshmëria e tregut. Zhvillimi i tregut është motori që drejton ekonominë e një vendi. Qëllimi i zhvillimit të tij është rritja e aftësisë së tregut financiar për të vepruar me efikasitet si një ndërmjetës për të lidhur ofertën dhe kërkesën. Shqipëria nuk ka ende një treg financiar (bursë) të mirëfilltë megjithatë vihet re një rritje e këtij treguesi ku si rrjedhojë dhe IKG-ja e ka rradhitur të 81-tën nga 118-tën në raportin e mëparshëm.

Indikator tjetër që analizohet është ai i eficientës së prodhimit të të mirave materiale dhe industrive prodhuese në përgjithësi. Në këtë kategori Shqipëria radhitet në vendin e 60 nga 137 vende të marra në konsideratë. Shqipëria⁴ numëron 162,452 ndërmarrje aktive në të gjithë Shqipërinë, ndërsa në Bashkinë e Tiranës janë 46,948 ndërmarrje aktive. Megjithëse shumica e tyre operojnë në fushën e shërbimeve, vlen të theksohet se prodhimi i të mirave është një sektor me një zhvillim të qëndrueshëm.

⁴Regjistri i Ndërmarrjeve INSTAT viti 2017

Terreni makroekonomik merr në konsideratë bilancin e buxhetit të qeverisë (në vendin e 43-të), inflacionin (në vendin e 1-rë), borxhin (në vendin e 103) si dhe kursimet (në vendin e 101-të). Lidhur me këtë indikator, Shqipëria renditet në vendin e 75-të për terrenin makroekonomik nga vendi 118-të që renditej në raportin paraardhës, duke lënë mbrapa gjithë vendet e sipër përmendur përveç Kroacisë.

2.2.3 Transporti

Tirana është në një pozicion gjeografik mjaft të favorshëm si në kontekstin rajonal ashtu dhe në atë kombëtar. Gjithashtu është një nyje e fortë komunikacioni, e lidhur me skajet më të largëta të vendit, dhe me shtetet fqinje. Nga ky rajon nisen e mbërrijnë disa nga arteriet me të rëndësishme automobilistike, hekurudhore si dhe vija ajrore ndërkombëtare.

IKG për vitin 2017-2018 e rendit Shqipërinë në vend të 60 nga 137 vende për konkurrueshmërinë në fushën e infrastrukturës rrugore, ndërkohë që Kroacia renditet në vend të 37, Greqia në vend të 53, Mali i Zi në vend të 87, Bosnja dhe Hercegovina në vend të 98, dhe Serbia në vend të 96. Kjo renditje është një përmirësim me 23 vende në krahasim me renditje e raportit të parafundit. Ky është një tregues i qartë se edhe pse Shqipëria është në një pozicion të favorshëm dhe konkurses kundrejt vendeve të rajonit, është ende larg standardit të BE-së dhe Kroacisë e cila ishte antarësimi i fundit. Ndikim në këtë renditje të vendit e jep edhe infrastruktura hekurudhore ku Shqipëria renditet e 101-ta.

2.2.4 Inovacioni dhe markat

Lidhur me inovacionin dhe sofistikimin e teknikave të të bërit biznes, Shqipëria renditet e 76-ta, para Serbisë (104), Bosnja dhe Hercegovina (119), Malit të Zi (92), Kroacisë (99) dhe pas Greqisë (71). Shqipëria ka një pozicionim më të mirë lidhur me sofistikimin e teknikave (vendi 74) dhe më pak lidhur me inovacionin (vendi 87).

Inovacioni merr në konsideratë aftësinë për të sjellë risi, performancën e institucioneve që bëjnë kërkime shkencore, fondet që kompanitë vendase shpenzojnë në Kërkim dhe Zhvillim (R&D), bashkëpunimet me universitetet dhe industrinë, numrin e shkencëtarëve dhe inxhinierëve si dhe numrin e aplikimeve për patenta, marka etj.

Me qëllim nxitjen e mëtejshme të inovacionit tek brezi i ri, BT në bashkëpunim të ngushtë me Fondin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit (AADF) do të shëndërrojë Piramidën e Tiranës në një prej qendrave më të mëdha rinore dhe edukative në Ballkan për Teknologjitë Kreative. Rikonceptimi i Piramidës do ndjekë modelin e qendrës inovative “TUMO” në Jerevan të Armenisë që konsiderohet një model i ri edukativ dhe inovativ për sa i përket kryqëzimit të teknologjisë dhe dizajnit.

Hapësira e re do të shërbejë për shkëmbim idesh e iniciativash, por edhe si një inkubator për bizneset e reja në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duke ushqyer kulturën digjitale dhe inovatore të të rinjve shqiptarë dhe duke rritur ndjeshëm konkurrueshmërinë e Tiranës dhe vendit në arenën ndërkombëtare.

2.2.5 Integrimi në Bashkimin Europian

Në Qershor të vitit 2014, Shqipëria mori statusin e vendit kandidat për t'u integruar në BE dhe në këtë mënyrë u afrua dhe një hap më pranë anëtarësimit me të drejta të plota në këtë organizatë. Megjithatë, në Raportet e Progresit përvitshme të Komisionit Europian parashtrihen pesë prioritete në të cilat Shqipëria duhet të përparojë në mënyrë që të fillojë procesi i hapjes së negociatave. Raporti të KE-së për vitin 2018 evidenton një sërë hapash pozitivë që janë bërë në kuadër të përmbushjes së këtyre prioriteteve dhe njëkohësisht jep rekomandime për vazhdimësinë e tyre. Edhe pse procesi i avancimit lidhur me përmbushjen e prioriteteve është detyrë e qeverisë qendrore, nuk përjashtohet kontributi i Tiranës si epiqendra dhe drejtuesja e të gjithë zhvillimit dhe progresit social në Shqipëri, prej detyrave të veta sidomos në aspektin e kriterit të parë dhe të pestë për zbatimin e reformës në administratën publike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kontributi i BT-së në këtë proces lidhet me Prioritetin 1 dhe Prioritetin 5 të cilat trajtohen më poshtë në detaj:

Prioriteti 1: Zbatimi i reformës në administratën publike. Reforma në administratën publike⁵ ka qenë në vijimësi ndër prioritetet e qeverive shqiptare. Detyrimi për të krijuar një administratë publike me nëpunës që zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit, që nëpunësit duhet të punësohen nëpërmjet procesit të konkurimit dhe që gëzojnë garanci të qëndrimit në detyrë, është detyrim Kushtetues (Neni. 107 i Kushtetutës) në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2015-2020, ka vijuar zbatimi i reformave të cilat synojnë konsolidimin e funksionimit të një rrjeti efikas institucional, si dhe të një administrate të qëndrueshme e profesionale, të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit. Raporti i KE-së për Shqipërinë (2018) evidenton progresin në lidhje me riorganizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, sidomos me miratimin e ligjit për financat vendore në Prill 2017. KE gjithashtu shprehet pozitivisht në lidhje me mirëfunksionimin e Këshillit Konsultativ, i cili u krijua në Dhjetor 2016 me qëllim kryesor koordinimin institucional midis qeverive qendrore dhe vendore.

a) Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit

BT ofron 163 shërbime të ndryshme ndaj qytetareve dhe bizneseve, ndër të cilat 130 ofrohen vetëm nga zyra me një ndalesë 'one stop shop'. Në këtë kuadër ajo ka ndërmarrë disa masa për përmirësimin e këtyre shërbimeve. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për publikun nëpërmjet thjeshtimit të procedurave për ofrimin e këtyre shërbimeve, duke e bërë shërbimin më të aksesueshëm për qytetarin. Janë krijuar sportele unike për ofrimin e shërbimeve si dhe është rritur numri i punonjësve në këto sportele. Eshtë zgjeruar përdorimi i teknologjisë për rritjen e shpejtësisë dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit, ruajtjen e të dhënave dhe sigurimin e transparencës. Megjithatë ka ende problematika në raport me informimin e saktë të qytetarëve për marrjen e këtyre shërbimeve (informimi për vendodhjen, dokumentacionin përkatës që duhet dorëzuar, afatet, etj). Në këtë kuadër BT do zbatojë dy projekte :

One Stop Shop për qytetarët, pra qendra me një ndalesë që përveç rritjes së numrit të nëpunësve që do të jenë në shërbim të qytetarëve do të vendosë në funksion një sistemi të ri elektronik për përpunimin dhe qarkullimin e dokumentacionit, si dhe përditësimin, unifikimin dhe standartizimin e formularëve të shërbimeve bashkiake

Dixhitalizimi i arkivit të BT-së. Ky projekt ka për qëllim dixhitalizimin e arkivave si dhe sistemin e dokumentacionit dhe protokollimin në mënyrë elektronike duke rritur cilësinë e shërbimeve dhe eficientë të punës së administratës së BT-së.

b) Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike

Në këtë kuadër vitet e fundit në BT janë bërë këto përparime:

⁵Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2013-2020

- Forcimi i zbatimit të legjislacionit nëpërmjet rregullimit të procedurës së ri-sistemimit të nëpunësve civilë pas ndryshimit të strukturës dhe organikës së institucionit (VKM 474, datë 16.6.2011) dhe mbajtjes në kufij të kontrolluar të numrit të punësimeve me kontratë të përkohshme në shërbimin civil, duke disiplinuar procedurën e kontratave dhe kushtëzuar marrjet në punë me miratime paraprake të kontrolluara. Për vitin 2017, Bashkia Tiranë ka publikuar gjithsej 158 vende të lira pune, duke përfshirë dhe pozicionet në NJA-të, për të cilat janë zhvilluar gjithsej 87 konkurse.
- Krijimi i një sistemi më të fortë karriere në administratën publike dhe unifikimi i procedurave të manaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet hartimit të letrës së politikave dhe më pas ligjit të ri për nëpunësin civil, Ligjit nr 152/2013.
- Rritja e performancës së aparatit të BT-së
- Është mirëstrukturuar dhe rritur numri i trajnimeve të ofruar për punonjësit në vitin 2016-2017. (përgjatë 2016-2017 janë trajnuar gjithsej 1978 nëpunës).
- Reformimi i sistemit të pagave në administratën publike me qëllim konsolidimin e sistemit motivues të punësimit.

Megjithatë mbetet ende për t'u përmirësuar procesi i planifikimit strategjik koordinimit eficient të investimeve, shmangia e mbivendosjes së kompetencave dhe funksioneve, si dhe përmirësimi i dialogut dhe koordinimit sektorial mes qeverive vendore dhe qeverisë qendrore, bazuar në rekomandimet e raportit të fundit të KE-së.

Prioriteti 5: Mbrojtja e të drejtave të njeriut

Regjistrimi civil. Sipas Censurit 2011 popullsia rome më e madhe është e vendosur në Qarkun e Tiranës me rreth 28.6% të romëve në nivel vendi ose 0.32 % të popullsisë së qarkut. Rreth 1.11 % e qarkut Tiranë përbëhet nga grupet etnike të tjera përveç Shqipëtarve. Për më tepër BT është ende në procesin e hartimit të programeve për të incentivizuar procesin e regjistrimit.

Arsimi. Në territorin BT për vitin shkollor 2016-2017⁶, janë të regjistruar në institucionet arsimore 1,144 fëmijë romë. Respektivisht, në çerdhe dhe në kopshte janë të regjistruar 265 fëmijë ndërsa në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme (të përgjithshme dhe profesionale) janë regjistruar 879 fëmijë. Shkalla e analfabetizmit sipas Censurit 2011, matur si raport i analfabetëve ndaj popullsisë së moshës 10 vjeç e lart gjithsej, për BT, rezultoi 1.6% nga 2.8% në nivel kombëtar. Në pjesën urbane të BT-ës ky tregues është edhe më ulët (1.4 %). Më problematike duket situata në NJA rurale ku NJA Ndroq ka % më të lartë prej 4.5%. Përveç kësaj, prej vitit 2015 e në vazhdim BT e ka kthyer përmirësimin e infrastrukturës arsimore parauniversitare në prioritetin kryesor me qëllim garantimin e barabartë të aksesit në arsim me kushte cilësore dhe sipas standarteve të për të gjithë qytetarët e vegjel nga të gjitha kategoritë e shtresat sociale. Gjithashtu, BT ka ndërhyrë në përmirësimin e infrastrukturës së gjithë çerdheve në territorin e BT-së, një pjesë të konsiderueshme të kopshteve e shkollave si në zonat urbane edhe në ato rurale dhe ngritjen e infrastrukturave të reja duke plotësuar kërkesën për arsim gjithmonë e në rritje.

Strehimi. Sipas Censurit 2011 në BT-ës rreth 84.22% e familjeve janë pronarë ose duke u bërë pronarë të banesave ky jetojnë. Kjo përqindje është e ulët krasuar me vendin ku ky tregues është rreth 90.22%. Në BT-ës, sipas Censurit 2011, jetojnë rreth 45.88 % e familjeve qeramarrëse në vend. Rreth 7.91% e familjeve të BT-ës nuk kanë pasur asnjë lloj ngrohjeje në banesat e tyre gjate 2011, rreth 0.3% nuk kanë tualet dhe rreth 1.5 % nuk kanë sistem të furnizimit me ujë. Përqindja e banesave boshe në BT-ës rezultoi 19.9%. Megjithatë ka një numër të madh familjesh rome të pastrehë. Sipas statistikave të BT-së janë rreth 267 familje rome dhe 50 familje egjiptiane.

⁶ Burimi: Bashkia Tiranë, *Opendata.tirana.al*

Punësimi. Për Qarkun e Tiranës situata është pak më optimiste. Sipas INSTAT, shkalla e papunësisë për vitin 2017 në qarkun e Tiranës rezultoi 16.7% nga 19.7% që ishte në 2016. Bazuar në Censusin e 2011, në BT-ës shkalla e papunësisë, matur si raport i të papunëve ndaj forcës së punës 15 vjeç e lart, rezultoi 24.3 %. Ky tregues në nivel qarku ishte 27.4 %.


Ndihma Sociale. Sipas Shërbimit Social Shtetëror në 2016, numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike në Qarkun e Tiranës është 8,722 familje (ose 10.9%) nga 80,147 familje në rang kombëtar. Bazuar në Censusin e 2011, raporti i numrit të familjeve me ndihmë ekonomike ndaj familjeve gjithsej rezultoi 4.9 % për BT, 6.3 % për qarkun dhe 11.7% për vendin. Rreth 9.7% e familjeve të BT-së përbëheshin vetëm nga pensionistë në 2011. Përgjatë vitit 2017 në BT kanë përfituar nga shërbimet sociale 365 familje rome, 48 familje egjiptiane dhe 114 fëmijë romë.

3. TIRANA NË KONTEKSTIN RAJONAL

3.1 POZICIONI GJEOGRAFIK

Tirana është Bashkia më e madhe në vend për sa i përket territorit. Deri në vitin 2014, Bashkia e Tiranës zinte një sipërfaqe prej rreth 42.8 km² dhe përfshinte vetëm pjesën e urbanizuar. Me ndarjen e re administrative, Bashkia e Tiranës ka rritur rreth 25 herë territorin e saj dhe ka afërsisht një sipërfaqe prej rreth 1.110.98 km² nga të cilat 9.900 ha sipërfaqe e ndërtuar, 40.000 ha zona të mbrojtura dhe 22.000 ha tokë e cila nga bujqësore është kthyer në urbane. Tashmë Bashkia përbëhet nga 24 njësi administrative, të cilat janë: 11 Njësitë Administrative urbane dhe 13 Njësi Administrative rurale (Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhitë, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri). Ndërkohë që numri total i fshatrave në territorin e kësaj bashkie është 135. Së bashku me 13 njësitë e reja, popullsia e Bashkisë së re të Tiranës numëron rreth 813,902 banorë për vitin 2017 sipas Gjendjes Civile. Numri mesatar vjetor i banorëve rezidentë për qarkun e Tiranës për vitin 2017, sipas INSTAT, rezultoi rreth 884,961 banorë, ose përafërsisht 30.8% të popullsisë së Shqipërisë.

Figura Nr 2: Harta e re territoriale e Bashkisë Tiranë



Burimi: PPV Tirana 030, Bashkia Tiranë

Nga pikëpamja e infrastrukturës Tirana është nyja kryesore ku bashkohet rrjeti më i rëndësishëm infrastrukturor i vendit dhe ku ajo e gjen veten thuajse të barazlanguar nga pikat kufitare kryesore dhe disa prej kryeqyteteve të rajonit. Më konkretisht:

- Afërsia strategjike me Aeroportin e Rinasit
- Lidhja me pjesën jugore të vendit dhe portin e Vlorës nëpërmjet autostradës Tiranë – Durrës.
- Lidhja me pjesën jug-lindore të Shqipërisë dhe me Maqedoninë e Greqinë nëpërmjet autostradës Tiranë – Elbasan.
- Lidhja me pjesën veri-lindore të vendit dhe Kosovën nëpërmjet Rrugës së Kombit.
- Lidhja me pjesën veri-perëndimore të vendit dhe Malin e Zi nëpërmjet autorstradës Tiranë-Shkodër.
- Dhe gjithashtu më e rëndësishmja pas aeroportit është afërsia me portin e Durrësit sërisht e lidhur nëpërmjet autostradës Tiranë - Durrës.

Kjo e fundit e bën pozicionin e Tiranës akoma më të favorshëm jo vetëm për lehtësirat që porti i Durrësit sjell në aspektin ekonomik, por gjithashtu për vlerën e shtuar në zhvillimin e turizmit rajonal që sjell afërsia me detin Adriatik.

Figura Nr 3: Lidhjet e Tiranës në kontekstin gjeografik



Burimi: Bashkia Tiranë

3.2 HISTORIKU DHE TENDENCAT E ZHVILLIMIT URBAN

Në vitin 1920, Kongresi i Lushnjës e shpalli Tiranën kryeqytet të Shqipërisë dhe u bë qendra më e madhe e vendit me një sipërfaqe prej 305 ha dhe popullsi 15.000 banorë. Pazari ishte edhe qendra e qytetit, ndërsa zona e banimit, e cila zinte 98,2 % të sipërfaqes së qytetit, shtrihej kryesisht në veri e lindje të tij. Rrjeti i çrregullt rrugor përbëhej nga rrugë e rrugica të ngushta dhe të deformuara.

Plani i parë rregullues i Tiranës u hartua në vitin 1923. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti strategjik ishte krijimi i një rrjeti të ri rrugor kuadratik në jug e në perëndim të pazarit, i cili do të harmonizohej me rrjetin ekzistues me anë të zgjerimit dhe sistemimit të rrugëve përbërëse të këtij të fundit. Ky plan theksonte krijimin e akseve kryesore të qytetit si: Rrugën e Barrikadave, Rrugën e Kavajës, Rrugën e Durrësit, etj por mbetej gjithsesi brenda kornizave të qendrës së sotme.

Plani i dytë rregullues i Tiranës viti 1926 ishte më shumë një rishikim i Planit të Parë 1923. Në këtë plan u materializua për herë të parë ideja e një aksi të fuqishëm veri - jug, i cili do të përshkontë qendrën e qytetit duke krijuar hapësirë për zhvillimin vertikal të Tiranës.

Plani i tretë rregullues u hartua në vitin 1928 nga arkitektë austriak. Ai ishte plani i parë i konceptuar gjatë periudhës së mbretërisë si dhe plani i parë urbanistik që merr në konsideratë të gjithë territorin e qytetit. Aty përcaktohej qartë vendosja e një sistemi rrugor modern kuadratik në të gjithë qytetin,

përfshirë pjesën e vjetër të tij. Në këtë dokument, akset kryesore radiale, që përfundojnë në qendër të qytetit si Rr. e Kavajës, Rr. e Durrësit, Rr. e Dibrës dhe Rr. e Elbasanit marrin një rol shumë të rëndësishëm nëpërmjet një profili të ri të zgjeruar. Nëpërmjet emrit ato tregojnë lidhjen e Tiranës me këto qytete dhe dëshmojnë forcimin e marrëdhënieve tregtare me to. Në këtë plan përcaktohej gjithashtu me saktësi Bulevardi me sheshin “Skënderbej” në pjesën veriore të tij, ku do të vendoset qendra administrative e qytetit, si dhe sistemimi i lumit Lana me rrugë paralele në të dy anët e tij.

Plani i katërt rregullues i Tiranës u hartua në vitin 1929. Në këtë plan, aksi i Bulevardit zgjatej në veri drejt ish stacionit të trenit, ku mendohej të ndërtohej stadiumi i ardhshëm i qytetit, ndërsa në jug drejt pallatit mbretëror. Plani përcaktonte kufijtë e qytetit, brenda të cilave përfshihej një sipërfaqe prej 450 ha, si dhe konturonte zonën e qendrës ku përfshiheshin Bulevardi dhe akset rrugore kryesore. Në fillim të vitit 1930 nisën punimet për ndërtimin e bulevardit “Zogu i parë”, Rr. së Durrësit dhe të godinave të ministrive pranë sheshit qendror.

Plani rregullues Italian 1940-1943 e konceptoi Tiranën si një qytet park shumë i gjelbëruar. Parimi kryesor për zhvillimet e reja do të ishte të bërit sa më pak shpronësime, për të ruajtur dhe vlerësuar godinat ekzistuese dhe fizionominë e qytetit. Zona ekstensive do të shtrihej në jug e në lindje të qytetit, me shtrirje 550 ha dhe popullsi 44.000 banorë. Qyteti do të zgjerohej në veri përtej Lumit të Tiranës, duke krijuar një zonë satelit të lidhur me pjesën tjetër nga rrugë dhe ura. Aeroporti do të ndërtohej në zonën përëndimore e do të kufizohej nga Unaza e jashtme e qytetit, Rr. e Durrësit dhe Rr. e Kavajës.

Plani rregullues i 1957-ës synonte fshirjen e gjurmëve të qytetit të vjetër me karakteristika orientale dhe parashikoi zëvendësimin e disa objekteve historike me ndërtime të reja, psh: prishja e pazarit të vjetër dhe zëvendësimi i tij me pallatin e kulturës. Lagjet e reja të krijuara pavarësisht zgjidhjes urbanistike, krijuan monotoni dhe varfëri nga ana arkitektonike. Gjithashtu blloqet me parafabrikat të ndërtuara në vitet 80 dhe sidomos ndërtimet me kontribut vullnetar të realizuara në vitet 70-80, që në pjesën më të madhe bëheshin pa studime urbanistike, deformuan në mënyrë të ndjeshme strukturën e qytetit.

Plani rregullues i viti 1990 tentonte spostimin dhe përqëndrimin e zonave industriale në hapësira të veçanta në veri, perëndim e në lindje të qytetit, larg zonave të banuara. Pjesa jugore, ku shtrihej zona e pushimit u përjashtua nga zhvillimet industriale. Ky spostim i rikthente qytetit një sipërfaqe banimi prej 75 ha. Plani parashikonte edhe rikonstruksionin e objekteve industriale dhe ekonomike, që do të mbeteshin brenda qytetit. Zonat industriale në total do të rriteshin me 158 ha. Plani parashikonte gjithashtu vendosjen e rreth 14 qendrave të reja social-kulturore brenda zonave të banimit, të baraslarguara nga qendra e madhe e qytetit. Gjithashtu, u propozua që aksi i Bulevardit "Zogu I" dhe Rr. e Durrësit, të merrnin karakterin e qendrave urbane. Megjithatë, situata kaotike e viteve 90 e ardhur si pasojë e ndryshimeve politiko-ekonomiko-sociale u pasqyrua në territor në trajtën e urbanizimit të pakontrolluar dhe zaptimin e hapësirave publike, në ndërtime shumëkatëshe me dendësi të lartë në qendrat e qyteteve dhe informale në periferi.

Fillimet e viteve 2000 janë të rëndësishme në historinë e zhvillimit territorial të Bashkisë së Tiranës, pasi përkojnë me hapat e parë transformues për kryeqytetin ku vendoset rikthimi i hapësirave qendrore publike dhe çlirimi tyre nga ndërtimet informale (Lumi Lana, Parku Rinia, Sheshi Skënderbej, Sheshi Nëne Tereza, etj.). Në këto vite Bashkia ndërmerr dhe rindërtimin e infrastrukturës ekzistuese si dhe zhvillimin e infrastrukturës për zonat e reja kryesisht informale. Në këtë periudhë nisin të vendosen principet e para të rigjenerimit urban dhe arkitektonik të kryeqytetit.

Plani i Përgjithshëm Vendor 2012 dhe Projekti për Planin Tematik Urban të Tiranës së Madhe i po të njëjtit vit, parashikonin një qytet të zhvilluar sipas një modeli territorial të qëndrueshëm, të pajisur me infrastrukture inxhinierike moderne, ku do të integroheshin mjedisi natyror dhe ai i urbanizuar për të garantuar cilësinë e lartë të jetës dhe shëndetin publik. Plani për zhvillimin tematik të qytetit⁷ ishte i rëndësishëm për faktin se vinte theksin në forcimin e tipareve natyrore të territorit zgjerimin dhe forcimin

⁷Hartuar nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar - JICA

e korridoreve ekologjike dhe historike të qytetit, atyre radiale dhe vertikale të cilat largoheshin nga qendra duke nisur largimin prej konceptit të zhvillimit monocentrik.

Plani i Përgjithshëm Vendor Tirana 2030 i miratuar në vitin 2016 është munduar ti vejë fre tashmë zhvillimit të mëtejshëm urbanistik të Tiranës duke krijuar një unazë të gjelbër ose ndryshe quajtur “Pylli Orbital” i cili do të rrethojë pjesën e urbanizuar të Tiranës duke u kthyer në një “mur të gjelbër” që përpiqet të frenojë zgjerimin e mëtejshëm urban dhe zaptimit e mëtejshëm të tokave bujqësore. Nëpërmjet tij i është kushtuar ende më shumë vëmendje sistemeve natyrore duke ndërlidhur më së miri konceptin e zhvillimit urban dhe rural në funksion të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Nëpërmjet futjes së koncepteve inovative dhe teknologjive moderne në planin e zhvillimit ky dokument sjell më së miri vizionin e një kryeqyteti Evropian “SMART”.

3.3 RAJONALIZIMI DHE POTENCIALET

Organizimi territorial administrativ i vendit ka qenë një nga rezultatet më të natyrshme të procesit të decentralizimit në Shqipëri i cili ka nisur që në fillim të viteve 90 me lindjen e shtetit të ri demokratik. Në Shtator 2013 nisi reforma administrative territoriale që synonte riorganizimin e NJQV dhe u konkretizuar më 31 korrik 2014 kur Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Sot Shqipëria është e ndarë në 12 Qarqe dhe 61 Bashki duke i dhënë fund fragmentimit të skajshëm administrativ të vendit aspak eficientë lidhur me përdorimin e fondeve dhe reduktimit të konsiderueshëm të stafit dhe funksioneve fantazëm. Krahas riorganizimit territorial dhe qeverisjes, reforma solli dhe parimin e subsidiaritetit dhe riorganizimin e përgjegjësive në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore për të qenë sa më pranë komunitetit.

Mirëorganizimi dhe orientimi strategjik i zhvillimit rajonal konsiderohet një hallkë e rëndësishme që Shqipëria dhe çdo vend tjetër kandidat duhet të përmbushë përpara aderimit në BE. Ky i fundit vë një theks shumë të rëndësishëm zhvillimit rajonal si proces që redukton pabarazitë dhe ngushton boshllëqet e theksuara ekonomike midis rajoneve.

Procesi i rajonalizimit strategjik të Shqipërisë nuk është një detyrim ligjor, megjithatë është një proces kyç i cili sjell rritje të qëndrueshme dhe të ekuilibruar ekonomiko-sociale. Nëpërmjet rajonalizimit efikas të vendit zonat malore të izoluara dhe në përgjithësi ato periferike do të kenë mundësi më të larta zhvillimi për tu afruar sa më shumë me nivelin e zonave qendrore dhe më të zhvilluara të Shqipërisë.

Organizimi rajonal kryhet duke patur parasysh:

- Kriteret gjeografike apo demografike
- Funksionet ekonomike
- Karakteristikat sociale dhe financiare
- Tiparet kulturore dhe historike
- Karakteristikat administrative
- Parimit të efikasitetit të raportit burime për banorë, etj.

Nga ana tjetër, Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) Shqipëria 2030 theksoi se ka një mungesë ndërlidhjeje efektive midis zonave urbane dhe rurale ç’ka disfavorizon këto të fundit duke i lënë me

kapacitete të limituara përsa i përket tërheqjes së investimeve të nevojshme për zhvillim. Për këtë arsye PPK⁸ theksoi rëndësinë e ndarjes së Shqipërisë në disa pole kryesore urbane zhvillimi. Nëpërmjet qendrave të mëdha urbane ekzistuese të këtyre poleve do të bëhet një përthithje më e lehtë e investimeve duke krijuar një shpërndarje më efektive të tyre drejt zonave më periferike të poleve. Në këtë mënyrë zonat urbane dhe rurale nuk do të shihen si konkurrese, por do të jenë më bashkëpunuese dhe më plotësuese me njëra-tjetrën duke siguruar zhvillim më proporcional.

Bazuar në parimet e mësipërme si dhe duke parë paraprakisht bashkëpunimin e qendrave urbane me njëra tjetrën, PPK vendosi në përcaktimin e 7 poleve të zhvillimit rajonal në nivel kombëtar, përkatësisht polet:

- Shkodër-Lezhë
- Tiranë-Durrës
- Elbasan
- Fier-Vlorë-Berat
- Kukës-Has-Tropojë
- Gjirokastër-Sarandë
- Korçë-Pogradec

Ky rajonalizim mund të konsiderohet një sukses fillestar pasi nga të gjitha debatet mbi ndarjen e rajoneve është ai që është përpjekur të ndërlidhë sa më mirë të gjithë tiparet kryesore që i bashkojnë rajonet si psh: ka marrë në konsideratë ndërlidhjet infrastrukturore dhe afërsinë më shtetet fqinjë për të nxitur bashkëpunimin ndërkuftar, ka marrë në konsideratë tiparet e përbashkëta kulturore dhe historike, ka marrë në konsideratë tiparet ekonomike dhe orientimet sektoriale të zhvillimit në të njëjtën kohë duke zbatuar parimin e subsidiaritit si dhe duke marrë në konsideratë shpërndarjen proporcionale të burimeve natyrore.

Rajonit i Tiranës përbëhet nga 3 qarqe: Durrës, Tiranë dhe Dibër. Ky lloj organizimi është menduar si një strategji zhvillimi e ndikuar nga avantazhet që sjell për zhvillimin rajonal ndërveprimi i këtyre 3 qarqeve.

Ekonomia konkurruese – Rajoni Ekonomik Tiranë-Durrës është dhe do të vazhdojë të jetë motorri ekonomik i Shqipërisë dhe ai që përthith pjesën më të madhe të investimeve. Kjo gjë tashmë do ndihmojë edhe Dibërën në përthithjen e fondve të cilat do sigurojnë kthimin e saj në një qëndër më të fuqishme zhvillimi për qarkun përkatës dhe rajonin.

Sisteme natyrore të përbashkëta – Korridoret ujore ndërmjet Tiranës dhe Durrësit dhe ato malore ndërmjet Tiranës dhe Dibërës krijojnë mundësi të tjera bashkëpunimi midis këtyre zonave. Ato mund të përfitojnë financime në lidhje me zhvillimin dhe ruajtjen e biodiversitetit në këto zona, zhvillimin e turizmit rajonal, etj.

Potencialet që ofron Rajoni

Pozicioni strategjik dhe zhvillimet ekonomike dhe demografike që kanë ndodhur përgjatë 20 viteve të fundit në rajon kanë krijuar potenciale të fuqishme dhe konkurruese. Ndër to përmendim:

- ✓ Forcë pune e kualifikuar dhe fleksibile- Tirana karakterizohet nga një popullsi e re dhe nga një forcë pune me arsimim të lartë, kjo dhe për faktin se Tirana është qyteti ku është përqëndruar numri më i madh i universiteteve në vend. Bazuar në raportin IKG 2017-2018 Shqipëria zë vendin e 49/137 për trajnimet dhe arsimin universitar.

⁸Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2030


- ✓ Force pune që flet shumë gjuhë- Rreth 50% e forcës së punës në Tiranë komunikon në gjuhët anglisht dhe italisht dhe 20% në greqisht.
- ✓ Kosto bazë konkurruese- Pagat mesatare në Tiranë si dhe taksat mbi pagat janë ndër më të ulëtat në vendet e BE-së dhe në rajon. Gjithashtu, llogaritja e raportit kosto/përfitim për hapjen e një biznesi të ri është në favor të investitorëve. Bazuar në raportin IKG 2017-2018 Shqipëria zë vendin e 36/137 për raportin e pagesave dhe produktivitetit të forcave të punës.
- ✓ Infrastruktura e përmirësuar- Infrastruktura në Tiranë është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, duke rritur konkurrencën me vendet e zhvilluara të Evropës dhe të rajonit.
- ✓ Klimë pozitive biznesi- Lehtësia e të bërit biznes është përmirësuar ndjeshëm në Tiranë në sajë të reformave që janë realizuar për reduktimin e procedurave, kostove dhe eliminimit të burokracive si në nivel vendor ashtu edhe në nivel qendror. Gjithashtu ky rajoni ofron mbështetje dhe mbrojtje të investimeve dhe investitorëve vendas dhe të huaj nga shumë agjenci të cilat operojnë prej shumë vitesh në Shqipëri. Bazuar në raportin IKG 2017-2018 Shqipëria zë vendin e 34 për indeksin e IHD-ve dhe transfertave teknologjike.
- ✓ Prezenca e shumicës së investimeve të huaja si dhe të shumë firmave prodhuese – rreth 70% e investimeve të huaja janë përqëndruar në Tiranë si dhe shumica më e madhe e firmave prodhuese, veçanërisht industria e lehtë përpunuese, si konfeksione, ushqimore, prodhim dhe përpunim mielli dhe nënproduktet e tij, kantina të ndryshme pijesh, etj. Gjithashtu nuk mungon dhe prezenca e shumë firmave ndërtuese.
- ✓ Pozicion gjeografik strategjik – Tirana ka një pozitë gjeografike shumë të përshtatshme, pasi ndodhet shumë pranë me aeroportin e Rinasit dhe me Portin e Durrësit.
- ✓ Potenciale turistike, jeta e natës, etj.

4. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

4.1 DEMOGRAFIA DHE TENDENCAT

Popullsia mesatare vjetore në Shqipëri sipas INSTAT për vitin 2017 rezultoi të ishte 2,873,457 banorë. Me një sipërfaqe prej 28,748 km², densiteti i popullsisë është 99.95 banorë/km². Popullsia ka një shpërndarje gjinore 49.7% femra dhe 50.3% meshkuj. Meshkujt mbizotërojnë në grupmoshat 0-39 vjeç ndërsa femrat janë më të shumta në numër në grupmoshat 40+ vjeç.

Grafiku Nr 1. Popullsia mesatare vjetore sipas 3-grupmoshave në Shqipëri



Burimi: INSTAT (popullsia mesatare vjetore)

Sipas INSTAT në vitin 2017 grupmosha më e madhe përbëhet nga popullsia në moshë pune 15-64 vjeç që përbën rreth 68.7% të popullsisë gjithsej. Të rinjtë 0-14 vjeç zënë 17.9%, ndërsa popullsia mbi 65 vjeç përbën rreth 13.3% të popullsisë gjithsej.


Tabela Nr 2: Raporti i varësisë moshore për Shqipërinë

	Viti 2011	Viti 2017
Raporti i varësisë së të rinjve (0 – 14 vjeç)	31.22 %	26.05%
Raporti i varësisë së të moshuarve (65 + vjeç)	16.48 %	19.42%
Koeficienti total i varësisë	47.71%	45.46%

Burimi: Llogaritje nga popullsia mesatare vjetore sipas grupmoshave, Instat

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur lindjet dhe vdekjet në Shqipëri në vitet 2010-2017. Siç vihet re edhe në grafik, numri i lindjeve në vitin e fundit ka shënuar nivelin më të ulët ndër vite. Tendanca në vite e uljes së numrit të lindjeve dhe rritja e numrit të vdekjeve ka sjellë e uljen e shtesës natyrore të popullsisë në Shqipëri.

Grafiku Nr 2: Shtesa natyrore në Shqipëri



Burimi: INSTAT

Shqipëria, në krahasim me vendet e tjera të Europës, ka përjetuar një plakje demografike të vonë, por dramatike. Koefficienti bruto i lindshmërisë është 10.7 lindje për 1,000 banorë në vitin 2017 i cili është pak më i lartë sesa mesatarja e përgjithshme e BE-së (10 lindje për mijë banorë). Lindshmëria ka qenë shumë më e lartë se në çdo vend tjetër në rajon, edhe pse në rënie, ndërsa koefficienti bruto i vdekshmërisë gjatë 2017 rezultoi 7.7 vdekje në 1000 banorë.

Për shkak të regjimit të një lindshmërie të lartë në të kaluarën, Shqipëria ka një strukturë moshore relativisht të re, ku mosha mesatare është përafërsisht 37 vjeç. Rreth 30% e popullsisë së saj është më e vogël se mosha 20 vjeç. Për rrjedhojë në Shqipëri, norma e lartë e lindjeve dhe norma e ulët e vdekjeve janë më tepër rezultat i strukturës moshore të re dhe jo rezultat i ndryshimeve ndërmjet lindshmërisë dhe vdekshmërisë.


4.1.1 Demografia e Tiranës

Sipas Regjistrit të Gjendjes Civile (DPGjC) gjatë vitit 2017 popullsia në Tiranë rezultoi 813,902 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,111.01 km²⁹, densiteti i popullsisë së BT-së është 733 banorë për km². Koefficienti bruto i lindshmërisë për vitin 2017 ishte 9.2 lindje për 1000 banorë, ndërsa koefficienti bruto i vdekshmërisë ishte 5.1 vdekje për 1000 banorë.

Sipas të njëjtit burim në 2017, shtesa natyrore rezultoi 3,317 banorë e cila përbën vetëm 15.97 % të rritjes së popullsisë në BT. Pjesa tjetër vjen si rrjedhojë e lëvizjeve të brendshme. Tirana tërheq pjesën më të madhe të migrantëve të brendshëm, prandaj balanca e lëvizjeve të brendshme është pozitive, numri i të ardhurve e tejkalon numrin e të larguarve. Përveç Tiranës dhe Durrësit, gjithë qarqet e tjera kanë balancë negative.

⁹Bashkia Tiranë, Opendata.tirana.al


Grafiku Nr 3: Trendi i Rritjes së Popullsisë në vite (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Gjëndjes Civile

Gjatë vitit 2011, raporti gjinor për BT ka qënë 96.6 meshkuj për 100 femra i cili vazhdon të mbetet i ulët edhe në vazhdim. Në vitin 2017 ky raport është rritur në 98.6 meshkuj për 100 femra.


Grafiku Nr 4: Popullsia në Tiranë sipas gjinisë 2010-2017



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Gjndjes Civile

Sipas DPGjC në totalin e popullsisë mesatare të Tiranës, popullsia në grupmoshën 15-64 vje) zë 71.41 % të totalit, ndërsa popullsia 0-14 vjeç zë rreth 17.12%, duke lënë kështu vetëm 11.47% për popullsinë 65+.

Grafiku Nr 5: Piramida e grupmohave 2017



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile


Tabela Nr 3: Raporti i varësisë moshore për Tiranën

	Viti 2011	Viti 2017
Raporti i varësisë së të rinjve (0 – 14 vjeç)	26.1%	23.97%
Raporti i varësisë së të moshuarve (65+ vjeç)	14.9%	16.07%
Koeficienti total i varësisë	41.0%	40.04%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes civile

Duke analizuar shpërndarjen e popullsisë urbane dhe rurale të BT-së në 2017 rezulton se popullsia urbane zë rreth 82.44% të popullsisë nga 84.59% që përbënte në 2016. Ky ndryshim vjen si rrjedhojë e implementimit të Reformës Administrative Territoriale që shumëfishoi sipërfaqen rurale të BT-së.


Figura Nr 4: Shpërndarja Demografike e Bashkisë Tiranë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Dendësia në zonat urbane sipas DPGJC, për vitin 2017 ka qenë 16,087 banorë/km² ndërsa për zonat rurale 134 banorë/km².


Grafiku Nr 6: Ndryshimi i popullsisë në NJA urbane 2010 – 2017



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Gjendjes Civile

NJA-ja që ka pasur rritjen më të madhe të popullsisë është NjA. 6 me 13,531 banorë përgjatë periudhës 2010 – 2017. Kjo lidhet me faktin se në këtë NJA urbanizimi është zhvilluar mjaft.

Grafiku Nr 7: Ndryshimi i popullsisë në NJA rurale 2010-2017



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Gjendjes Civile

Siç vihet re në Grafikon Nr. 7 numrin më të lartë të popullsisë e ka NjA Kashar për vitin 2017 me 37,373 banorë (sipas DPGjC 2017), duke vazhduar me atë të Dajtit, Farkës, Zall- Herr, etj. Këto NJA janë populluar nga të ardhurit e zonave të tjera periferike të Tiranës apo dhe qytete të tjera dhe sigurojnë një nivel relativisht më të mirë të zhvillimit social ekonomik dhe mundësi më të mira për punësim. Numrin më të ulët të popullsisë e ka NJA e Shëngjergjit pasi është në distancë më të largët nga Tirana dhe akoma nuk ka një infrastrukturë të mirë. Gjithashtu për të njëjtin vit kjo njësi shënon një rënie të numrit të banorëve me -176 banorë.

4.1.2 Projektioni i popullsisë 2011-2031

Ndryshimet demografike të Shqipërisë do të çojnë në ndryshime thelbësore në dekadën e ardhshme. Siç parashikojnë projektionet e popullsisë (2011-2031), popullsia shqiptare do të përjetojë ulje të numrit të lindjeve dhe shtesa e saj natyrore do të jenë të barabarta me zero. Kjo do të thotë që numri i lindjeve do të jetë i barabartë me numrin e vdekjeve.


Migrimi do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në dinamikën e popullsisë. Këto rrjedha do të kompensohen nga kthimi i njerëzve që kanë emigruar, siç sugjerojnë projektionet e popullsisë vitet e ardhshme. Tendencat e popullsisë në Shqipëri do të përcaktohen kryesisht nga sjelljet migratore dhe të lindshmërisë. Efektet e tyre demografike do të rriten nga hyrja e brezave relativisht të shumtë të rinjve në moshën e migrimit dhe të lindjes së fëmijëve. Sipas skenarëve të ndryshme të rritjes së popullsisë, numri i banorëve do të variojë ndërmjet 2,503,751 dhe 3,033,017 në vitin 2031, që përfaqëson respektivisht një humbje prej 14% dhe një rritje të lehtë prej 4% përkundrejt vitit 2011. Edhe nëse popullsia në moshë pune do të stabilizohet gjatë dhjetë viteve të ardhshme (rreth 1,920,000 persona), ajo pritet të ulet rreth 11% deri në vitin 2031.

Numri vjetor i vdekjeve pritet të jetë më i lartë sesa numri i lindjeve në vitin 2031. Megjithatë, nëse brezat e rinj vazhdojnë të emigrojnë dhe të ulin më shumë lindshmërinë e tyre, Shqipëria do të pësojë një rënie natyrore të popullsisë nga fillimi i viteve 2020.

Rritja e popullsisë deri në vitin 2031 mund të pritet vetëm për Tiranën (deri në 30%). Tirana është Qarku i vetëm në të cilin popullsia në moshë pune mund të rritet. Kjo dinamikë demografike rajonale do të nxjerrë në pah përqendrimin gjeografik të popullsisë së Shqipërisë në qendrat kryesore ekonomike në vend, dhe veçanërisht në Tiranë.

Për të arritur në projektimin e popullsisë së BT-së sipas ndarjes së re administrative janë përdorur projeksionet e popullsisë së Qarkut Tiranë, duke supozuar se sjellja demografike e popullsisë së BT-së nuk ndryshon nga sjellja e të gjithë popullsisë së qarkut Tiranë. Projeksionet e popullsisë së qarkut Tiranë bazohen mbi variantin e mesëm të projeksioneve kombëtare i cili supozon lindshmëri të mesme, vdekshmëri të mesme dhe migrim të mesëm.

Grafiku Nr 8: Projeksioni i popullsisë 2011- 2031



Burimi: INSTAT Projeksioni i Popullsisë

Siç vihet re nga grafiku i mësipërm popullsia e Qarkut Tiranë, ku përfshihet edhe BT, nga viti 2011 (763,560 banorë) në vitin 2031 (965.109 banorë) do të rritet me rreth 26.4% edhe pse popullsia në rang vendi do ulet me 4.2%. Kjo do të thotë se popullsia e kryeqytetit do të rritet çdo vit mesatarisht me 1.32% të popullsisë ose me 9 banorë për km² çdo vit.

4.2 PUNËSIMI DHE TRENDET

Shqipëria po pëson një rritje në ekonomi e cila ka ardhur si rezultat i transformimeve strukturore, të mbështetura kryesisht në lëvizjen e punës nga profesionet në bujqësi tek shërbimet, ndërtimi dhe në një masë të vogël tek prodhimi.

Në rang kombëtar sipas të dhënave të Instituti i Statistikave (INSTAT), Anketa e Forcave të Punës 2017, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për grupmoshën (15-64) është 66.8%. Femrat përbëjnë 43.46% të forcës së punës dhe meshkujt 56.54 %. Shkalla e punësimit është 57.4% ndërsa shkalla e papunësisë është 11.1%. Në vitin 2017, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë duke

ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional përbëjnë 25.9% të të rinjve gjithsej duke pësuar rënie mbi 3 % krahasuar me një vit më parë.

Sektori bujqësor dhe sektori i shërbimeve kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 38.2% dhe 42.4% të të punësuarve gjithsej. Në vitin 2017, rezulton se 44.1 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 35.8 % janë të vetëpunësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 20.1 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.


Në nivel kombëtar, shpërndarja e punësimit sipas sektorëve kryesorë tregon se sektori privat mbetet ofruesi më i madh i vendeve të punës. Punësimi në sektorin privat jo-bujqësor zë 43.3% të të gjithë të punësuarve në rang vendi, ndërsa punësimi në sektorin privat bujqësor zë 41.7%. Sektori shtetëror zë 15.0% të të gjithë të punësuarve në Shqipëri.

4.2.1 Punësimi në Tiranë

Lidhur me situatën e punësimit në Tiranë të dhënat aktuale janë në nivel Qarku, por nisur nga pesha që zë Bashkia e Tiranës në këtë Qark, analiza e këtij sektori jep edhe trendin e punësimit në BT.

Të dhënat nga Tregu i Punës 2017, tregojnë se numri i të punësuarve për Qarkun Tiranë është 305,493 ose 25.6% e të gjithë punësuarve në rang kombëtar. Përqindja që zë qarku në forcat e punës është 26.5%. Punësimi në sektorin privat jo-bujqësor zë 74.7%, më pas vjen sektori publik (administrata) me 20.4% dhe sektori bujqësor me 4.9%. Tendanca e punësimit sipas këtyre sektorëve në vite paraqitet si në grafikun më poshtë:


Grafiku Nr 9: Të punësuarit për qarkun Tiranë sipas sektorëve



Burimi: Tregu i punës, Instat

Të dhënat nga Census 2011 japin një pasqyrë më të qartë të situatës së punësimit për BT dhe të NjA-ve të saj. Tendanca e përgjithshme e punësimit në këto njësi është më e lartë për gjininë mashkullore, me një mesatare prej (51.6%), dhe për femrat 35.4%, që është tregues për statusin e femrave në këto njësi. Femrat më shumë punojnë punë të papaguara brenda shtëpisë ose punojnë në ekonomitë familjare.


Grafiku Nr 10: Shkalla e punësimit në Bashkinë Tiranë (%)



Burimi: Census 2011, INSTAT

Nga i njëjti burim kemi punësimin në NJA-të të ndarë sipas nivelit arsimor. Shkallën më të lartë të punësimit në korrelacion me nivelin arsimor e zënë banorët që kanë mbaruar shkollën 8/9-vjeçare, përkatësisht 42.4% të mesatares, banorët që kanë mbaruar nivelin arsimor të mesëm të përgjithshëm dhe professional zënë 39.9% të mesatares dhe 16.5% të mesatares e zënë ata banorë që kanë mbaruar nivelin arsimor universitar. Këto të dhëna tregojnë se pjesa më e madhe e të punësuarve është më shumë në sektorin e punëve mjeshtrorore jashtë zonës së tyre, që në të shumtën e kohës kanë punuar në informalitet, në sektorin e bujqësisë apo blegtorisë.


Grafiku nr 11: Punësimi sipas nivelit arsimor arsimimit në Bashkinë Tiranë



Burimi: INSTAT, Census 2011

NjA Zall Bastar ka përqindjen më të lartë të punësimit me arsimim 8-9 vjeçar krahasuar me njësitë e tjera administrative. Kërraba ka përqindjen më të lartë të punësimit me arsim të mesëm të përgjithshëm dhe profesional, ndërsa përqindjen më të lartë në punësimin me arsim të lartë e zë Tirana me 45.3%.

Grafiku Nr 12: Punësimi sipas degëve të ekonomisë




Burimi: INSTAT, Census 2011

Nga të dhënat vihet re se përqendrimi më i lartë në punësim është në sektorin e bujqësisë në NJA Zall-Bastar (85.7%), por nuk nënkupton se ky sektor është shumë i zhvilluar në këtë NJA, pasi vetë nga relievi malor që karakterizon njësinë nuk lë hapësirë për zhvillimin e bujqësisë. Punësimi në shërbime zë përqindjen më të lartë të punësimit të banorëve në Tiranë me 79.3%.

4.2.2 Papunësia në Tiranë

Në Qarkun e Tiranës numri i punëkërkuesve të papunë për vitin 2017 ra me 9,466 persona, pra shkalla e papunësisë shkoi 16.67% nga 19.74% që ishte në 2017. Punësimi u rrit me 18,501 persona, pra shkalla e punësimit shkoi 45.8% nga 43.06 % në 2016. Rreth 57% janë punëkërkues me arsim 8-9 vjeçar, 25% me arsim të mesëm të përgjithshëm, 12% me arsim të mesëm profesional dhe 6% me arsim të lartë.

Grafiku Nr 13: Shkalla e papunësisë meshkuj-femra%



Burimi: Treguesit Rajonal 2015, INSTAT

Papunësia më e lartë vihet re në NjA-të Kërrabë dhe Zall-Herr. Në këto komunitete jo vetëm që shkalla e papunësisë është e lartë, por problem social është dhe shkalla e lartë e papunësisë së të rinjve. Këto janë tregues të pamjaftueshmërisë së zhvillimit. Prioritet në zhvillimin e këtyre NJA-ve do të jetë hapja e shkollave profesionale për arsimimin profesional të të rinjve.

Një përqindje e banorëve që jetojnë në këto njësi mbahen me punë të paguar ose janë të vetëpunësuar. NjA Pezë zë përqindjen më të lartë të banorëve të cilët kryejnë punë të papaguar ose vetëpunësim rreth 79.4%, duke u ndjekur nga Vaqarri 72.7% dhe Dajti me 69.7%. Shëngjergji zë përqindjen më të ulët të shkallës së vetëpunësimit me 28.2%.

4.2.3 Programet e Nxitjes së Punësimit

Një nga programet e BT-së është Fondi i Programit të Nxitjes së Punësimit në Ndhimë të Krijimit të Biznesit Social Rinor. Qëllimi i tij është të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga të rinjtë në Tiranë, të cilat janë të afta që të mbijetojnë në një treg konkurrues. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve ka si qëllim të ofrojë transparencë dhe konkurrencë të barabartë si dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, të veçanta, fitimprurëse dhe që garantojnë rezultate të qëndrueshme. Përveç mbështetjes në formë granti, programi ofron gjithashtu trajnim për aftësitë në biznes si dhe mbështetje duke ndihmuar të rinjtë me orientime profesionale dhe kualifikime për të qenë të suksesshëm në fushën e përzgjedhur.

Një tjetër program është Fondi për gratë sipërmarrëse. Kjo nismë e Aleancës së Grave të Këshillit Bashkiak ka bërë të mundur që 22 gra në kryeqytet të kenë sot bizneset e tyre duke punësuar veten, por edhe duke krijuar mundësi për t'u punësuar me dhjetëra të tjerë. Për herë të parë BT miratoi një fond gjashtë milion lekë për mbështetjen e sipërmarrësve gra nga 18 deri në 60 vjeç.

Në vijim të nxitjes së hapjes së bizneseve të reja, por edhe të rritjes së punësimit do të vazhdohet jo vetëm në 22 kompanitë e para për mbështetjen e sipërmarrësve gra por edhe për të gjitha start-up që hapen nga

të rinjtë deri në moshën 35 vjeç. Këto biznese, shtojnë fuqinë shpenzuese dhe gjenerojnë aktivitete për qytetin tonë.


4.3 STREHIMI

Qëllimi i Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025 (SSS) është përmirësimi i kushteve të jetesës së 25,000 familjeve shqiptare me të ardhura të ulta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë një shtëpi në tregun e lirë, duke përfshirë familjet në pozita të pafavorizuara që vuajnë nga përjashtimi social.

Në Qarkun e Tiranës për periudhën 2011 – 2016 janë ndërtuar 707 ndërtesa të reja me një sipërfaqe 3,048,000 m2, nga të cilat rreth 78% kanë qenë ndërtesa për banim.

Bazuar në censusin e 2011, në qytetin e Tiranës 21.3% e ndërtesave të reja janë ndërtuar për qëllime banimi në harkun kohor 2001-2011. Ky tregues në nivel vendi ishte 17.7 %. Rreth 50.6% e ndërtimeve të realizuara në 2001-2011 përqëndrohen në 11 Njësitë urbane të BT-së. Ndërtimet për qëllime banimi janë përqendruar në nivele të ndryshme në NJA-të rurale, të cilat me reformën administrative territoriale janë bërë pjesë e Bashkisë Tiranë. Gjatë kësaj periudhe, përqindjen më të lartë të ndërtimeve të kryera në vitet 2001-2011 e zë Farka me rreth 42.9% , Kashari me 32.7% dhe Dajti me 30.3%, kjo për arsye se këto tre njësi shtrihen në periferi të zonës urbane dhe gjatë këtij 10 vjeçari çmimi i tokës ka qenë i ulët (konsideroheshin më së shumti si toka bujqësore) dhe hapësira për ndërtim ka qenë e disponueshme dhe mund të përballonin kërkesat e vazhdueshme për ndërtesa banimi, duke u bërë tërheqëse për kompanitë e ndërtimit. Shëngjergji ka përqendrimin më të ulët me 2.4% të ndërtesave për qëllime banimi, kjo për shkak të terrenit, largësisë nga zona urbane dhe kërkesave për banim.

Grafiku nr 14: Ndërtesa banimi të reja gjatë 2001-2011, ndaj gjithsej ndaj ndërtimeve (%)



Burimi: Instat, Census 2011


Pjesa më e madhe e ndërtesave të banimit në këto NJA-të janë shtëpi (ndërtesa private) ndërsa pjesa që janë apartamente është ndjeshëm më e vogël, megjithatë ka ndryshime nga njëra njësi tek tjetra. Në zonën urbane të Tiranës ndodhet numri më i madh i apartamenteve të banimit, rreth 12.19% e totalit të

ndërtesave për qëllime banimi. Në Farkë vetëm 9.88% e ndërtesave janë pallate për qëllime banimi. Në Kashar dhe në Dajt pallatet përbëjnë 8.35% dhe 5.31% respektivisht. Megjithatë është e nevojshme të theksohet se këto të dhëna bazohen në Censur 2011 dhe nuk pasqyrojnë intensitetin e lartë të ndërtimeve të pallateve në vitet pas publikimit të tij. Gjithësesi këto NJA zënë përqindjen më të lartë të ndërtimeve të pallateve shumëkatëshe si rezultat edhe i përqendrimit më të madh të banorëve në këto zona. Në NJA-të rurale ka një numër shumë të vogël apartamentesh banimi dhe pjesën më të madhe të ndërtesave të banimit e zënë shtëpitë private.

Njësitë administrative me përqendrim më të lartë të apartamenteve të banimit janë dhe ato të cilat kanë më shumë familje që jetojnë me qira. Në Kashar është numri më i madh i tyre, rreth 15.8% e familjeve, në Tiranë rreth 13.5% e familjeve, në Farkë rreth 9.9% e familjeve dhe në Dajt rreth 9.4%. Në NJA-të e mbetura, numri i familjeve që jetojnë me qira është në nivele shumë të ulta.

Në gjithsej bashkinë e Tiranës rreth 19.9% e fondit të banesave është boshë, dhe 3.3% përdoret për qëllime dytësore. NJA-të e BT-së kanë një numër të konsiderueshëm banesash boshë, të cilat janë shtëpi ose apartamente të pa shitura. Në Kashar, një nga njësitë me numrin më të madh të apartamenteve, rreth 43% e banesave janë boshë; në Dajt rreth 39.7% e tyre, dhe në Farkë rreth 36.8% e tyre. Në Tiranë, pavarësisht numrit të madh të apartamenteve të banimit, numri i banesave boshë është 15.2%, më i moderuar krahasuar me nivelet e larta të sipërpërmendura. NJA-të Shëngjergj, Petrelë, Vaqarr dhe Zall-Herr kanë nivelet më të ulta të banesave boshë në BT.


Grafiku Nr 15: % e banesa boshë ndaj ndërtesave për qëllime banimi



Burimi: Instat, Census 2011

Banesa të pabanuara janë banesat e zakonshme të banuara nga persona, banesat e destinuara për qëllime dytësore apo sezonale. Përqindja e shtëpive të pabanuara në Shqipëri është e lartë. Apartamentet janë bosh për shkak se njerëzit lëvizin drejt zonave të ulta dhe jashtë shtetit, si dhe ndërtimi i shtëpive të reja nga familjet që jetojnë në vende të tjera, por që investojnë para për familjet e tyre. Në vitin 2001, numri i banesave të pabanuara është më e ulët se në vitin 2011. Në vitin 2001 ishte 11.3%, ndërsa në vitin 2011 ishte 29.8%.

Figura Nr 5: Banesa vakante si % e totalit të stokut të banimit



Burimi: Instat, Census 2011

Në tabelën më poshtë paraqitet gjendja e tregut të shitjes dhe qirasë së banesave/apartamenteve, të moduleve 1+1 dhe 2+1, në BT, ku përfshihen disa zona të qytetit dhe NJA-të me përqendrimin më të lartë të ndërtimeve dhe apartamenteve të banimit. Zona lindore e qytetit, Shkoza është ndër zonat më të lira për shitje të apartamenteve të banimit, së bashku me zonën perëndimore, e përfaqësuar me ndërtesat Misto Mame, Pallatet Malajziane dhe Unaza e Re. Në mënyrë të përgjithshme, vërehet se banesat e modulit 2+1 shiten më lirë se ato të modulit 1+1 dhe e kundërta vërehet për qiradhënien, në këtë rast qiraja është më e shtrenjtë për modulit 2+1 dhe më e lirë për 1+1.

Tabela Nr 4: Çmimet e shitjes/qirasë në zonat me përqendrim më të lartë të ndërtimeve

Zona Bashkia Tirane	Çmimi për shitje EUR/m ²		Çmimi për qira EUR/ m ²	
	1+1	2+1	1+1	2+1
Shkoze	500	430	90	100
Don Bosko	630	770	175	279
Laprakë	650	643	126	144
Ish-Stacioni i Trenit	1050	875	100	300
Yzberisht (Misto Mame)	506	480	93	144
Pallatet Malajziane	525			
Unaza e Re	536	437	190	180
Komuna e Parisit	690	802	170	280
Ish Kopshti Botanik	662	1000	500	300
Nj.A Dajt	599	557	104	16

Nj.A Farkë	675	823	215	
Nj.A Kashar			108	

Burimi: Instat,

4.3.1 Strehimi Social dhe Programet

Programet sociale të strehimit janë “programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekare. Qeveria ka ngritur tre programe sociale strehimi: banesat sociale me qira, banesat me kosto të ulët dhe programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë.

Sipas ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ofrimi i strehimit është detyrë e autoriteteve vendore. Konkretisht, neni 72 përcakton se njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë dhe komunat mbajnë përgjegjësi të plotë për kryerjen e funksioneve të tyre...në fushën e urbanistikës, rregullimit të territorit dhe strehimit [ndër të tjera].” Përgjegjësia e ofrimit të strehimit social ndahet midis qeverisë qendrore dhe njësisve vendore.

Autoritetet vendore janë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave për strehim; krijimin e programeve dhe projekteve afatmesme dhe afatgjata; ofrimin e truallit të lirë për ndërtim; paraqitjen e kërkesave për financime, investime dhe subvencione të qeveria qendrore; zhvillimin dhe administrimin e një inventari të dhënash; përcaktimin e koston maksimale të ndërtimit të banesave; ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira. NJV duhet të krijojnë një plan strehimi afatgjatë që të përfshijë burimet financiare, nevojat për strehim dhe, ndër të tjera, numrin dhe llojin e familjeve që do të përfitojnë nga programe të ndryshme strehimi.

Në BT, për periudhën kohore 2015-2017 numri i përgjithshëm i aplikuesve për programet sociale të strehimit social 13,962. Programet sociale të strehimit që aplikon Bashkia Tiranë janë:

- ✓ Banesa me kosto të ulët - Për këtë program për periudhën 2005 – 2017 kanë aplikuar 9,993 qytetarë dhe vetëm për vitin 2017 aplikuan 441 familje.
- ✓ Banesat sociale me qira – programi i banesave sociale me qira u aktivizua për të parën herë në vitin 2016, i vetmi pas një periudhe prej 2-3 vitesh. Për këtë program, për të njëjtën periudhë kanë aplikuar 3,849 aplikues dhe kanë përfituar mbi 419 familje për këtë program. Gjatë vitit 2017 për këtë program aplikuan 1,187 familje.
- ✓ Bonus strehimi - është një program që mbështet familjet që jetojnë në apartamente me qira të cilat nuk mund të përballojnë financiarisht qiranë e tregut vetëm për vitin 2017 kanë përfituar 232 familje.
- ✓ Skema për Subvencionimin e interesave të kredisë për Strehimin – Me 20 Shkurt 2017 u miratua nga Këshilli Bashkiak vendimi për të ndihmuar kryesisht çiftet e reja me kredi të buta për blerjen e një shtëpie. BT merr përsipër të subvencionojë interesat e tregut bankar për rreth njëmijë kredi. Financimi i programit në buxhetin e vitit 2017 ishte 95 milionë lekë. Në korrik, Komisioni i Strehimit deklaroi 999 fitues, nga 2438 aplikues

Treguesi më shqetësues në lidhje me strehimin social në BT është raporti shumë i ulët i numrit të përfituesve ndaj numrit të aplikuesve. Bashkia ka në plan disa politika të cilat do të mundësojnë maksimizimin e këtij raporti në të ardhmen, të cilat janë ende në nivel projekti. Një prej këtyre politikave është shfrytëzimi i partneritetit publik privat për banesa sociale me qira.

Programi i kredisë sociale në Partneritet Publik Privat (PPP) ka për qëllim që të shfrytëzojë kapacitetet e lira të apartamenteve të pa shitura të ndërtuesve privatë, të cilët mund ti ofrojnë ato për programin e banesave sociale me qira. Ndërtuesit privatë pritet të ofrojnë qira të arsyeshme për apartamente të pa shitura të vendosura kryesisht në zonat periferike të qytetit. Vlera e qirasë sociale do të përballohet pjesërisht nga familjet aplikuese dhe pjesërisht nga Bashkia. Nëpërmjet kësaj politike bashkia do të mbështesë shtresat në nevojë me aftësi paguese të kufizuara.

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi lidhur me përgjegjësitë dhe detyrat që ka BT për programet sociale të strehimit, çdo njësi vendore duhet të hartojë një plan strehimi afatgjatë që të përfshijë burimet financiare, nevojat për strehim dhe ndër të tjera, numrin dhe llojin e familjeve që do të përfitojnë nga programe të ndryshme strehimi. Aktualisht priten ndryshime ligjore dhe BT me zyrarizimin e këtyre ndryshimeve do të hartojë planin. Gjithashtu ka një nevojë urgjente për një sistem të ri për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave lidhur me aplikuesit dhe përfituesit, që jo vetëm do të shërbejë si bazë për njohjen e situatës aktuale por edhe për studime dhe analiza strategjike për të gjithë territorin e BT-së.

4.4 KUJDESI SOCIAL

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020 (SMS) synon reformimin e Programit të Mbrojtjes Sociale nëpërmjet transformimit të Ndhmës Ekonomike (NE) në një skemë aktive të ri-integrimit social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë kufizuar; ndërhyrjes dhe ri-integrimit të fëmijëve në familje dhe komunitet duke treguar kujdes të veçantë për fëmijët jetimë social dhe biologjikë dhe ofrimin e shërbimeve të integruara. Prioritet është sigurimi i burimeve të nevojshme për grupet më të rrezikuara nëpërmjet Fondit Kombëtar për Shërbimet Shoqërore dhe Fondeve Rajonale për Shërbimet Shoqërore si pjesë e Fondit Shoqëror.

Skema e Ndhmës Ekonomike është instrumenti kryesor për “zbutjen e varfërisë” në vend, edhe pse aktualisht ka një ndikim të kufizuar në varfëri. Aktualisht janë rreth 79,661¹⁰ familje në rang kombëtar të cilët përfitojnë pagesat e ndihmës ekonomike. Kjo skemë ekonomike shënjestron relativisht mirë familjet e varfra, pasi pjesa më e varfër e popullsisë përfiton 56% të shpenzimeve të skemës. Skema arrin të mbulojë me pagesa 24.6% të të varfërve ekstreme, 19.5% të varfërve total dhe 5.6% e popullsisë jo të varfër arrin të përfitojë këto pagesa. Pagesat e NE-së, pas transferimit, mbulojnë rreth 15% të shpenzimeve të konsumit të familjeve përfituese. Pagesa mesatare e tanishme e NE-së është rreth 3.800 – 5.136 lekë në muaj. Shpenzimet për ndihmën ekonomike janë rritur në vlerë absolute gjatë dekadës së fundit, por kanë rënë krahasuar me përqindjen që zënë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB).

Aftësia e kufizuar ose "Pagesa e Aftësisë së Kufizuar" është pjesë e programit të Mbrojtjes Sociale dhe shërben për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe përmirësuar cilësinë e jetesës. Aktualisht kjo pagesë është mekanizmi i vetëm për mbështetjen e tyre, pasi vlerësohen për nivelin e aftësisë së kufizuar nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë. Masa e pagesës për aftësinë e kufizuar është shumë më i lartë se masa e NE-së (8,784 lekë në muaj për përafërsisht 157,702 individë në vend gjatë 2017).

Shpenzimet për pagesat e aftësisë së kufizuar janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit dhe tashmë përbëjnë pjesën kryesore në shpenzimet e Mbrojtjes Sociale. Kjo është shkaktuar nga indeksimi i lartë i përfitimit dhe mbulimi i zgjeruar. Në përgjithësi, shpenzimet për aftësinë e kufizuar janë rritur ndjeshëm në vlerë absolute dhe, ndryshe nga NE, është rritur edhe si përqindje e PBB-së. Po kështu numri i personave që marrin pagesën e aftësisë së kufizuar është rritur me gati 2/3 ose me 63.7%. BT përmbush disa shërbime në kuadër të programit të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale:


¹⁰<http://ë.ë.sherbimisocial.gov.al/ë-p-content/uploads/2014/03/ANALIZA-SHSSH-2017-v2.pdf>

4.4.1 Ndhimja Ekonomike

Në kuadër të programit të kujdesjes sociale, sipas të dhënave të Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS), në BT, ka disa kategori grupesh sociale që janë përfshirë në këtë shërbim.

Gjatë vitit 2017, sipas të njëjtit burim, kanë përfituar mesatarisht çdo muaj rreth 5,086¹¹ familje në rrezik/ nevojë. Nisur nga numri total i familjeve në territorin e BT-së për vitin 2017 rreth 1.8% e familjeve në nevojë kanë përfituar ndihmë ekonomike.

Grafiku Nr 16: Familje përfituese të ndihmës ekonomike në zonat urbane (%)




Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale

Në NJA-të urbane vetëm për vitin 2017, kanë përfituar 2,269 familje ose rreth 10% e familjeve që jetojnë në zonën urbane. Duket qartë se është NJA 6 ajo e cila ka numrin më të madh të familjeve përfituese për zonën urbane (1.6% e familjeve së kësaj NJA). Ndërsa në zonat rurale situata paraqitet ndryshe. Numri total i familjeve përfituese për 13 Njësitë Administrative Rurale, për të njëjtin vit, është 2,817 ose 6.5% e familjeve që jetojnë në zonat rurale.

¹¹Bashkia Tiranë, Raportuar në open-data, për gjashtëmuajorin II 2017

Grafiku Nr 17: Familje përfituese të ndihmës ekonomike në zonat rurale (%)



Burimi: Opendata, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale

Sa më sipër, vihet re se NjA Zall Bastar dhe Shëngjergj ka numrin më të madh të përfituesve të ndihmës ekonomike, përkatësisht me 504 familje (27.4%) dhe 279 familje (28.4%) të këtyre NJA-ve janë subjekt i këtij shërbimi. Farka ka numrin më të vogël të përfituesve 2.5% të familjeve ekzistuese.

Përveç familjeve që aplikojnë për marrjen e NE-së ka edhe disa kategori të tjera që janë përfitues të kësaj ndihme që për vitin 2017 janë trajtuar:

- Individë me status jetimi, (228 mesatarisht çdo muaj)
- Individë viktimi të dhunës, (53 mesatarisht çdo muaj)
- Individë viktimi të trafikimit, (5 mesatarisht çdo muaj)
- Individë prindër të fëmijëve të lindur:
 - o Trinjakë (14 mesatarisht çdo muaj)
 - o Katërnjakë (4 mesatarisht çdo muaj)
 - o Pesënjakë (1 mesatarisht çdo muaj)
- Familje kujdestare (43 mesatarisht çdo muaj)

4.4.2 Shërbime të tjera të kujdesit social

Kategoritë sociale që përfitojnë nga shërbimet sociale ndahen në 9 nënkategori si:

Fëmijë në risk

Në kategorinë e fëmijëve në risk bëjnë pjesë 5 nënkategori: fëmijët në varfëri, fëmijët e rrugës, fëmijët e dhunuar, fëmijët e trafikuar dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Për vitin 2017 numri i fëmijëve të trajtuar me shërbim është 715 Rreth 68.5% e fëmijëve të trajtuar i përkasin kategorisë fëmijë në varfëri dhe 31.5% janë fëmijët e rrugës.

Të rinj në risk.

Të rinjtë janë një tjetër kategori në nevojë por që nuk kanë marrë vëmendjen e duhur dhe mbartin me vete shumë probleme duke filluar që nga mungesa e punësimit dhe deri në mungesën e strehimit. Në këtë kategori përfshihen të rinjtë me viktimë/përdorues droge, të rinj që dalin nga institucionet e riedukimit dhe të rinj të shërbimit të provës. Për vitin 2017 numri i përfituesve ka qenë vetëm 3, kjo lidhur me hezitimin e kësaj kategorie për të qenë objekt diskriminimi, paragjykimi.

Gra në risk.

Në këtë kategori përfshihen gratë kryefamiljare që përfitojnë ndihmë sociale, gra të dhunuara dhe gra viktimë të trafikimit. Për vitin 2017 numri i grave në risk që kanë përfituar nga shërbimi social janë 979, ku 89.8% e zë kategoria e grave kryefamiljare.

Të moshuar në risk.

Në Bashkinë Tiranë, të moshuar që akomodohen në institucionet e përkujdesjes për vitin 2017 janë 243. Në këtë kategori bëjnë pjesë të moshuar të të identifikuar si njerëz në nevojë, për arsye se të mbetur vetëm, janë pa të ardhura dhe përkrahje. Në territorin e Bashkisë Tiranë ka 5 qendra sociale të cilat vetëm për vitin 2017 kanë ofruar përkujdesje për të moshuar.

Persona me Aftësi të Kufizuar (PAK)

Kjo kategori përbëhet nga PAK me përfitim kujdestarie.

Për 2017 ¹²në total kanë përfituar nga programi i përfshirjes sociale 20,012 persona të ndarë në kategoritë:

- PAK të verbër (1,687)
- PAK fizikë-mendorë (5,182)
- Paraplegjikë dhe tetraplegjikë (797) dhe
- Invalidë pune (12,346)


Ndërsa të paaftë më përfitim kujdestari për të njëjtin vit kanë përfituar 2,565 persona.

Komuniteti Rom-Egjiptianë

Në programet e përfshirjes sociale futen edhe këto kategori që për vitin 2017 sipas të njëjtit burim kanë përfituar 302 familje rome dhe 17 familje egjiptiane.

¹²Bashkia Tiranë, Raportuar në open-data, për gjashtëmuajorin II 2017

Figura Nr 6: Familje përfituese të Ndhmës Ekonomike dhe shpërndarja e Qendrave Sociale/Ditore



Burimi: Bashkia Tiranë

Bashkia e Tiranës ka nën administrim 5 Qendra Sociale/Ditore:


- Qendra Sociale Multidisiplinare- ofrohen shërbime ditore për kategorinë e moshës së tretë me synim përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre duke zbutur dhe parandaluar problemet sociale që vijnë nga vetmia apo braktisja. Qendra ditore “Fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë ose Drop in Center”. Kjo qendër është e financuar nga SAVE the CHILDREN. Para 2017 funksiononte si qendër më vete, nga 2017 është integruar në qendrën sociale multidisiplinare.
- Qendra sociale “Të qëndrojmë së bashku” ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre. Qëllimi i saj është të sigurojë asistencë cilësore për të rinjtë, fëmijët dhe gratë në risk dhe veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuar, fizike dhe mendore, me qëllim përmirësimin e statusit të tyre social, mirëqënien personale dhe rritjen e cilësisë së jetës së tyre.
- Qendra sociale “Shtëpia e Përbashkët” ofron shërbime të cilat sigurojnë mbështetje shoqërore, psikologjike, emocionale, ligjore, profesionale dhe një sërë shërbimesh për gratë në rrezik për të reduktuar problemet, parandaluar përkeqësimin e situatave si dhe zgjidhje të problemeve të

ndryshme familjare. Në këtë qëndër ofrohet edhe një vakt ushqim për individë me probleme sociale dhe familje me probleme të varferise ekstreme.

- Qendra Sociale Ditore Shkozë ofron shërbime arsimore dhe sociale për fëmijet e komunitetit
- Qendra sociale “Shtëpia e ngjyrave”, është e financuar nga UNICEF dhe manaxhuar nga Shoqata ARSIS. Kjo qëndër ofron shërbime për fëmijët që jetojnë në rrugë. Një shërbim tjetër i ri i ngritur nga Bashkia e Tiranës, pranë qendrës ditore “Shtëpia e ngjyrave” është shërbimi i emergjencës i cili funksionon për rastet e fëmijëve që ndodhen në situatë rreziku të lartë ose emergjent. Qendra ofron shërbime parësore (ushqim, veshje, strehim), shërbime shëndetësore dhe këshillim psikosocial për 72 orë, deri në gjetjen e mundësive dhe alternativave afatmesme dhe afatgjata që garantojnë mbrojtjen e fëmijës.

Për vitin 2017 janë akomoduar në këto qendra gjithsej 243 të moshuar, 141 fëmijë në nevojë dhe 1,295 familje.

Grafiku Nr 18: Përfitues nga përkujdesja e Qendrave Sociale dhe Ditore 2017



Burimi: Bashkia Tiranë

Një vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe skuadrave të terrenit për fëmijët në situatë rrugë. Për vitin 2017 numri i skuadrave ka qenë 15 të cilat përgjatë këtij viti u identifikuan 497 raste dhe prej të cilave u manaxhuan rreth 69.6% e tyre. Manaxhimi i këtyre rasteve është realizuar nëpërmjet dhënies së ndihmës në fushën e arsimit, punësimit dhe 19 raste janë me ndjekje penale për prindërit.

Në janar të vitit 2017, BT ka shpërndarë bursa për 2,228 nxënësit më të mirë të të gjitha shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazet e Tiranës për vitin shkollor 2015-2016. Të gjithë nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat dhjeta janë shpërblyer duke u investuar nga BT.

4.5 ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KLIMA E BIZNESIT

Bazuar në kuadrin ligjor BT është përgjegjëse për kryerjen e disa funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik: (I) hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor, (ii) ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë, (iii) mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike (iv) organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj, (v) publikimin e broshurave

informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj dhe dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor


Në vitin 2016, PBB me çmime korente u vlerësua 1,475,251 milionë Lekë, duke shënuar një rritje në terma realë prej rreth 3.35 %, krahasuar me vitin 2015. Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2016, e ka dhënë Qarku Tiranë me +1.62 pikë përqindje. Rritja në terma reale e qarkut Tiranë në 2016 krahasur me 2015 rezultoi 4.03%.

Në kontekstin e zhvillimit ekonomik, Qarku i Tiranës, zë një vend mjaft të rëndësishëm në ecurinë e zhvillimit të të gjithë vendit. Sipas INSTAT (Rajonet Statistikore), për vitin 2016 rajoni qëndër (Elbasan – Tiranë) ka kontribuar me rreth 699 miliardë lekë ose me 47.4% në strukturën e PBB-së në rang kombëtar. Vlera më e lartë në PBB paraqitet në Qarkun e Tiranës me rreth 596.4 miliardë lekë ose 40.4 % e totalit të PBB-së.

Në rajonin qëndër (Tiranë – Elbasan), PBB për frymë në vitin 2016 ishte rreth 614 mijë lekë ose 19.7% mbi mesataren e vendit. Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas qarqeve në vitin 2016 ishte Tirana me rreth 699 mijë lekë ose 36.4% mbi mesataren e vendit. Të ardhurat për frymë të në Tiranës janë 4,860 euro ose sa 35% e mesatares se BE-së.

Sektorët që kanë peshën më të madhe në ekonominë e Qarkut Tiranë janë sektori i tregtisë, transportit dhe hoteleve (21.4%), më pas vjen aktivitetet e administratës publike (15.5%) dhe ndërtimi (12.5%). Përqendrimi i administratës qendrore në Tiranë është një avantazh që ekonomia e kryeqytetit ka në krahasim me qytetet e tjera.

Grafiku Nr 19: Përqindja e qarkut Tiranë në VSHB me çmime bazë, sipas degëve të ekonomisë



Burimi: INSTAT

Qarku Tiranë ka kontributin më të madh në vlerën e shtuar bruto me çmime bazë në rang vendi me rreth 40.4%. Gjithashtu qarku Tiranë ka kontributin më të madh në vlerën e shtuar bruto në pothuajse të gjitha degët përveç Bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit. Vlera e shtuar bruto në bujqësi e qarkut të Tiranës përbën vetëm 7,6 % të VSHB të degës së bujqësisë në vend. Ndikimin më të madh qarku Tiranë e ka në

aktivitetet shkencore, profesionale, teknike dhe ato mbështetëse duke gjeneruar 75,0% VSHB për degën në rang vendi.

4.5.1 Biznesi në Tiranë

Reforma territoriale ka rritur kufijtë e administruar nga BT me 25 herë, si rrjedhojë janë rritur mundësitë për biznesin për tu zgjeruar drejt bujqësisë, ndërtimit, turizmit dhe shërbimeve të tjera. Gjatë dekadës së fundit, ka pasur një rritje të shpejtë të numrit të ndërmarrjeve, rreth dy herë më shpejt se rritja e popullsisë së qytetit.

Në Tiranë janë rreth 70 ndërmarrje për 1,000 banorë (grafiku Nr 20). Rreth 32.8% e të gjitha ndërmarrjeve që janë aktive në Shqipëri janë të vendosura në Qarkun Tiranë dhe prodhimi ekonomik i këtyre ndërmarrjeve është gjerësisht i larmishëm. Tirana është edhe tërheqja kryesore për investitorët e huaj, pasi shumica e kompanive në pronësi të të huajve në Shqipëri janë të vendosura në Tiranë.


Për më tepër, me reformën e re administrative territoriale dhe kalimin e disa komunave në varësi të Bashkisë, numri i bizneseve të reja është rritur ndjeshëm. Ndërkohë që parashikohen shifra më të larta, për shkak se nga 1 Janari 2017 kanë hyrë në fuqi masat për reduktimin e procedurave tatimore dhe shkurtimin e afateve në zyrën vendore të taksave, pasi jo pak herë burokracitë e shumta janë bërë shkak për stepjen e iniciativave të qytetarëve për të ngritur një biznes.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore është insttucioni kryesor që ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në BT, duke kontribuar në mbulimin e shpenzimeve publike, përmes një procesi efektiv dhe transparent. Gjatë vitit 2017 janë zbatuar disa projekte të rëndësishme për të lehtësuar bashkëveprimin me qytetarët dhe bizneset duke reduktuar burokracitë, vonesat, dokumentacionin e tepruar, koston dhe kohën e kryerjes së shërbimeve. Ndër më të rëndësishmet janë:

- ✓ Dhënia e disa shërbimeve qytetarëve dhe bizneseve nëpërmjet E-Albania
 - Marrje e njoftim-detyrimit online
 - Pajesa online nëpërmjet e-albania, easypay, akinvest, unioni financiar etj
- ✓ Lidhje me ëbservise për të komunikuar online me Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Regjistrin e Gjendjes Civile etj
- ✓ Krijimi i një ëeb-i të ri funksional, informues dhe interaktiv me qytetarët dhe bizneset
- ✓ Krijimi në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë i programit “Sistem i qëndërzuar për menazhimin e hoteleve dhe taksave në Bashkinë Tiranë”.
- ✓ Vendosje në punë e një sistemi për numerizimin e aplikimeve në sportelet e asistencës
- ✓ Përmirësim i strukturës së IT (server, kompjutera, etj) dhe rritje e sigurisë së të dhënave nëpërmjet backup-eve dhe plani “disaster recovery” të afruar nga AKSHI.

Duke qenë se zhvillimi ekonomik është i lidhur ngushtë me performancën e bizneseve dhe klimën në të cilë ata ushtrojnë aktivitetin po analizojmë situatën aktuale të tyre në territorin BT-së.

Grafiku Nr 20: Bizneset ne Bashkinë e Tiranës 2010-2017




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Kryeqyteti është më i lakmuari ndër qytetet e tjera për të zhvilluar biznes, kjo për shkak të numrit të lartë të popullsisë, të përqendrimit të shërbimeve dhe institucioneve shtetërore.

Në 24 NJA-të e Tiranës zhvillojnë aktivitetin 45,912 subjekte kryesore dhe sekondare, ku 11 NJA urbane kanë edhe përqendrimin më të lartë. Por ajo që vihet re është shifra e lartë edhe e bizneseve sekondare, pra që janë në pronësi të individëve që kanë edhe një biznes kryesor. Numri i subjekteve sekondare tek 24 NJA-të e Tiranës që zhvillojnë aktivitetin ekonomik është 9,270.

Sipas të dhënave nga BT, 86.1% e subjekteve kryesore e përbejnë NJA-të urbane dhe 13.9% e përbëjnë ato rurale. Biznesi i madh ka numrin më të lartë të subjekteve aktive në BT. Pas reformës, bizneseve që kanë pasur një xhiro nga 5-8 milionë lekë (që është kufiri që e ndan biznesin e vogël nga i madhi) i'u është kërkuar të kalohen si subjekte të mëdha. Për këtë arsye kemi një numër më të lartë të bizneseve të mëdha pasi në mënyrë vullnetare bizneset kanë deklaruar fitimet dhe kanë bërë ndryshimet.


Grafiku Nr 21: Bizneset sipas kategorive 2010-2017



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Biznesi i vogël ka pasur nje rritje të qëndrueshme gjatë viteve 2010-2017, dhe vitin e fundit numri i tyre është rritur ndjeshëm, kjo lidhur edhe me përpjekjet e qeverisë qendrore dhe vendore për uljen e informalitetit. Kategoritë e tjera vazhdojnë të kenë një stabilitet ekonomik.

Grafiku Nr 22: Bizneset sipas llojit të aktivitetit 2010 – 2017



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Shitja me pakicë dhe njësitë e shërbimit vazhdojnë të jenë kategoritë e biznesit që vazhdojnë të rriten dhe të zhvillohen në Tiranë përgjatë pesë viteve të fundit. BT i ka kushtuar veçanërisht vëmendje bashkëpunimit me bizneset për të ndihmuar zhvillimin e tyre si edhe për të lehtësuar procedurat administrative me të cilat përballen bizneset në nivel vendor.

Për 5-vjeçarin e ardhshëm janë parashikuar këto objektiva dhe projekte ne funksion të opermirësimit të cilësisë shërbimeve që BT ofron për bizneset dhe qytetarët:

- Rritja e cilësisë dhe eficiencës së shërbimeve qytetarëve dhe bizneseve nëpërmjet E-Albania (marrje e vërtetimit të likuidimit të taksave online, marrje e informacionit online për të dhënat e regjistruara në sistem, ndjekje online e kërkeses/ankesave të qytetarëve dhe informacionit për kontrollet tatimore online, kryesisht për taksën e ndërtesës).
- Lidhje me ëbservise me të gjithë database-t shtetërore, me agjentët tatimore dhe me bankat e nivelit të dytë për të komunikuar online DPT, QKB, ZRPP, OSHE, NUK, DPSHTRR etj
- Krijim i mundësive që nëpërmjet ëeb-it qytetarët dhe bizneset të kryejnë aplikimin online, ndjekjen e kërkesë/ankesë dhe përgjigjen online.
- Hartimi i një programi të ri për taksën e pronës për taksat e tarifave që mbështetet mbi pronën (jo biznesin siç ka qënë deri më tani)

- Digitalizimi i procedurave të specialistëve të terrenit dhe vlerësimit (akt-konstatim, procesverbal, foto, informacion, kontroll, vlerësim, miratim, dërgim në subjekt etj)
- Program i ri për protokollimin dhe qarkullimin e informacionit dhe aplikacione të reja për burimet njerëzore, qarkullimin e materialeve në DPTTV etj.
- Krijim i regjistrit elektronik të kategorisë “familjar” që përjashtohen nga taksat e tarifave, regjistër online me të gjithë agjentët që mbledhin taksat vendore

4.5.2 Zonat ekonomike dhe Klasterat

Krijimi i zonave ekonomike ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin ekonomik në vend, veçanërisht atë privat, të nxisë investimet, të hap vende të reja pune, të tërheq teknologjitë e përparuara, të rrisë konkurrencën e biznesit vendor, etj. Ato kanë për qëllim që të stimulojnë tregtinë pasi ofrojnë përjashtime doganore dhe reduktime taksash.

Disa nga faktorët negativë që kanë influencuar në bllokimin e këtyre investimeve kanë qenë problemet me pronësinë e tokës, ngadalësimi dhe pengesa burokratike në marrjen e licencave, mosrespektimi i afateve për ndërtimin e infrastrukturave, shkelja e detyrimeve që rrjedhin nga lejet dhe kontratat, tolerimi i ndërtimeve pa leje brenda këtyre zonave, moszbatimi i afateve për kryerjen e studimeve të fizibilitetit, kushtet dhe kërkesat jo të arsyeshme nga ana e kompanive që kanë marrë përsipër zhvillimin e këtyre zonave.

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e Agjencisë së Zhvillimit të Investimeve, Qeveria shqiptare ka aprovuar në të gjithë territorin e vendit 2 zona ekonomike (Spitalla dhe Kopluku).

Zonat ekonomike në Shqipëri

Pozicioni strategjik i Shqipërisë ofron potenciale të fuqishme për zhvillimin e tregtisë me vendet e Bashkimit Evropian e më gjerë dhe shërben si urë komunikimi ndërmjet dy korridoreve më të mëdhenj tregtare duke lehtësuar lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet Detit Adriatik dhe Detit të Zi, i njohur si Korridori i VIII-të.

Në këtë kuadër ZTZHE-të, shihen nga Qeveria si mënyra të reja me të cilat Shqipëria planifikon të shpenzojë të gjithë potencialin e saj ekonomik. Ligji Nr. 9789, datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” u përmirësua ndjeshëm gjatë vitit 2015 dhe u plotësua më akte të tjera nënligjore, duke përcaktuar qartë kriteret dhe procedurat e nevojshme për krijimin e ZTZHE-ve, të shoqëruar me një paketë fiskale shumë konkurruese. Qëllimi ishte krijimi i kushteve maksimale të parashikueshmërisë, produktivitetit dhe të përfitimit për zhvilluesit dhe përdoruesit e këtyre zonave. Këto instrumente përbëjnë një mundësi shumë të mirë për krijimin dhe zhvillimin e zonave duke i bërë ato mjaft të konkurrueshme me zona të tjera në Ballkan dhe në Evropë.

Aktualisht Qeveria Shqiptare ka miratuar dy zona ekonomike, të cilat kanë statusin e "Zonave të Zhvillimit Teknologjik dhe Ekonomik (ZTZHE)": ZTZHE Kopluk (qarku Shkodër, përafërsisht 61 ha), si dhe ZTZHE Spitalë (qarku Durrës, përafërsisht 213 ha). Të dyja këto zona kanë si synim përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të banorëve të zonës përreth duke parashikuar hapjen e vendeve të reja të punës.

4.5.2.1 Zona Ekonomike në Tiranë (TEDA Kashar)

BT synon krijimin e një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (ZTZHE) të standarteve perëndimore me prioritet industritë me karakter teknologjik sic janë industria automobile, ICT, dhe elektronike.

Pavarësisht impaktit së krizës globale në tregun e automobilëve, ky sektor vazhdon të jetë konkures dhe premtues. Pikave të forta të rajonit, si konkurenca, afërsia gjeografike me tregjet Evropiane dhe forca e lirë punëtore, i shtohet edhe eksperiencia historike e vendeve të Ballkanit në periudhën e para viteve 1990, në prodhimin e pjesëve përbërëse të automobilëve.

Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e mësipërm, Shqipëria përbën një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e këtyre industrive, duke marrë në konsideratë forcën punëtore të edukuar, ndër më të rejt në Evropë dhe më të lirën, lidhje shumë të mirë me tregjet Evropiane perëndimore dhe ato lindore. Gjithashtu, këtyre pikave ju shtohen edhe incentivat e dizenuara enkas për projektet e zonave ekonomike.

Konceptet bazë të këtij projekti janë:

Greenfield – i personalizuar që në themele Ndryshe nga zonat e tjera ekonomike në territorin e Shqipërisë, Technologic Economic Development Area (TEDA) Kashar është Greenfield, duke krijuar kështu një mundësi për ndërtesa të personalizuara në varësi të kapacitetit specific të investitorit. Sipërfaqja e përzgjedhur është rreth 50 hektarë, ndërkohë që gjithë sipërfaqja fushore e pandërtuar shkon në 150 hektarë. Elementi i cili krijon një potencial për zgjerimin e zonës në rast të rritjes së kërkesës.

Infrastrukturë e përshtatur për kapacitetin e nevojshëm Një faktor specific që përcakton destinacionin e investimeve është infrastruktura. Zhvilluesi i zonës, në këtë rast BT, është përgjegjëse për vendosjen e infrastrukturës së nevojshme brenda kufijve të zonës së përcaktuar. Duke qenë gjithashtu një projekt me përfitim publik, është detyrë e qeverisë qendrore të pajisë me infrastrukturë pjesën jashtë kufijve të zonës.

Një vendndodhje strategjike Një nga përcaktuesit kryesorë për suksesin e një zone ekonomike është edhe vendndodhja. Tirana, si kryeqytet i Shqipërisë, është i vendosur në zemër të vendit, dhe është e lidhur strategjikisht me rrjete rrugore që e lidhin më së miri me kufijtë e vendit, tregjet rajonale dhe jo vetëm. Janë rreth 3,719 km rrugë, ku rrugët primare kombëtare janë të shtrëna sipas standarteve ndërkombëtare, dhe janë të mirëlidhura logjistikisht me korridorët kryesorë të Evropës Lindore.

Kashari është njësi administrative e Tiranës me 43,353 banorë dhe 1,591 biznese operuese, dhe është i pozicionuar mes Tiranës dhe Durrësit, qyteti i dytë më i madh në vend. Me këtë vendndodhje, TEDA Kashar përfiton akses edhe nga Porti i Durrësit (32 km distancë), porti më i madh në rang kombëtar dhe porta kryesore e Korridorit të VIII.

Gjithashtu Kashari ndodhet vetëm 12 km larg aeroportit Nënë Teresa, i pozicionuar strategjikisht në qendër të vendit, mes një kryqëzimi të madh që lidh veriun, jugun dhe Shqipërinë qendrore me atë lindore, ndërkohë që është vetëm fare pak kilometra nga zonat industriale të formuara organikisht në Tiranë.

Krahë pune me potencial të lartë Zona metropolitane midis dy qyteteve kryesore të Shqipërisë, Tiranës dhe Durrësit, ku ZTZHE do të implementohet, përfaqëson pothuajse 40% të popullsisë totale, 63% të prodhimit kombëtar dhe 50% të ndërmarrjeve vendasë duke krijuar organikisht një nga cluster-at ekonomik më të rëndësishëm në Shqipëri.

Me dispozitat ligjore që do lejojnë BT-në të jetë zhvilluesi kryesor i ZTZHE Kashar, dhe duke marrë në konsideratë të gjitha avantazhet dhe autoritetin që BT ka, kjo rrjedhimisht rrit kredibilitetin e investitorëve

potencial, duke krijuar në këtë mënyrë ekuilibër dhe besueshmëri në një vend në zhvillim siç është Shqipëria.


Edhe pse ka një legjislacion të miratuar, Shqipëria ende nuk ka arritur të tërheqë investitorë të huaj në zonat e lira ekonomike. Një nga problemet më të mëdha për zhvillimin e tyre mbetet çështja e së drejtës së pronës. Vendi ynë shihet si një rast përjashtimor, pasi ligji përcakton se çështja e pronësisë duhet të zgjidhet mes pronarëve të tokës dhe zhvilluesit të zonës.

Në zbatim të Ligji Nr. 9789, datë 19.07.2007 (i ndryshuar) “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, ndryshuar me ligjin Nr. 54/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9789 datë 19.07.2007” dhe VKM-ve përkatëse, Bashkia e Tiranës ka iniciuar projektin e krijimit të një zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik pranë Njesisë Administrative Kashar, në të cilën Bashkia do të ketë rolin e zhvilluesit të kësaj zone duke përmbushur kriteret e legjislacionit në fuqi.

Krijimi dhe funksionimi i kësaj Zone (TEDA Kashar), ka si qëllim krijimin e një territori të veçantë me një regjim fiskal dhe doganor tepër lehtësues për ushtrimin e aktivitetit ekonomik dhe që nxit investimet, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e të ardhurave, përshpejtimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, futjen e teknologjisë së përparuar dhe përshpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe kapitaleve. Deri më tani është identifikuar zona ku do të zhvillohet projekti si më poshtë vijon:

Sipërfaqja totale e zonës së madhe shkon 87.2 ha dhe përfshin fshatrat Yzberisht, Gropaj dhe Yrshek. Kjo sipërfaqe përbëhet nga tre zona kadastrale: (i) ZK 3866 – Yzberisht, (ii) ZK1867 – Gropaj dhe (iii) Zona Yrshek.

Figura Nr 7 Harta e zonës së identifikuar të TEDA



Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban

Për të aplikuar dhe marrë statusin e ZTZHE, në bazë të legjislacionit të fuqi, Bashkia e Tiranës në rolin e zhvilluesit të projektit do të hyjë në procedurë jokonkurrese dhe duhet të dorëzojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën, së bashku me:

- ✓ Studimin e parafizibilitetit, për projektin e ndërtimit të zonës së teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik. (është përgatitur Drafti paraprak nga Bashkia e Tiranës)
- ✓ Informacionin e marrë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për statusin aktual të pasurisë, për sipërfaqen, në të cilën do të ndërtohet zona, të shoqëruar me aktin përkatës të pronësisë.

Aktualisht projekti gjendet ende në fazën e grumbullimit të informacionit nga ZRPP, pasi me gjithë korrespondencën e vazhdueshme me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kjo e fundit nuk zotëron një hartë kadastrale dixhitale dhe pasuritë e përfshira kanë kufijë të pasaktë e të paazhurnuar, mungesë informacioni, kartelet, dublime të pronësisë etj. gjë e cila ka sjellë vështirësi në realizimin e projektit. Për këtë arsye Bashkia e Tiranës ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me palët e treta (Abkons),” Për përmirësimin, përditësimin e pasurive të paluajtshme dhe sistemit kadastral për Zonën Ekonomike”.

Pas plotësimit të dokumentacionit të mësipërm dhe kryerjes së vlerësimit paraprak, institucioni përgjegjës (Ministria) do të shprehet për pranimin e kërkesës dhe më pas Bashkia e Tiranës do të vijojë plotësimin e dokumentacionit të mëtejshëm sipas të gjitha kritereve vlerësuese, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës.

Pas shpalljes dhe marrjes së statusit si Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA Kashar), do të vijojë investimi në zonë, ndërtimi i infrastrukturës deri në kufijtë e zonës nga buxheti i shtetit dhe investimet brenda zonës do të bëhen nga zhvilluesi (Bashkia e Tiranës), duke përfshirë dhe kapononet përkatëse.

Pasi të shpallet zona dhe të buxhetohen ndërhyrjet do të fillojë strategjia e marketingut të saj me qëllim thithjen e investitorëve të huaj potencialë, e cila është draftuar dhe përgatitur nga Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me ekspertë të huaj dhe mbështetjen e institucione të tjera (Ministria e Jashtme, Trupi Diplomatik, Minsitria e Ekonomisë etj.).

Për 5-vjeçarin e ardhshëm janë parashikuar këto objektiva dhe projekte për t’u përmbushur:

- ➔ TEDA Kashar (2018-2022)
- ➔ Mbështetje me skema financiare (grant, fond, ndihmë financiare) për hapjen e bizneseve të reja dhe ekzistuese në fushën e ekonomisë kreative (2019-2021)
- ➔ Krijimi i qendrës së artizanëve në qytetin e Tiranës i cili synon të nxisë bizneset e vogla artizanale në qytetin e Tiranës, drejt ideimit, prodhimit, marketimit, ekspozimit dhe tregtimit të produkteve të tyre në një qendër të përbashkët të Artizanatit. Kjo qendër do të shërbejë si një ambient i dedikuar tërësisht për artizanët e kryeqytetit.
- ➔ Në kuadër të Tirana Policentrike – Poli Kombinatit – 1. Krijimi i një Creative Hub/platformë e dedikuar mjeshtërive. 2. BID Kombinat, një partneritet publik privat për një mjedis fizik të përmirësuar dhe më shumë mundësi biznesi (modeli Pazari Ri).
- ➔ Krijimi i One Stop Shop për bizneset - në të cilën do të sigurohen shërbime dhe këshilla për bizneset me cilësi dhe në kohë reale, më qëllim për të bërë biznesin më të suksesshëm kundrejt një kostoje më të ulët, e cila do të do të ofrojë shërbime si: regjistrim, licencim në nivel qendror dhe lokal, informim dhe këshillim të biznesit, aplikime dhe informacione online etj.

- ➔ Në kuadër të Green City- 1. Mekanizmat për nxitjen e investimeve për teknologjitë me efikasitet ndaj energjisë (penele diellore etj.) 2. Masat për ngritjen e kapaciteteve për bizneset (paketë trajnimesh për bizneset që kanë ndikim në mjedis) (2019-2021)
- ➔ Krijimi i portalit ekonomik (Tirana HUB) - Koncepti i “Tiranahub.al” qëndron në krijimin e një portali ekonomik, informativ dhe informatik, në formën e një faqeje ëeb, ku do të ofrohet një mbështetje gjithëpërfshirëse për çdo sipërmarrës potencial ose operues, me anë të informacioneve mbi situatën e përgjithshme ekonomike kombëtare dhe vendore, sistemit taksativ, sistemit të licensimit dhe mbështetjeve për financim të projekt-ideve, tutoriale, formate për përgatitjen e dokumentave në mënyrë profesionale, këshilla për realizimin e strategjive, etj. Gjithashtu, krijimi i kësaj hapësire virtuale synon të krijojë një vend takimi mes Engjëjve të Biznesit/Investitorëve dhe Sipërmarrësve potencialë ose atyre operues, që synojnë të rrisin më tej kapacitetin e ndërmarrjes. Portali do të lidhë gjithashtu pjesën akademike me tregun e punës duke shërbyer si një urë lidhëse mes forcës punëtore dhe spin off-eve universitare. Gjithashtu ky portal do të jetë pjesë përbërëse e kërkesë- ofertave për punë nga sipërmarrja private dhe jo vetëm.

4.6.2.2 Klasterat

Klasterat janë ndërveprim i bizneseve të tipologjive të ngjashme që plotësojnë njëra tjetrën në ciklin e zinxhirit të vlerës, që ndërliiden në rrjet dhe bashkëpunojnë midis tyre.

Rajoni Durrës-Tiranë është nyja kryesore e ndërveprimit të burimeve njerëzore, mallrave, dhe hapësirave të jetueshme të veriut dhe jugut të Shqipërisë si dhe porta hyrëse e “Korridorit VIII”. Ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e rajonit luajnë dhe portat logjistike të pozicionuara në të, Porti Durrësit dhe Aeroporti “Nënë Tereza”. Rajoni Durrës Tiranë është kontribuesi kryesor i zhvillimit ekonomik në rang kombëtar, si në numër biznesesh po njësoj dhe në shumëllojshmërinë e tyre, kjo falë prezencës së lartë në numër të institucioneve, numrit të lartë të dendësisë së banorëve në rajon si dhe pozicionimit të favorshëm gjeografik.

Si rrjedhojë, ky rajon, do të vazhdojë të mbetet motorri ekonomik i vendit dhe të shndërrohet në rajonin më konkurrues në Ballkanin Perëndimor. Rajoni do të mbështesë krijimin e klasterave ekonomike dhe do të mbështesë bizneset dhe industritë kreative, të cilat do të sjellin një zhvillim teknologjik në të ardhmen.


4.5.2.3 Tregjet Publike

Një nga funksionet e BT-së, në bazë të ligjit nr 139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ neni 28, pika 2 është ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë në qytetin e Tiranës. BT, kufizohet vetëm në planifikimin dhe menaxhimin e tregjeve publike në qytet, hapjen apo mbylljen e tyre. Sipas bazës ligjore, tregjet përkufizohen si sipërfaqe të paracaktuara dhe të licencuara publike ose private, të pajisura me mjete dhe infrastrukturë të përshtatshme për ushtrimin e aktiviteteve tregtare, në një ose disa ditë të javës apo muajit duke ofruar mallra të të gjitha llojeve të lejueshme nga legjisllacioni në fuqi, me shumicë apo pakicë në shërbim të komunitetit.

Tregjet klasifikohen sipas strukturës së administrimit të tyre. Ato ndahen në tregje publike dhe private. Për zbatimin e kuadrit ligjor përkatës përveç strukturave ekzistuese në BT, me VKB nr 28, datë 05.04.2017 u krijua Agjencia e Administrimit të Tregjeve, me qëllim monitorimin dhe administrimin e aktiviteteve të përditshme në tregjet publike.

Në Tiranë gjenden gjithsej 8 tregje publike, me një sipërfaqe totale prej rreth 17,634 m², nga e cila është e shfrytëzueshme rreth 8,370 m². Kapaciteti i përgjithshëm në këto tregje publike është rreth 909 vende tregtimi, në të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 645 tregtarë, pra aktualisht shfrytëzohen në masën 70% . Shumica e tregjeve publike kanë një përzierje merceologjike edhe pse fillimisht janë projektuar për fruta-perime.

Figura Nr 8: Harta e Tregjeve Publike ekzistues në Tiranë



Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban

Aktualisht në qytet dhe zonat përreth janë hapur qendra tregtare, të cilat garantojnë një shërbim të përmirësuar dhe kanë thithur një pjesë të konsiderueshme të konsumatorëve vendas dhe jo vetëm. Megjithatë nga vërtetimi në territor dhe analiza qytetare rezultojnë se ende ka nevojë për ekzistencën e tregjeve në afërsi të zonave të tyre të banimit. Gjithashtu vlen të përmendet se në këto tregje punësohet një numër i konsiderueshëm tregtarësh. Për arsyet e sipërpërmendura tregjet në Tiranë do vijojnë të ekzistojnë, por do shihet mënyra e ndërhyrjes për t'i bërë sa më efikasë dhe me kapacitet të plotë shfrytëzimi.

Për 5 vjeçarim e ardhshëm janë parashikuar këto objektiva dhe projekte:

- ✓ Pilotimi i tregjeve të lëvizshme në 3 NJA (faza e hartimit).
- ✓ Rehabilitimi tregjesh ekzistuese NJA 11 dhe 6
- ✓ Ndërtimin tregjesh të reja në tre Lagjet e reja (12, 13, 14) dhe NjA 11
- ✓ Hapja e tregut të rrobave të përdorura në NJA 1 (i vetmi treg në këtë NJA)

PAZARI I RI (TID TIRANA)

Miruar me VKB nr. 89 datë 26.07.2017, Zona TID pozicionohet rreth 500 m larg nga Sheshi Skënderbej dhe përfshin Pazarin e Ri dhe Rr. “Luigj Gurakuqi”.

Pazari i Ri / Sheshi Avni Rustemi përbën një simbol të jetës tradicionale urbane të qytetit dhe një destinacion me vlera të spikatura tregtare. Kjo zonë është streha e mbi 15 siteve të trashëgimisë kulturore të mbrojtura me ligj. Site të cilat ishin të fshehura nën fasada të dërrmuara, infrastrukturë të vjetëruar dhe në një hapësirë aspak joshëse për të zhvilluar aktivitetin tregtar.

Ditët e sotme Pazari i Ri është kthyer në një qendër tregtare të hapur ku bizneset private dhe përfaqësimet publike po zhvillohen nën petkun e modelit BID/TID. AADF ka bashkëpunuar me Qeverinë Shqiptare (Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Zhvillimit Urban), Bashkinë Tiranë dhe komunitetin e biznesit lokal për të rijetësuar Pazarin e Ri/Sheshin Avni Rustemi.

Pazari është shndërruar në një ndër atraksionet më të vizituara turistike të kryeqytetit. Restaurimi ka përfunduar në Mars të vitit 2017. Fondacioni gjithashtu po mbështet bizneset që kryejnë aktivitetin në zonë nëpërmjet shërbimeve këshillimore dhe skemës së granteve, me qëllim përmirësimin e performancës së tyre dhe shfrytëzimin sa më të mirë të mundësive të reja. TID Tirana, shoqata e biznesit e cila mbikqyr administrimin ditor të zonës, është themeluar në Mars të 2017 në partneritet me Bashkinë Tiranë dhe komunitetin e bizneseve lokale.

Figura Nr 9. Plan vendosja e TID Pazar i Ri



Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban

Zona TID ka një hapësirë publike (m²) për shfrytëzim nga bizneset: Plan. 2414.99 m² Fakt. 1351.5 m². Hapësira është planifikuar për rreth 170 tregtarë (të licensuar 150 dhe aktualisht prezent në treg 90).

Markata e Re ofron mundësinë e ushtrimit të aktivitetit për 25 njësi tregtare në një sipërfaqe totale 1120.41 m². Aktualisht, procesi i dhënies me qira dhe lidhja e kontratave përkatëse ka përfunduar për 23 njësi tregtimi/shërbime, realizuar me dy faza konkurruese nga Bashkia Tirane dhe kanë mbetur bosh dy vende vakante me numeracionin përkatës të paraqitur në tabelë si më poshte:

Meqënëse Markata e Gjellbër është aset publik i BT, ka rekomanduar të caktohet një person përgjegjës nga Agjencia për Administrimin e Tregjeve, i cili koordinon dhe bashkëpunon me Administratorin e TID Tirana për zbatimin e Urdhresës së Kryetarit për Tregun e Pazarit të Ri. Gjithashtu, koordinatori faciliton të gjitha hallkat ndërvepruese qendrore dhe lokale. (BT, AMK, APR, DPPTV, AKU);

Pavarësisht ndërhyrjeve infrastrukturore dhe rregullatore të BT në këto tregje problematikat të ndryshme vijojnë të ekzistojnë të tilla si:

- **Infrastruktura fizike aktuale.** Aktualisht në këto tregje tregtohet në kushte të papërshtatshme higjieno-sanitare. Problem kryesor mbetet ndriçimi, higjena, uji i pijshëm brenda ambienteve të tregjeve, mungesa e tualeteve për tregtarët dhe mungesa e masave kundër zjarrit. Është e nevojshme që BT të rehabilitojë fillimisht strukturat aktuale të tregjeve publike dhe njëkohësisht të planifikojë investimet e reja sipas kërkesës dhe nevojave që paraqesin NJA-të.
- **Lidhja e kontratave midis autoritetit përkatës dhe subjektit privat pronar i truallit.** Aktualisht kemi dy kategori tregjesh publike: tregje publike në truall publik dhe tregje publike në truall privat, por që administrohen dhe manaxhohen nga strukturat ndërlidhëse të BT-së. Tregjet publike janë administruar deri në vitin 2015 nga NJA dhe kontratat janë lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe NJA-ve. Me reformen e re administrative territoriale tregjet publike administrohen nga BT por kontratat nuk janë rilidhur pas vitit 2016 dhe pronarët e truallit nuk marrin detyrimin financiar, ndërkohë që tregjet vazhdojnë të funksionojnë.
- **Mungesa e një Administratori në manaxhimin e tregjeve publike.** Aktualisht tregjet funksionojnë pa një administrator dhe mungesa e tij sjell mosmanaxhim të problematikave të tregtarëve dhe konsumatorve etj.

Agjencia e Administrimit të Tregjeve (AAT)

Me vendim Nr. 28, datë 05.04.2017 është krijuar Agjencia e Administrimit të Tregjeve (AAT) institucion në varësi të BT-së për administrimin dhe menaxhimin e shërbimeve të tregjeve publike. Misioni i saj është manaxhim më efikas drejt përmirësimit të strukturës së tregjeve, arritjen e standarteve më të larta të tregtimit për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve dhe krijimin e kushteve më të favorshme për tregtarët.

Rezultatet e pritshme nga krijimi i AAT-së

- Përdorimi me efikasitet i hapësirave publike për modele të ndryshme tregjesh;
- Ofrimi për qytetarët e Tiranës lehtësi në tregtim, nëpërmjet menaxhimit të sukseshëm të tregjeve;
- Manaxhimi dhe administrimi i tregjeve publike për të gjithë Njësitë Administrative në Bashkinë Tiranë me qëllim përmirësimin e shërbimit, infrastrukturës dhe përmirësimin e sigurisë ushqimore;

- Modernizimi dhe rimodelimi i tregjeve si pjesë e politikave të Bashkisë Tiranë me qëllim zhvillimin ekonomik të zonave dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës nga ekonomia lokale;
- Propozimin e ndryshimeve në paketën rregullatore për organizimin dhe funksionimin e tregjeve në BT;
- Nxitja e bashkëpunimit në sektorin privat në lidhje me iniciativa dhe vende të ndryshme;
- Promovimi i tregjeve të lëvizshëm për fermerët dhe prezantimi i produkteve organike lokale, në zonat urbane sipas një plan-veprimi të mirë përcaktuar;
- Të krijojë një sitem të përditësuar të dhenash në funksion të përmirësimit të politikave zhvilluese edukuese për transformimin e tregjeve si vende me potencial turistik.
- Të koordinojë me të gjithë aktorët e pushtetit lokal dhe qëndror për një administrim me efikas dhe shërbime më të mira për konsumatorin.

Gjatë vitit 2017 ka përfunduar rehabilitimi i 3 (tre) tregjeve publike (tregu Lulishte 1 Maji, tregu Mine Peza dhe tregu 4 Dëshmorët, politikë dhe investim i Bashkisë Tiranë për tregjet e mëposhtme: (tregje fruta-perime) që administrohen aktualisht nga AAT:

4.6 ZHVILLIMI RURAL

Zhvillimi Rural konsiderohet si një ndër prioritetet kryesore të BE-së në kuadër të nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe ambiental të komunitetit. Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020 (SNZHRB) ka synuar pikërisht orientimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit rural e bujqësor në Shqipëri për të qëndruar në linjë me prioritetet e BE-së për këtë sektor.

Kjo strategji ka evidentuar disa sektorë prioritarë, të cilat kanë më shumë mundësi për t'u zhvilluar dhe për të qenë konkures në tregun vendas, rajonal apo ndërkombëtar të tilla si:

- Sektori i frutave dhe perimeve, (kryesisht ullinjëtë, vaji i ullirit, rrushin dhe vera)
- Sektori i bimëve aromatike-medicinale dhe arrorët;
- Sektorët e mishit dhe bulmetit, (kryesisht produktet e bagëtive të imëta);
- Blegtoria;
- Apikultura – Mjalti
- Turizmi rural dhe agroturizmi

Tirana rurale ofron të gjitha kushtet për zhvillimin e këtyre sektorëve dhe me kalimin e NJA-ve rurale nën administrimin e BT-së i gjithë sektori i bujqësisë dhe blegtorisë do të gëzojë vëmendje më të lartë.

Në kuadër të zbatimit të reformës territoriale BT me marrjen e funksioneve dhe përgjegjësi lidhur me zhvillimin urban, krijoi strukturat përkatëse përgjegjëse për këtë fushë të cilat do hartojnë dhe zbatojnë politika vendore rurale në fushën e bujqësisë, pyjeve dhe kullotave për të garantuar zhvillimin e zonave rurale të Tiranës, në funksion të mbrojtjes dhe shtimit të pyjeve dhe kullotave, mbështetjes ndaj fermerëve, adresimit të çështjeve teknike bujqësore të biznesit në fushën e agro-turizmit, agrobiznesit, etj.

Gjatë vitit 2017 janë hartuar dhe zbatuar projekte mjaft të rëndësishme:

A.1. Në fushën e hartimit të projekteve për zhvillim rural:

- ✓ “Ruga e Verës dhe e Ullirit”. Ku projekt kishte si qëllim promovimin e produkteve të vajit dhe të verës, lidhjen e prodhuesve me njëri -tjetrin, si dhe kthimin e këtyre subjekteve në destinacione turistike të vizitueshme në çdo kohë të vitit. Ky projekt u realizua në bashkëpunim me Agjensia për Zhvillim Rajonal 2, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e cila u finalizua me printimin e hartave turistike në dhjetor 2017.
- ✓ “Marketingu i Produkteve Bujqësore Tipike”. Ky projekt mbështet fermerët e NjA-ve Rurale për zhvillimin dhe rritjen e cilësisë së produktit vendas (Made in Tirana) nëpërmjet ambalazhimit, etiketimit dhe promovimit konstant me qëllim nxitjen e formalizmit të fermerëve dhe rritjen e të ardhurave të tyre. Përgjate vitit 2017 ky projekt u pezullua për të riparë mundësinë e realizimit të tij në vitin tjetër kalendarik.
- ✓ Panairi Kombëtar: “Shqipëria punon tokën- Konsumo shqip”. Ky panair kishte si qëllim promovimin e produkteve vendase autentike si dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor. Ky panair mblodhi rreth 70 fermerë që reklamuan produktet e tyre bujqësore, blegtorale dhe një hapësirë iu dedikua artizanëve të Tiranës. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Shoqatat e Agrobiznesit dhe Bashkitë në mbarë vëndin.
- ✓ “Ngritja e pikave të grumbullimit dhe magazinimit”. Aktualisht ende në fazë studimi, ky projekt kërkon të evidentojë nevojën për ngritjen e pikave si dhe zonat më të përshtatshme për ngritjen e tyre.
- ✓ Bashkia Tiranë ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me UNDP (PNUD), ku në kuadër të projektit “Promovimi i zgjidhjeve gjithëpërfshirëse të tregut të punës në Ballkanin Perëndimor” do të implementojë “Paktin Territorial të Punësimit” (PTP) në NjA Baldushk. PTP është një inovacion institucional i bazuar në "planifikimin e negociuar", ku aktorë të ndryshëm në nivel lokal marrin role dhe përgjegjësi plotësuese dhe të ndërlidhura në funksion të objektivave të punësimit. Prej PTP-së do të përfitojnë rreth 318 individë dhe do të sjellë hapjen e mbi 90 vendeve të reja pune për shtresat në nevojë të komunitetit. Ndërhyrjet që do të bëhen në kuadër të këtij Pakti janë:
 - Përgatitja e regjistrit të fermerëve për territorin e Baldushkut;
 - Nxitja e punësimit dhe formalizimi për bizneset e vogla rurale (prodhimi i qumështit dhe perimeve);
 - Turizmi rural – fermë për promovimin e produkteve bujqësore të zonës dhe demonstrimi i proceseve të përpunimit, si një mundësi e re për promovimin e profesionit të fermerëve.

A.2. Në fushën e pyjeve dhe kullotave

- ✓ Krijimi dhe azhurnimi i databazës së fondit pyjor e kullosor të Bashkisë Tiranë, e cila është krijuar mbi bazën e ekonomive pyjore të shprehura në spiërfaqe dhe volum për çdo NjA Rurale sipas VKM Nr. 433, datë: 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike”. Krijimi i kësaj baze të dhënash ka përfunduar brenda vitit 2017, ndërkohë që azhurnimi i saj realizohet në mënyrë periodike çdo 6-muaj.
- ✓ “Plani 10 vjeçar i Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave”. Hartimi i këtij plani ka për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve në kuadër të biodiversitetit pyjor dhe kullosor, ndalimin e degradimit të tyre, krijimin e mundësive përfituese në mbrojtjen, konservimin dhe përmirësimin e burimeve

pyjore dhe kullosore, mbështetjen e turizmit, eko-turizmit, turizmit familjar dhe agroturizmit, shtimin e sipërfaqeve të mbjella, kryesisht në zonat e shfrytëzuara pa kriter e të përkeqësuar, etj. Ky plan ka përfunduar brenda vitit 2017.

- ✓ Analiza e shfrytëzimit të materialit drusor, për furnizimin e enteve dhe popullatës me dru zjarri. Kjo analizë u realizua për të identifikuar nivelin e kostove që sjell shfrytëzimi i materialit drusor nga ana e subjekteve private dhe nga ana e vetë Bashkisë Tiranë. Nga kjo analizë u arrit në përfundimin se kostot më të ulëta të shfrytëzimit të materialit drusor vijnë me anë të bashkëpunimit privat-publik me detyrat si më poshtë:
 - a) Subjekti privat të jetë i ngarkuar për prerjen dhe transportin e materialit drusor, nga pylli deri në pikën e grumbullimit të ngritur nga ana e Bashkisë Tiranë;
 - b) Bashkia Tiranë, nëpërmjet APR-së, të jetë i ngarkuar për asortimin dhe shpërndarjen e materialit drusor te entet publike dhe drejt popullsisë lokale.

A.3. Në fushën e tokave bujqësore


- ✓ Krijimi i një databaze për tokat e dhëna me qira, për menaxhimin e sipërfaqeve të tokave bujqësore në pronësi të BT-së.
- ✓ Krijimi i një databaze për të dhënat statistikore në lidhje me bujqësinë e blegtorinë për 13 NjA Rurale të BT-së.
- ✓ “Shërbimi Këshillimor Bujqësor”. Nëpërmjet këtij shërbimi, fermerëve u ofrohet asistencë e vazhdueshme në lidhje me teknologjinë e re të prodhimit bimor, blegtoral, sigurimin e inputeve cilësore, tregjeve, çmimet, legjislacionin, manaxhimin e fermës, mundësitë e kreditimit, përpunimit, etj. Ky shërbim realizohet çdo vit nga muaji shtator deri në muajin qershor të vitit pasardhës.

4.6.1 Bujqësia

Spektori i bujqësisë në Shqipëri ka luajtur gjithmonë dhe vazhdon të luajë një rol shumë të rëndësishëm ekonomik dhe social për vendin. Thuhet gjysma e popullsisë shqiptare jeton në zonat rurale ndërsa prodhimtaria bujqësore përbën rreth 1/5 e PBB-së vjetore të vendit. Prodhimtaria bujqësore e blegtorale e Qarkut të Tiranës deri në vitin 1990 ka qenë e përqendruar kryesisht në prodhimin e perimeve, qumështit, vreshtat dhe frutikulturën. Tirana siguron rreth 8 - 10% të prodhimit të perimeve në shkallë vendi, 8% të numrit të rrënjëve të ullirit dhe 11% të sipërfaqes së vreshtave.

Sipërfaqja e përbërë nga NjA rurale është rreth 106,198 ha. Të dhënat e marra nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë (DRB) për vitin 2015 tregojnë se rreth 20,638 ha e kësaj sipërfaqeje përbëhet nga tokë bujqësore e punueshme. NjA me sipërfaqen më të lartë të tokës së punueshme është ajo e Zall – Herit e cila zë rreth 13% të totalit, e pasuar nga ajo e Petrelës dhe Ndroqit me rreth 10% tokë të punueshme për secilën njësi. Si rrjedhim këto njësi janë ato të cilat kanë më shumë potencial për zhvillimin e bujqësisë. Ndërkohë Krraba është njësi me më pak tokë bujqësore të punueshme pasi ka vetëm 1% të totalit të tokës së punueshme. Kjo vjen edhe për shkak të relievit kryesisht kodrinor/malor të kësaj njësie.

Figura Nr 10: Harta e sistemit bujqësor në Bashkinë e Tiranës



Burimi: Bashkia Tiranë, PPV TR030

Qarku i Tiranës dallohet kryesisht për prodhimtari të lartë të arrave, perimeve dhe pemëve frutore. Sipas INSTAT, për vitin 2017 prodhimi i bimëve të arrave ka qenë rreth 720,004 ton nga të cilat rreth 90% zënë bimët foragjerë. Ndërkohë që mesatarisht ky Qark prodhon 124,148 ton perime në vit nga të cilat rreth janë 65% perime të njoma, 9% perime të thata dhe 26% perime bostanore .

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna më të detajuara për vitin 2017 për mbjelljen dhe prodhimtarinë e produkteve kryesore bujqësore të Qarkut të Tiranës.

Tabela Nr 5: Mbjellja dhe prodhimi në bujqësi Qarku Tiranë (2017)

Lloji	Nr. i Rrënjëve		Sip. e mbjellë (HA)	Prodhimi (Ton)	Rendimenti Kv/ha ose Kg/rrënjë
	Gjendje	Në Prodhim			
Tir Bimë të arave	-	-	36,285	720,004	198

ana Qark	Perime (gjithsej)	-	-	6,081	124,148	204
	Peme frutore	893,269	739,595	-	15,778	21.3
	Ullinj *	869,068	612,220	-	6,238	10.2
	Vreshta	809,290	758,450	-	9,234	12.2
	Pjergulla	500,430	455,220	-	7,389	16.2
	Agrume	89,865	60,960	-	1,228	20.1

Burimi: Vjetari Statistikor i Bujqësisë 2017

Shënim: Nga prodhimi total i ullinjve, rreth 95% e tyre përpunohen për prodhim vaji ndërsa pjesa tjetër prej 5% shkon për konsum tavoline.

Tirana është gjithashtu e njohur për një varietet ulliri që njihet si “Ulliri i bardh i Tiranës”, aktualisht numërohen rreth 600 mijë rrënjë të shpërndara në gjithë territorin e BT-së. Ky varietet mbahet si një ndër varietetet autoktone më cilësore të ullirit në Shqipëri për shkak të vlerave të pasura ushqimore dhe anti-kancerogjene që përmban¹³. Mes zonave që mbahen për kultivimin e këtyre varieteteve mund të përmendim: Tujani, Petrela, Preza, Vrapit etj. Megjithatë kjo kulturë shekullore e ullirit të Tiranës gjendet gjithashtu e rrezikuar pasi Ulliri tradicional dhe cilësor i Tiranës, po zëvendësohet me shumë lloje të ndryshme varietetesh.

Tirana kultivon edhe dy varietete autoktone rrushi për verë që njihen si Sheshi i Bardhë dhe Sheshi i Zi. Megjithatë, thuhet në gjithë kodrat e Tiranës plantacionet e mëdha të vreshtave autoktone janë zëvendësuar me parcela të vogla vreshtash të shumëllojshme ku trajtimi i pakontrolluar me kimikate dhe pesticide mbetet një nga problematikat më serioze. E njëjta problematikë ekziston edhe për frutikulturën, ku mungon veçanërisht kontrolli i farave dhe fidanëve. Për të nxitur eksportin e këtyre produkteve si dhe shfrytëzimin e tyre në funksion të agroturizimit është shumë e nevojshme të krijohet mekanizma kontrolli rigoroz dhe të nxitet plotësimi i standardeve evropiane të kualitetit.

Për sa u përket serrave, gjithsej në gjithë territorin e Shqipërisë ka rreth 1243 ha Serra¹⁴, nga të cilat 1,173 ha janë serra diellore ndërsa 70 ha e tjera janë me ngrohje. Sipërfaqja e serrave të mbjella me perime në Qarkun e Tiranës është rreth 85 ha (rreth 7% e sipërfaqes në rang kombëtar) ku për vitin 2015 janë prodhuar rreth 2,762 ton perime. Rendimenti mesatar i perimeve të mbjella në Serra është rreth 3 deri 4 herë më i lartë sesa rendimenti i atyre të mbjella nëpër fusha. Për këtë arsye është e nevojshme që BT të marrë në konsideratë shtimin e numrit të serrave në territorin e saj me qëllim që edhe rendimenti i prodhimit të perimeve të jetë më i lartë se ai aktual.

Që prej vitit 2015 qeveria ka nisur të bashkëpunojë ngushtë me sektorin bankar për të trefishuar numrin e serrave në vend për shkak se potenciali i lartë bujqësor mbetet ende i pashfrytëzuar totalisht. Mbështetja financiare për ndërtimin e serrave të reja do të vijë në masën prej rreth 60% nga skemat kombëtare dhe rreth 40% nëpërmjet partneritetit me bankat e vendit. Nga ky bashkëpunim do të përfitojë gjithashtu edhe Qarku i Tiranës dhe rrjedhimisht edhe BT.

Në lidhje me bujqësinë organike sektori bujqësor në Shqipëri përballet ende me disa sfida. Fillimisht ka ende mangësi në lidhje me legjislacionin e prodhimeve organike, i cili duhet të plotësohet dhe adaptohet sipas legjislacionit për prodhimin organik të BE-së. Në vitin 2011 numëroheshin mbi 120 prodhues organikë në gjithë Shqipërinë. Shumica e tyre janë të vendosur përgjatë rajonit Tiranë - Durrës ku edhe kërkesa e tregut për këto prodhime është më e lartë si dhe në zonat e tjera fushore të Fierit, Lushnjës, Kavajës dhe Vlorës. Mendohet që prej 2011-ës numri i këtyre prodhuesve të jetë shtuar, megjithatë mbetet mangësi dhe disponueshmëria e informacionit të plotë mbi numrin dhe vendodhjen e saktë të tyre.

Përveç tokës së punueshme, potenciali bujqësor i një zone varet edhe nga disponueshmëria e një sërë kushteve të tjera gjeografike dhe natyrore. Aktualisht, PPVBT ka identifikuar katër korridore me

¹³Burimi: Universiteti Buqësor i Tiranës, 2015

¹⁴Vjetari Statistikor 2015, INSTAT

potencial prodhimtarie me të lartë për shkak të pozicionit gjeografik dhe të disponueshmërisë së baseneve ujore. Këto korridore janë:

- Lugina e Pezës
- Lugina e Baldushkut
- Zona e Ndroqit
- Lugina Bërzhitë

Duke lidhur këto zona me infrastrukturën e duhura, logjistikë efektive, magazinim dhe transport në tregje, do të arrihet ndërtimi i zinxhirëve të vlerave të qëndrueshëm që mbështesin fermerët e vegjël dhe të mëdhenj. Projektet e investimeve duhet të zhvillohen duke përshkruar se cilat janë mundësitë dhe strategjitë në periudhën e ardhshme 15 vjeçare. Korridoret duhet të përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet qeverisë shqiptare, kompanive private, donatorëve, institucioneve të zhvillimit.

Ky koncept do të përmirësojë strukturën e financimit dhe skemat e kredive, në veçanti për fermerët e vegjël dhe tregtarët e produkteve të agrobiznesit duke lehtësuar aksesin e fermerëve në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Kështu, do të incentivohet zhvillimi rural dhe rritja ekonomike e zonës.

4.6.2 Blegtoria

Qarku i Tiranës zë një vend të rëndësishëm përsa i përket prodhimeve blegtorale. Kështu, për vitin 2017¹⁵ ky Qark kontribuon me 10.3% të prodhimit të qumështit, 8% të prodhimit të mishit, 7.9% të prodhimit të vezëve, 6.7% të prodhimit të mjaltit dhe 5.2% të prodhimit të leshit. Struktura e blegtorisë për Qarkun paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr 6: Numri i krerëve për Qarkun e Tiranës (000)

	Gjesh ë	Lopë	Të imta	Të leshta	Dele	Të dhirta	Dhi	Derra & Dosa	Njethu - ndrakë	Shpend ë	Pula	Bletë
Shqipëria (000 krerë)	475	349	2,859	1,926	1,407	933	717	180	89	7,835	4,820	290
Qarku i Tiranës (000 krerë)	43	34	134	76	62	58	47	3	7	687	429	22
% e QT në rang vendi	9.1%	9.8%	4.7%	3.9%	4.4%	6.2%	6.6%	1.6%	7.5%	8.8%	8.9%	7.6

Burimi: INSTAT, Vjetari Statistikor i Bujqësisë

Për sa i përket fermerëve, në territorin e Bashkisë rezultojnë rreth 15,000 fermerë të regjistruar ndërkohë që për disa NJA, si Petrelë, Farkë, Krrabë dhe Ndroq ende nuk ka informacion të saktë¹⁶.

¹⁵Vjetari Statistikor 2017, INSTAT

¹⁶Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural, Bashkia Tiranë

Aktualisht BT ka vënë në dispozicion të fermerëve Shërbimn Këshillimor Burjqësor e Blegtorial për të qenë më pranë nevojave të tyre dhe për të dhënë asistencë teknike mbi:

- Përmirësimin e cilësisë së produkteve të tyre dhe rritjen e aksesit në tregje
- Nxitjen e bashkëpunimit mes fermerëve për krijimin e Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB)¹⁷, shitje më të mëdha të produkteve të tyre. Ky shërbim është shumë i rëndësishëm për të siguruar një rritje të qëndrueshme të ekonomisë rurale dhe për të nxitur edhe më tej shitjen e prodhimeve Made in Tirana.
- Duke i dedikuar më shumë vëmendje fermerëve të rinj, BT synon të sjellë më shumë inovacion në zonat rurale, duke fuqizuar ekonominë e fshatit.

4.6.3 Sistemi i Ujitjes dhe Kullimit

BT është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe administrimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të gjithë territorit të BT-së si dhe të infrastrukturave mbrojtëse nga përmbytjet. Gjithashtu merr masa të sigurojë që nevojat e prodhuesve bujqësorë për ujitje të plotësohen, uji i tepërt të largohet duke parandaluar përmbytjet si dhe të parandalojë zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit të ujërave nëpërmjet kontrolleve periodike.

Qarku i Tiranës ka rreth 114 kanale të para dhe të dyta të sistemit të ujitjes. Këto sisteme janë pjesë përbërëse e një tërësie ujore e cila fillon me pellgjet e vegjël ujëmbledhës, rezervuarët artificialë, kanalet kryesore të ujitjes si dhe ato dytësore. Për një rivitalizim të tokave bujqësore të zonës së BT-së është e domosdoshme mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i tyre. Sipërfaqja totale e ujitur rregullisht në rang Qarku është rreth 14,733 ha ndonëse potenciali i tokës që mund të ujitet është 25,070 ha, ndërkohë që kanale të para dhe të dyta janë rreth 387 km.

Tabela Nr. 7 Sipërfaqja bujqësore për Qarkun Tiranë me aftësi ujitëse, 2017 (ha)

Vendi	Aftësia ujitëse		
	Potenciale	Aktuale	Sip faktike e ujitur
Tirana Qark	25070	18542	14733
Vendi	354366	233442	171064
% Tiranës	7.07%	7.94%	8.61%

Burimi: INSTAT

Në territorin e BT-së¹⁸ ndodhen 46 rezervuar. Lidhur me problematikat që ndeshen në këtë fushë BT ka krijuar strukturat përgjegjëse të cilat janë duke hartuar plane veprimi dhe duke marrë masa në bashkëpunim me institucione të tjera në nivel vendor për përmirësimin e infrastrukturës së këtij sistemi.

Bazuar në kapacitet ujëmbledhës të rezervuarëve, gjëndjes teknike dhe funksionimit të sistemeve të ujitjes, rezulton që në vitin 2017 kemi këtë panoramë të ujitjet së kryer, e ndarë sipas Njësisve Administrative-Territoriale.

Tabela Nr. 8 Të dhë mbi potencialin dhe situatën e sistemit ujitës 2017

¹⁷Një formë modern kooperatizimi ku fermerët vazhdojnë të jenë pronarë të tokës së tyre, por në këtë rast organizohen së bashku për të përfituar më shumë fonde zhvillimi, ulje të kostove të përpunimit dhe grumbullimit, për të patur më shumë siguri në shitjen e produkteve, etj.

¹⁸Drejtoria e Punëve Publike, Bashkia Tiranë

Nr.	NJA	Sipërfaqe e kultivuar gjithsej (Ha)	Aftësia Ujitëse		Sipërfaqe faktike e ujitur në 2017 (Ha)	Fermërë	
			Potenciale	Aktuale		Nr. Fermereve gjithsej	Fermerët perfitues 2017
1	Baldushk	1670	600	455	450	1040	674
2	Bërshitë	1316	800	590	450	1005	69
3	Dajt	1790	505	350	350	968	550
4	Kashar	1570	994	801	694	2499	1856
5	Ndroq	2115	850	650	650	2005	1370
6	Pezë	1455	750	550	500	1287	875
7	Petrelë	2128	870	450	400	1410	987
8	Farkë	1518	500	300	200	1800	1260
9	Shëngjergj	1496	370	330	330	543	3525
10	Vaqarr	1443	600	400	380	1900	1347
11	Zall-Bastar	1166	920	755	610	1584	1164
12	Zall_Herr	2730	2000	1645	1595	1916	1137
13	Krabë	241	140	135	119	220	120

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Nr 2 e Punëtorëve

BT realizoi një inventar dhe një analizë në terren lidhur me situatën aktuale të tyre. Gjatë vitin 2017 filloi menjëherë ndërhyrja për pastrimin dhe rikthimin në funksion të sistemit sidomos në zonat ku edhe nevoja qenë më e madhe.

Tabela Nr. 9 Të dhëna mbi ndërhyrjet në sistemin e kullimit dhe ujitjes 2016 - 2017

	Të dhënat analitike	Vitet		
		2016	2017	
1	Sipërfaqe e mbuluar me sistem (ha)	Ujitje	6583	7411
2		Kullim	1890	2190
3	Total (km) kanale kulluese		51,6	51,6
4	Total (km) kanale ujtesë		165	185
5	Total (km) kanale ujtesë pastruar		12,8	44,3
6	Total (km) kanale kulluese pastruar		2,5	43,33

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Nr 2 e Punëtorëve

Gjatë vitit 2017, janë kryer një sërë ndërhyrjesh në sistemet e kullimit dhe të vaditjes. Për sa i përket kullimit, janë rehabilituar rreth 43 km kanale të para dhe të dyta kullimi ose një sipërfaqe totale prej rreth 535 ha. Ndërsa për sa i përket sistemit të ujitjes, janë rehabilituar rreth 44 km kanale te para (rreth 4,231 m³) ku tashmë sipërfaqja e shtuar të cilës i rikthehet ujitja është rreth 31 ha.

Nevoja e riaktivizimit te sistemeve të ujitjes me ngritje mekanike.

Nje aspekt i zhvillimit afatgjatë të sistemeve të ujitjes, është dhe rindërtimi dhe riaftësimi i sistemeve ujitëse me ngritje mekanike. Kjo, mbi bazën e vënies nën ujë të tokës bujqësore që nuk mund të ujitën me rrjedhje të lirë.

Ky objektivi bazohet në riaftësimin dhe vënien në përdorim të sipërfaqeve të tokës bujqësore, të cilat për shkak të vendndodhjes së tyre, nuk mund të shfrytëzohen aktualisht sistemet e ujitjes me rrjedhje të lirë dhe janë planifikuar me sisteme me ngritje mekanike. Për arsye të amortizimit dhe dëmtimeve, këto stacione pompimi janë jashtë funksionit. Rindërtimi dhe vendosja në funksionim e tyre do të shërbente në vënien në përdorim të sipërfaqeve të tokës bujqësore djerrë, duke ndikuar në ekonominë e këtyre fermerëve. Riaktivizimi i këtyre sistemeve me ngritje mekanike mund të rezultojë efektiv për arsye të:

- Paisja me sistem vaditje e sipërfaqeve të tokave bujqësore, që deri tani janë pa ujitje, duke patur një efekt pozitiv në zhvillimin e ekonomisë së fermerëve në aspektin bujqësor dhe të agroturizmit.
- Riaktivizimi dhe ristrukturimi te OPU (Organizatave të Përdoruesve të Ujit) që do të jetë një element i rëndësishëm në menaxhimin e këtyre sistemeve.
- Ndryshime teknologjike, për rritjen e fuqisë së pompave dhe uljen e konsumit të energjisë elektrike, që do të sjellin uljen e kostos për m³ ujë dhe përballimin e saj nga ana e fermerëve.

Në këtë kontekst duhet të kryhet:

- Identifikimi dhe vlerësimi i tërësisë së gjendjes teknike të STP-ve (stacione pomponimi) në territorin e BT-së
- Realizimi i një studimit teknik-ekonomik për këto sisteme, për të vlerësuar se cilat rrjete do të jenë funksionale në kuadër të investimeve kapitale që nevojiten, shpenzimet operative të domosdoshme dhe mundësinë e përballimit të tyre nga ana e fermerëve në bazë të sipërfaqeve të ujitura.
- Mundësia e mbështetjes nga ana e BT-së për OPU-në në aspektin financiar dhe organizativ të menaxhimit.

4.6.4 Pyjet dhe Kullotat

Në bazë edhe të Ligjit 139/2-15 “Për Vetëqeverisjen Vendore” tashmë kompetencat e BT-së në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë dhe administrimit të pyjeve janë zgjeruar dhe përfshijnë edhe administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik dhe mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit sipas legjislacionit në fuqi. Aktualisht, fondi i pyjeve dhe kullotave të BT-së zë një sipërfaqe prej 36,567 ha. Në tabelën e mëposhtme paraqitet sipërfaqja e fondit e detajuar sipas njësive administrative rurale.

Tabela Nr 10: Sipërfaqja e Fondit të Pyjeve dhe Kullotave sipas NJA-ve.

Njësia Administrative	Sipërfaqe e Fondit Pyjor e Kullor (ha)
Baldushk	8,557.44
Berzhitë	4,419.95
Vaqarr	1,818.74

Ndroq	2,461.65
Shëngjergj	3,864.19
Dajt	1,603.32
Kashar	547.24
Krrabë	1,399.66
Petrelë	3,148.29
Pezë	7,400.88
Zall - Herr	1,345.75
Total	36567.11

Burimi: Drejtoria e Statistikave, Bashkia Tiranë

Shënim: Në Listë nuk është përfshirë Njësia administrative Farkë pasi nuk ka përfunduar procesi i transferimit të pyjeve dhe kullotave nga kjo njësi në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe Njësia Zall – Bastar.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve ka qenë një ndër problemet kryesore me të cilën Shqipëria është përballur prej viteve 90 e deri më sot. Mungesa e kontrollit dhe zbatimit të ligjit ka bërë që situata të dalë jashtë kontrolli duke sinjalizuar alarmin. Rajoni i Tiranës gjithashtu nuk ka mbetur i pa prekur nga ky fenomen ku zona më e rrezikuar në këtë drejtim ka qenë ajo e Parkut të Madh të Dajtit e shpallur zonë e mbrojtur e kategorisë II me VKM nr. 402, datë 21.06.2016 si dhe zona e Malit me Gropa – Bizë-Martanesh e shpallur zonë e mbrojtur e kategorisë V me VKM nr. 49, datë 31.01.2007.

Moratoriumi i cili ka hyrë në fuqi më datë 11 Shkurt 2016 parashikon të ruajë fondin pyjor publik/privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nga shpyllëzimi pa kriter për tregtimin/eksportin e lëndës drusore dhe produkteve të tij për një periudhë 10 vjeçare. Nga ky moratorium përjashtohen vetëm rastet kur shfrytëzimi i lëndës drusore bëhet për plotësimin e nevojave të banorëve të bashkive për dru zjarri apo për rigjenerimin, shëndetësimin e pyjeve dhe pastrimin e mbetjeve drusore si dhe nëse ndryshon destinacioni i fondit pyjor dhe të kullës sipas legjislacionit në fuqi.

Për herë të parë ka nisur dhe hipotekimi i fondit pyjor në pronësi të BT-së e cila do të ndihmojë në evidentimin e problematikave që kanë të bëjnë me zënien e fondit pyjor dhe keq-administrimin e tij. Për këtë qëllim në Malin e Dajtit është vendosur një kamera termike për evidentimin e zjarreve në kohë reale dhe një kullë vrojtimi nga ku do të bëhet evidentimi i aktiviteteve të jashtëligjshme për rreth 300 km katrorë hapësirë pyjore. Monitorimi do të jetë i vazhdueshëm duke funksionuar 24 orë/7 ditë dhe fillimisht do nisë për zonën Kllojkë, Fag dhe Shëngjergj si pjesa më me rëndësi e fondit e më pas do të shihet mundësia e zgjerimit të rrezes së monitorimit. Përveç kësaj, në portalin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit (APR) është vendosur gjithashtu një hapësirë ku qytetarët kanë mundësi të denoncojnë personalisht dhe në kohë reale shkeljet e evidentuara prej tyre.

4.7 TURIZMI

Tirana është një qytet me një zhvillim të vrullshëm, shumë i përshtatshëm për vizitorë që tërhiqen nga qytete dinamike, rinore dhe me kontraste kulturore të cilat në kryeqytetin Shqiptar bashkëjetojnë në harmoni me njëra-tjetrën. Si kryeqytet i një shteti në zhvillim e sipër, Tirana po përjeton një zhvillim me

përmasa të mëdha ndaj mbetet një destinacion që ngjall mjaft interes tek turistët e huaj, sidomos ata të cilët preferojnë vende autentike të cilat ende nuk janë mbipopulluar me turistë.

Sipas Këshillit Botëror për Udhëtimet dhe Turizmin (KBUT)¹⁹ Shqipëria ka patur një ndër rritjet më të mëdha në sektorin e Turizmit në Evropë vitet e fundit dhe pritet që të vazhdojë të rritet konsiderueshëm edhe në dekadën e ardhshme. Kështu numri i të punësuarve në mënyrë direkte dhe indirekte nga kjo industri për vitin 2017 ka qenë rreth 291,500 persona duke përbërë rreth 24.1% të totalit të punësuarve në Shqipëri.

Ndërsa kontributi total i këtij sektori në PBB-në me çmime korrente e vendit për vitin 2017 ka qenë rreth 414.2 miliard lekë ose 26.2% e totalit të PBB-së së vendit. Për më tepër, sipas parashikimeve të tyre pritet që pas 10 vitesh, pra në vitin 2028, kontributi total në PBB-në e Shqipërisë me çmime korrente të jetë rreth 28.9%, ndërsa në nivel punësimi të kontribuojë për rreth 27.3% të totalit të të punësuarve. Në vitin 2016 Shqipëria gjeneroi rreth 228.9 miliard lekë që vetëm prej shpenzimeve të tilla dhe pritet që për 10 vitet e ardhshme të ketë një rritje në 385.5 miliard lekë. Ndërkohë që me rritjen e pritshme të sektorit të turizmit në Shqipëri edhe investimet kapitale në këtë sektor mendohet të arrijnë rreth 52.1 miliard lekë në vitin 2028, sërish sipas të njëjtit burim (KBUT).

4.7.1 Turizmi në Tiranë

Turizmi në Tiranë gjithashtu ka pasur një bum të vërtetë cilësor dhe sasior në vitet e fundit. Këtë e tregon më së miri hapja e mjaft hoteleve, hosteleve dhe njërive të tjera akomoduese ekonomike, mesatare dhe luksoze. Në bazë të të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) të BT-së sot zhvillojnë aktivitetin e tyre rreth 220 njësi të tilla akomoduese. Numri gjithmonë e më i lartë i njërive akomoduese, restoranteve apo aktiviteteve të tjera argëtuese, por edhe eksperiencat më të gjatë në ofrimin e shërbimeve të mikpritjes dhe atyre argëtuese i japin Tiranës mjaft avantazh në lidhje me konkurrencën vendore përsa i përket cilësisë në ofrimin e shërbimit turistik.

Zyra e Informacionit Turistik (ZIT) pranë BT-së vizitohet çdo ditë nga turistë me prejardhje nga të 5 kontinentet (Tabela Nr 8) për të marrë informacione të ndryshme mbi Tiranën (transportin, atraksionet e qytetit, restorantet, hotelet, hostelet, qendrat tregtare, mbi atraksionet rreth e qark qytetit por edhe për qytete të tjera karakteristike etj.). Duhet theksuar se numri i turistëve që paraqitet në tabelën e mëposhtme nuk është numri total i turistëve që vizitojnë Tiranën, por vetëm të atyre që vijnë në mënyrë individuale dhe të paorganizuar në Tiranë e që kërkojnë informacion nga ZIT.

Tabela Nr 11: Numri i Turistëve sipas origjinës/kontinenteve

Turistë sipas origjinës	Zyra e informacionit turistik	Kulla e Sahatit
Evropë	3798	4975
Azi	314	203
Amerikë	257	223
Afrikë	78	4
Australi	133	42

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, pranë sportelit kryesor të ZIT kanë marrë informacionin e kërkuar rreth 1,313 turistë. Sipas të njëjtit burim sezoni i verës është ai që mirëpret më shumë turistë në krahasim me muajt e tjerë. Një pjesë e madhe e këtyre vizitorëve qëndrojnë në Tiranë për një periudhë të shkurtër,

¹⁹<https://ë.ë.ë.ttc.org/>

përpara se të drejtohen drejt rivierës apo alpeve të cilat janë më të parapëlqyerat gjatë këtij sezoni nga turistët e huaj.

Një strategji e mirë e BT-së në këtë rast, për ta zgjatur mesataren e qëndrimit të turistëve në kryeqytet gjatë periudhës së verës është organizimi i eventeve kulturore, tradicionale apo festivaleve verore të mirë organizuara të cilat mund të kthehen dhe në traditë të përvitshme. Gjithashtu edhe krijimi i një strategjie për zbutjen e sezonalitetit turistik duke futur elemente të ngjashme kulturore dhe kreative edhe gjatë muajve të vjeshtës dhe dimrit do e bëjnë Tiranën atraktive për turistët.

Deri në vitin 2015, BT planifikonte kryesisht zhvillimin e turizmit në kryeqytet, pra në pjesën urbane. Tashmë me reformën territoriale dhe zgjerimin e territorit nën administrimin e saj, BT ka përfshirë në planin e zhvillimit turistik edhe 13 NJA rurale të cilat kërkojnë vëmendje më shumë se kurrë. Tashmë oferta turistike e Tiranës është pasuruar ndjeshëm duke i dhënë mundësi kryeqytetit që të zhvillojë agroturizmin dhe sidomos turizmin outdoor dhe atë të aventurës i cili sa vjen e po kthehet në një nga tipologjitë turistike më të kërkuar në rang global. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit (OBT) turizmi i aventurës përbën një ndër oportunitetet më të mira për rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim e sipër.

4.7.2 Llojet e Turizmit

Megjithatë Tirana ka mjaft potencial dhe mundësi për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit ndër të cilat veçojmë:

1. **Turizmi kulturor** si një nga tipologjitë turistike më të vlerësuara dhe të kërkuara tashmë në tregun botëror. Pellgu i Tiranës mbart një histori të lashtë që provohet nga gjurmët arkeologjike dhe monumentet të trashëgimisë kulturore historike të cilët gjenden në shumë pak kilometra katrorë sipërfaqe dhe përbëjnë një vlerë të shtuar për territorin e Tiranës. Qyteti ka një numër të konsiderueshëm monumentesh kulturore si: Kalaja e Tiranës, Mozaiku i Tiranës, Kalaja e Dajtit, Kalaja e Tujanit, Ura e Brarit, Kalaja e Ndroqit, Kalaja e Dorzit, Kalaja e Petrelës, etj. Gjithashtu në qendër të Tiranës gjenden monumente dhe godina historike për t'u vizituar brenda ditës dhe në një sipërfaqe mjaft të vogël.

Gjithsej numërohen rreth 100 pika turistike nga të cilat 52 janë objekte kulturore²⁰, vlen të veçohet këtu qendra e qytetit të Tiranës e cila është shpallur Ansambël Monument-Kulture i aksit kryesor dhe qendra historike e qytetit të Tiranës. Ky lloj turizmi nxit zhvillimin ekonomik dhe ndihmon në ruajtjen dhe promovimin e vlerave dhe traditave të vendit të cilat në një botë të globalizuar si kjo e sotmja është gjithmonë e më e vështirë të pasohen nga njëri brez tek tjetri.

Artizanati. Ekonomia kreative (kryesisht sektori i artizanatit që zë dhe peshën kryesore në këtë ekonomi) konsiderohet si një sektor ekonomik premtues me potencial për të kontribuar në ekonominë lokale, rajonale dhe atë kombëtare, si dhe në krijimin e vendeve të punës. Edhe pse në Tiranë ka shumë artizanë të aftë që kanë ruajtur brez pas brezi sekretet e punimeve, vlerat dhe cilësitë të reflektuara në veprat artistike, nuk janë të identifikuara produktet artizanale karakteristike të qytetit. Gjithashtu nuk ekziston asnjë ambjent i dedikuar posaçërisht për ekspozimin e tyre. Për të adresuar këto problematika, këtë vit BT ka ndërmarrë një sërë iniciativash të cilat synojnë mbështetjen në sektorin e prodhimit të produkteve artizanale me qëllim fuqizimin e tij dhe ruajtjen e traditave kulturore artistike.

2. **Turizmi i aventurës.** Ky lloj turizmi po merr zhvillim të vullshëm në gjithë Shqipërinë por gjithashtu dhe në Tiranë. Krijimi i shtigjeve turistike dhe infrastrukturës për hiking e biking po

²⁰Bashkia Tiranë, opendata.tirana.al

përqëndrohet kryesisht në asetet natyrore dhe kulturore të territorit të BT-së. Shtigjet për hiking në shumicën e rasteve ndjekin rrugët e vjetra në zonat rurale të cilat të çojnë drejt atraksioneve natyrore dhe atyre kulturore. Megjithatë pjesa rurale e Tiranës ka mjaft potencial ende të pashfrytëzuar për të zhvilluar turizmin e aventurës edhe në përgjithësi atë natyror/peisazhor. Kjo zonë është shumë e pasur me atraksione dhe monumente natyrore.

- 3. Agroturizmi dhe turizmi kulinar.** Edhe këto tipologji turistike qëndrojnë në bazë të ofertës turistike të Tiranës. Shijimi i ushqimeve karakteristike krahinore së bashku me peizazhin e mrekullueshëm rural dhe ajrin e pastër shpalosin kënaqësitë që sjell agroturizmi. Këto dy vite BT i ka kushtuar vëmendje të madhe zhvillimit rural duke nxitur dhe mbështetur fermerët për prodhimin e produkteve Made in Tirana. Megjithatë është e nevojshme që të punohet më tej për nxitjen e certifikimit të produkteve dhe fermave bio dhe organike me qëllim rritjen e kualitetit ushqimor dhe sidomos nxitjen e konkurrencës duke ofruar gjithmonë e më shumë shërbime pranë standardeve Evropiane. Në qytet por edhe në rrethina ka mjaft restorante dhe resorte të cilat servirin një menu të pasur me pjata tradicionale por dhe me kuzhinë ndërkombëtare. Ata sjellin përzierjen më të mirë të kuzhinës vendase me menutë e njohura orientale e Evropiane ndër të cilat dallohen restorantet që servirin menu italiane, turke, greke, kineze, japoneze, etj.
- 4. Turizmi fetar.** Shqipëria është një ndër vendet me diversitetin më të lartë religjioz dhe dallohet për tolerancën e lartë fetare. Karakteristikë në Shqipëri është fakti se festat fetare si Pashkët, Krishtlindjet apo Bajrami festohen thuajse nga të gjithë pa dallim feje. Përpos kësaj, në Shqipëri vazhdojnë të festohen ende festat pagane si psh 14 marsi apo “Dita e Verës” dhe 6 maji “Dita Shën Gjergjit” e cila është një festë kristiane por me rrënjë pagane.
- 5. Turizmi i konferencave.** Përsa i përket turizmit të konferencave, Tirana është vendi ideal për organizimin e konferencave, seminareve, simpoziumeve, panairove, ëorkshopeve, etj. Industria e turizmit në Tiranë, duke u fokusuar në Evropën juglindore, mund të përfitojë nga një rritje e numrit të seminareve, kongreseve dhe konferencave që organizohen në qytet. Megjithatë ekziston një nevojë e madhe për përmirësimin e reputacionit të Tiranës si dhe të shërbimeve dhe lehtësirave faktike në sektorin e turizmit, me qëllim ofrimin e më shumë stimuljve për organizatorët e ngjarjeve të tilla. Tirana, me një kapacitet prej më shumë se 3,000 vende për të fjetur në hotelet e saj të shumtë si dhe me sallën Pallatit të Koncerteve, me një kapacitet prej 2,500 vendesh është shumë e përshtatshme edhe për zhvillimin e turizmit të konferencave.
- 6. Turizmi Rajonal.** Kjo tipologji turizmi karakterizohet nga një ndërthurje e tipologjive të mësipërme por të zhvilluara tashmë në rang rajonal. Kjo ndodh duke krijuar udhëtime turistike rajonale (me zonat apo bashkitë e tjera të afërta) të cilat mund të pasurojnë më tej ofertën turistike të Tiranës. Një shembull i mirë është promovimi i turizmit për rajonin Tiranë-Durrës. Afërsia e konsiderueshme midis dy qyteteve favorizon kryesisht Tiranën duke i dhënë mundësinë e përfshirjes së bregdetit Adriatik dhe arkeologjisë së pasur të Durrësit në itinerarin e saj turistik duke e pasuruar ofertën e saj. Përveç kësaj, bizneseve të këtyre aktiviteteve apo dhe atyre që duan të përfshihen në itinerar do u ofrohet asistencë teknike dhe financiare për përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre me qëllim arritjen e standardeve të nevojshme.
- 7. Turizmi dentar** është përhapur konsiderueshëm vitet e fundit në Tiranë për arsye të kostove të ulta që ka shërbimi dentar krahasuar me vendet e tjera. Oferta për shërbimin dentar në Tiranë është me çmime mjaft të arsyeshme krahasuar me shumë vende Evropiane apo dhe SHBA, Kanada, Australi, etj. Kështu që ka një numër gjithmonë e më në rritje të të huajve, kryesisht italianë, të cilët vizitojnë Tiranën për këtë qëllim.

Duke patur parasysh se numri i turistëve në Tiranë dhe Shqipëri po rritet ndjeshëm çdo vit, është shumë e rëndësishme që asetet kulturore e natyrore të Tiranës të cilat promovohen vazhdimisht të jenë gjithashtu më të aksesueshme prej turistëve. Në këtë aspekt, BT ka investuar kohët e fundit në ngritjen e disa

tabelave informuese dhe orientuese në zonat kryesore turistike të qytetit, vendosjen e tabelave flamur në çdo NJA, si dhe ka pajisur me tabela dhe harta turistike hyrëse 5 NjA-të rurale (Petrela, Baldushku, Peza, Ndroqi dhe Vaqarri. Mbeten ende për t'u pajisur me këto tabela dhe NJA-të e tjera rurale të cilat po ashtu ofrojnë mjaftë atraksione për vizitorët, por mbartin probleme lidhur me orientimin dhe aksesimin e tyre sidomos nga turistët e huaj.

Një tjetër problem thelbësor në lidhje me aksesueshmërinë dhe orientimin e turistëve në gjithë territorin e BT-së, por më së shumti në zonën urbane është mungesa e stacioneve fizike të autobuzave dhe emërtimi i tyre. Ky mbetet një nga problemet më të evidentuara jo vetëm nga turistët të cilët nuk i njohin zonat dhe nuk dinë të orientohen por edhe për vetë qytetarët është kthyer në problem i cili demotivon përdorimin e transportit publik, duke patur parasysh faktin se Tirana është një qytet që zgjerohet e ndryshon çdo ditë. Mungesa e një sistemi transporti të organizuar dhe sidomos mungesa e stacioneve me emrat përkatës të ndalesave e penalizon mjaft kryeqytetin, i cili aspiron të kthehet në një “smart and green city” ndërkohë që i mungojnë strukturat bazike dhe mekanizmat motivuese për përdorimin e transportit publik.

4.8 EDUKIMI

Ekonomia e Tiranës përfiton shumë nga fakti se ka numrin më të madh të universiteteve dhe shkollave të tjera të të gjitha niveleve. Ky fakt e kthen Tiranën në qytetin me forcën punëtore më të kualifikuar në vend duke e bërë atë më të konkureshme në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Kompetencat e BT-së në fushën e arsimit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 69/2012, Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë si dhe në Ligjin nr. 139/ 2015 për “Vetqeverisjen Vendore”. Sipas këtyre ligjeve, BT është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike.

Kështu, sot në BT numërohen 562 institucione arsimore publike dhe private. Për sa i përket arsimit të lartë, Tirana numëron 8 universitete publike dhe 39 universitete private me 66 fakultete ku studiojnë rreth 115,093 studentë nga i gjithë vendi. Thuajse në të gjitha shkollat e larta të Tiranës ofrohen kushte bashkëkohore të krahasueshme me standartet Evropiane, me një nivel mësimdhënie të lartë dhe të kualifikuar.

Tabela Nr 12: Të dhëna mbi institucionet arsimore Publike dhe Private në BT (2017 - 2018)

Emertimi	DAR Tirana Urbane Publike & Private				DAR QARK Rurale Publike & Private			
	Publike	Nr.nx./fëmijë	Private	Nr.nx./fëmijë	Publik	Nr.nx./fëmijë	Private	Nr.nx./fëmijë
Çerdhe	33	3079	0	0	0	0	0	0
Grupe parashkollore	51	2536	0	0	0	0	0	0
Kopshte	43	7362	51	2091	76	2434	1	40
9-vjeçare	66	47404	40	8716	113	11009	1	407
Shkolla të mesme	14	4207	37	3585	20	2689	2	369
Profesionale	9	6715	5	964	0	359	0	0
Totali	216	71303	133	15356	209	16491	4	816

Burimi: Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore e Shëndetësore në BT

Për sa i përket profilit të arsimit të lartë publik të studentëve të Tiranës tabela e mëposhtme paraqet të detajuar fakultetet që kanë patur numrin më të lartë të studentëve për vitin akademik 2017-2018, në nivelin Bachelor, Master dhe Doktoraturë. Ndërkohë, për sa u përket Universiteteve Private, degët

kryesore të tyre konsistojnë në: Ekonomi dhe Menaxhim Biznesi, Shkenca Politike, Shkenca Sociale dhe Arkitekturë.

Tabela Nr 13: Profilet e studentëve sipas fakulteteve në Universitet Publike (Viti akademik 2017-2018)

Universitete & Fakultete	Bachelor	Master	Doktorant ë	Të gjitha nivelet	%Femra
1.Universiteti i Tiranës	17,916	8,428	1,110	28,394	75.5%
-Fakulteti Ekonomik	3,660	1,759	6	5,479	77.5%
-Fakulteti Gjuhëve të Huaja	3,799	965	0	4,773	80.5%
-Fakulteti Histori Filologji	1,816	1,571	0	3,861	86.3%
-Fakulteti I Drejtësisë	2,021	1,544	0	3,680	71.8%
-Fakulteti I Shkencave te Natyrës	4,700	1,429	0	7,233	63.6%
-Fakulteti Shkencave Sociale	1,920	1,160	0	0	85.9%
2.Universiteti i Mjekësisë	1,455	6,060	470	7,427	85.2%
-Fakulteti I Infermierisë	1,429	1,316	169	3,120	85.2%
-Fakulteti I Mjekësisë	26	1,991	301	4,307	88.4%
3.Universiteti Politeknik	9,958	2,687	174	14,349	31.0%
-Fakulteti Inxh .Ndërtimit	1,872	734	55	4,321	36.5%
-Fakulteti Inxh. Elektrike	1,504	470	15	1,907	10.7%
-Fakulteti Inxh. Mekanike	2,363	368	23	2,791	28.0%
-Fakulteti Inxh.Gjeol.Miniera	2,127	476	38	2,602	31.5%
-Fakulteti Inxh.Mat.e Fizike	820	188	34	1,027	49.5%
-Fakulteti Teknol. Informacionit	1,272	451	18	1,701	39.7%
4.Universiteti Bujqësor Tiranë	6,116	2,308	128	10,727	51.8%
-Fakulteti Bioteknologjisë dhe Ushqimit	814	294	17	1,091	54.4%
-Fakulteti Bujqësisë e Mjedisit	2,519	768	111	3,546	44.9%
-Fakulteti Ekonomi-Agrobiznes	2,595	1,179	0	4,847	60.8%
-Fakulteti Shkencave Pyjore	188	67	42	1,243	8.5%
5.Universiteti i Arteve Tiranë	704	245	0	990	43.7%
-Fakulteti Artit Skenik	183	60	0	238	46.9%
-Fakulteti i Arteve të bukura	256	72	0	334	53.9%
-Fakulteti Muzikës	265	113	0	418	31.6%
6.Universiteti i Sporteve	935	439	0	1,349	32.5%
-Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	494	109	0	785	30.3%
-Fakulteti i Veprimtarisë Fizike	441	82	0	564	34.9%

Burimi: INSTAT

Tjetër aspekt pozitiv është edhe rritja e numrit të të rinjve që regjistrohen në arsimin e mesëm profesional duke rritur më tej kapacitetet e fuqisë punëtore të këtij profili. Për vite me radhë shkollat profesionale në Shqipëri dhe kryesisht Tiranë pësuan një ulje të ndjeshme të numrit të të regjistruarve për shkak se profilet profesionale janë parë gjithmonë si profesione pa perspektivë. Kjo solli si rrjedhim një ç'ekuilibrim të theksuar në sektorin e punësimit ku kërkesa për të hyrë në universitet ishte shumë më e lartë se oferta e punës në degët përkatëse. Nga ana tjetër kishte më shumë kërkesë për profesione si hidraulik, elektrikist, artizanat etj., por nuk kishte krah pune të pamjaftueshëm. Promovimi i vazhdueshëm

i arsimit profesional nga Qeveria, vitet e fundit ka ndihmuar në rritjen e kërkesave për këtë sektor duke i dhënë më shumë frymëmarrje tregut të punës në kryeqytet.

Megjithatë Tirana mbetet mjaft prapa në krahasim me kryeqytetet e tjera të rajonit për sa i përket kërkimit shkencor. BT është duke nxitur në mënyra të ndryshme zhvillimin e inovacionit dhe kërkimit në kryeqytet. Kjo kryesisht nëpërmjet krijimit të kushteve dhe hapësirave fizike, si biblioteka, laboratorë apo qendra inovacioni, restaurimit të laboratorëve ekzistues nëpër godinat shkollore të arsimit para-universitar dhe krijimin e tyre në çdo shkollë të re që ndërtohet. Për sa i përket politikave për nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor, kjo pjesë i përket Ministrisë së Arsimit. Për fat të keq, për arsimin parauniversitar në vitin 2017 Ministria ka përcaktuar 85% të buxhetit për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe vetëm 0.05% të buxhetit ose 42 euro për shkollë (në nivel vendi) do të shpenzohen për kabinete dhe laboratorë shkencorë.

4.9 KULTURA, RINIA DHE SPORTET

Tirana një kryeqytet i zhvilluar dhe modern nuk kërkon vetëm një ekonomi të qëndrueshme apo infrastrukturë moderne por sidomos ofrimin e mundësive për të edukuar dhe stimuluar aritistin dhe qytetarinë. Investimi në kulturë, ndihmon në përmirësimin e bashkëjetesës në komunitet por edhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik si pasojë e pashmangshme që vjen prej zhvillimit njerëzor.

4.9.1 Kultura

Kreativiteti është një opsion politik tërheqës për stimulimin e një sërë objektivave ekonomike, kulturore dhe sociale të orientuara drejt zhvillimit. Investimet e sektorit publik në zhvillimin kreativ kanë përfshirë kryesisht tre qasje:

- Industritë kreative
- Qytetet kreative
- Grupe kreative

BT po i synon të treja këto qasje duke nxitur jo vetëm krijimin e aktiviteteve apo bizneseve kreative dhe inovative por gjithashtu duke investuar në potencialin njerëzor të qytetarëve si katalizatori kryesor për një qytet kreativ.

Tirana ofron gjithmonë e më shumë një program të pasur me aktivitete artistike dhe kulturore me karakter lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilat po kthehen në traditë si p.sh: Bienalja e Tiranës, Panairi i Librit, Artfest, Festivali Ndërkombëtar i Filmit, Nata e Bardhë, Peza n' Fest etj. Këto aktivitete kanë patur impakt të madh në jetën artistike e kulturore të Tiranës, kryesisht janë zhvilluar në qendër të kryeqytetit, ku ndodhen edhe institucionet kryesore kulturore.

Gjatë vitit 2017 vetëm Sheshit Skendërbej si hapësira më e re pedonale e rikthyer tek qytetarët ka mirëpritur rreth 35 koncerte dhe evente masive ku ka patur nje pjesëmarrje prej rreth 70.000 spektatorësh gjithsej. Veç këtyre evenimenteve masive BT ka organizuar dhe mbështetur mbi 100 aktivitete të tjera të një shkalle më të vogël si shfaqje dokumentarësh, ekspozita artistike, aktivitete sociale dhe natyrore, konferenca etj. Prej këtyre aktiviteteve pjesa më e madhe prej 90% janë zhvilluar në zonën urbane, kryesisht në qendër dhe vetëm 10% në zonat rurale.

Organizimi i aktiviteteve në qendër të qytetit shpesh ka privuar rrethinat e kryeqytetit nga jetën aktive komunitare kulturore, kjo edhe për shkak të mungesës së institucioneve kulturore pranë vendbanimeve të tyre. Prandaj BT në PPVBT, ka parashikuar krijimin e Tiranës policentrike me shtimin e pesë qendrave të reja urbane të cilat janë Kombinati, Lapraka, Kinostudio, Bulevardi i Ri dhe Farka. Pajisja me infrastrukturën e duhur dhe shërbime do krijojë disa qendra të reja me karakteristika të veçanta nga njëra-tjetra për të cilat do të hartohen programe me aktivitete kulturore, argëtuese etj.

Gjatë dy viteve të fundit BT përveç kryeqytetit, ka filluar ti kushtojë më shumë vëmendje edhe fshatrave përreth duke zhvilluar shpesh aktivitete turistike apo panaiere me qëllim promovimin e turizmit, kulinarisë, trashëgimisë natyrore dhe kulturore të zonave rurale. Një projekt i rëndësishëm është edhe krijimi i një teatri lëvizës kukullash për fëmijë për të mundësuar gjithashtu argëtimin e fëmijëve në fshatrat më të thella. Në vazhdim BT synon të nxisë më tej festivalet e reja të qytetit si ai Evropian i Filmit, Festivali Ndërkombëtar i Bandave Frymore Muzikore, Festivali Ndërkombëtar i Kulturës së Regjioneve, Festivali i Teatrit të Rrugës, Salloni i Librit Ballkanik etj të cilat panifikohen të zhvillohen si në zonat urbane dhe në ato rurale.

Objektet kryesore kulturore të Tiranës si Muzeu Historik Kombëtar, Galeria Kombëtare të Arteve, Pallati i Koncerteve, Biblioteka Kombëtare, Mozaiku i Tiranës, Shtëpia me Gjethe, etj si dhe shumë institucione të tjera të kulturës, historisë dhe artit kombëtar tërheqin çdo vit një numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj. Sot në Tiranë numërohen pesë teatre, ndër të cilët 1 teatër kukullash, cirku kombëtar (i vetmi në Shqipëri), 7 Kinema ku disa prej tyre kanë më shumë se 1 sallë, 9 muze dhe 2 galeri artesh. Gjithashtu kryeqyteti ka edhe disa qendra kulturore të rëndësishme si Qendra Kulturore “Tirana”, Qendra Kombëtare e Kulturës për fëmijë, Qendra Kulturore “Tulla”, Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike etj. Tirana ka gjithashtu rreth 30 Biblioteka publike dhe universitare. Ndër më kryesoret mund të përmendim Bibliotekën Kombëtare, Biblioteka e Akademisë së Shkencave dhe ajo e Fakultetit të Shkencave të natyrës, Biblioteka e Universitetit Bujqësor të Tiranës etj.

Tirana ka shumë vlera kulturore dhe mjaft burime akoma të pa shfrytëzuara me të cilat mund të krijohen projekte interesante apo vepra tërheqëse dhe të vizitueshme për të promovuar dhe zhvilluar kujtesën e qytetit. Duke konsideruar një hark kohor 5-10 vjeçar, Tirana ka potencial për të zhvilluar edhe institucione të tjera kulturore si: Muzeu Etnografik ku mund të pasqyrohen vlerat historike dhe kultura popullore e zonës së Tiranës; Galeria e Arteve të qytetit me karakter lokal nën vartësinë e BT-së, Galeria e Artistëve të Vegjël ku mund të ekspozohen vetëm punimet e fëmijëve dhe të rinjve nën 18 vjeç, etj.

4.9.2 Rinia

Rinia është një nga pasuritë më të mëdha që ka Tirana. Në territorin e BT-së përqëndrohet më shumë se gjysma e gjithë të rinjve të Shqipërisë (75%), për shkak edhe të numrit më të lartë të universiteteve. Përveç atyre që janë banues të përhershëm të Tiranës, apo studentë të ardhur nga rrethet e tjera të vendit, vitet e fundit janë shtuar shumë edhe numri i të rinjve me prejardhje ndërkombëtare. Shumica e tyre përbëhet kryesisht nga shtetas të rinj italianë, të cilët ndjekin universitetin apo punojnë në Tiranë, shpesh herë nëpër bizneset e shumta të hapura nga bashkë-kombësit e tyre, si call centers, restorante, agjenci kreative etj.

Veç shtetasve Italianë të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të të huajve që banojnë në Tiranë vihet re se është shtuar konsiderueshëm numri i të rinjve nga vende të ndryshme të Europës apo të botës të cilët kryesisht punojnë në sektorin privat duke u bërë rezidentë të përkohshëm e me raste dhe të përhershëm të Tiranës. Kjo larmishmëri kulturore gjithmonë në rritje përbën një ndër aspektet më pozitive për kthimin e Tiranës në një kryeqytet dinamik e me karakter evropian.

Si qyteti ku përqëndrohet thajse gjysma e ekonomisë së vendit, Tirana ofron më shumë mundësi dhe shpresë për të rinjtë e shkolluar jashtë vendit, të cilët duan të vijnë e të punojnë në vendin e tyre duke sjellë eksperiencën e reja. Përveç kësaj Tirana së fundmi po merr trajtën e një qyteti të fokusuar kryesisht tek rinia ç’ka e bën situatën më pozitive dhe shpresëdhënëse për të ardhmen. Kjo përbën një avantazh thelbësor për kryeqytetin por edhe për zonat përreth për shkak se rinia është gjithmonë shtysa e inovacionit dhe ndryshimit të statusit “quo” të komunitetit.

Sipas ‘Indeksit të zhvillimit global të Rinisë’ 2016 (IZHGR), Shqipëria ka patur një ndër rritjet më të konsiderueshme në rajonin e Evropës për sa i përket indeksit të zhvillimit të rinisë. Gjatë pesë-vjeçarit 2010-2015 ky indeks është rritur me rreth 10% duke bërë që Shqipëria të kalojë nga ‘indeksi i lartë i zhvillimit’ tek ai ‘shumë i lartë’. Sërish sipas IZHGR pesë ishin fushat ku Shqipëria shënoi rritje të ndjeshme ku spikat pjesëmarrja më e lartë qytetare dhe vullnetariati. Ndërkohë që përmirësime pati edhe në fushën e punësimit, megjithëse përqindja e të rinjve jo të punësuar, jo në shkollë dhe jo në trajnim është relativisht e lartë, rreth 31%, në krahasim me mesataren globale, e cila qëndron në 20% dhe normën mesatare rajonale të Evropës prej 15%.

BT po i kushton më shumë vëmendje së kurrë rinisë së Tiranës duke i dhënë një rol më të rëndësishëm në organizimin e jetës rinore të qytetit. Në vitin 2014 Këshilli Bashkiak i Tiranës (KBT) dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (QMDFSH) në bashkëpunim me Leadershipin e të Rinjve të Tiranës, themeluan Bordin Rinor Këshillimor pranë KBT-së. Ky bord i jep mundësi të rinjve të Tiranës të përfshihen në proceset dhe vendim-marrjet demokratike, që përbën dhe një ndër objektivat kryesore të Planit Kombëtar për Rininë 2015-2020 (PKR). Gjithashtu, krahas disa komisioneve të reja, në Këshillin Bashkiak u shtua gjithashtu Komisioni për Politikën Rinore. Numri i këshilltarëve të rinj në KB nën moshën 35 vjeç u rrit, duke arritur shifrën 2016. Duke marrë shkas nga kjo, në dhjetor 2016, me ndihmën e CRCA, u krijua Aleanca e Këshilltarëve të Rinj Tiranë, me pjesëmarrjen e 5 partive në KB.

Një tjetër aspekt pozitiv ka qenë firmosja e “Kontratës Sociale për të Rinjtë” nëpërmjet BT-së dhe rrjetit “Zëri i të Rinjve” në vitin 2015. Sipas kësaj kontrate BT ka marrë përsipër përmbushjen e prioriteteve kryesore të të rinjve të Tiranës ku mes të cilave veçojmë çështjet e arsimit dhe trajnimit, mbrojtjes sociale, punësimit, etj. Për sa i përket këtij të fundit, Drejtoria e Nxitjes së Punësimit ka një fond dedikuar të Rinjve prej 10.000.000 lekë për Programin e Biznesit Social Rinor dhe 5.000.000 lekë për programin “Të Rinj dhe të Reja drejt një Profesionit”. Përveç kësaj, Bashkia e Tiranës krijon shpesh herë mekanizma në bashkëpunim me banka të nivelit të dytë të vendit për të stimuluar iniciativat rinore, kryesisht duke ofruar linja krediti për sipërmarrësit e rinj nën 30 vjeç.

Në lidhje me fushën e inovacionit dhe teknologjisë, në bashkëpunim me Fondin Shqiptar-Amerikan të Zhvillimit (FSHAZH), BT ka nisur projektin për kthimin e Piramidës, në një nga qendrat më të mëdha të inovacionit dhe teknologjisë, artit e kulturës, në rajon. Hapësira e re do të shërbejë si një lloj inkubatori për bizneset në fushën e inovacionit, artit dhe kreativitetit dhe do të sjellë një përvojë të re arsimore për të rinjtë nëpërmjet kryqëzimit të teknologjisë dhe dizajnit.

Për sa i përket qendrave rinore ekzistuese, në Tiranë operojnë disa qendra kryesore të fokusuara posaçërisht tek zhvillimi i rinisë:

- Qendra Rinore e Tiranës. Misioni i saj është zhvillimi i veprimtarive rinore, kulturore, artistike, letrare, sportive, organizimi i takimeve, trajnimeve, etj.
- Qendra Multifunktionale “TEN” me synim për tu dhënë të rinjve mundësinë për t’u socializuar në kushte e standarde Evropiane.
- Qendra Multifunktionale pranë Bregut të Lumit nuk është e projektuar vetëm për të rinjtë por do t’u vijë në ndihmë gjithë qytetarëve të zonës të cilët përbëjnë një ndër komunitetet me më shumë probleme sociale në Tiranë.

Për vitet e ardhshme BT parashikon të vijojë me ndërtimin e qendrave të tjera rinore të cilat do të mundësojnë më shumë hapësira rekreative dhe komunitare për të stimuluar iniciativat rinore dhe zhvillimin e tyre.

4.9.3 Sportet

Jeta sportive e qytetarëve të Tiranës nuk ka qenë shumë e zhvilluar vitet e fundit. Kjo për arsye të mungesës në përgjithësi të infrastrukturës dhe ambienteve sportive e rekreative si edhe për shkak të mungesës në përgjithësi të informacionit dhe kulturës shqiptare në lidhje me sportin dhe kujdesin për shëndetin. Megjithatë vihet re gjithmonë e më shumë një rritje e interesit qytetar ndaj një jete më aktive për shkak se dhe kërkesa e tyre ndaj BT-së për ti mundësuar të tilla ambiente është rritur, kryesisht nga të rinjtë dhe prindërit me fëmijë.

Për këtë arsye BT ka vendosur ti kushtojë vëmendje më të lartë sportit në kryeqytet për të përmbushur edhe një ndër objektivat kryesore të vizionit për një Tiranë me qytetarë të kulturuar dhe aktivë të cilët kthehen në aset për qytetin e tyre. Më konkretisht BT synon ta nxisë dhe zhvillojë jetën sportive të qytetarëve të Tiranës duke u fokusuar kryesisht në:

1. Rehabilitimin e terreneve dhe sallave sportive në gjithë shkollat e Tiranës dhe promovimin e sportit dhe jetës aktive si dhe duke aktivizuar ambientet e shkollave si qendra komunitare dhe duke i vënë ato edhe në shërbim të sportit. Deri më sot BT ka rehabilituar një numër të konsiderueshëm terrenesh sportive nëpër shkollat e Tiranës dhe ka nisur një fushatë promovuese ndaj sporteve dhe jetës aktive qytetare më së shumti në mediat sociale të cilat janë më të frekuentuara dhe nga moshat e reja.
2. Krijimin e hapësirave sportive në lagjet e Tiranës, si dhe në çdo NJA rurale, të cilat do shërbejnë edhe si hapësira të integritit të komunitetit.
3. Krijimin e ekipeve të shkollave në sporte të ndryshme si dhe organizimin e kampionateve mes tyre.
4. Rehabilitim i të gjitha ambienteve sportive në pronësi të BT-së dhe krijimin e ambienteve të reja i cili është një proces që ka filluar intensivisht që në 2015-ën.
5. Garantimit të mundësive të barabarta për të gjitha moshat, shtresat dhe personat me aftësi të kufizuar për t'u ushtruar në infrastrukturën publike ekzistuese dhe atë që do ndërtohen. Në lidhje me këtë objektivi, BT ka ndërtuar këndin e tretë të forcës brenda Parkut të Liqenit Artificial të Tiranës e cila së bashku me atë ekzistuesen krijojnë më shumë mundësi stërvitjeje falas për qytetarët.

Për sa u përket evenimenteve sportive, për vitin 2017, nga Bashkia e Tiranës në bashkëpunim të ngushtë dhe me organizata e shoqata sportive kombëtare janë realizuar mbi 30 aktivitete sportive në disiplinën e ndryshme. Nga këto aktivitete vetëm 6 prej tyre janë realizuar në zonat rurale ndërkohë që kryeqyteti ka pritur si përherë pjesën më të madhe të tyre ku vlen të përmendet Gjysmë Maratona e Tiranës tashmë po kthehet në një traditë sportive vjetore. Në edicionin 2017 ky aktivitet tërhoqi 2,500 pjesëmarrës profesionist dhe amatorë nga 40 vende të ndryshme të botës, duke u kthyer në eventin më të madh dhe gjithëpërfshirës sportiv në Shqipëri.

Nëpërmjet katër kategorive u siguroa pjesëmarrja e grupeve sociale dhe grupmoshave të ndryshme; kategoria 'Fun Run' ftoi të gjithë nxënësit e shkollave të Tiranës për të vrapuar duke mbartur mesazhin sensibilizues "Edukimin e brezave nëpërmjet sportit"; dhe Kategoria 'ëe Too' mirëpriti individët me aftësi të kufizuar (PAK), duke krijuar mundësinë edhe për këtë grup shoqëror të bëhet pjesë në aktivitete të tilla të rëndësishme si dhe të kthehen në motivim për të gjithë qytetarët. Dy kategoritë e tjera janë Gjysmë Maratona (21, 0975 km) dhe Tirana 10K (10, 000 km) për të gjithë vrapuesit profesionist dhe amatorë mbi 18 vjeç. Gjysmë Maratona e Tiranës është e listuar në kalendarin zyrtar të maratonave botërore, prandaj nuk është vetëm një aktivitet që promovon jetesën aktive dhe të shëndetshme por njëkohësisht promovon Tiranën duke nxitur turizmin dhe për rrjedhojë i jep një shtytje ekonomisë së kryeqytetit.

Viti 2017 shënoi gjithashtu fillimin e një tradite të re sportive si event i "Tirana Triathlon" e cila u organizua në Njësinë Administrative Farkë, përkatësisht në liqenin e Farkës dhe zonën përreth tij dhe pati rreth 100 garuesë. Ky aktivitet konsiston në një garë sportive intensive e cila përfshin a) not b) vrap dhe c) garë me biçikletë përreth perimetrit të paracaktuar. Organizimi i këtij evenimenti në një zonë rurale si ajo e Farkës përbën një aspekt tejet pozitiv për nxitjen e aktiviteteve dhe jetës sportive në zonat rurale të cilat siç vihet re kanë ende nevojë për vëmendje në këtë aspekt. Aktualisht nga BT janë ndërtuar 9 terrene sportive publike, pjesë e shesheve kreative si edhe rezultojnë rreth 35 terrene sportive në jeditet e jashtme të shkollave.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm të cilit BT po synon ti japë jetë është zhvillimi i **"Festivalit Kombëtar të Lojërave Popullore"** i cili synon të rikthejë në jetë lojëra dhe aktivitete sportive tradicionale të cilat janë në rrezik harrese.

Veç zhvillimit të aktiviteteve të tilla të reja apo promovimit e përmirësimit të Maratonës dhe Triathlonit të Tiranës, BT do të ketë në vitet e ardhshme një fokus më të madh në promovimin e shëndetit fizik për fëmijët e grup moshës 6-12 vjeç nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve edukuese sportive dhe multi sportive. Elemente të forta për sportin e kryeqytetit janë dhe qendrat e mëdha të aktiviteteve sportive, të cilat për vetë funksionin rikrijues dhe pozicionin e tyre, përbëjnë pole të rëndësishme zhvillimore për komunitetet e ndryshme pranë tyre. Në vitin 2017 u inaugurua gjithashtu Parku Olimpik i Tiranës, pranë ish kompleksit "Dinamo", i cili është konceptuar në dy godina gjigante dhe moderne, ku përfshihen të gjitha federatat olimpike, palestrat përkatëse për stërvitje dhe salla e madhe e lojërave me dorë, ku do të organizohen eventet kombëtare të basketbollit dhe volejbollit. Salla e lojërave me dorë ka një kapacitet prej 1,200 vendesh dhe në të do të zhvillojnë fazën përgatitore dhe stërvitjen ekipet kombëtare të lojërave me dorë. Kjo është një godinë moderne e konceptuar për të siguruar sa më shumë komoditet për sportistët dhe tifozët.

Gjithashtu qyteti është në pritje të përfundimit të rikonstruksionit të stadiumit kombëtar 'Qemal Stafa' i cili do të ketë kushte dhe standarde më të mira për të mirëpritur ndeshje kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat do të kthehen në faktor zhvillimi të turizmit për kryeqytetin.

4.10 ADMINISTRIMI I PRONAVE DHE ASETVE TË BASHKISË TIRANË

Që prej vitit 2003 BT ka nisur përpjekjet e saj për inventarizimin e pasurive të paluajtshme në koordinim me Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Publike (AITPP).

Në një shtrirje kohore pothuajse të 15 viteve të fundit janë miratuar pesë lista inventari nga KBT. Megjithatë, vetëm për dy pjesët e para të listës, me VKB-në nr. 32, datë 18.11.2013 është marrë miratimi përfundimtar. Për tre pjesët e mbetura është miratuar lista paraprake e inventarit por ende nuk është miratuar lista përfundimtare në mënyrë të tillë që të përfundoj procesi i inventarizimit të pronave të BT-së. Këto lista nuk përfshijnë asetet e inventarizuara nga NJA-të të cilat kanë kryer të njëjtin proces (analizuar në kapitullin më poshtë). Megjithatë për sa ju përket këtyre të fundit në zbatim të VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015 për "Miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" është përcaktuar se BT është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme, të NJA-ve.

Me përfundimin e procesit të inventarizimit i cili duhet thënë se për arsye të problematikave të mbartura ndër vite të Shqipërisë është tejet i vonuar, do të nisë procesi i regjistrimit të pronave në hipotekë. Momentalisht BT e ka bërë këtë regjistrim vetëm rast pas rasti për arsye të detyrimeve ligjore në përfundimin e projekteve të ndryshme që po ndjek dhe numri i pronave të regjistruara është shumë i ulët. Megjithatë për vitin 2017 rezultojnë 562 prona në pronësi të BT-së, në zonën urbane, të cilat janë të

regjistruara në ZVRPP dhe disponohet certifikatë pronësie. Gjithashtu rezultojnë 22 prona në administrim (Parku Rinia dhe 21 prona tek Pazari i Ri).

4.10.1 Situata në NJA Rurale të Bashkisë Tiranë

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në zbatim të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.510/2015 për “Miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, arkivave të trupëzuara dhe të patrupëzuara, dhe të çdo dokumenti tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, si dhe të VKM-së nr. 500, datë 14.08.2001, për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, pas verifikimeve të bëra të dokumentacionit tekniko-ligjor (VKM, listës së inventarit, hartave treguese të pasurive), për njësitë administrative, ka disa problematika të mbartura në vite që lidhen me mospërputhje të hartave të ZVRPP me gjendjen faktike të pasurive në terren. Për më tepër, asnjë pronë sipas listës së inventarit nuk është regjistruar në ZVRPP, apo të jetë në proces regjistrimi.

Bazuar në kuadrin ligjor për miratimet e listave përfundimtare gjatë vitit 2017 rezultojnë 8 NJA rurale me lista përfundimtare të transferimit të pronave, ndërsa për 5 NJA e tjera disponohen vetëm listat paraprake të inventarit.

BT zotëron një potencial ekonomik fantastik në këto zona. Megjithatë për ta vënë këtë hapësirë në shërbim të zhvillimit ekonomik bujqësor, duhet së pari të zgjidhen problematikat e azhornimit të kufijve të pronave (në zonat rurale) dhe regjistrimit të Aktet e Marjes së Tokës në Përdorim (AMTP) në ZRPP. Vetëm në këtë mënyrë pronarët/fermerët e tokave mund të përfitojnë grante/kredi për të zgjeruar aktivitetin e tyre dhe prona merr vlerë ligjore.

Për pesë vitet e ardhshme BT do të përballlet me disa sfida që lidhen me:

- Përfundimi i procesit të transferimit të pronave nga pushteti qendror kundrejt BT-së për zonën urbane;
- Përfundimi i procedurave të aplikimit pranë ZVRPP Tiranë, për 8 NJA për të cilat disponohet lista përfundimtare e transferimit;
- Përfundimi i procedurave për 5 NJA për të cilat disponohet lista inventari/paraprake.

4.10.2 Pronat në përdorim

Bazuar në Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Bashkia Tiranë mund të lidhi kontrata me të tretë për të dhënë në përdorim objekte që janë në pronësi të saj. Për sipërfaqe nën 200 m² kontratat mund të kenë një afat 1 vjeçar, ndërkohë që për kontratat 200 – 500 m² dhe mbi 500 m² kontratat mund të kenë një afat deri në 10 vjet dhe 20 vjet respektivisht.

BT për vitin 2017 ka 83 kontrata me persona fizik ose juridik për prona të ndryshme që ajo zotëron. Ndër to 12 kontrata janë lidhura me subjekte që zhvillojnë veprimtaritë e tyre në: Rezidenca studentore Nr 1 sha, Rezidenca studentore Nr 2 sha dhe Ndërmarrja e trajtimit Studentor Nr 3 sha. Këto tre institucione bazuar në VKM Nr.54, date 05.02.2014, Kreu VII “Shperndarja e te Ardhurave”, pika 6, nuk kanë detyrim ti japin BT 50% por i përdorin të ardhurat nga objektet e dhena me qira për të mbuluar shpenzimet e tyre.

Kështu për të njëjtin vit 68 kontrata e tjera janë lidhur për objekte nën 200 m². Këto sipërfaqe janë nën administrimin e 6 institucioneve: ish- Uzina Mekanike, Qendra Rekreative, ish-Uzina e Autotraktorëve (UPNA), Qendra Sportive sha, Eco Tirana sha dhe ish-Uzina Metalike Tirana. Sipërfaqja totale që këto ndërmarrje kanë dhënë në përdorim është 9,836 m² objekte dhe truall duke gjeneruar 31,488,260 lekë prej të cilave 50% është detyrim për Bashkinë Tiranë (141,966,630 lekë) dhe 50% për vetë ndërmarrjen.

Për të njëjtin vit BT ka në fuqi 3 kontrata të sipërfaqeve mbi 200 m². Në total nëpërmjet këtyre kontratave BT ka dhënë në përdorim të të tretëve 29,032 m² objekt dhe 17,232 m² truall. Sipërfaqja më e madhe është UPNA për një investitor në sektorin e tekstileve (këpucëve), me një sipërfaqe prej 26,857 m² objekt dhe 15,057 m² truall, ndërkohë që dy kontratat e tjera kanë dhënë në përdorim 601.3 m² për një kinema dhe 474 m² për një investitor në industrinë e lehtë të prodhimit të mobilieve. Këto kontrata gjenerua për vitin 2017, një detyrim prej 23,050,334 lekë në vit të cilat sërish ndahen në raportin 50/50 ndërmjet Bashkisë dhe ndërmarrjes përkatëse. Për vitin 2017 detyrimi për BT ka qenë 11,525,167 lekë.

4.11 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE

4.11.1 Rrjetet dhe Transporti Publik në Shqipëri

Në rajonin e Ballkanit, Shqipëria bën pjesë në zonën e transportit pan-Evropian të detit Adriatiko-Jonian, që nëpërmjet Korridorit VIII me korridorin X (Austri – Greqi) dhe me korridorin IV në pjesën e Sofie-Plovdiv. Korridori i Mesdheut, është një tjetër korridor i rëndësishëm që nis nga Rijeka (Kroaci) duke kaluar Shqipërinë deri në Igumenicë (Greqi) dhe ka një gjatësi prej 376.5 km, ndër të cilat rreth 194.5 kalojnë në territorin e Shqipërisë.

Figura Nr 11: Korridoret ndërkombëtare që përshkojnë Shqipëri



Burimi: Strategjia sektoriale e transportit 2016 – 2020

Këto korridore përbëjnë bazën për integrimin modal, ndërveprimin, zhvillimin e koordinuar dhe manaxhimin e infrastrukturës. Përfundimi i këtyre korridoreve do të sjellë impakt në investime dhe përmirësime në infrastrukturë, shërbime më efikase, inovative si edhe do të krijojë mundësinë për një dimension të ri të transportit multimodal.

5.11.1.1 Rrjeti dhe Transporti Rrugor

Përcaktuar në PPK dhe rreferuar në Plani Kombëtar të Transportit Faza I (PKT), korridoret kryesore vertikale me rëndësi për Shqipërinë janë përcaktuar si më poshtë:

- Korridori Veri-Jug me një gjatësi prej 405 km
- Korridori Durrës-Kukës-Morinë me një gjatësi 129,4
- Rruga e Arbërit si degëzim i Korridorit VIII, me gjatësi 180 km

Përveç korridoreve vertikale gjithashtu janë me rëndësi disa akse si: aksi qendror (Tiranë- Elbasan-Berat-Gjirokastrë) dhe aksi tërthor mbështetës (Durrës-Krujë-Dibër).

Përlllogaritur nga Autoriteti Rrugor Shqipëtar (ARRSH) gjatësia e rrugëve kombëtare (rrjeti parësor dhe dytësor) është rreth 3,848km. Sipas ARRSH-së, të gjitha rrugët parësore në rrjetin kryesor dhe rreth 2/3 e gjatësisë totale të rrjetit dytësor janë rrugë të asfaltuara. Pothuajse 48% e gjatësisë së përgjithshme të

rrjetit parësor dhe 21% e rrjetit dytësor është në terren të sheshtë, ndërsa 34% e rrjetit parësor dhe 56% rrjetit dytësor gjendet në terren malor. Gjithashtu rrjeti kombëtar rrugor përfshin një total prej 590 urash me gjatësi të përgjithshme mbi 10 m. Rrjeti rajonal dhe lokal perbëhet nga rreth 9,500 km rrugë rajonale dhe vendore.

Rajoni Tiranë – Durrës përfshin rreth 400 km rrugë. Akseset e rajonit dhe ndërveprimi i zonave funksionale të tij janë të varura nga lëvizshmëria në transportin rrugor. Ndërveprimi midis këtyre qendrave social-ekonomike kryhet nga dy rrugë paralele. Ndërlidhja e shpejtë bëhet nga “Autostrada Durrës-Tiranë” ndërsa rruga e “Ndroqit” është e ndërlidhjes së ngadaltë, e cila ndjek dhe formën e terrenit. Distanca e dy qendrave është 38 km, dhe aksesueshmëria e tyre kryhet në 40 minuta deri në një orë. Flukset kryesore të ndërveprimit ekonomik mbuloohen nga “autostrada” e cila është e shoqëruar në gjysmën e gjatësisë së saj nga ndërtime me karakter biznesi që e bën këtë të fundit jo rentabël për flukset e trafikut të lartë dhe për lëvizjen e shpejtë të mallrave.

Rrugët parësore dhe sekondare përmbajnë pjesën më të madhe të trafikut të rrugëve kombëtare, me një trafik mesatar ditor prej 6,695 automjete në ditë dhe që mbartin 76% të fluksit të automjeteve, ndërsa rrugët sekondare kanë një trafik mesatar prej 1,705 automjete në ditë dhe mbartin vetëm 24% të fluksit të automjeteve, pavarësisht se përbëjnë 56% të gjatësisë së rrjetit kombëtar. Numri i automjeteve në nivel kombëtar është rreth 330 mijë, 39% e pasagjerëve qarkullojnë me automjete personale, 61% e tyre përdorin transportin publik si autobuzët, mikrobuzët për lëvizjet jashtë rajonit.

Flukset më të larta të trafikut të pasagjerëve regjistrohen mes Tiranës dhe Durrësit me 63,700 pasagjerë në ditë. Tirana është origjina ose destinacioni për 76 linja ndër – urbane, 70% e tyre vijnë nga jugu i Shqipërisë. Kjo shpjegohet nga madhësia e këtyre aglomerateve, çfarë i bën distancat shumë të largëta për të ecur, sikurse madhësia dhe densiteti që i bëjnë rrjetet e transportit publik efikase dhe me më shumë përfitim. Përsa i takon flukseve të mallrave, rajoni mbart peshën kryesore në qarkullimin e mallrave në rang kombëtar.

Siguria rrugore dhe elementët që e përbejnë atë përfshijnë një kompleks problemesh të karakterit legjislativ, institucional dhe zbatues, niveli i arritjes së të cilave është në shërbim të përmirësimit të gjendjes aktuale. Situata e sigurisë rrugore në nivel kombëtar varjon nga 300-390 viktima në vit e cilësuar si tepër e lartë sipas standarteve Evropiane. Shkaktarët kryesore të aksidenteve listohen: mungesa e zgjerimit të rrjetit rrugor të asfaltuar, mungesa e kontroleve periodike të automjeteve, veçanërisht e automjeteve tregtare si dhe numri i madh i drejtuesve të rinj të pakujdesshëm, që nuk zbatojnë rregullat e qarkullimit dhe pa përvojë. Aksidentet më të shumta kanë ndodhur në rrethet Tiranë dhe Durrës përkatësisht 17% dhe 7% të aksidentëve në nivel kombëtar. Numri i aksidenteve automobilistike është rritur duke mbërritur në një nivel shqetësues. Trafiku transit ndërmjet këtyre dy qendrave kalon në disa segmente brenda në qytet për shkak të mungesës së unazave të përshtatshme (Unaza V) ose bypass.

Institucioni përgjegjës për veprimtarinë e transportit rrugor është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila merret me hartimin e politikave të transportit rrugor (hyrjen në tregun e transportit të operatorëve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave) dhe funksionet rregullatore (licencat e transportit).

- Transporti ndërkombëtar ka rreth 63 shoqëri transporti që operojnë në 35 linja me rreth 150 autobuzë;
- Transporti ndërqytetës brenda dhe jashtë qarkut ka rreth 171 operatorë transporti në 400 linja me rreth 855 autobuzë;
- Transporti ndërkombëtar i mallrave për të tretë kryhet nga 90 shoqëri transporti, të cilat përfaqësojnë rreth 1090 mjete. Këtij trafiku i shtohet edhe transporti ndërkombëtar i mallrave për llogari të vet që përfaqësojnë rreth 640 mjete. Gjithashtu operojnë 378 mjete të transportit të mallrave të rrezikshme, nga të cilat 98 mjete për transport ndërkombëtar.

5.11.1.2 Rrjeti dhe Transporti Hekurudhor

Hekurudha Shqiptare është një kompani tërësisht publike shtetërore që operon në shërbimin e transportit të mallrave dhe të pasagjerëve në një gjatësi totale prej rreth 392 km dhe ka një rrjet kryesor prej 156 km një rrjet dytësor prej rreth 200 km (Strategjia Sektoriale e Transportit 2016 -2020).

Rrjeti hekurudhor është një sistem radial që përqëndrohet nga Porti i Durrësit në katër drejtime kryesore:

- në veri, për në pikën kufitare të Hanit të Hotit në kufirin Shqipëri – Mali i Zi;
- në jug, për në zonën e Ballshit dhe Porti i Vlorës;
- në jug lindje, në Pogradec afër kufirit me Maqedoninë; dhe
- në lindje për në Tiranë.

Rrjeti Kryesor përfshihet në një pjesë të vogël të Korridorit VII – rreth 37 km që lidh me Tiranën dhe Portin e Durrësit – dhe 119.6 km të Rrugës Shtetërore 2 që lidh Shqipërin me Malin e Zi. Këto pjesë të rrjetit hekurudhor në territorin Shqipëtar janë vetëm me një palë binarë dhe me lokomotiva me naftë. Mungesa e investimeve në rrjetin hekurudhor nga 2004-2014 ka kontribuar në përkeqësimin e gjendjes së infrastrukturës ku vërehet se shpejtësia mesatare 35 km/ore arrihet vetëm 44% të rrjetit dhe përkeqësimi i kushteve të binarëve.

Trafiku hekurudhor i pasagjerëve në 2009 arriti në 414,280, i barabartë me 1,135 pasagjerë në ditë. Kjo është më pak se 0.1% e pasagjerëve që udhëtojnë me rrugë. Sasia e mallrave dhe e udhëtarëve të transportuar me këtë rrjet ka rënë që nga vitet 90 si rezultat i një rënie të aktiviteteve industriale shtetërore dhe me mbylljen e shumë fabrikave shtetërore në të gjithë vendin, të cilat funksiononin me anë të hekurudhës. Si rezultat, hekurudha humbi pothuaj të gjithë të ardhurat dhe mbështetjen nga shteti, pasi filluan investime në programe të përmirësimit të rrugëve dhe prioritete të tjera infrastrukturore.

Vihet re gjithashtu se 26% e pasagjerëve të trafikut hekurudhor i përket rrjedhjes së pasagjerëve Tiranë – Durrës. Në Shqipëri transporti hekurudhor dhe rrugor nuk konkurojnë për pasagjerë si pasojë e mungesës së investimeve në sektorin hekurudhor dhe ky transport nuk pasqyron ndryshimet që kanë ndodhur në Shqipëri. Transporti rrugor dominon tregun me rreth 97% e pasagjerëve në nivel kombëtar. Trafiku i pasagjerëve përqëndrohet në linjën Tiranë – Durrës. Pjesë e problemit që po përballon hekurudha shqiptare është ulja e numrit të pasagjerëve dhe nevoja për të rritur subvencionimet për shërbimet për publikun.

Së fundmi, vihet re një rritje e vëmendjes së qeverisë shqiptare edhe për këtë lloj transporti, e cila do të shoqërohet me një plan veprimi kombëtar që do të përmirësojë performancën e këtij sistemi në tërësi.

Infrastruktura e vetme rajonale hekurudhore midis Tiranës dhe Durrësit ka katër ndalesa, duke përfshirë edhe qytetin e Vorës. Pozicioni strategjik i Tiranës dhe lidhja e saj me nyjen kryesore të transportit hekurudhor në portin e Durrësit krijon akses në shfrytëzimin e transportit hekurudhor të mallrave dhe të pasagjerëve duke mundësuar një gamë më të gjerë në mobilitet. Gjithashtu PINZETD vendos në prioritet edhe zhvillimin e sistemit hekurudhor Tiranë – Durrës duke krijuar një potencial zhvillimi për dy nga qendrat kryesore të zhvillimit në Shqipëri.

5.11.1.3 Transporti Ajror

Aeroporti “Nënë Tereza” (TIA) është i vetmi aeroport ndërkombëtar i Shqipërisë dhe gjendet rreth 17 km nga Tirana. Të gjitha fluturimet ndërkombëtare kryhen nëpërmjet këtij aeroporti. Manaxhimi i aeroportit kryhet nga një kompani ndërkombëtare “Tirana International Airport SHPK”.

TIA ka një kapacitet të terminalit të pasagjerëve rreth 2,000,000 pasagjerë në vit. Statistikat e qarkullimit të trafikut ajror tregojnë rreth 2,600,000 pasagjerë në vit duke përdorur rreth 24,336 fluturime në vit – rreth 67 fluturime në ditë. Në vitin 2017 janë 18 kompani ajrore, duke përfshirë një kompani shqiptare (Albaëings), që veprojnë në transportin ajror.

PPK-ja ka planifikuar për ndërtimin e dy aeroporteve të reja në vendin tonë, në veri dhe në jug. Në veri, aeroporti i Kukësit është konkretizuar si investim. Ndërsa në jug sugjerohet ndërtimi i një aeroporti të ri, në brendësi të territorit me qëllim mbrojtjen e vulnerabilitetit të bregdetit shqiptar. Megjithatë, një studim fizibiliteti do të kryhet nga autoritetet përgjegjëse sektoriale të transportit, për të përcaktuar me saktësi vendndodhjen e këtij investimi. Ky aeroport do t’iu shërbejë ndër të tjera, qyteteve si Saranda dhe Gjirokastra, të cilat janë konsideruar si qendra kryesore urbane për 15 vitet e ardhshme, por janë projektuar edhe si portat hyrëse në rajonet turistike më interesante në jug të vendit tonë.

5.11.1.4 Transporti Detar

Rrjeti detar në Shqipëri përbëhet nga katër porte kryesore: Durrës, Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë dhe dy terminale private për përpunimin e naftës dhe nënprodukteve të saj në Porto Romano (Durrës) dhe në Gjirin e Vlorës (Vlora 1).

Të dhënat statistikore flasin për modele të ndryshme të rritjes së mallrave dhe pasagjerëve në pesë vitet e fundit për katër portet, por në përgjithësi, normat e rritjes kanë një nivel të përgjithshëm të sheshtë ose të ulët, me një përqëndrim të lartë të trafikut në portin e Durrësit i cili trajton afërsisht 78% të tonazhit të tregtisë detare në rang kombëtar dhe 75% të gjithë volumit të eksportit dhe importit të Shqipërisë. Kjo e bën portin e Durrësit një nga portet më të rëndësishëm në Shqipëri dhe me një rëndësi të drejtpërdrejt në zhvillimin rajonin Tiranë – Durrës.

4.11.2 Rrjeti rrugor dhe Transporti në Tiranë

Infrastruktura rrugore dhe transporti publik në nivel vendor është një nga shërbimet në fokus të veçantë të BT. Me zbatimin e reformës administrative territoriale BT ka nën administrim edhe rrugët rurale të NJA, të cilave duhet t’iu ofrohet transport, sipas standarteve ligjore dhe rrjet rrugor i pajisur me sinjalistikë dhe element të sigurisë.

4.11.2.1 Rrjeti Rrugor Urban

Qyteti i Tiranës, që në fillimet e tij, është zhvilluar sipas një modeli koncentrik, ku trafiku përqëndrohet në qendër të qytetit. Strukturat hapësinore metropolitane në qytet janë formuar përgjatë korridoreve kryesore, të ndara në rrugë radiale dhe unaza. Korridore radiale:

- Korridori i Durrësit;

- Korridori i Kamzës;
- Korridori i Kavajës;
- Korridori i Elbasanit;
- Korridori i ish-Uzinës Traktori;
- Korridori i Dajtit;
- Korridori i Dibrës; dhe
- Korridori i Paskuqanit.

Arterja kryesore e zhvillimit cilësohet Bulevardi Kryesor si boshti historik Veri – Jug, i cili përshkron qendrën e qytetit “Sheshi Skenderbej” si dhe sistemin radial unazor. Hapësirat ndërmjet unazave dhe radialeve përshkrohen nga rrugë dytësore. Rrjeti unazor i qytetit parashikohet të përbëhet nga pesë unaza (PPVBT). Aktualisht vetëm 3 cilësohen funksionale në mënyrë të pjesshme ose të plotë.

Unaza e Parë, e Tretë dhe Unaza e Pestë janë elementët më të rëndësishëm të strukturës dhe mbështesin aftësinë për rritje urbane të qendrueshme. Qyteti i Tiranës përshkohet edhe nga një korridor rrugor Perëndim-Lindje në të dy krahët e lumit Lana, që ndërpritet nga sistemi unazor.

Bazuar në të dhënat e fundit të BT-së si dhe të PPVBT lidhur me elementët e infrastrukturës së rrjetit rrugor përmendin se janë rreth 132 rrugë urbane dhe 350 lokale me një shtrirje prej 1,100.6 km nga të cilat, 1000 km janë me 1 kors, 54 km janë me 2 kors dhe rreth 47 km janë me mbi 2 kors.

Korsitë e rezervuara për transportin multimodal (BUS) janë rreth 5.1 km dhe 13.3 km janë kors biçikletash. Rrugët kryesore radiale të Tiranës janë zgjeruar: nga pjesa perëndimore në drejtim të Durrësit dhe Aeroportit;

- në jugperëndim në drejtim të Kavajës/Durrësit;
- në juglindje në drejtim të Elbasanit; dhe
- në verilindje në drejtim të Dajtit dhe të Tufinës.

Gjatë viteve në vazhdim pritet të marrë një vëmendje të veçantë zhvillimi i pjesës veri-lindore të qytetit me përfundimin e Rrugës së Arbërit. Gjatë vitit 2017 janë mirëmbajtur dhe rikonstruktuar 56,246 m² rrugë nga të cilat 67% (37,600 m²) janë ndërhyrje me asfalt.

Unaza e Parë Unaza e Vogël me gjatësi totale 2.5 km u përfundua në fund të vitit 2016 pas ndërtimit të segmentit të ri veri-lindor midis Rr. Urani Pano dhe Rr. së Barrikadave me gjatësi 200 m dhe rikonstruksionin e saj duke përfshirë infrastrukturën përkatëse dhe korsinë e biçikletave. Vlen për t’u theksuar plotësimi i infrastrukturës me sinjalistikë për kors biçikletash dhe ndalim parkimi në rrugë, në segmentet: Rr. Ibrahim Rugova dhe segmenti i Rr. së Barrikadave nga “Ushtari i pa Njohur” deri te Muzeu i Besimit dhe përgjatë Lumit Lana.

Unaza e Dytë Aktualisht nuk është funksionale pasi mungojnë një pjesë e madhe e segmenteve që mbyllin këtë unazë. Zhvillim i saj përfshin zgjerimin dhe rindërtimin e disa rrugëve ekzistuese dhe gjithashtu ndërtimin e disa rrugëve të tjera që mungojnë.

Unaza e Tretë Kategorizohet si rrugë urbane kryesore me 4 kors të ndara me breza të gjelbër dhe nga një kors parkimi respektivisht në të dy senset e lëvizjes. Aktualisht kjo unazë nuk përmban kors biçikletash. Unaza e tretë cilësohet mjaft e rëndësishme pasi mban pjesën më të madhe të trafikut rrugor dhe ka në përbërjen e saj nyje/kryqëzime të rëndësishme të lidhjeve me korridoret kryesore si: kryqëzimi i Zogut të


Zi, 21 Dhjetori, kryqëzimi i Rrugës së Dibrës, dhe lidhjen me Lumin Lana si edhe ish Stacionin e Trenit që pritet të kthehet në një kryqëzim të rëndësishëm pas zgjatimit të Bulevardit Kryesor. Përfundimi i Unazës së Tretë konsiston në mbylljen e seksionit jug-lindor, zonë e cila nuk është e pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për të shërbyer si unazë. Hendeku që mungon në këtë segment është nga Ambasada e SHBA-së në Rr. Kont Leopold Bertold me gjatësi prej 0.96 km sipas Planit Tematik Urban të Tiranës (JICA). PPVBT parashikon devijimin e unazës në rrugët Stavro Vinjau dhe Qemal Guranjaku pasi nuk mundësohet shpronësimi i ambasadës dhe ndërtimi i rrugës në pronën e saj. Gjatësia në total në përfundim të Unazës pritet të jetë rreth 9.5 km.

Unaza e Katërt është parashikuar për herë të parë gjatë Planit të Ri Rregullues për Zhvillimin Urban të Tiranës në vitin 1939. PPVBT rikthen ndërtimin e kësaj unaze e cila parashikohet të jetë mbi gjurmën e unazës së madhe të atëhershme dhe vendos si objektiv realizimin e një unaze tërësisht të dedikuar për transportin publik të qëndrueshëm. Me një diametër prej 3,5 km unaza do të kthehet në një kufi fizik brenda të cilës qyteti të mund të përkufizohet si “zonë për këmbësorë” dhe që në 2030 do të kthehet në zonë me trafik të kufizuar ku do të zbatohet taksa e trafikut. Korridori mjedisor do të jetë rreth 12 km i gjatë dhe lëvizshmëria do të variojë nga 20-50 metra gjerësi e cila do të vendosë në një sistem të vetëm hapësirat ekzistuese si dhe ato të parashikuara. Aktualisht nuk ka një studim të plotë për ndërhyrjet në këtë unazë por është parashikuar që zhvillimi i kësaj unaze të jetë pjesë e planeve sektoriale të ardhshëm.

Unaza e Pestë bën pjesë në rrjetin kombëtar të rrugëve dhe është një investim i ARRSH-së. Kjo unazë parashikohet të ketë një gjatësi totale rreth 21.5 km. Aktualisht ka përfunduar pjesa perëndimore, jug-perëndimore dhe jugore që ka rëndësi specifike për lidhjen me Elbasanin. Përfundimi i kësaj unaze ka rëndësi të veçantë strategjike për rrjetin rrugor në Tiranë dhe për përmirësimin e trafikut pasi i shërben kryesisht trafikut tranzit. Gjithashtu, do të shërbejë si një korridor i rëndësishëm për transportin e mallrave. Rëndësia e Unazës së Pestë do të jetë veçanërisht e dukshme në zonat veriore dhe lindore të qytetit, ku përfundimi i segmenteve përkatëse unazore do të ndihmojë gjerësisht në integrimin ekonomik të këtyre zonave në rajonin qëndror. Gjithashtu realizimi i segmentit verior merr një rëndësi të veçantë sepse do të shërbejë si një portë hyrëse (lidhja me Rrugën e Arbërit).

Korridori i Lumit Lana përbëhet në pjesën veriore nga Bulevardit Gjergj Fishta dhe Zhan D’Ark dhe në pjesën jugore nga Bulevardi Bajram Curri. Ky korridor përshkohet në të dy anët e tij nga rrugë urbane dytësore me dy korsi për automjetet, nga një korsi parkimi në të dy kahët e drejtimit dhe është i ndarë nga shtrati i lumit i cili është i sistemuar. Kjo arterie ka mjaft rëndësi pasi kryen lidhjen lindje-perëndim të rrjetit rrugor dhe iu shërben tre unazave të para duke mbajtur një pjesë mjaft të rëndësishme të trafikut


Figura Nr 12: Rrjeti Rrugor Urban



Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve

Në vitin 2015 pas reformës territoriale, BT-së i kaloi administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor të 13 NJA-ve Rurale.

Figura Nr 13: Harta e Periferialitetit



Burimi: Bashkia Tiranë, TR030

Tabela Nr 14: Gjendja e rrjetit rrugor në NJA Rurale


Njësia Administrative	Infrastruktura rrugore	
	Rrugë e asfaltuar	Rrugë e paasfaltuar
Pezë	12.96 km	106.7 km
Farkë	10 km	30 km
Kërrabë	X	X
Dajt	67 km	X
Kashar	X	X
Ndroq	X	X
Vaqarr	15.2 km	X
Zall- Herr	X	120 km
Bërzhitë	46.5 km	77 km
Zall Bastar	X	X
Shëngjergj	X	X
Petrelë	X	X
Baldushk	10.7 km	89 km

4.11.2.2 Transporti Publik

Transporti publik qytetas në BT për vitin 2017 kryhet nga 8 operatorë private me një tarifë prej 40 lekë/person për çdo udhëtim, të cilët operojnë me një flotë prej 236 autobusë, nga të cilët 88.5 % e tyre janë të pajisura me platformë të sheshtë dhe platformë PAK dhe 26% e tyre kanë kamera sigurie. Flota e transportit publik ka një flotë me moshë mesatare 9 vjeç. Numri i linjave që mbulojnë gjithë territorin është 15 dhe kanë një frekuencë mesatare 9 minuta (orari i pikut është 16:00 dhe orari normal është ora 18:00). Në territorin e BT ka 236 stacione të transportit publik. Numri i pasagjerëve që përdorin këtë transport mesatarisht është 18.5 milion në vit ndër ta mestarisht 7.1 milion janë me sistemin abone, 10.6 milion janë me bileta dhe 0.5 milion të tjera me libreza. Transporti publik për vitin 2017 ka një vëllim mesatar ditor prej 50,572 pasagjerësh. Në lidhje me infrastrukturën e transportit publik ka një mungesë të përgjithshme të korsive operative të autobuzëve dhe mungesa e një rrjeti të plot levizje, që çon shpesh herë në një bllokim të mjeteve të transportit publik gjatë kongestionit të trafikut duke sjellë shtimin e kohës së udhëtimit po ashtu edhe kostot.

Kthimi i Tiranës në një qytet policentrik bën të nevojshme krijimin e një rrjeti të fortë të rrugëve të shpeshta të autobusëve për ta bërë këtë lloj transporti një alternativë tërheqëse, në veçanti për udhëtime më të gjata se 5 kilometra. Për t'u siguruar që autobusët nuk do të bllokohen në trafik, sistemi "Bus Rapid Transport (BRT)" shihet i nevojshëm dhe sipas PPVBT. Zhvillimi i rrjetit të korsive të autobusit është i nevojshëm të zgjerohet, dhe të monitorohet me kujdes.

Figura 14: Linjat e Transportit Publik në Bashkinë e Tiranës



Konsiderohet me përparësi zgjerimi i sistemit të autobusave dhe modernizimi për të përballuar kërkesën në rritje dhe frekuencën më të lartë, veçanërisht në rrugët kryesore të tranzitit të shpejtë. Si politika të rëndësishme shihen me prioritet:

- Zgjerimi dhe zbatimi i rrjetit korsi-autobus
- Përmirësimi dhe zgjerimi i sistemit të autobusave
- Përmirësimi i rrjetit të autobusave për të lidhur nyjet me densitet të lartë

Vlen të theksohet se përveç futjes për një sistem BRT, PPVBT nuk ka parashikuar një “lightrail” ose tramvaj për shkak se autobusët cilësohen më fleksibël dhe janë nga ana financiare dhe infrastrukturore më të lehta për tu zbatuar në një kohë më të shkurtër.

Modernizimi i transportit publik është një prioritet i rëndësishëm dhe në vitin 2018 do të testohet dhe zbatohet edhe projekti i biletimit elektronik.

Transporti Rrethqytetës


Në Tiranë, përveç 15 linjave qytetase të sipër përmendura, ka edhe 25 linja të tjera të transportit rrethqytetas, që bëjnë lidhjen me NJA rurale pas ndryshimeve të reformës territoriale. Dendësia e shërbimit nuk është e pandryshueshme, por lëvizin në intervale prej 3-30 minuta. Për më tepër, shumica e

linjave rrethqytetase duket se mbivendosen me linjat e autobusëve të qytetit. Megjithëse operatorët e autobusëve rrethqytetas zyrtarisht nuk lejohen të transportojnë udhëtarë, nëse të dyja stacionet e hipjes dhe të zbritjes janë brenda qytetit të Tiranës, është e zakonshme që udhëtarët të shfrytëzojnë linjat e autobusëve rrethqytetase në vend të linjave të autobusëve të qytetit për të udhëtuar brenda Tiranës, duke paguar tarifë të njëjtë (40 lekë).

4.11.2.3 Trafiku Krugor

Tirana ka rreth 40% të automjeteve të Shqipërisë. Ngarkesa e trafikut është shumë e lartë dhe rrjeti në pjesën më të madhe të ditës është i bllokuar, sidomos brenda unazës së mesme. Tirana ka pasur një raport rreth 105 makina për 1,000 banorë, por me ndryshimet e reja administrative territoriale raporti shkon në rreth 200 makina për 1,000 banorë, që është vetëm pak më pak se mesatarja Evropiane (300 makina/1000 banorë)²¹ dhe pritet që të rritet me shpejtësi vitet e ardhshme.

Figura Nr 15: Trafiku në Bashkinë Tiranë



Burimi: Bashkia Tiranë

Motorizimi i shpejtë ka sjellë shumë probleme urbane në zonën metropolitane të Tiranës, si bllokimet e trafikut dhe ndotjen e mjedisit. Tirana në vitin 2017 numëron rreth 225 mijë automjete në përdorim. Kjo ngarkesë përkthehet në bllokimet e shpeshta të trafikut në rrugët e qytetit dhe në rrugët inter-urbane. Arsyeja është kapaciteti i kufizuar i rrugëve në zotërim për të udhëtuar nga rrethinat në qendër të qytetit për shkak të parkimit ligjor/joligjor, gjithashtu ka një bllokim të trafikut, veçanërisht në rrugët radiale gjatë orëve të pikut në mëngjes dhe pasdite.

²¹EUROSTAT

Një fakt i rëndësishëm është mungesa e korsive të dedikuara të autobusëve dhe e terminaleve për kamionë mallrash. Fluksi më i madh i mjeteve haset në pjesën Veri-Perëndimore të Tiranës si pasojë e zgjerimit të zonave të banuara dhe gjithashtu është segmenti kryesor i lidhjes me zonën e biznesit Tiranë-Durrës, Kamzën dhe aeroportin “Nënë Tereza”. Përkatësisht trafiku fillon e rëndohet duke filluar nga mbikalimi i Kamzës dhe në drejtim të Sheshit Shqiponja duke shënuar një fluks prej mbi 1,500 mjete/orë dhe me shpejtësi mesatare rreth 20 km/orë.

Rr. Dritan Hoxha dhe Rr. e Durrësit kanë një fluks prej rreth 1,000-1,500 mjeteve në orë me shpejtësi mesatare rreth 30 km/orë, vlen të theksohet se rreth rrotullimi i “Zogut të Zi” në oraret e pikut (ora 18:00) ka një fluks të shtuar të mjeteve. Fluksi i lart automjeteve vërehet dhenë segmentin perëndimor të Unazës së Pestë me rreth mbi 1,500 automjete/orë. Ky fluks pritet të lehtësohet me përfundimin e segmentit jug-perëndimor të kësaj unaze. Gjithashtu vlen të theksohet se mungesa e përfundimit të Unazës së Tretë në pjesën lindore sjell rritje të fluksit të automjeteve në korridorin e Lumit Lana duke shënuar një fluks mbi 1,500 mjete/orë dhe shpejtësi nën 20 km/orë. Përsa i përket segmenteve të tjera rrugore në Tiranë gjendja përgjithësisht është e normalizuar. Gjatë vitit 2016 për të reduktuar trafikun e shkaktuar nga linjat e transportit ndërqytetas dhe ndërkombëtar u realizua me sukses transferimi i terminaleve të përkohshëm jashtë Unazës së Tretë.

Numri i kryqëzimeve të rregulluara me semafor për vitin 2017 është 70, numri i kamerave për të kontrolluar trafikun është 23 dhe janë të vendosura 6 tabela elektronike me informacione të ndryshme.

4.11.2.4 Parkimi Publik

Me rritjen e numrit të makinave dhe përdorimin e vazhdueshëm të tyre në Tiranë, shfaqet si nevojë thelbësore rritja e kapacitetit të parkimit në Tiranë, veçanërisht në Zonën qendrore të Biznesit (ZQB) brenda unazës së mesme. Problemet e parkimit të tejmbushur të automjeteve vërehen kudo në ZQB. Parkimi i paligjshëm në rrugë jashtë zonës së përcaktuar zvogëlon numrin e korsive në përdorim. Kjo shkakton çrregullim të trafikut, për pasojë sjell uljen e kapacitetit të rrugëve, rritjen e kohës së udhëtimit dhe ndotjen mjedisore nga trafiku.

Gjatë vitit 2016 u realizua projekti për “Përcaktimin e Zonave të Administrimit të Parkimit (ZAP) dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim” nga BT (bazuar në VKB Nr 49). Pas përcaktimit të ZAP u përcaktuan edhe Nënzonat e Destinuara për Parkim (NDP).

- ✓ NDP-të pa pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rrugë (mbi dhe nëntokë) që përfshijnë:
 1. parkim për rezidentet
 2. parkim i lirë (pa pagesë)
 3. parkim i rezervuar për automjetet e personave PAK (pa pagesë)
- ✓ NDP-të me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rrugë (mbi dhe nëntokë) që përfshijnë:
 1. vendparkim me pagesë
 2. vendparkim i rezervuar

Ky proces përcaktoi zonimin e parkimit në zonë urbane dhe u realizua vijëzimi dhe sinjalistika e saktë për vendndodhjen e mjeteve taksit, parkimi publik pa pagesë, parkimi publik me pagesë, vendet e përcaktuara për invalidët sipas Kodit Rrugor.

Ndër projektet më të rëndësishme të ATP-së për vitin 2017, përveç ndërtimit të shesheve të parkimit janë:

1. Projekti SMS Paymemnt si një mënyrë alternative e pagesës së parkimit në rrugët kryesore që i nënshtrohen sistemit të tarifimit sipas VKB 48 dhe 49, datë 11.11.2015. Ky projekt inovativ mundësoi kryerjen e pagesës së shërbimit të parkimit vetëm duke dërguar me një SMS targën e mjetit pa hapësira në numrin 50500 nga të gjithë operatorët celularë. Ky projekt nisi më 27 Shkurt 2017. në fillim u pilotuan tre rrugë kryesore të destinuara për parkim publik me pagesë dhe më pas u shtri në të gjithë Zonën A.

2. Projekti Rezident. Bazuar VKB Nr.49 dt.11.11.2015, për: “Miratimin e Kritereve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim”, Tirana është e ndarë në 4 Zona Administrimi të Parkimit publik, ku Projekti Rezident po gjen zbatim.

Zona 1, me kufij: Vija kufizuese e qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Perëndimore, bulevardi “ZOG 1” në anën Lindore dhe kordoni hyrës me rrugët “Lazi Miho”, “Konferenca e Pezës” duke vazhduar përgjatë bulevardit “Gjergj Fishta” në anën jugore, deri në ndërprerjen me bulevardin “Dëshmorët e Kombit”.

Zona 2, me kufij: zonën përgjatë bulevardit “ZOG 1” në pjesën perëndimore, vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Lindore dhe zgjatimin e bulevardit “Zhanë D'Ark” deri në vijën kufizuese në anën Jugore.

Zona 3, me kufij: segmentin e bulevardin “Dëshmorët e Kombit” në anën perëndimore, bulevardi “Bajram Curri” dhe përgjatë lumit të Lanës deri në vijën kufizuese në anën veriore dhe vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Jug/Lindore.


Zona 4, me kufij: kordonin hyrës përgjatë rrugës “Konferenca e Pezës” në anën veriore, bulevardin vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në anën lindore, zonën përgjatë segmentit të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” në pjesën Lindore dhe vijën kufizuese të Tiranës në pjesën jugore të saj.

Pavarësisht se ky projekt filloi të zbatohet në muajin nëntor 2016, si një Projekt Pilot vetëm në Bllokun Shushica (pjesë e zonës 4), ai mori zgjerim në vitin 2017 në të gjithë zonën 1 dhe zonën 4.

Implementimi i Projektit Rezident është ndërmarrë për t’ju ardhur në ndihmë qytetarëve të Tiranës për të parkuar automjetet e tyre në zonën ku janë rezident, sipas NjA-së ku qytetari është i regjistruar. Karta e Rezidentit ofrohet FALAS dhe është e vlefshme për afatin kohor 12 mujor.

NDP-të me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë). Që prej vitit 2016 u përcaktuan 3 zonat e administrimit të parkimit, të ndara sipas tarifave (zona A 100 lekë/ora, Zona B 40 lekë/ora dhe Zona C 20 lekë ora).

Figura Nr 16: Harta e Nënzonave të parkimit në rrugë (sipas zonave tarifore)



Burimi: Bashkia Tiranë

Zonat ndahen në:

- Zona A: Përshkon të gjithë hapësirën deri në kufij të Unazës së Tretë (4.8 km²)
- Zona B: Përshkon një pjesë të mirë të hapësirës midis Unazës së Tretë dhe të Pestë (6.8 km²)
- Zona C: Përshkon rreth 60-70 % të hapësirës tjetër të zonës urbane të Tiranës (17,9 km²)


Tabela nr 15: Të dhëna mbi vendparkimet fizike për automjetet në Tiranë 2017.

Zona	Vendparkime me pagesë në rrugë	Vendparkim i rezervuar me pagesë	Vendparkim pa pagesë (invalid + i lirë)	Totali
Zona A	2032	281	1310	3623
Zona B	770	26	633	1429
Zona C	398	5	435	838
TOTAL	3200	312	2378	5890

Burimi: Tirana Parking

Shënim: Përsa i përket parkimit të rezervuar me kontratë, nga ana e ATP-së janë shfrytëzuar edhe vende të tjera në rrugë të cilat nuk janë përfshirë në rrugët e përcaktuara me VKB 49 por janë brenda në hartën e tarifimit përkatësisht A, B ose C

Figura Nr 17: Sheshparkimet dhe terminalalet në Bashkinë Tiranë



Burimi: Bashkia Tiranë

Nga të dhënat e disponueshme të ATP koeficienti i shfrytëzimit për vitin 2017, është 57% krahasuar me 85%, (Shoup D.C. 2004²²) i cili vlerësohet si një koeficient eficient shfrytëzimi, në të cilën akomodohet në çdo orë kërkesa potenciale për parkim dhe në të njëjtën kohë gjenerohen të ardhura. Edhe pse mbetet edhe shumë punë për të mbërritur eficientësinë e duhur, vlen të theksohet progresi i shkëlqyer i ATP-së pasi për vitin 2016 ky koeficient ishte 30%. Pra vetëm gjatë 1 viti ky koeficient është rritur me 90%, pra pothuajse është dyfishuar.

Tabela Nr 16: Përqindja e shfrytëzimit sipas zonave

Nr	Emërtimi	Vendparkime	Vendparkim me pagesë (bileta)	Vendparkim i rezervuar	Shfrytëzimi
1	Bulevardi Deshmoret e Kombit	53	31	22	66%
2	Gjin Bue Shpata	74	72	2	66%
3	Rruga Ibrahim Rugova	138	82	56	68%
4	Papa Gjon Pali 2	72	44	28	81%
5	Rruga e Barrikadave	55	53	2	73%
6	Rruga Myslym Shyri	97	94	3	73%
7	Komuna e Parisit	32	32	0	17%
8	Emin Duraku	23	21	2	57%
9	Bulevard Gjergj Fishta	33	23	10	73%
10	Rruga Jul Variboba	14	13	1	54%
11	Rruga Mustafa Matohiti	20	13	7	52%
12	Rruga Pashko Vasa	61	51	10	62%
13	Rruga Luigj Gurakuqi	32	31	1	75%
14	Rruga Lek Dukagjini	35	35	0	12%
15	Tefta Tashko Koco	23	23	0	6%
16	Muhamet Gjollësua	22	18	4	68%

²²The ideal source of local public revenue. Regional science urban economic

17	Abdyl Frasheri	36	33	3	56%
18	SMS Payment ZONA A	693	524	169	68%
19	ZONA B	62		62	
20	ZONA C	52		52	
TOTALI		1513	1193	434	57%

Burimi: Agjencia Tirana Parking

Ndërtimi i objekteve të parkimit shtesë për të paktën 2,500 automjete, është tepër i ngutshëm dhe i nevojshëm në ZQB për të larguar parkimin në rrugë nga rrugët kryesore dhe ato dytësore, për të shfrytëzuar rrugët për transportin publik dhe biçikletat.

Tabela Nr 17. Të dhëna mbi Parkimin e Rezervuar 2017

	Parkimi Rezervuar me Kontrate 2017	NR. Vende
1	Subjekte	480
2	Individe	4
3	Administratë Publike	42
4	Taxi	361
Total		887

Burimi: Agjencia Tirana Parking

DTTR dhe ATP kanë realizuar vendosjen, vijëzimin dhe sinjalistikën e saktë për vendndodhjen e mjeteve taksi. Momentalisht janë 29 rrugë nga 69 të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) Nr. 49 dhe po punohet që brenda vitit të shtohen edhe 22 rrugë të tjera.

Tabela nr 18: Vend parkimet në sheshe

NR	EMERTIMI	KAPACITETI	NR. MESATAR I MJETEVE /DITË
1	Shesh parkimi "Selman Stërmasi"	84	280
2	Shesh parkimi "Asllan Rusi"	66	145
3	Shesh parkimi "Qyetet Studenti"	108	246
4	Shesh parkimi Infosoft	37	54
5	Diga Liqenit	20	133
6	Shesh parkimi "Avni Rustemi"	24	246
7	Shesh parkimi "Shkolla Kosova"	30	28
Totali		369	1132

Burimi: Bashkia Tiranë

Megjithatë manaxhimi i parkimeve mbetet një problem i rëndësishëm sidomos pas realizimit të ndërtimit të qendrës së Tiranës, për arsye se në këtë zonë ndodhen një pjesë e mirë e institucioneve shtetërore. Gjithsesi me projektin për ndërtimin e Sheshit Skenderbej u shtuan edhe 9,573 m² parking nëntoksor në zonën qendrore të qytetit me një kapacitet prej 300 vendesh parkimi publik. Ndërkohë, ndërtimi i objekteve të parkimit shtesë, do të ishte e nevojshme në ZQB për të larguar parkimin nga rrugët kryesore dhe ato dytësore dhe për të shfrytëzuar rrugët për transportin publik dhe biçikletat, duke ruajtur të njëjtin kapacitet të trafikut. Vlen të theksohet ndërtimi i parkimit të ri publik në pjesën veriore të Unazës së 3-të në nyjen që kryen lidhjen me Bulevardin e Ri me kapacitet prej 321 vendesh, unazë kjo e cila mban një pjesë të madhe të trafikut në kryeqytet.

Tabela Nr 19. Kapacitetit i Shesh parkimeve nëntokësore

NR	EMERTIMI	KAPACITETI	NR. MESATAR I MJETEVE /DITË
1	Sheshi Skënderbej	300	377
2	Bulevardi I RI	321	27
	Totali	621	404

Burimi: Agjencia Tirana Parking

Hapja e dy parkimeve nëntokësore në muajin Qershor 2017, iu ka ardhur në ndihmë qytetarëve për parkimin e mjeteve të tyre me dy hapësira të mëdha, me kushte komode dhe sigurie dhe shërbim 24/7 në dy zona të ndryshme tarifimi A dhe B.

Shesh parkimi nëntokësor pranë sheshit “Skënderbej” rriti ndjeshëm të ardhurat financiare të BT-së, pasi frekuentimi i mjeteve në këtë parkim ishte shumë herë më i lartësi si pasojë dhe i organizimeve të shpeshta të eventeve të ndërmara nga Bashkia Tiranë në sheshin “Skënderbej”.

Por gjithashtu krijimi i dy shesheve nëntokësore me hapësira mbi 300 vende parkimi dhe mundësi parkimi për 24 orë gjatë ditës, i ka lehtësuar qytetarët si nga ana e kushteve të shërbimit si dhe ana financiare, duke ofruar mundësinë e paketave të abonimit dhe tarifave preferenciale për orët e gjata të qëndrimit.

Bazuar në PPVBT, shihet e nevojshme shpërndarja e hapësirave të parkimeve jashtë shtratit të rrugës i cili aktualisht shoqërohet me kors parkimi në të dy senset e levizjes. Sigurimi i këtyre hapësirave sipas planit do të krijojë mundësinë për shpërndarjen intermodale dhe do të sigurojë një infrastrukturë të sigurt për biçikletat të ndara nga trafiku i makinave përgjatë gjatësisë së Unazës së Tretë pasi kjo unazë gjithashtu shërben si një shpërndarës nga rrugët kryesore në rrjetin e biçikletave.

NDP-të pa pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë). Bazuar në statistikat e dhëna nga zyra e Projektit Rezident, për vitin 2017 janë pajisur me Kartën Rezident 2,501 automjete.

Tabela Nr 20. Të dhëna mbi parkimin vetëm për rezidentët

Zona	Nr.i kartave Rezident për periudhën 1 Janar- 31 Dhjetor 2017		
	Pulla Identifikuese	Vërtetime për Rezident	Totali
Zona 1	1386	-	1386
Zona 2	-	-	-
Zona 3	-	-	-
Zona 4	291	824	1115

Burimi: Agjencia Tirana Parking

Shënim: Tirana Parking në mungesë të Pullave Ngjitëse vetëm për Zonën 4, ka shpërndarë për periudhën (07.04.2017 - 31.12.2017) vërtetime të cilat kanë qënë të barazvlefshme me Kartën Rezident.

4.11.2.5 Termialet Multimodale

Gjatë vitit 2016 u realizua transferimi i stacioneve të transportit ndërqytetas dhe ndërkombëtar në terminale të përkohshme jashtë Unazës së Tretë. Aktualisht në territorin e administruar nga BT janë dy terminale kombëtare dhe një terminal ndërkombëtar.

- Terminali i autobusave ndërqytetas për zonën e Jugut dhe qytetin e Durrsit me sipërfaqe 3,037 m², mbulon 25 linja me qytetet jugore. Në këtë terminal ushtrojnë veprimtarinë 55 subjekte dhe është i organizuar me 24 vende stacionimi.
- Terminali i autobusëve ndërqytetas për zonën e Jug-Lindjes me sipërfaqe 2,660 m² mbulon 6 linja me qytetet juglindore dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre 20 subjekte. Ky terminal është i organizuar me 19 vende stacionimi, ku 5 prej tyre u janë dedikuar linjave rrethqytetase ndërsa 14 të tjerat për linjat ndërqytetase.
- Terminali i autobusave ndërkombëtar dhe ai i Kosovës. Në këtë terminal ushtrojnë veprimtarinë 49 subjekte që kryejnë 25 linja. Sipërfaqja e këtij terminali është organizuar në 19 vende stacionimi për automjetet, të cilat janë të ndara sipas linjave përkatëse që ushtrojnë subjekte të ndryshme.

Portat intermodale janë të dobishme për të parandaluar futjen e automjeteve të mëdha në qëndër të Tiranës dhe janë të kombinuara me objekte të nevojshme të tilla si tualete, dhomë për shitjen e biletave, dhoma e pritjes, dyqane, restorante, qendra taksish, dhe gjithashtu janë të nevojshme vendet për biçikletat dhe parkingjet. Këto terminale të parkimit duhet të lidhen me qytetin me linja të shpeshta dhe me linjat e tjera të transportit publik për transferim në qendër të Tiranës apo edhe në destinacione të tjera.

Tabela Nr 21. Të dhëna mbi performancën e terminaleve

Nr	TERMINALET E AUTOBUSAVE/ TË DHENA 2017	NR.I STACIONIMEVE	NR I LINJAVE	NR I MJETEVE NE QARKULLIM(AFERSISHT NE NJE DITE PA SHKARKIME)
1	Terminali Jugut	30	25	250
2	Terminal Ndërkombetar	19	25	125
3	Terminal Juglindje	19	6	90

Burimi: Agjencia Tirana Parking

Aktualisht në Tiranë mungon nje terminal për të siguruar shpërndarjen e mallrave dhe trafikun e kamionëve duke patur parasysh edhe nevojën për një terminal të tillë pas zhvillimit të zonave industriale të planifikuara si dhe atyre ekzistuese. Nevoja për një terminal për kamionë, si një “qëndër metropolitane logjistike” për shpërndarjen e mallrave, diku përgjatë rrugëve kryesore, sidomos në korridorin për transportin e mallrave (Durrës-Elbasan) shihet e nevojshme sipas PPVBT. Gjithashtu shihet e nevojshme ngritja e një agjencie të re, si autoriteti i transportit vendor, e cila duhet të bazohet në përputhje me një plan për zhvillimin e sistemit të gjerë të transportit metropolitane.

4.11.2.6 Këmbësorët dhe çiklistët

Përshkrimi i itinerareve në këmbë është në fokus të përmirësimit të mobilitetit në Tiranë. Sipas PPVBT dhe disa anketimën rreth 30-40% e udhëtimeve në Tiranë kryhen në këmbë. Megjithatë trotualet e cila është dhe infrastruktura në të cilën zhvillohet kjo mënyrë transporti shpesh janë të pamjaftueshme dhe në gjendje jo të mire dhe jo funksionale.

Nga ana tjetër kapaciteti i trotuareve brenda lagjeve është i pamjaftueshëm ose mungon tërësisht. Kjo bën të mundur që edhe siguria e këmbësorëve të jetë e ulët. Duhet theksuar fakti që nuk ekzistojnë standardet për rrugët urbane. Gjithashtu në rrjetin rrugor të Tiranës vërehet një numër i vogël i kalimeve të këmbësorëve me anë të vijëzimit apo me anë të mbikalimeve.


Korsitë e Biçikletave

Një nga pjesët kryesore të sistemit multimodal, të qëndrueshëm dhe të barabartë të mobilitetit është rrjeti i biçikletave, i cili është zhvilluar pjesërisht në Tiranë dhe vetëm pas vitit 2015 ka filluar të bëhet një opsion i sigurt dhe i përshtatshëm pas implementimit të korsive të sigurta në disa nga rrugët kryesore. Gjithashtu numri i vendparkimeve për bicikleta ishte 140 duke vendosur të githë infrastrukturën e nevojshme për këtë rrjet. Ky rrjet biçikletash aktualisht është i limituar në hyrjen e rrugëve urbane dhe nuk ka vazhdimësi ç'ka sjell dhe përdorim të ulët të biçikletave.

Në një pjesë tjetër të mirë korsitë e biçikletave janë në rrugë ose në trotuar të shënuar me sinjalistikë horizontale. Çiklizmi në këto rrugë është i përzier me trafikun e makinave dhe për trafikun e lehtë janë marë masat për të siguruar sjelljen e duhur të makinave.

Një element tjetër është mirëmbajtja e korsive ekzistuese. Kjo çon në krijimin e një rrjeti me kosto të ulët. Ka nevojë për zhvillim dhe formalizim të këtij rrjeti nëpërmjet bashkëpunimit me organizata që inkurajojnë qytetarët në përdorimin e biçikletave për udhëtime nën 5 km. Kjo mund të arrihet nëpërmjet mbështetjes financiare dhe logjistike që do të forcojë kulturën e çiklizmit.

Figura Nr 18: Harta e Rrjetit aktual të Biçikletave



Burimi: Bashkia Tiranë TR030

Bazuar në PPVBT synohet krijimi i një rrjeti të lëvizjes me biçikleta, duke ofruar një rrjet minimal ku qytetarët orientohen që shumicën ta kryejnë me këto mjete (pesë km nga qendra). Korsitë midis këtyre rrugëve parashikohen të kenë një trafik të lehtë 30 km/h (ose më të ulët), për të siguruar çiklizmin e sigurt.

BT e ka fokusuar vëmendjen në këto pika:

- Dizenjimin e një broshure informative/hartografike për rrjetin e biçikletave
- Zgjerim i rrjetit bazë të çiklizmit
- Shtimi i një zëri të veçantë në buxhet për këtë rrjet
- Forcimi dhe zgjerimi i sistemit të biçikletave me qira
- Mbështetje dhe ndërgjegjësim mbi kulturën e përdorimit të biçikletave

4.12 UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime e Tiranës (UKT) u krijua në 1939 pas përfundimit të ndërtimit të sistemit të parë të ujësjellësit. Uji merrej nga Lumi i Tiranës, kalonte përmes një impianti të trajtimit të ujit dhe furnizonte qendrën e re të asaj kohe, që përbëhej kryesisht nga ndërtesa qeveritare. Detyrat e UKT-së ishte të administronte impiantin e trajtimit dhe të furnizonte rrjetin e shpërndarjes së asaj kohe. Gjatë viteve që pasuan, popullsia e Tiranës u rrit në mënyrë të qëndrueshme dhe po kështu u rrit edhe kërkesa për burime të reja të ujit, duke përfshirë Selitën në vitin 1951, Shën Mërinë në vitin 1964 dhe Bovillën në vitin 1974. Në vitin 1989 u vendos të ndërtohej diga e Bovillës për të krijuar një liqen me ujë për të furnizuar impiantin e saponduar të trajtimit të ujit me kapacitet depozitimi dhe furnizimi prej 100 milion m³.

4.12.1 Sistemi i Furnizimit me Ujë

Menaxhimi i kërkesës për ujë nga UK Tiranë ka qenë gjithmonë një çështje prioritare, duke qenë se sistemi i ujësjellësit është më i madhi në vend dhe ka kompleksitetin më të madh teknik të çdo sistemi që përfshin të gjithë komponentët që mund të gjenden në një sistem ujësjellës-kanalizime.

Sistemi aktual mbi të cilin është ngritur dhe funksionon UKT përbëhet nga 4 shtylla kryesore:

- ❖ Burimet
- ❖ Transmetimi
- ❖ Akumulimi dhe
- ❖ Shpërndarja


Aktiviteti kryesor i UKT-së është i fokusuar në:

- Shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij
- Mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm
- Prodhimin dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve
- Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura dhe shitja e tij

- Mirëmbajtja e sistemeve të ujrave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre

Rritja e cilësisë së shërbimit, përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit të shpërndarjes, furnizimi me ujë i qytetit të Tiranës 24 orë në ditë dhe sigurimi i cilësisë sipas standardit shtetëror 3604:1997 “ujin e pijshëm” që furnizon konsumatorët është prioritet i UKT-së.

Figura Nr 19: Zona e re e Shërbimit të UKT-së



Burimi: Bashkia Tiranë, UKT

Zona aktuale e shërbimit e UKT-së furnizohet nga tre lloje burime të ndryshme uji; burime natyrore që zakonisht vijnë nga malet, puse dhe stacione pompimi, ujëra sipërfaqësorë dhe impiante të trajtimit të ujit të pijshëm.

Vëllimi vjetor i ujit të prodhuar për vitin 2017 ishte rreth 206 milion m³. Mbulimi me shërbim i popullsisë në zonën e UKT-së, për të njëjtin vit, për NJA urbane ishte 92.% ndërsa për NJA rurale 50.4%. Vëllimi i ujit të faturuar për vitin 2016 ishte mesatarisht 67 milion m³ dhe lidhjet me matës për të njëjtin vit ishin rreth 75% e totalit të lidhjeve. Përqindja e ujit pa të ardhura ishte 67.6% në zonën e UKT-së dhe 67.4 në zonat e NJA rurale.

Tabela Nr 22: Karakteristikat e Burimeve të ujit

Lloji	Emri	Sasia maks. (l/sek)	Sasia min. (l/sek)	Niveli (m. mbi niv.det)
Burime	Selita	1,000	230	1,150
	Shën Mëria	640	450	750
	Bovillë e Vjetër	420	140	282
Pus	Pishinat	120	80	96
	Laknas	160	80	56
	Bërçull	200	150	48

	Pema	40	35	91
	Buka	50	40	90
	Coca-Cola	25	20	71
	Çokollata	60	40	95
Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm	Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm Bovillë	1,800	1,800	206
Total		4,515	3,065	2,935

Burimi: Bashkia Tiranë, UKT

Rrjeti i furnizimit me ujë i UKT-së, që fillon nga rezervuarët e ndryshëm dhe përfundon me lidhjen tek konsumatorët, përbëhet nga dy lloje: rrjeti i hapur dhe rrjeti unazor. Në shumicën dërrmuese në Tiranë, sistemi është rrjeti i hapur dhe vetëm në disa zona të vogla mund të gjendet një rrjet unazor. Kuptohet që ka shumë probleme gjatë orëve të pikut të kërkesës për furnizim me rrjetin e hapur. Rrjeti i përgjithshëm i shpërndarjes së ujit është i përbërë nga 1.8 milion metra tubacione. Ky rrjet ka tuba që datojnë që nga viti 1940 si dhe tuba të rinj të instaluar në vitin 2015.

4.12.2 Impianti i Trajtimit të Ujit

Impianti i Trajtimit të Ujit (ITU) të Bovillës ka një kapacitet prodhimi deri në 1,800 l/sek ujë të pijshëm për të furnizuar BT-në. Uji rrjedh me gravitet nga diga e Bovillës, në lartësinë 275 m mbi nivelin e detit, përmes një tubi çeliku me diametër DN900 mm dhe gjatësi 10 km, drejt impiantit të trajtimit të ujit që ndodhet në Babrru, në lartësinë 217 m mbi nivelin e detit. Cilësia e ujit që shkon në ITU konsiderohet e kategorisë A1 sipas standardeve të BE-së, kështu që proceset që duhen për të shndërruar këtë ujë në të pijshëm janë koagulimi-flokulimi, filtrimi dhe dezinfektimi. Dezinfektimi arrihet duke futur kimikate të tilla si acidi klorhidrik, hipokloriti i natriumit, polikloridi i aluminit, etj, në doza të përcaktuara në momentin kur uji hyn në fazën e parë të procesit të trajtimit.

Pas fazës përfundimtare të trajtimit, që është filtrimi, uji kalon në rezervuarin e ITU-së, me kapacitet 30,000 m³. Nga aty, uji shpërndahet me dy tubacione kryesore transmetimi, një që sjell ujë direkt në sistemin e furnizimit të Tiranës dhe tjetri në rezervuarin e Kinostudios.

4.12.3 Sistemi i kanalizimeve

Sistemi i kanalizimeve të UKT-së ka një gjatësi totale prej 596 km dhe është i gjithi me një sistem graviteti, prandaj nuk ka stacione pompimi apo ngritjeje. Ky rrjet është i ndarë në rrjet parësor (30%), dytësor (50%) dhe tretësor (20%). Brenda zonës urbane të BT-së ka dy pika kryesore shkarkimi: Lumi i Lanës dhe Lumi i Tiranës. Të gjitha shkarkimet bëhen përmes kolektorëve dhe kanaleve, të cilat përbëhen nga tuba të mbyllura betoni me DN që ndryshon nga 1000 mm në 2000 mm. Rrjetet dytësore dhe tretësore përbëhen nga tuba PE, betoni ose betonarme, me DN që varion nga 200 mm në 1,000 mm.

Deri në vitin 1997, të gjitha investimet që bëheshin në rrjetin e kanalizimeve mbështeteshin në një plan të detajuar të hartuar në vitin 1962, plan që parashikonte një periudhë 20-vjeçare. Pas 1997, kur popullsia e

Tiranës filloi të rritej me shpejtësi, nuk u ndoq më asnjë plan për zbatimin e infrastrukturës së kanalizimit duke e lënë atë ndonjëherë të papërfunduar ose në disa raste edhe duke dëmtuar atë ekzistuese. Ka ende një numër të konsiderueshëm kolektorësh të kanalizimeve në Tiranë, të cilët janë ende të bllokuar për shkak të ndërtimeve të reja të ndërtuara mbi to, pa respektuar rregullat standarde teknike të ndërtimit.

Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve për vitin 2017 ishte 85.9% në zonë e UKT-së dhe 37.6% në zonën e NJA rurale. Aktualisht të gjitha kanalizimet shkarkohen të patrajtuara në pikat e shkarkimit të përmendura më sipër. Në vitin 1997, Agjencia Japoneze për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (JICA) financoi një studim për të trajtuar shërbimin e kanalizimeve në Tiranë dhe në 2014 nisi projektimi, i pasuar nga ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të ndotur që i shërben BT-së. Ky impiant ndodhet në NJA Kashar dhe pritet të vihet në punë në fillim të vitit 2019.

Problematikat e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve

- Rrjeti i amortizuar i linjave të transmetimit që furnizojnë me ujë Qytetin e Tiranës është investuar nga vitet 1950 -1964-1974 dhe në vazhdim ndërsa për rrjetin e shpërndarjes që prej vitit 1964.
- Ndërhyrje emergjente të fragmentuara në rrjet pa një projekt afat-gjatë dhe gjithëpërfshirës.
- Mungesë e furnizimit me ujë 24 orë dhe krijimi i situatave të emergjencës gjatë sezonit veror.
- Mbulimi me shërbim ujësjellës i popullsisë 85%.
- Nivel i lartë i ujit pa të ardhura prej 67.6 %.
- Lidhje të paligjshme që kryesisht vijnë nga zonat informale që në total të hapësirës ku operon UKT përbën 26.4%.
- Mungesë e azhurnimit të hartave të sistemit.
- Mos trajtimi i ujërave të ndotura sipas udhëzimeve të BE-së për shkak të mungesës së Impjantit të Perpunimit të Ujërave të Zeza.
- Zgjerimi i zonës së shërbimit në NJA rurale.
- Performancë financiare e dobët për shkak të detyrimeve të prapambetura të pashlyera.
- Nivel i matjes prej 75% (79.35% Tiranë dhe 35.8% NJA rurale) dhe mungesa e matësave në burim dhe rrjetin shpërndarës krijojnë probleme për hartimin e bilancit të ujit.
- Performancë e dobët arkëtimi e mbartur nga vitet e mëparshme (vlera e madhe e llogarive të arkëtueshme).

4.13 HAPËSIRAT PUBLIKE

Koncepti i hapësirave publike është tepër kompleks. Hapësira publike janë territore, të destinuar për përdorim publik, ku me përdorim publik kuptohen disa lloje aktivitesh. Hapësirat publike mund të jenë si prona publike dhe prona private, të destinuara për përdorim publik.

Në bazë të përkufizimit hapësirat publike do të klasifikojmë në grupe të mëdha dhe në nëngrupe të tjera për të identifikuar më pas se cilat do të jenë ato që do lejohen të shfrytëzohen nga bizneset dhe cilat jo.

Hapësirat publike territoriale janë:

Hapësirat e gjelbra <ul style="list-style-type: none"> - parqet - lulishtet - hapësirat e gjelbra pranë blloqeve të banimit - fushat e futbollit - fondi i bimësisë së lartë (pemët) 	Hapësira të standartizuara <ul style="list-style-type: none"> - rrugët kryesore, dytësore - trotuaret - bulevardet - sheshet - korridoret - shëtitoret - varrezat - urat lidhëse - këmbesore
Hapësirat e hapura të institucioneve <ul style="list-style-type: none"> - stacionet e autobusave, trenit - objektet fetare, kulturore - shkollat, universitetet - komplekset e argëtimit dhe ato sportive - stadiumet - tarracat e godinave - fasadat urbane 	Hapësirat publike ujore <ul style="list-style-type: none"> - Lumenjtë - Liqenet - Rezervuarët

Hapësirat publike të shfrytëzueshme janë ato hapësira publike të cilat do të lejohen për tu përdorur nga biznesi dhe përfituesit e tij dhe nuk pengojnë zhvillimin e jetës normale të qytetit dhe komunitetit. BT ka hartuar një rregullore për kushtet dhe mënyrën sesi do të shfrytëzohen hapësirat nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar në këto hapësira.

Hapësirat publike të pashfrytëzueshme (nga biznesi dhe përfituesit e shërbimeve të tij) janë ato hapësira të cilat janë jetike për ushtrimin e veprimtarisë së komunitetit dhe kanë vlera natyrore, kulturore, historike dhe arkeologjike.

Figura Nr 20: Hapësirat e Gjelbra në Tiranë



Studimet e zhvilluara në qytete të mëdha tregojnë se si hapësirat e gjelbra urbane ndikojnë në uljen e dioksidit të karbonit. Pra një mbulesë e mirë me pemë në qytet mund të ndikojë në mënyrë të rëndësishme në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Parqet dhe hapësirat e gjelbra në Tiranë

Në strukturën përbërëse të qytetit dallohet qartë një ndarje midis pjesës veriore (e ndërtuar në mënyrë të dendur) dhe jugore të tij (ku janë vendosur përgjithësisht parqet dhe lulishtet). Të vendosura brenda qytetit ose në afërsi të tij, ato përbëjnë pikat më të vizituara nga qytetarët. Sipërfaqja kryesore e gjelbrë dhe atraktive për banorët e kryeqytetit, është Parku i Tiranës i krijuar në vitet '60 me sipërfaqe 288 ha. Sipërfaqe të tjera të gjelbëruara në Tiranë janë "Parku Rinia", parku përballë Parlamentit, si edhe një sërë lulishtesh të shpërndara në brendësi të qytetit.

Sot Tirana është zgjeruar shumë dhe në të përfshihen zona të gjelbra si: zona nën malin e Dajtit, zona e Selitës, e Saukut etj. Shumë sipërfaqe të gjelbra ndodhen brenda institucioneve të ndryshme që nga ministritë, spitalet, shkollat, kopshtet, çerdhet etj. Brenda tyre gjenden një numër shumë i madh drurësh, shkurresh e lulesh.

Në qytetin e Tiranës infrastruktura e gjelbrë prej 1,996,432 m² ndahet në:

- Parqe e lulishte të qytetit, 277,304 m² (pa përfshirë 6,220m² sipërfaqe të zënë)
- Parqe periferike, 1,719,128 m² (Parku i Madh i Tiranës, Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, Kopshti Zoologjik)

Nga kjo sipërfaqe totale kanë kaluar me VKB në administrimin e Njërive Bashkiake 59,258 m².

Për sa i përket sipërfaqeve të gjelbra të rehabilituara dhe që mirëmbahen nga APR sipërfaqet e gjelbra të rehabilituara gjithsej janë 292,816 m², prej të cilave 171,043 m² janë rikonstruktuar plotësisht dhe pjesa tjetër është rikonstruktuar pjesërisht.

Sfida e BT-së mbetet evidentimi dhe kategorizimi i të gjithë hapësirave publike duke hartuar plane lokalizimi sipas destinacionit të përdorimit të kësaj hapësire për ti dhënë frymë qytetit.

4.13.1 Administrimi i Objekteve në Bashkëpronësi

Si kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana duhet të kthehet në një model të gjithëpërfshirjes që të plotësojë nevojat e komuniteteve, integrimin e tyre në shoqëri dhe në ekonominë lokale. Administrimi i bashkëpronësisë dhe hapësirave të përbashkëta ku banojnë qytetarët janë rastet më direkte të nevojës për gjithëpërfshirjen qytetare.

Administrimi i bashkëpronësisë rregullohet nga Ligji 10 112 (2009) "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit" i cili ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve juridike në fushën e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, të truallit dhe mjediseve ndihmëse, që janë në bashkëpronësi të detyrueshme, përcaktimin e subjekteve, marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe me të tretët, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta, si dhe sanksionet përkatëse, në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve.

Në Tiranë ekzistojnë rreth 5,000 objekte banimi (pallate), prej të cilëve në 2017 vetëm 2,765 ose 55.3% prej tyre kanë të regjistruar kryesinë në Regjistrin e Bashkëpronësisë dhe 480 administrator në librin përkatës të administratorëve, 20 janë shoqëri administrimi dhe 460 janë persona fizik (19 janë persona fizik të pajisur me NIPT). Shumë prej këtyre ndërtesave kanë nevojë për ndërhyrje rehabilituese dhe

përmirësim të infrastrukturës. Në këtë kuadër BT ka nisur dy programe për të adresuar problematikat që ndeshen në fushën e bashkëpronësisë.

- Regjistrimi dhe formalizimi i strukturave të Kryesive dhe Administratorëve. Me anë të VKB-së Nr. 45, datë 06.07.2016 për "Ngritjen e Task Forcës për regjistrimin e asambleve të bashkëpronësisë dhe administratorëve të bashkëpronësisë", BT nisi një fushatë të gjerë inventarizimi dhe formalizimi të asambleve dhe administratorëve të objekteve në bashkëpronësi. Për këtë BT ngriti një task forcë që do realizojë inventarizimin dhe formalizimin e objekteve deri në përfundim të mandatit 18 mujor.
- Programi "Fondi i Komuniteteve". Me anë të VKB-së Nr. 14, datë 20.02.2017 për "Miratimin dhe Zbatimin e Programit "Fondi i Komuniteteve", hartuar sipas Udhëzuesit Operacional për Zbatimin e Programit "Fondi i Komuniteteve", BT nisi një tjetër fushatë nxitje bashkëpunimi efektiv mes qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të banimit dhe ruajtjen e ambjenteve në pronësi të përbashkët.

Në këtë kuadër Në këtë kuadër gjatë vitit 2017 janë depozituar 12 projekt ide nga administratortë. Këshilli teknik ka miratuar 10 projekte përfundimtare. Në 8 pallate ka përfunduar investimi dhe kanë përfituar 225 bashkëpronarë. Këto projekte janë shtrirë në NJA urbane Nr. 4, 5, 7 dhe 10.

Në zbatim të programit "Fondi i Komuniteteve", me qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe asamblesë së bashkëpronarëve dhe bazuar në fluksin e aplikimeve të bëra pranë NjA-ve për vitin 2017, propozojmë që ky fond të rritet (dyfishohet) në vitin e ardhshëm në vlerën 40,000,000 lekë / vit, në mënyrë të tillë që të gjejë zbatim minimalisht në dy objekte në çdo NJA.

4.14 INFRASTRUKTURA ARSIMORE

Një nga sfidat kryesore që has sot arsimit parauniversitar në gjithë vendin është gjendja jo e mirë e infrastrukturës fizike të institucioneve arsimore. Kjo situatë është evidentuar edhe në SKZHI ku theksohet se gjendja përgjithësisht e dobët e infrastrukturës fizike shkollore pengon ofrimin e një arsimit cilësor në të gjitha nivelet.

Programi i ndërhyrjeve të BT-së në përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parauniversitar në përputhje dhe me objektivat e SKZHI-së dhe Strategjia e Arsimit Parauniversitar (SAPU) synon pikërisht rritjen e cilësisë mësimore dhe performancës së nxënësve. Zhvillimi i pakontrolluar hapësinor dhe demografik i Tiranës është shoqëruar me një "stres" në ofrimin e shërbimeve siç është dhe ai i arsimit parauniversitar. Gjatë viteve të fundit, investimet në infrastrukturën arsimore parauniversitare të Tiranës kanë ardhur duke u rritur. Megjithatë, pavarësisht nevojës për shkolla të reja që diktohet nga rritja drastike e popullsisë së Tiranës dy dekadat e fundit, këto investime më së shumti janë fokusuar në rikonstruksionin e ambienteve shkollore ekzistuese për të përmirësuar kushtet e mësimin dhe arritjen e standardeve.

Përmes programit të Qeverisë "Ndërtimi dhe Rehabilitimi i Shkollave" me një financim të pjesshëm prej 12.4 milion euro nga Banka e Këshillit të Evropës (BKE), i cili filloi të zbatohet në vitin 2005, në kryeqytet u ndërtuan 7 shkolla të reja (4 të ciklit të mesëm dhe të ulët dhe 3 shkolla të mesme) si dhe u rehabilituan ambientet e 12 shkollave të tjera (9 të ciklit të mesëm dhe të ulët dhe 3 shkolla të mesme). Nga ky program u arrit përmirësimi i normave akademike dhe ambienteve fizike të shkollave prej të cilave përfituan rreth 17,000 nxënës dhe rreth 1,000 mësues.

Ndërkohë nga vetë të ardhurat e BT-së në 10 vitet e fundit, shpenzimet kapitale për investimet në arsim kanë qënë rreth 2 miliard lekë nga të cilat vetëm në periudhën 2015-2017 janë investuar rreth 6 miliard lekë.

Nevoja për përmirësimin e infrastrukturës në shkollat e Tiranës nuk lidhet thjesht me kushtet bazë të godinave shkollore (si ndriçimi, ngrohja, hapësirat rekreative dhe sportive, etj.) por sidomos me shpërndarjen jo-efektive dhe aksesueshmërinë e dobët të objekteve shkollore, sidomos në zonat informale të kryeqytetit. Përpos investimeve të shumta në rinovimin e godinave dhe ndërtimit të një numri shkollash, ritmet e zhvillimit të Tiranës kanë qënë në përpjestim të drejtë me ritmin e mbulimit të zonave me këtë shërbim.

Kjo ka bërë që gjatë viteve të krijohen disa probleme të mprehta me të cilat përballlet komuniteti si:

Mësimi me dy turne. Në BT, 66% e shkollave 9-vjeçare në zonat urbane dhe 8% e shkollave 9-vjeçare në zonat peri-urbane dhe rurale e zhvillojnë mësimin me dy turne. Ndërsa 15% e shkollave të mesme në zonat urbane dhe 25% e shkollave të mesme në zonat peri-urbane dhe rurale e zhvillojnë mësimin me dy turne. Është vërtetuar nga studime të ndryshme se zhvillimi i mësimin me dy turne është burim i një sërë problemesh, si: përqëndrimi i dobët i fëmijëve gjatë mësimin të zhvilluar në oraret e pasdites, mundësia e limituar e prindërve për të shoqëruar fëmijët nëpër shkolla për shkak të përplasjes me oraret e punës, mbipërdorimi i shkollave dhe amortizimi i shpejtë i tyre etj.

Numri i lartë i nxënësve për klasë, apo siç njihet ndryshe në literaturën ndërkombetare "madhësia e klasës". Sot në Tiranë, një numër i konsiderueshëm shkollash të ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm kanë një madhësi klase që shkon mbi 30-35 nxënës për klasë ku mesatarja e madhësisë së klasës në vendet e OECD është nga 21-25 nxënës për arsimin parësor. Ndërsa sipas Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", numri optimal i nxënësve për klasë mësimore është 30 ose brenda intervaleve të shprehura në tabelën e mëposhtme:


Tabela Nr 23: Numri i nxënësve për klasë mësimore

Arsimi	Klasat	Nr i nxënësve
Arsimi bazë	Klasa përgatitore	25
	Klasa e parë	26 -30
	Klasat II-IV	30-35
Arsimi i mesëm i ulët		30-35
Arsim i mesëm i lartë		30-35

BT duhet të përpiqet të arrijë fillimisht standartet e përcaktuara në kuadrin ligjor përkatës, e më pas të synojë drejt standarteve më të larta ndërkombëtare.


Vështirësia e aksesit në shkolla. Zhvillimi i vullshëm demografik i Tiranës dhe përqëndrimi i ndërtimeve të reja në territore periferike të pazhvilluara deri në fillim të viteve '90, ka bërë që në disa NJA të Tiranës të kenë zona me dëndësi banimi urbane të pambuluara me institucione arsimore, duke e bërë të vështirë aksesin e nxënësve. Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" shërbimi parauniversitar ka rrezën e saj të mbulimit.

Figura Nr 21: Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave 9-vjeçare (2016)



Burimi: Bashkia Tiranë, Studim Fizibiliteti "Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë"

Figura Nr 22: Rrezet e mbulimit të territorit me shërbimin e shkollave të mesme (2016)



Burimi: Bashkia Tiranë, Studim Fizibiliteti "Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë"

Në vitin 2016, BT ndërmorri kryerjen e një studimi fizibiliteti për të evidentuar nevojat e Tiranës për ndërtimin e shkollave të reja në ato zona që kanë më shumë nevojë. Ky studim nxorri në pah nevojën për

ndërtimin e 17 shkollave të reja, nga të cilat 10 do të jenë shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Financimi i ndërtimit të këtyre shkollave do të arrihet nëpërmjet një modeli të Parteneritetit Publik Privat (PPP) për shkak se buxheti i BT-së nuk e përballon dot ndërtimin e tyre me ritmet urgjente për të cilat kanë nevojë qytetarët. Me ndërtimin e këtyre shkollave të reja, si dhe me përfundimin e rindërtimit të tre shkollave të reja të nisura përpara kryerjes së studimit, Tirana nuk do të ketë më shkolla të mbushura mbi kapacitetin e tyre normal apo që e zhvillojnë mësimin me dy turne. Godinat e reja do të përmbushin standartet e cilësisë dhe sigurisë si dhe do të jenë më të aksesueshme për nxënësit me aftësi të kufizuara. Gjithashtu kusht i rëndësishëm në projektimin e tyre është krijimi i hapësirave sportive, rekreative dhe të gjelbra sipas standarteve të përcaktuara për të investuar jo vetëm në përmirësimin e procesit mësimor por edhe në kulturën e përgjithshme të qënurit aktiv.

Përveç shkollave, problemi i mungesës së ambienteve edhe mbipopullimi, ka prekur edhe kopshtet. Për vitin shkollor 2017 – 2018 numri i kopshteve publike në BT është 43 kopshte, mes të cilëve 36 me dreke dhe 7 pa dreke dhe frekuentohen nga rreth 10.800 fëmijë. Sipas Udhëzimit Nr. 21, datë 23.7.2010 të Ministrisë së Arsimit, grupet e fëmijëve në kopshte në qytet formohen me jo më pak se 25 fëmijë. Nga ana tjetër, për të përballuar nevojën në rritje për kopshte, vihet re një rritje konstante e numrit të kopshteve private. Në këtë mënyrë, numri i kopshteve private në Tiranë është rritur nga 17 në vitin 2006 në 57 në vitin 2017 ndërsa numri i fëmijëve që frekuentojnë këto kopshte është rreth 3.300.

Por, megjithë këtë rritje të numrit të kopshteve private, kapaciteti total i institucioneve arsimore parashkollore në Tiranë (duke kombinuar kopshtet publike dhe private) është shumë herë më i ulët se nevojat e qytetit. Për ti dhënë zgjidhje këtij problemi studimi i fizibilitetit evidentoi mundësinë për të inkuorporuar kopshte brenda godinave të 10 shkollave 9-vjeçare që do të ndërtohen të reja por duke patur hyrje dhe oborr të veçantë. Ndërtimi i kopshteve të integruara, nga njëra anë, zgjidh problemin e mprehtë të mungesës së infrastrukturës parashkollore dhe nga ana tjetër, ka kosto ndërtimi shumë më të ulët sesa po të ndërtoheshin si objekte të veçanta.

Një nga iniciativat më të suksesshme të BT-së në lidhje me APU ka qenë nisma e “Adopto një Çerdhe” ku nëpërmjet saj u rikonstruktuan 31 çerdhe/kopshte falë kontributit të donatorëve, që i'u bashkuan nismës. Aktualisht në Tiranë çerdhet frekuentohen nga 3,079 fëmijë.

BT do të vazhdojë të evidentojë nevojat për ndërhyrjet rehabilituese në këto objekte vit pas viti. Projektet me një fokus maksimal tek arsimimi i një brezi më të mirë për Tiranën është një element i rëndësishëm i programit politik të Kryetarit të Bashkisë për mandatin 2015 – 2019. Gjithashtu është në përputhje si me procesin e planifikimit kombëtar e sektorial ashtu edhe me politikat afatgjata të zhvillimit të Tiranës.


4.14.1 Rezidencat studentore universitare dhe konviktet

Nevoja për përmirësimin e infrastrukturave arsimore nuk prek vetëm arsimin parauniversitar por gjithashtu edhe arsimin universitar, më saktë administrimin e rezidencave studentore dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale. Sipas kuadrit ligjor aktual, kompetencat e lidhura me mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore universitare i ka qeveria qendrore ndërsa infrastruktura e rezidencave universitare dhe konvikteve të gjimnazeve është përgjegjësi e bashkive. Për vite me radhë këto rezidenca i janë nënshtruar ndërhyrjeve dhe rikonstruksioneve të pjesshme që kanë zgjidhur përkohësisht ose pjesërisht problemet e shfaqura. Nevoja për ofrimin e infrastrukturave akomoduese me standarte ka bërë që Bashkia Tiranë të ndërmarrë hapa konkrete për të ndërhyrë në përmirësimin e situatës.

Sha “Rezidenca Studentore Universitare” Nr.1

Qyteti Studenti është ndërtuar para më shumë se 50 viteve dhe në projekt ishin parashikuar 35 ndërtesa, me një sipërfaqe 255,000 m² dhe me një 155.000 m² sipërfaqe ndërtimit. Aktualisht sipërfaqja e tij është 234,300 m² dhe përbëhet nga 26 objekte (78. 450 m² sipërfaqe ndërtimit) në shërbim të studentëve, të ndara sipas gjinisë dhe 4 objekte shërbimi dhe administrimi (12.800 m²), si edhe ambiente të gjelbëruara, rrugë, sheshe, të cilat janë nën administrimin e shoqërisë aksionere “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”. Në këto rezidenca aktualisht janë të akomoduar 5100 studentë (70% e kapacitetit) në 2013 dhoma.

Nevoja për përmirësimin e kushteve për studentët që akomodohen në to mesatarisht për një periudhë nga 1-6 vite, është emergjente nisur nga problematikat infrastrukturore të mbartura në vite, të cilat nëpërmjet ndërhyrjeve të pjesshme vetëm kanë zgjidhur përkohësisht problemet por asnjëherë përfundimisht ato duke sjellë degradimin e disa prej godinave.



Nevojë për një konceptim të këtyre rezidencave si një kampus i mirëfilltë bëri që gjatë vitit 2016 të hartohet Masterplani i Qytetit Student, një dokument që përcakton riorganizimin e të gjithë hapësirës së qytetit Studenti me fokus ndërtimin dhe rikonstruktimin e rezidencave, objekteve të shërbimit, hapësirave të përbashkëta argëtuese dhe sportive. Pas rikonceptimit dhe përfundimit të ndërtimit/rikonstruksionit kapaciteti i përgjithshëm i kësaj rezidence do të rritet me 33% pra do të mund të akomodohen 10.000 studentë. Për shndërrimin e këtyre rezidencave bazuar në Masterplanin e vitit 2016, ndërhyrjet në të do realizohen në këto faza:

Faza 1 përfshin prishjen e një pjese të rrugës 'Arben Broci' dhe pjesën jugore të mensës si dhe transformimin rrënjësorë të rezidencave nr 16, nr 17, nr 18.

Faza 2 përfshin prishjen e mensës ekzistuese dhe transformimin rrënjësorë të rezidencave nr 11, nr 12, nr 13, gjithashtu edhe ndërtimin e një residence të re nr 35, mense të re dhe një bibliotekë studentore.

Faza 3 përfshin prishjen e ndërtesës përgjatë rrugës 'Pjetër Budi', dhe transformimin rrënjësorë të rezidencave nr 3, nr 5, nr 6, nr 7, nr 8, nr 9, nr 10.

Faza 4 përfshin prishjen e 4 ndërtesave përgjatë rrugës 'Pjetër Budi', transformimin rrënjësorë të rezidencave nr 1, nr 2, nr 4, dhe ndërtimin e rezidencave të reja nr. 37 dhe nr 38. Në këtë fazë parashikohet edhe ndërtimi i një hoteli.

Faza 5 përfshin transformimin rrënjësorë të rezidencës nr 14, dhe ndërtimin e rezidencës së re nr 36, një qendër sportive dhe për media si dhe ndërtimin e një fakulteti.

Faza 6 përfshin prishjen e 10 ndërtesave në pjesën perëndimore të rrugës 'Kadri Kerciku' dhe 'Gramoz Pashko' dhe 'Arben Broci', dhe ndërtimin e rezidencave të reja nr 39 dhe nr 40, ndërtimi i një hoteli dhe një fakulteti tjetër si edhe dhe unazën rrugore të kampusit.

Faza 7 përfshin prishjen e stacionit të energjisë, dhe stacionit të policisë dhe si edhe të 3 ndërtesave në rrugën 'Pjetër Budi' and 'Arben Broci', dhe transformimin rrënjësorë të rezidencave nr 24, nr 25, nr 26, nr 27, dhe ndërtimin e rezidencave të reja nr 30, nr 31 dhe nr 32.

Faza 8, përfshin prishjen e ndërtesave në jug të rrugës 'Pjetër Budi' dhe transformimi rrënjësorë të rezidencave nr 20, nr 21, nr 22, nr 23, nr 28, nr 29, dhe ndërtimi i rezidencave të reja nr 33, dhe nr 34.

Për realizimin e këtij Masterplani nevojitet shembja e 10 ndërtimeve pa leje dhe 5 ndërtesave.


Sha “Trajtimi i studenteve” Nr. 2

Sha “Trajtimi i studentëve” nr.2 ka në administrimin e saj 8 godina, të cilat mirëpresin studentë nga fakulteti Inxhinjerisë dhe Ndërtimit dhe nga Fakulteti i Mjeksisë.

Rezidencat studentore të Fakultetit të Inxhinjerisë dhe Ndërtimit

Këto rezidenca përbëhen nga 4 objekte të ndërtuara në vitin 1990, të projektuara për të mirëpritur një kapacitet rreth 1500 studentësh. Këto 4 godina 6- katëshe lidhen përmes një strukture shërbimi 1 katëshe.

Këto objekte që prej vitit 2018 janë në proces rikonstruktimit nëpërmjet projektit “Rehabilitimi me Eficiência Energjetike” një bashkëfinancim me Republikën Federale të Gjermanisë nëpërmjet KFë me vlerë 16.8 milion euro.



Sipërfaqja totale ku do të ndërhyhet është 16, 814 m². Ndërtesat në total janë parashikuar të kenë 236 apartamente dhe do të akomodojnë në të ardhmen rreth 1100 studentë. Ulja e kapacitetit mikpritës që parashikon ky projekt lidhet me faktin se struktura e godinave nuk do të jetë më me dhoma 3-she ose 4-she, por mini-apartamente, me nga dy dhoma përbërëse që do të akomodojnë 2 – 3 studentë dhe me një tualet të përbashkët. Në çdo kat, është menduar të jetë nga një kuzhinë e përbashkët si dhe një hapësirë ngrenëjeje. Ky investim ka bërë që me ristrukturimin e ri, do të ripozicionohen shumë ambiente teknike të nevojshme për komoditetin që do të ofrohet (sistem qendror ngrohjeje, ujë 24h në ditë, sistem energjie, sanitar etj), të rritet ndjeshëm cilësia e kushteve që iu ofrohet studentëve duke iu afruar atyre standarde europiane. Projekti pritet të përfundojë në shkurt 2019.

Rezidenca studentore të Fakultetit të Mjekësisë

Këto rezidenca përbëhen nga 4 godina të cilat janë kanë një sipërfaqe në total prej 1915 m² dhe me një kapacitet prej rreth 900 studentë. Këto godina janë ndërtuar në periudhën 1955 -1968.

Gjendja infrastrukturore e të 4 godinave edhe pse në këto objekte është ndërhyrë herë pas here (rikonstruksioni i pjesshëm i fundit është bërë në vitet 2011 – 2012) përsëri rezulton me nevoja të mëdha për investime të mirëfillta për eliminimin përfundimtar të problematikave shumë vjeçare dhe përmirësimin cilësor të kushteve dhe shërbimeve për studentët që akomodohen në to dhe jo për të zgjidhur përkohësisht problematikave duke sjellë degradim të mëtejshëm të godinave.


Aktualisht në dy prej godinave(nr 1 dhe nr 3) janë duke u realizuar disa ndërhyrje emergjente falë disa financimeve në sistemin e furnizimit me ujë, sistemin sanitar dhe i një salle studimi.

Sha "Trajtimi i studenteve" Nr. 3

Kjo strukturë ka në administrim 10 godina, të ndërtuara në harkun kohor 1963 – 1993 prej të cilave vetëm në godinat nr 9 dhe nr 10 janë akomoduar 340 studentë në fillim të viti shkollor. Këto godina kanë edhe ambiente shërbimi (mense) por që nuk janë funksionale.

Godinat nr 2 dhe nr 6 janë bosh dhe të pabanueshme për shkak të amortizimit. Në godinat e tjera janë të strehuara rreth 40 familje. Rikonstruksioni i pjesshëm është bërë në vitin 2013 në godinat nr 9 dhe nr 10. Në godinën nr 9 është bërë kati i 4 dhe i 5-të me vlerë 1.943,190 lekë dhe në godinën nr.10 janë bërë pllakat në katin e fundit me vlerë 168,000 lekë.

Numri i studentëve që akomodohen në këto godina gjithmonë pëson rënie gjatë vitit shkollor kjo lidhur me kushtet jo të mira të rezidencave (për vitin 2018 u regjistruan 340 studentë dhe aktualisht kanë mbetur 214 studentë). Nga ana e kësaj strukture është paraqitur një projekt për rikonstruksionin e godinave nr 9 dhe nr 10 në Bashkinë e Tiranës dhe është miratuar paraprakisht rikonstruksioni i tyre. Probleme kanë edhe hapësirat ndërmjet rezidencave pasi kanë nevojë për asfaltim, ndriçim dhe mobilim urban.




Probleme të tjera shfaqen lidhur me gjetjen e një mënyre për largimin e familjeve nga këto objekte (proponohet futja e tyre në programet e strehimit social, bonus qiraje, kreditë e buta, banesat sociale etj) dhe me pagesat e faturave të energjisë elektrike kjo e fundit lidhur me reduktimin e fondit të rimbursimit nga Ministria e Arsimit me 1.3 milion lekë çfarë ka sjellë mungese fondesh edhe për pagesat e rrogave të punësuarve në këtë strukturë. Nga ana e kësaj strukture propozohet futja në rikonstrukcion e godinës nr. 2 dhe 6 për të rritur kapacitetin mikpritës të këtyre rezidencave.

Drejtorja e Konvikteve të Shkollave të mesme (profesionale)

Kjo strukturë është përgjegjëse për akomodimin e nxënësve në shkollat e mesme dhe administron jo vetëm procesin e akomodimit por edhe atë të mirëmbajtjes së objekteve që shërbejnë si konvikte.

Aktualisht kjo drejtori administron 4 godina në të cilat akomodohen 505 nxënës. Kërkesat për akomodim në konvikte rriten nga viti në vit dhe për vitin 2018 nga fluksi i madh i kërkesave DKSHM ka gjetur një zgjidhje alternative (marrja me qira e një godine tjetër). Godinat janë të pajisur me shërbimin e sigurisë (roje) gjatë natës dhe për çdo godina ka dy kujdestarë që punojnë me turne.

Drejtorja e konvikteve te shkollave te mesme (profesionale)



Përveç problemit të mungesës së ambienteve shtesë për akomodim, herë pas herë shfaqen probleme lidhur me kushtet higjieno-sanitare, si edhe dy prej godinave ekzistuese janë privatizuar. Për të ulur shpenzimet operative dhe për të rritur cilësinë e kushteve të akomodimit janë propozuar disa zgjidhje afatmesme (konsolidimi i 4 konvikteve në një godinë të vetme duke shtuar edhe shërbimin e transportit për nxënësit. Konsolidimi do të sjellë edhe zgjidhjen e problemeve të vazhdueshme infrastrukturore. Kjo gjë mund të realizohet në bashkëpunim me bizneset apo me financimet e huaja.

Probleme të tjera lidhen edhe me mungesën e një sistemi prioritizimi që të mund t'ju jepet mbështetje më e madhe shtresave në nevojë (PAK, jetimët, nxënësve me ndihmë ekonomike etj) si edhe unifikimi i formave të subvencionimit për këta nxënës.

BT do të vazhdojë të evidentojë nevojat për ndërhyrjet rehabilituese në këto objekte vit pas viti duke i dedikuar fokus maksimal projekteve që ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të mësim nxënies dhe kushteve të jetesës për gjithë brezin e ri të qytetit. Rritja e këtyre standardeve për tu afruar sa më pranë BE-së dhe për të ushqyer sot zhvillimin social e gjithëpërfshirës të së nesërme ka qenë një element i rëndësishëm i programit politik të Kryetarit të Bashkisë për mandatin 2015 – 2019 dhe do të vijojë të jetë fokus kryesor në mandatin e dytë. Gjithashtu është në përputhje si me procesin e planifikimit kombëtar e sektorial ashtu edhe me politikat afatgjata të zhvillimit të Tiranës.

4.15 PASTRIMI DHE SISTEMI I MANAXHIMIT TË MBETJEVE

Manaxhimi dhe mbledhja e centralizuar e mbetjeve urbane në Shqipëri nuk është në një stad të avancuar, shoqëruar me probleme infrastrukturore, mungesën e kapaciteteve financiare dhe teknike, etj. Mungesa e sistemeve moderne dhe sanitare për trajtimin e mbetjeve urbane dhe atyre inerte, ka sjellë një problematikë serioze në mjedis dhe në shëndetin e njërëzve. Industria e riciklimit është në një fazë fillestare dhe duhet të importojë shumicën e lëndëve të para nga jashtë. Ende mungojnë facilitetet për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe nuk ka procedurë të qartë për menaxhimin dhe kontrollin e landfilleve. Është me rëndësi që investimet e reja në këtë fushë duhet të përqëndrohen më tepër në ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve.

BT ushtron funksionin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve që prej vitit 1994. Bashkia përfshihet në Zonën e Mbetjeve Nr.1 sipas përcaktimeve të Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve (PKMM).


Tabela Nr 24: Sasia e mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Tiranë

Zona e mbetjeve/Bashkia	Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë 2001	Popullsia 2009	Prodhimi i mbetjeve/person/ditë	Ton/ditë	Ton/vit
Zona e mbetjeve 1					
Tiranë	341,453	468,718	1.5	703	256,623
Kamëz	44,443	59,952	1	60	21,882
Vorë	12,885	16,350	0.7	11	4,177
Kavajë	24,776	28,193	1	28	10,290
Rrogzhinë	7,071	9,398	0.7	7	2,401
Komunat	167,298	217,439	0.4	87	31,746

Burimi: Strategjia Kombëtare e Mbetjeve (2010-2025)

Manaxhimi i mbetjeve mbetet një ndër problemet mjedisore më të mprehta për Tiranën, pavarësisht përmirësimeve në kuadrin ligjor përkatës. Sistemi aktual i manaxhimit konsiston në grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane në një rrymë të vetme, transportimi dhe depozitimi i tyre në Landfillin e Sharrës. Shërbimi i mbledhjes dhe transportit në qytet realizohet nga 6 kompani pastrimi private të kontraktuara nga BT.

Figura Nr 23: Pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane



Burimi: Bashkia Tiranë, PPV TR030

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka ngritur dhe përditësuar Regjistrin Vjetor të prodhimit të mbetjeve dhe inerte sipas qarqeve dhe për vitin 2015 rezultoi se në Qarkun Tiranë janë gjeneruar rreth 2 milion ton mbetje të ngurta shtëpiake, 58,743 ton mbetje inerte. Pra raporti për vitin 2015 është 4.7 kg mbetje të ngurta për person. Në mbetjet e ngurta që gjenerohen në territorin e BT-së përfshihen të gjitha tipet urbane, inerte, mjeksore, industriale të parrezikshme dhe të rrezikshme. Për vitin 2017 sasia e mbetjeve të depozituar në Landfillin e Sharrës, për vitin 2017 paraqitet si më poshtë:


Tabela Nr 25: Sasia në % e mbetjeve të depozituara në landfillin e Sharrës sipas kategorive

Rryma e mbetjeve	Janar-Dhjetor 2017
Tekstile	4.42
Dru-shkurre	5.1
Letër-karton	20.41
Materiale Plastike	37.41
Metal	3.06
Inerte-dhera	6.12
Substanca Organike	15.65
Tetrapak	1.7
Qelq	3.06
Të tjera	3.06

Burimi: Open data Tirana

Mbetjet mbidhen në kazanët e vendosur anash trotuareve ose ndërmjet blloqeve të banimit pa asnjë ndarje formale. BT përdor kontenierë mbetjesh me një kapacitet mbajtës 1.1 m³, 1.7 m³, 2.4 m³ dhe 3.2 m³. Numri kontenierëve gjithsej është rreth 3,872 copë. Të gjithë kontenierët e mbetjeve grumbullohen të paktën një herë në ditë ndërsa në zonat me shkarkim të madh mbetjesh shërbimi kryhet dy herë në ditë. Frekuenca e shërbimit të mbledhjes së mbetjeve në gjashtë zonat urbane është 4,070 kontenierë në ditë me volum 610 ton të cilat depozitohen në Landfillin e Sharrës.

Tabela Nr 26: Volumi i mbetjeve të depozituara në Sharrë sipas zonave 2017




Burimi: Bashkia Tiranë TR030

Përlllogaritet që pranë Landfillit të Sharrës depozitohen rreth 800 ton mbetje në ditë. Vendepozitimi i mbetjeve në Sharrë ndodhet në jugperëndim të qytetit të Tiranës. Largësia nga qendra është rreth shtatë km, rreth 20 minuta me automjet. Vendi i tanishëm i depozitimit ka një sipërfaqe rreth 22.5 ha dhe ndodhet në një territor shtesë pranë vendepozitimit të vjetër që është mbyllur në mënyrë të sigurt. Projekti është financuar nga një kredi prej gjashtë milion Euro, dhënë nga qeveria italiane.

Aktualisht procesi është aktivizuar në zonën ku ushtron aktivitetin Eco Tirana Sha, e njohur me emrin "Zona e Kuqe". Kjo zonë përfshin të gjithë territorët brenda unazës së mesme dhe përfaqëson zonën me elemente urban më të plotësuar si në nivel aksesimi ashtu edhe të administrimit të procesit të shërbimit të ofuar. Në këtë zonë kemi të vendosur dy modele kontenierësh (Blu dhe Jeshil), që do të thotë procesi ka parashikuar grumbullim të ndarë të mbetjeve i orientuar në dy rryma, ku në kontenierët blu është parashikuar të grumbullohen mbetjet e biodegradueshme ndërsa në konteinerin jeshil mbetjet e thata si letër, plastik, qelq dhe hekurishte. Në raport me pritshmërinë mbetemi skeptike në lidhje me grumbullimin e ndarë sepse realisht procesi nuk ka kapur parametrat e parashikuar. Shtrirja e tij në gjithë qytetin është detyrim për të cilin po punojmë me të gjithë aktorët pjesë të këtij shërbimi. Nga ana jonë do të dëshironim të konsolidoheshim në nivel qyteti dhe pastaj të organizoheshim edhe në zonat periferike.


Figura Nr 24: Vendodhja e Landfillit të Sharrës



Burimi: Bashkia Tiranë.

Megjithatë landfilli ka shërbyer për zonën urbane, ndërkohë që në zonat rurale mbetjet vazhdojnë të mbledhen në vende jo gjithmonë të autorizuara dhe për më tepër jashtë kushteve mjedisore. Në territorin e BT-së ekzistojnë rreth 46 vendepozitime të paligjshme të cilat janë jashtë çdo kushti mjedisor dhe teknik. Këtu përfshihen edhe shtretërit e lumenjve kryesore që përshkojnë territorin e BT-së.

Figura Nr 25: Vendepozitime e paligjshme të mbetjeve urbane në Tiranë



Pjesë e mbetjeve urbane janë edhe mbetjet spitalore, një pjesë e të cilave përfundojnë në landfill, ndonëse vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në fushën e trajtimit të mbetjeve spitalore disa kompani private. Gjithsesi ka mjaft klinika ambulatorie që mbetjet e prodhuara gjatë veprimtarisë së tyre i hedhin në të njëjtat kontenerë me mbetjet urbane.

Duke qenë kryeqendra dhe metropoli më i madh në vend, BT karakterizohet nga një aktivitet intensiv ndërtimor, pavarësisht se trendi i prodhimit të këtyre mbetjeve për periudhën 2011 – 2015 është në ulje²³. Situata e manaxhimit të tyre vazhdon të mbetet larg kritereve ligjore dhe mungesa e infrastrukturës përkatëse (landfille) ka rezultuar me depozitimin e tyre të paligjshëm përgjatë brigjeve të lumit Erzen, Lumit të Tiranës, Liqenit të Tiranës duke dëmtuar rëndë mjedisin dhe shëndetin.

4.15.1 Diferencimi i Mbetjeve dhe Riciklimi

Në fillim të vitit 2016 BT dhe Bashkia e Veronës nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi për krijimin e një ndërmarrjes publike (ECO Tirana) që do të realizojë grumbullimin dhe manaxhimin e mbetjeve. Ndër projektet strategjike të ndërmarrja nga BT, një prej tyre është manaxhimi dhe trajtimi i mbetjeve nëpërmjet PPP-së.

Ky projekt synon hapjen e qelizave të reja të grumbullimit të mbetjeve në terriore të reja në zonën e Sharrës. Për këtë u vendosën rreth 160 kontejnerë në zonat përreth qendrës së qytetit dhe u shoqërua me një fushatë sensibilizuese për ndarjen e mbeturinave që në burim si edhe me udhëzues (broshura) për mënyrën sesi do realizohet ndarja me qëllim marrjen e mbështetjes qytetare lidhur me këtë nismë. Pavarësisht suksesit fillestar të këtij projekti, ndërgjegjësimi i ngadaltë qytetar por dhe mbledhësit independentë të plehrave nga komuniteti rom dhe egjiptian përbëjnë një pengesë thelbësore në përparimin e mëtejshëm të projektit.

Vihet re depozitimi i lartë i mbetjeve plastike, ndër të cilat një pjesë e mirë e tyre vjen nga përdorimi blerja e ujit të pijshëm i cili shitet me bidona plastike, si dhe pijeve të tjera çka mund të shërbejë si bazë oportuniteti në lidhje me riciklimin e këtyre mbetjeve. Për nga sasia mbetjet organike që gjenerohen nga konsumi i përditshëm zënë vendin e dytë.

Në fund të vitit 2016 ish Ministria e Mjedisit hapi tenderin për koncesionin për ndërtimin e impiantit të djegies së plehrave (inceneratorit) të Tiranës i cili sot Autoritet Kontraktor është MIE dhe Bashkia Tiranë është në rolin e përfituesit të këtij investimi të pritshëm. Ky incenerator do të zhvillojë përpunimin e mbetjeve dhe prodhimin e energjisë por parashikohet të ketë gjithashtu hapësira dhe makineri të cilat do të kryejnë ndarjen e mbetjeve të riciklueshme.

Riciklimi i mbetjeve është në fazën fillestare dhe në territorin e Tiranës ka vetëm pak kompani private riciklimi të cilat grumbullojnë, përpunojnë tipe të ndryshme mbetjesh kryesisht skrap, letër, tekstile etj. BT gjatë 2016 implementoi ndarjen e mbeturinave që në burim në një pjesë të territorit urban të qytetit me sistemin me dy kosha. Kjo metodë ndan materialet e riciklueshme të thata dhe mbetjet e tjera familjare të përziera. Sistemi përfshin dhe shtimin e një koshi për materialet e riciklueshme të njoma (mbetje të biodegradueshme) i cili do të zbatohet në muajt që vijojnë. Bazuar në SKMM, përgatitja për ripërdorim dhe riciklim të materialeve nga familjet deri në 2020 duhet të realizohet të paktën deri në 50% sipas peshës.

Probleme dhe Çështje të Menaxhimit të Mbetjeve

²³Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2015

- Duke marrë parasysh kohën për identifikimin e truallit, projektimin, ndërtimin deri në fillimin e funksionimit të landfillit të ri, duhet që BT të fillojë identifikimin e një vend depozitimi të ri apo edhe zmadhimin e sipërfaqes së vend depozitimit aktual.
- Mungesa në infrastrukturë, numri i kontejnerëve i pamjaftueshëm, mungesë mjetesh motorike, kushte teknike të dobëta etj.
- Numri i paketë i industrive ricikluese dhe vështirësitë teknike që këto kompani hasin në sigurimin e lëndës së parë
- Mungesa e fondeve të nevojshme për investime kapitale, pasi aktualisht tarifohet vetëm shërbimi i largimit të mbetjeve.
- Mungesa e traditës dhe shkalla e ulët e perceptimit të publikut për rrezikun që paraqet për shëndetin dhe mjedisin mostrajtimi i duhur i mbetjeve.
- Mungesa e një sistemi për menaxhimin e mbetjeve voluminozë

Edhe pse puna për ngritjen e strukturave të nevojshme për riciklimin apo grumbullimin e mbetjeve vijon pa ndërprerje, pa patur një kuadër rregullator të mirëfilltë në rang vendi si dhe pa ndërgjegjësimin e plotë qytetar, çështja e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve ka për të mbetur gjithmonë një problem kyç. Është shumë e nevojshme që BT si kryeqytet të bashkëpunojë ngushtë me strukturat qendrore për të nxitur dhe udhëhequr mekanizmat e duhura në drejtim të zgjidhjes së kësaj çështje në rang kombëtar si dhe paralelisht të vijojë një fushatë më të fuqishme, konstante dhe më kreative për ndërgjegjësimin qytetar.

Përsa i takon procesit të riciklimit, BT ka aktivizuar për menaxhimin e shërbimit të pastrimit (bazuar në klauzolat e kontratave të lidhura me operatorët) promovimin e elementeve bazë të këtij shërbimi ku pa dyshim është edhe promovimi i grumbullimit të ndarë të mbetjeve në terren ku secili nga Operatorët në zonën ku ushtron aktivitetin të organizojë dy herë në vit këto fushata promovimi në bashkëpunim me autoritetin kontraktor. Për këtë është parashikuar vijimi i procesit në nivel komunikimi viziv apo percjellja e mesazhit duke filluar nga shteresat me sensibil te shoqerise.

Në nivel politikash parashikohet:

- ◆ Shtirja e shërbimit të grumbullimit të ndarë të mbetjeve (fillimisht me dy rryma) në të gjithë territorin e BT-së urbane.
- ◆ Konsolidimi dhe aktivizimi i shërbimit derë më derë në zonat apo blloqet e banesave ku aksesimi nuk garantohehet për mjetet teknologjike.
- ◆ Përshtatja ligjore e Rregullores së Brendshme të Administrimit të Mbetjeve me legjislacionin aktual
- ◆ Sensibilizimin e bizneseve dhe popullatës me qëllim përcaktimin e fashave të orareve për nxjerrjen e mbetjeve pranë vend-grumbullimeve.


4.16 SIGURIA PUBLIKE

4.16.1 Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)

Ky shërbim ofrohet nëpërmjet strukturave që janë të vendosura brenda territorit të BT-së. Ka 6 stacione të MZSH-së (një qëndror dhe 5 të tjera plotësuese). Dy janë strukturat kryesore: Sektori i mbrojtjes dhe parandalimit dhe Sektori operacional. Në dispozicion është edhe një sallë operative e cila koordinon operacionet në terren si edhe strukturat paralele në raste emergjencash. Kjo sallë ndjek sinjalizimet nga qytetarët deri në zgjidhjen e situatës.

Në dispozicion të qytetit janë rreth 117 zjarrfikës dhe 8 automjete zjarrfikëse. Falë punës së mirë të bërë nga sektori i parandalimit dhe mbrojtjes janë manaxhuar me sukses rreth 2,729 raste (të zjarreve, shfaqje zjarresh dhe ndërhyrje) përgjatë vitit 2017.

Figura Nr 26: Stacionet e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit



Burimi: Bashkia Tiranë, PPV TR030

Kapaciteti aktual i automjeteve edhe stafit të MZSH-së nuk përballon më dinamikën urbane të qytetit si edhe shumëfishimin e sipërfaqes së territorit sidomos pas reformës administrative territoriale. Është përgjegjësi e BT-së që të kryejë studime të hollësishme si edhe të hartojë projekte konkrete në bashkëpunimi me MZSH-në si edhe me simotrat e saj jashtë Shqipërisë për të arritur standardin e duhur të këtij shërbimi.

Në bazë të kuadrit ligjor standardi që ky shërbim duhet të ketë është 1 zjarrfikës për 1,500 – 2,000 banorë (standarti European 1 zjarrfikës për 1300 – 1500 banorë). Nga ky standard rezulton se stafi MZSH-së duhet të shtohet edhe me 280 zjarrfikës, për të mbuluar të gjithë territorin që ka aktualisht BT.

Gjithashtu në qytetin e Tiranës është instaluar një rrjet hidrantësh. Hidrantët janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Vlen të theksohet se funksionimi i tyre është në varësi të gjendjes së ujësjellësit. Nuk ka një përcaktim të qartë se kompetenca e kujt është mirëmbajtja e tyre dhe nuk ekziston një inventar i saktë i tyre. Gjithsesi vënia në funksionim e hidrantëve, zbatimi i kuadrit ligjor lidhur me vendosjen e hidrantëve dhe instrumentave të tjera parandaluese do të përmirësojë ndjeshëm këtë shërbim në qytet.

4.16.2 Policia Bashkiake

Misioni dhe përgjegjësitë e Policisë Bashkiake (PB) përcaktohen në Ligjit nr. 8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar) ku shpreh qartë se PB është organ ekzekutiv që ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të tjera shtetërore.

Me VKM dhe VKB në vite është rritur numri i punonjësve të PB-së në 300 vetë (1 kryeinspektor, 40 inspektorë dhe 259 policë).

Detyrat kryesore të kësaj struktura lidhen me:

- Kontrollin e përditshëm të territorit
- Zbatimin e Vendimeve Administrative
- Parandalimin dhe pezullimin e ndërtimeve pa leje
- Siguria rrugore, etj

4.16.3 Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës, në themel të punës së saj ka mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit dhe konsiderohet si institucioni/organi i administratës publike simbol i sinkronisë dhe bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe atij qendror.

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës, synon të rrisë bashkëveprimin, efektivitetin dhe efikasitetin e punës në përmbushje të objektivave të planifikuara prej saj, nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe kontrollit të vazhdueshëm.

Vizioni i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës, është njëkohësisht vizioni i Bashkisë së Tiranës për mbrojtjen e konsumatorit të qytetit të Tiranës, jo vetëm nëpërmjet monitorimit dhe evidentimit të rasteve, por të ushtrimit të kontrollit të vazhdueshëm dhe marrjen e masave, për rritjen dhe garancinë e sigurisë ushqimore, rritjen e cilësisë së shërbimit në transportit publik qytetas, respektimin e normave të bashkjetesës, etj. me piksynimin e rritjes së standarteve të jetesës në qytetin e Tiranës.

Synohet gjithashtu, që nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe fushatave sensibilizuese, konsumatorët të jenë më të mirëinformuar dhe vetëpërcaktues, në mënyrë që të zotërojnë njohuritë përkatëse mbi të drejtat e tyre në raport me tregun, ofrimin e shërbimeve publike etj. Ata do të kenë një pozicion të mirë në vlerësimin e situatës së tregut, që rrjedh nga mbikëqyrja bashkëkohore dhe transparenca. Duke qënë më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, konsumatorët do të luajnë rol më aktiv, për denoncimin e shkeljeve përkatëse, si dhe një rol përcaktues për mbrojtjen në mënyrë më efektive nga rreziqet, të cilat nuk mund t'i trajtojnë në mënyrë individuale.

Shërbimet që ofron aktualisht kjo agjenci, lidhen me monitorimin, evidentimin dhe kontrollin e zbatimit të kushteve kontraktore dhe akteve të Këshillit Bashkiak apo kryetarit të Bashkisë Tiranë, si dhe sanksionimin e tyre në rast konstatimi të kundërvajtjeve, për:

- Ushtrimin e aktivitetit të ofruar në shërbimin e transportit publik, nga operatorët.
- Mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet e shkaktuara nga mbetjet urbane, të çastit, nga aktivitete prodhimi apo përpunimi, në hapësira publike apo të gjelbër.
- Mbrojtjen nga ndotjet akustike, shkaktuar nga veprimtaritë që për shkak të natyrës së tyre përdorin vazhdimisht gjeneratorë/ventilatorë, të cilët lëshojnë zhurmë në mjediset e hapura të zonave të banuara.
- Mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet që shkaktohen në hapësirat publike nga aktivitetet e shoqërive ndërtimore.
- Ndërhyrjet në infrastrukturën publike dhe që specifikisht kanë të bëjnë me ndërhyrjet në: rrjetin rrugor, rrjetin elektrik rrugor, rrjetin e telefonisë, rrjetin e ujësjellësit, hapësirat publike dhe atë të gjelbër.
- Fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes nga pronarët/kujdestarët e kafshëve/shpendëve shtëpiake, shoqeruese dhe të luksit, në njësitë individuale të banimit, ambjentet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike.

Gjatë vitit 2017, AMK ka kryer kontrole dhe ka konstatuar 255 shkelje në fushën e transportit publik, në fushën e veterinarisë janë kryer 192,730 kontrole, si edhe nga 405 ankesa të ardhura për problematika të ndryshme janë zgjidhur 348 prej tyre.

4.16.4 Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Tiranë (IMT)

Misioni i këtij inspektorati është kontrolli, mbrojtja e territorit dhe e mjedisit nga ndërtimet e zhvillimet e paligjshme apo në shkelje të kushteve të lejeve, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, planifikimit, mbrojtjes së territorit, disiplinimit të punimeve në ndërtim, produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e manaxhimit të integruar të burimeve ujore.

Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) organizohet në dy nivele: në nivelin qendror dhe atë rajonal nëpërmjet këtyre degëve dhe përkatësisht për BT-në është dega e IKMT-së. Për vitin 2016, janë marrë rreth 2,340 ankesa për problematika të ndryshme dhe në 335 prej tyre është ndërhyrë për të zgjidhur situatën. Gjatë 2017 IMT ka marrë 258 vendime pezullimi dhe ka vendosur 635 gjoba.

4.16.5 Emergjencat Civile

Bazuar në Ligjin 8756 datë 26.3.2001 “Për emergjencat Civile” janë një sërë strukturash që angazhohen për mbrojtjen e jetës së shtetasve, pronën e tyre, gjënë e gjallë, mjedisin, objektet social-kulturore dhe të rëndësishme të veçantë, objektet e trashëgimisë kulturore, etj. nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësi që shkaktohen nga veprimtaria njerëzore, duke koordinuar veprimet e strukturave operacionale që kanë përgjegjësi në fushën e emergjencave civile (EC).


Në BT këto struktura operacionale janë Kryetari, Komisioni i EC-së dhe Drejtorja e EC-së që së bashku realizojnë:

- Angazhimin e menjëhershëm dhe efikas të gjithë kapaciteteve dhe burimeve për përballimin e emergjencave civile dhe situatave emergjente;
- Monitorimin e situatës në bashkëpunim me strukturat monitoruese/njoftuese dhe paraqitjen e opsioneve për zgjidhjen e problematikës së identifikuar për koordinimin e punës e marrjen e

masave sa më efikase për përballimin e fatkeqësive që mund të evidentohen në pjesë të ndryshme të territorit të BT-së

- Organizon punën për verifikimin në vend të situatës, procedurave që ndiqen nga personat që merren me emergjencat civile, komisionet e verifikimit dhe vlerësimit të dëmeve dhe përgatitjes së dokumentacionit procedural konform ligjit (asistencë teknike)
- Nxjerr dhe përgatit sistemin e të dhënave të ndryshme për zonat me risk që mund të shkaktojnë situata emergjente, për kapacitetet dhe burimet që mund të aktivizohen në raste emergjence (studime, database)
- Realizon komunikimin me aktorët e ndryshëm, organizatat jofitimprurëse, subjektet e ndryshme private dhe shtetërore, qytetarë, në funksion të gjetjes së zgjidhjeve të duhura dhe përballimit me sukses të situatave emergjente.

Figura Nr 27: Harta e pikave të nxehta



Burimi: Bashkia Tiranë, PPV TR030

Tirana tashmë e ka një Plan Veprimi për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike që përcakton objektivat që ky qytet të ketë një nivel më të lartë qëndrueshmërie kundër këtyre ndikimeve dhe për të shmangur ndikimet negative të ngjarjeve të motit ekstrem me rritjen e shpejtë të qytetit. Megjithatë ka një nevojë për implementimin e ndryshimeve organizative brenda BT-ssë në mënyrë që të rritet gatishmëria e sistemeve të shumëfishtë të qytetit në rast përmbytjesh apo ngjarjeve të shokut.

Në vjeshtën e vitit 2017 BT ngriti për herë të parë “Magazinën e Emergjencave të Qytetit” ku tashmë grumbullohen rezerva ushqimesh, veshjesh dhe materialesh për përballimin e situatave të emergjencës.

Magazina e Emergjencave të Tiranës do të shërbejë gjithashtu si një vend ku mund të ruhen donacionet e shumta që ofrojnë qytetarët apo bizneset e organizatat, të cilat do t'u shpërndahen më pas qytetarëve sipas nevojave.

Sërisht në vazhden e masave pro-aktive për shmangjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike, në kuadër të Planit të Veprimit “Qyteti i Gjelbër” për Tiranën, për pesë vitet e ardhshme janë evidentuar tre masa me prioritet të lartë për të qenë në fokusin e BT, më konkretisht::

1. Vlerësimi i infrastrukturës së digave të Tiranës
2. Krijimi i një plani veprimi për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e tyre
3. Përgatitja e një plani veprimi (organizativ të brendshëm) për emergjencat civile


Veç këtyre masave prioritare të evidentuara në planin e veprimit, BT synon të përmirësojë më tej shërbimin e emergjencave civile për pesë vitet e ardhshme nëpërmjet:

- Ngritjes së Qendrës Operacionale të Emergjencave Civile e cila do të ndihmojë më tej në organizimin dhe efencën e punës përballë situatave emergjente
- Ngritjes së një rrjeti vullnetarësh të trajnuar dhe certifikuar për emergjencat civile në 24 NjA-të
- Pajisjes me mjete të teknologjisë së lartë (sensorë) për sinjalizimin e rritjes së nivelit të lumenjve duke qenë në këtë mënyrë më të përgatitur përpara shirave ekstreme
- Pajisjes me kamera termike për evidentimin e zjarreve në pyjet të cilat janë në hartën e rrezikshmërisë së lartë

4.16.6 Agjencia e Shërbimit Funeral

Varrezat Publike të BT-së janë nën administrimin e Agjencisë së Shërbimeve Funerale (ASHF) me VKB nr.88, datë 29.12.2016. Dy janë sektorët kryesorë në zonën urbane të BT-së, sektori Tufinë dhe Sharrë të cilat në total kanë një sipërfaqe prej 608,843 m² dhe një kapacitet prej 102,086 vende varrimi (Sharra 56,297 dhe Tufina 45,789). Kjo sipërfaqe është shtuar gjatë tre viteve të fundit (105,773 m² shpronësime) nisur nga prioriteti që Kryetari i Bashkisë i ka dhënë këtij shërbimi.

Figura Nr 28: Harta e Varrezave Publike



Burimi: Bashkia Tiranë, PPV TR030.

Gjatë viteve të fundi për shkak të rritjes së numrit të popullsisë është rritur ndjeshëm edhe numri i varrimeve me një mesatare prej 3,400 varrime në vit. Sektori Sharrë ka rreth 5.4 ha tokë të disponueshme, që nënkupton mbulimin me këtë shërbim të varrimit për tre vitet e ardhshme, duke marrë parasysh shfrytëzimin e varrezës murale. Në sektorin Tufinë ka rreth 2.2 ha tokë të disponueshme, që nënkupton mbulimin me shërbimin e varrimit për vetëm 1 vit. Gjatë vitit 2017 sipas VKM nr. 94 dhe 486 janë shpronësuar 7.47 ha dhe përkatësisht 5.43 ha në sektorin Sharrë dhe 2.04 ha në sektorin Tufinë.

Në këta dy sektorë janë projektuar/ndërtuar edhe varrezat murale me kapacitet ende të pashfrytëzuar 1,138 vende (Sharrë 438 dhe Tufinë 750 vende). Shfrytëzimi i varrezës murale Sharrë do të fillojë 6 mujorin e dytë të vitit 2018. Kjo varrezë do të mundësojë lirim të 438 vendeve për varrime të reja, përkatësisht shtimin e shërbimit të varrimit edhe me 2 muaj të tjerë, kjo në varësi të numrit të vdekjeve në muaj. Ndërtimi i varrezës murale në Tufinë nuk ka përfunduar, pasi nuk janë vendosur kasetat dhe për rrjedhojë nuk mund të fillojë shfrytëzimi i saj. Nëse do të vendosej në shfrytëzim do të mundësohej lirim i 750 vendeve për varrime të reja, përkatësisht shtimin e shërbimit të varrimit për rreth 3-4 muaj, kjo në varësi të numrit të vdekjeve në muaj.

Aktualisht, ASHF në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit në BT, janë në proces të verifikimit të statusit juridik të varrezave publike të 13 NJA-ve rurale. Problematikat e hasura në vite në këto NJA rurale lidhen me:

- Nevoja e zgjerimit të territoreve për varreza

- Mungesa e rrethimit të territoreve të varrezave
- Mungesa e administrimit të territoreve të varrezave publike.
- Mungesa e mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave.

Për 5-vjeçarin e ardhshëm janë parashikuar të përmbushen këto objektiva dhe projekte:

- ◆ Manaxhimi eficient i territorit të varrezave publike, nëpërmjet respektimi i distancave ligjore midis varrezave, riaftësimi i varrezave murale (rreth 4,000 zhvendosje në total) dhe aplikimi i varrezës familjare
- ◆ Krijimi i hapësirave të reja për varreza publike, nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve, ndërtimi i varrezave të reja publike dhe murale sipas Planit Urbanistik
- ◆ Informatizimi i të dhënave për të ndjerët
- ◆ Rritja e të ardhurave përmes shërbimeve të reja në varrezat publike

4.16.7 Shërbimet administrative

BT përveç garantimit të mbulimit të territorit të saj më shërbimet që janë të përcaktuara në kuadrin ligjor përkatës, është përgjegjëse edhe për ofrimin e shërbimeve administrative ndaj qytetarëve dhe biznesit.

Me anë të Urdhrit nr. 29662 data 05.10.2016, Kryetari i BT-së përcaktoi listën e shërbimeve që u jepen qytetarëve nga NJA-të dhe/ose strukturat e Aparatit të BT-së. Qëllimi i këtij inventarizimi ishte ofrimi i shërbimeve sa më pranë qytetarëve dhe lehtësimi i marrjes së informacionit rreth këtyre shërbimeve. Aktualisht BT ofron shërbime në 22 fusha:

- | | |
|-----------------------------|-------------------------------------|
| 1. Transport | 15. Kultura |
| 2. Hapësira Publike | 16. Financa |
| 3. Planifikim Territori | 17. Burime njerëzore |
| 4. Tokë | 18. Bashkëpronësi |
| 5. Pronë | 19. Ujësjellës Kanalizime |
| 6. Taksa dhe Tarifa vendore | 20. Procedura ankimimi |
| 7. Strehim | 21. Mbrojta nga Zjarri dhe shpëtimi |
| 8. Shërbim social | |
| 9. Shërbim i varrezave | |
| 10. Ushqim dhe Veterinari | |
| 11. Emergjencia Civile | |
| 12. Arkiva | |
| 13. Banim | |
| 14. Gjendja Civile | |

BT ofron mbi 140 shërbime për qytetarët dhe bizneset në Tiranë. Nga këto shërbime, 74 prej tyre ofrohen nga Bashkia qendrore dhe 67 të tjera në zyrat e NJA-të urbane dhe rurale.

Vitet e fundit Tirana ka bërë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e shërbimeve. Janë hapur Qendra e Licencimit Tiranë (QLT), One stop shop/ zyrat me një ndalesë të UKT-së, dhe onerstop shop i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarfave Vendore (DPTTV). Për më tepër aplikimi për paisjen me leje ndërtimi bëhet nëpërmjet portalit të shërbimeve online e-Albania.

Megjithatë ka ende problematika që duhen adresuar. Informacioni i aksesueshëm online për sa i përket institucionit/vendodhjes ku ofrohen këto shërbime, dokumentacionit përkatës që duhet dorëzuar, afateve të aplikimit, etj është ende i pa përfunduar. Për më tepër, është e domosdoshme që një pjesë e mirë e këtyre shërbimeve të ofrohen online për të rritur shpejtësinë dhe evitimin e procedurave burokratike.

Shërbimet administrative janë kontakti i parë dhe më i shpeshtë që Bashkia bën me qytetarët e saj. Ofrimi i këtyre shërbimeve në kohë dhe me cilësi të lartë ka qenë objektiv i përhershëm i BT-së, e cila ka organizuar më së miri strukturat që i ofrojnë këto shërbime me një efikasitet të lartë. Fokusi në vazhdim për këto shërbime do të jetë drejt futjes së teknologjisë inovative për të marrë shërbime me kosto të ulët, afate të shkurtra dhe duke eliminuar informalitetin dhe burokracinë.

Gjatë vitit 2017, nëpërmjet të gjitha rrugëve të komunikimit që Sektori i Informimit dhe Shërbimeve me Qytetarët (SISHQ) administroi:

- 117.709 qytetarë që i janë drejtuar Bashkisë Tiranë;
- 96.800 qytetarë (mesatarisht 390 qytetarë/ditë) janë paraqitur në sportelet e SISHQ dhe QLT;
- 37.065 qytetarë (mesatarisht 150 qytetarë/ditë) kanë protokolluar kërkesat/ankesat e tyre.

Për periudhën në fjalë, më poshtë gjeni numrin e qytetarëve sipas rrugëve të komunikimit që SISHQ administron:

- 88.466 qytetarë janë paraqitur në sportelet e Bashkisë Qendër;
- 8.334 qytetarë janë paraqitur në sportelet e QLT;
- 9.391 qytetarë kanë telefonuar në numrin e gjelbërt 0 800 0 888;
- 325 qytetarë kanë hedhur letra në Kutinë Postare të Kryetarit;
- 3.168 qytetarë kanë dërguar letra nëpërmjet shërbimit postar;
- 1.432 qytetarë kanë dërguar e-maile në adresën elektronike info@tirana.al;
- 6.593 qytetarë kanë dërguar raportime në aplikacionin “Tirana Ime”.

Më poshtë do të referohen disa konstatime mbi fluksin e punës që SISHQ ka mbuluar gjatë vitit 2017, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me logjistikën dhe sistemet e informimit që janë përdorur.

- Referuar raportit vjetor 2017 (bashkëngjitur) të aktivitetit të Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët (SISHQ), shifrat për të gjitha shërbimet që ky Sektor ofron ofron reflektojnë dyfishim të volumit të punës dhe numrit të qytetarëve që marrin shërbime bashkiake, krahasur me periudhat e mëparshme.

- Në muajin nëntor 2017, Bashkia Tiranë u bë pjesë e “Shqipëria që duam”, një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi e qeverisë me qytetarët. Deri në muajin gusht 2018, në adresë të Bashkisë Tiranë kanë mbërritur 919 raste të raportuara nëpërmjet kësaj Platforme, shifër që reflekton domosdoshmërinë e mbulimit të këtij shërbimi në distancë nga një staf i dedikuar.

- SISHQ ka një staf prej 21 punonjësish të cilët trajtojnë kërkesat/ankesat/aplikimet e qytetarëve që mbërrijnë nëpërmjet të gjitha rrugëve të komunikimit që administron (Sportelet e SISHQ, sportelet e Qendrës së Licencimit të Tiranës (QLT), numri i gjelbër 0 800 0 888, adresa elektronike info@tirana.al, shërbimi postar, Kutia postare e Kryetarit, aplikacioni celular “Tirana Ime” dhe Platforma e Bashkëqeverisjes). Praktika e punës me larmishmërinë e rrugëve të komunikimit në dispozicion të

publikut, na orienton drejt ndarjes së mënyrës së ofrimit të shërbimeve në: 1. shërbimeve të ofruara face to face (sportele), dhe 2. shërbime të ofruara në distancë (telefon, mail, platforma elektronike).

- Me urdhrin e Kryetarit nr. 10021, date 09.03.2018, u ngritur grupi i punës “Për përditësimin e shërbimeve që u jepen qytetarëve nga Njësitë Administrative dhe/ose Strukturat e Bashkisë së Tiranës”, në përfundim të punës të të cilit numri i shërbimeve bashkiake të evidentuara u rrit në mbi 140 shërbime nga rreth 123 shërbime që ishin listuar në vitin 2016. Grupi i punës do të përditësojë çdo 2 muaj listën e shërbimeve bashkiake, duke i mundësuar qytetarëve më shumë njohje dhe përfitim nga shërbimet bashkiake.

- Punonjësit e SISHQ janë të trajnuar për ofrimin e të gjitha informacioneve dhe shërbimeve të nevojshme bashkiake, trajnohen dhe mbështeten vazhdimisht me informacion mbi çdo projekt, iniciativë apo nismë të re bashkiake dhe kanë kualifikimin e nevojshëm për t’i shërbyer personave fizikë dhe juridikë. Trajnimi i vazhdueshëm i personelit të SISHQ mbetet një faktor kyç, që ndikon drejtpërdrejtë nivelin e shërbimeve ndaj publikut.

- SISHQ ka në përdorim programin elektronik Document Management System (DMS), mbi të cilin protokollohen të gjitha kërkesat/ankesat/aplikimet e qytetarëve. Numri i lartë i korrespondencës së regjistruar ndër vite dhe nevojat aktuale teknologjike, kanë sjellë nevojën e zëvendësimit me një sistem të ri elektronik procesimi dhe qarkullimi të dokumentacionit në formë elektronike, brenda institucionit dhe në kohë reale.

- Gjatë vitit 2017 Bashkia Tiranë është kontaktuar nga 117.709 qytetarë, nga të cilët 96.800 qytetarë (mesatarisht 390 qytetarë/ditë) janë paraqitur në sportelet e SISHQ dhe QLT. Kjo shifër dhe kushtet aktuale të organizimit të ambientit ku priten qytetarët, ka evidentuar nevojën për mjedise më të mëdha pritjeje për qytetarët.

Nisur nga sa më sipër, në kuadrin e hartimit të Strategjisë të Zhvillimit të Qëndrueshëm të BT-së për periudhën e viteve 2018 – 2022, Drejtoria e Komunikimit me Qytetarët, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, ka propozuar që SISHQ, i cili funksionon në idenë e One Stop Shop të kalojë në një mënyrë të re organizimi dhe funksionimi sipas propozimeve të mëposhtme:


- ✓ Ndarje e re organizative e SISHQ nga një sektor në dy sektorë. Nga të cilët njëri sektor do të mbulojë shërbimet e drejtpërdrejta (front office) me 19 specialistë, nga të cilët 3 punonjës do të jenë të atashuar pranë receptionit të BT-së, dhe sektori tjetër shërbimet e ofruara në distancë (back office) për publikun me 8 specialistë. Këta dy sektorë do të administrohen nga 2 përgjegjësa sektori
- ✓ Vënia në përdorim e sistemit të ri elektronik për përpunimin dhe qarkullimin e dokumentacionit, sipas planifikimit në buxhetin e vitit 2018.
- ✓ Përditësimi, unifikimi dhe standartizimi i formularëve të shërbimeve bashkiake të evidentuara me urdhër Kryetari (mbi 140 shërbime bashkiake).
- ✓ Zhvendosja në ambjente të reja pune, të cilat të ofrojnë komoditet dhe lehtësi si në marrjen e shërbimeve nga qytetarët, ashtu mjedise të gjera dhe me ndarje fizike që mundësojnë rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së punës të punonjësve.
- ✓ Trajnimi i të gjithë punonjësve të SISHQ mbi mënyrën e trajtimit të informacionit dhe shërbimeve bashkiake sipas ndarjes së re organizative të punës dhe përgatitja e përshkrimeve të reja të punës.
- ✓ Zbatimi i këtij projekti do të zgjasë 1 vit.
- ✓ Aktualisht ndodhet në fazën e planifikimit.

4.16.8 Infrastruktura Shëndetësore

Bazuar ne Ligjin Nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore, Neni 23 Funksionet e Bashkive në fushën e Infrastrukturës dhe Shërbimeve publike, pika 13, Bashkia ka përgjegjësi për ndërtimin, rehabilitimin dhe

mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Figura Nr 29: Harta e Qendrave Shëndetësore në Bashkinë Tiranë



Burimi: Bashkia Tiranë

Në 11 NJA Urbanë ndodhen 12 Qendra Shëndetësore dhe 6 Qendra Specialitetesh, ndërsa në 13 NJA-të rurale ndodhen 23 Qendra Shëndetësore. Nisur nga fakti se procesi i decentralizimit dhe delegimit të kompetencave në kuadër të reformës administrative territoriale në fushën e shëndetësisë nuk ka përfunduar ende, informojme se ndërtimi apo rikonstruksioni i qendrave shëndetësore nuk është ende kompetencë e Bashkisë Tiranë. Në këto qendra janë trajtuar 610,830 banorë.

Lidhur me situatën aktuale të infrastrukturës të gjithë këtyre institucioneve është e nevojshme kryerja e një studimi fizibiliteti së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë për të analizuar nevojat për investime në burime njerëzore, infrastrukturë dhe logjistike, për të përmirësuar standartet e këtij shërbimi.

4.17 TERRITORI DHE MJEDISI

4.17.1 Kushtet fizike dhe Klimaterike

Tirana, 110 m mbi nivelin e detit, karakterizohet nga një klimë e ngrohtë dhe e butë. Stina e dimrit është më e lagësht sesa ajo e verës. Temperatura mesatare vjetore është 14.8°C dhe niveli i reshjeve mesatarisht 1,207 mm në vit. Muaji më i thatë është korriku, ku dhe niveli i reshjeve arrin në 35 mm. Sasia më e madhe e reshjeve bie në nëntor, me një mesatare prej 166 mm. Me një mesatare prej 23.8°C, korriku është muaji më i ngrohtë. Temperaturat mesatare më të ulëta në vit shfaqen në janar, rreth 6.3°C. Reshjet variojnë me 131 mm ndërmjet muajit më thatë dhe atij më të lagësht. Ndryshimi në temperaturë gjatë gjithë vitit është 17.5°C.

Tiparet gjeomorfologjike të BT-së në tërësi janë formuar në mënyrë graduale që në zhvillimet gjeologjike të Plio-Kuaternarit. Ata janë pasojë e bashkëveprimit të forcave të brendshme dhe të jashtme të cilët kanë kushtëzuar relievin e sotëm. Morfologjia e Tiranës përbëhet nga të gjitha format e tij si: fushat, luginat, kodrat dhe malet.

Qyteti, pra pjesa urbane, është ndërtuar mbi një terracë aluvionale, midis ultësirës së lumit Tirana dhe planit të parë të sistemit kodrinor të Kërrabës. Kjo hapësirë përbën një fushë të gjerë, pjesa më e madhe e së cilës mban emrin e trevës së Tiranës. Fusha e Tiranës së bashku me fushat e tjera të Krujës e të Lezhës, formojnë pjesën veriore të Ultësirës perëndimore.

Fushat kryesore janë ajo e Tiranës që shtrihet në drejtim të veriut deri në Kamëz, në drejtim të Jugut deri në rrjedhën e lumit Erzen, në drejtim të perëndimit deri në vijën Vorë – Yzberish dhe në drejtim të Lindjes, deri në vijën Babrru-Zall Herr-Qinam, ku fillon e ngrihet mali i Dajtit. Fusha e Tiranës së bashku me fushat e tjera të Krujës e të Lezhës, formojnë pjesën veriore të Ultësirës perëndimore. Fusha e Tiranës paraqet një pjerrësi të lehtë, me rënie në drejtimin veriperëndimor, ku qyteti i afrohet detit, çka lejon dhe derdhjen e ujërave të lumenjve në të.

Në anët e tjera të Tiranës ndodhen kodrinat e Saukut, Kërrabës e Vaqarrit, të cilat formojnë një kurorë, përkatësisht në skajet perëndimore, lindore dhe jugore të qytetit. Relievi i tyre është i butë, tipik mesdhetar, me një natyrë të pasur me vreshta e ullishte. Këto vargje kodrinore shtrihen gjërë tek Kepi i Rodonit duke arritur lartësi mbi 300 m. Kurora kodrinore e Tiranës ndërpritet nga gryka, midis të cilave shquhen korridorët natyrorë të Vorës e të Yzberishit, nga ku depërtojnë në qytet dy rrugët kryesore të jugut. Në lindje të qytetit ngrihet mali i Dajtit, i cili përbën sfondin natyror të Tiranës. Me lartësinë e tij prej 1612 m mbi nivelin e detit dhe me gjatësinë prej afro 11 km, ai e mbron qytetin nga erërat e ftohta kontinentale. Parku kombëtar i Dajtit, përbën një ndër burimet më të rëndësishme natyrore për qytetin.

Uji gjithashtu është një burim i rëndësishëm natyror i territorit që rrethon Bashkinë e Tiranës. Tre Lumenjtë kryesorë (lumi i Tiranës, lumi Lana dhe lumi Erzeni) kalojnë nga lindja në perëndim. Me mbi 100 liqene përreth ku Tirana, Farka, Kashari dhe Bovilla janë katër nga ato kryesoret.

Luginat kryesore të Bashkisë Tiranë janë ajo e Erzenit e lumit të Tiranës dhe Lumit të Tërkuzës. Qyteti i Tiranës është i rrethuar pothuajse i tëri nga vargjet kodrinore si ato të Ibë- Linëz-Vaqarr-Sharrë-Arbanë, Sauk-Lundër etj. Malet zënë pothuajse të gjithë pjesën lindore, në drejtimin Veri-Juglindje shtrihet vargmali i Bjesh Dajt, Mali i Priskës, Mali i Peshkasheshit.

Rajoni i Tiranës, i cili nga pikëpamja e rajonizimit tektonik bën pjesë në Zonat tektonike Kruja dhe Jonike, ndërtohet nga depozitime terrigjene të Paleogjenit, Neogjenit dhe Kuaternarit. Ky rajon përfshihet në një strukturë regjionale thyerjesh inverse dhe mbihipjesh post-pliocenike që përbën stilin tektonik të Albanideve të jashtme.

Pozicioni i Shqipërisë i vendosur midis kontaktit të pllakës së Adriatikut dhe asaj Evropiane e bën atë një zonë me riskun më të madh sizmik ku potencialisht një tërmet mund të arrijë deri në shatë ballë të shkallës Rihter, i mjaftueshëm për të rrafshuar çdo ndërtim që është ngritur jashtë standarteve bazë inxhinierike, kujtojmë tërmetin e 1998 në Tiranë që prishi rreth 2,083 shtëpi. Nga kjo rrezikojnë të gjithë ndërtesat e vjetra si dhe ndërtimet informale e ato në proces legalizimi që janë ndërtuar jashtë kriterëve teknike.

4.17.2 Planifikimi i Territorit

PPVBT identifikon 10 objektiva strategjike të cilët kanë për qëllim të drejtojnë zhvillimin urban, ekonomik dhe shoqëror të Tiranës në 15 vitet e ardhshme të strukturuar në 14 projekte strategjike të cilët përcaktojnë komponentin strukturor të planit të parashikuara në harkun kohor afat shkurtër, mesëm dhe afatgjatë.

PPVBT paraqet dy lloje projektesh të cilët dallohen për mënyrën e realizimit dhe afatet kohore për zhvillimin dhe zbatimin e tyre: projekte që përbëjnë bazën e komponentit operativ dhe projekte unitare që parashikojnë zhvillimin e Planeve të Sektorëve specifike të parashikuara në legjislacionin kombëtar dhe VKM nr. 671, datë 29.7.2016 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit si “- Plani Sektorial në Nivel Bashkie (PSNB).

PPVBT propozon ndarjen dhe vendosjen në hierarki të territorit në tre kategori bazë.

- Urban: të urbanizuara, pothuajse plotësisht të ndërtuara dhe të përbëra nga hapësira urbane kompakte me densitet të mesëm dhe të lartë,
- Perirubane: zonat e ndërtuara me densitet të mesëm të cilat përbëhen nga pallate banimi informale, nga godina industriale dhe tregtare të shpërndara dhe
- Rurale: zonat e vendosura jashtë zonave sub-urbane, dhe në to përfshihen njësitë urbane (polet) dhe zonat bujqësore dhe natyrore.

PPVBT ka përcaktuar tipologjitë e ndryshme hapësinore dhe funksionale të qytetit si dhe ka përcaktuar si do të përdoren këto kategori për të drejtuar zhvillimin e njësive strukturore unike.

Në përcaktimin e karakteristikave të çdo njësie strukturore janë identifikuar cilat njësi strukturore do të jenë subjekte të zbatimit të mëvonshëm dhe që për këtë arsye parashikojnë hartimin e një Plani të Detajuar Vendor (PDV).

Rregullorja e Planit përcakton instrumentet e zbatimit të cilat ndahen në:

- Instrumente për zbatimin e mëvonshëm PDV
- Instrumente për zbatimin e ndërtimeve të menjëhershme infill, rigjenerimi dhe ristrukturimi, ruajtje etj

PPVBT incentivon dhe konsolidon aksin Tiranë-Kashar-Durrës, aksin Tiranë-Vaqarr-Durrës dhe aksin Tiranë-Elbasan si tre akset kryesore përgjatë të cilave në 15 vitet e ardhshme do të pozicionohen aktivitetet kryesore ekonomike dhe prodhuese.

PPVBT identifikon mjete të reja rregullatore për zbatimin e fleksibilitetit si një mënyrë e funksionimit të planit, si edhe parashikon një rregullore të thjeshtuar, e cila mundëson një kufizim të mënyrave dhe të parametrevë të kontrollit të zhvillimit të qytetit dhe lejon diversifikimin dhe lirinë e funksioneve të

instalueshme, forma dhe variante transformuese më qëllim që të përfitojnë ndërhyrjet për iniciativën private.


- Barazimi (e drejta e transferimit të të drejtave të zhvillimit) vlen edhe për kategori të veçanta të zonave të transformimit, zonave për përfundimin e shërbimeve ekzistuese dhe zonave me standarde për t'u fituar. Kësaj të fundit i është dhënë një intensitet maksimal teorik i shprehur në metra katrorë, që përkthehet në të drejta volumetrike të krijuara në favor të privatëve të këtyre zonave, në momentin në të cilin ato i janë dhënë BT për ndërtimin e shërbimeve publike.
- Për zonat e transformimit, është mundësia e titullarëve të paraqesin në KB një propozim për zbatimin e zonave për sektorët e ndërtimit. Ky propozim do të ofrojë një plan të përgjithshëm urban (Masterplan) shtrirë në të gjithë zonën, duke synuar të demonstrojnë zbatimin praktik dhe efektiv të ndërhyrjeve, për të siguruar zbatimin e plotë të projekteve të infrastrukturës publike dhe paisjen e zonave me shërbime. Miratimi nga BT i një ndërhyrjeje të propozuar, do të jetë pengesë dhe referencë e ndërhyrjes nga pronarët e tjerë të zonave të përfshira në zonën e transformimit.
- Tenderat në zonat e përpunimit. Ndërhyrjet në zonat e përpunimit mund të jenë subjekt i procedurave për përgatitjen e masterplanit, për të lehtësuar krahasimin me zgjedhjeve të ndryshme, me qëllim përmirësimin e ofertës dhe cilësisë dhe përzgjedhjen e projektit më cilësor. Aktivizimi i të drejtës së procedurës së tenderimit, I jep të drejtën e një rezerve volumetrike të performancës e cila do të zbatohet si për ndërhyrjet e zëvendësimit ashtu edhe për ndërtimet e reja me hapat e përshkruara në rregulloren e PPV.
- Bonuset e zhvillimit sipas vlerësimit të cilësisë. Ndërhyrjet e ndërtimit dhe planifikimit të njëjësive strukturore subjekt i PDV-së për të cilat pritet miratimi nga ana e Bt-së, mund të përfitojnë një bonus për të rritur intensitetin volumetrik nëse janë vlerësuar pozitivisht ndaj një liste të kriterëve të performancës dhe cilësisë në rregulla të cilat korrespondojnë me rezultatet.

4.17.3 Mjedisi dhe Ekosistemet

Pozicioni gjeografik, klimaterik dhe pozicioni territorial e kanë vendosur Tiranën në listën e qyteteve të privilegjuar nga natyra. Vetë struktura edhe pozicionimi i qytetit është favorizues për përcimin e gjelbërimit përreth tij në formën e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara masivisht. Shtimi dhe përmirësimi i hapësirave të gjelbra urbane nuk lidhet vetëm me cilësinë fizike të mjedisit por dhe me shëndetin fizik të njerëzve duke ndikuar pozitivisht në gjendjen psikologjike dhe mirëqënien mendore të tyre. Një sërë studimesh kanë treguar se mjediset e gjelbra publike ndikojnë pozitivisht në vlerën e pronave në afërsi të tyre, duke ndikuar direkt në rritjen e mirëqënies të banorëve të zonës.

Në qytetin e Tiranës gjenden disa lloje parqesh rekreative dhe memoriale në administrim të APR-së. Kjo agjenci ka si mision mirëadministrimin e parqeve ekzistuese, krijimin e parqeve të reja si dhe mbrojtjen e Kurorës së Gjelbër të Tiranës.

Figura Nr 30: Harta e Parqeve




Burimi: Bashkia Tiranë, PPV TR030

Politikat mjedisore të BT-së parashikojnë përmirësimin e mjedisit dhe stimulimin e mundësive për të përmirësuar jetesën nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të burimeve natyrore, kulturore, shoqërore dhe historike për një zhvillim më të qëndrueshëm.

Në përgjithësi, ekosistemet e peisazhit të mbrojtur janë të ruajtura pjesërisht. Kjo ka ndodhur për shkak të emigrimit dhe nivelit të ulët të prodhimit bujqësor. Megjithatë, faktorët kryesorë që kërcënojnë të zhdukin dhe copëzojnë habitatet janë shfrytëzimi pa kriter i pyjeve, prerja e paligjshme e drurëve, dhe zjarret të shkaktuara prej faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë, shpyllëzimi dhe aktiviteti mineral. Sipërfaqe të mëdha pyjore janë në rrezik serioz dhe përbëjnë një kërcënim për habitatet dhe ruajtjen e botës së egër. Aktivitetet minerare konsiderohen si kërcënim kryesor mjedisor me pasoja negative në cilësinë e ujërave, burimeve dhe komuniteteve vendore. Aktivitetet ushtarake që po zhvillohen kohët e fundit brenda peisazhit të mbrojtur po përbëjnë një rrezik ndaj burimeve natyrore dhe komuniteteve vendore.

Figura Nr 31: Harta e Zonave të Mbrojtura



Burimi: Bashkia Tiranë, PPV TR030

4.17.4 Ndotja industriale dhe Hot-spotet

Aktivitetet industriale luajnë një rol të rëndësishëm në mirëqenien ekonomike të vendit pasi kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, por gjithashtu kanë një ndikim të rëndësishëm në mjedis. Ndotja industriale paraqet një rrezik të madh për njerëzit, kafshët dhe mjedisin.

Parandalimi ose kufizimi i ndotjes industriale dhe aksidenteve madhore nga industria është një prioritet për të ruajtur një mjedis të shëndetshëm. Transformimet demokratike dhe orientimi i përgjithshëm nga ekonomia e tregut pas 1990, vendosi prioritete të reja për zhvillimin ekonomik edhe në Tiranë, ku vendin kryesor e zuri tregtia dhe shërbimet dhe më pak industria. Kjo çoi në mbylljen e shumë ndërmarrjeve shtetërore industriale duke “zhdukur” edhe zonat e vjetra industriale brenda territorit të Tiranës. Aktualisht aktivitete më të rëndësishme industriale janë të vendosura në zonën ekonomike Tiranë-Durrës që është zhvilluar në të dy krahët e autostradës Tiranë-Durrës. Këto aktivitete janë të lidhura më së shumti me industrinë e lehtë: me përpunimin e ushqimit, prodhimin e pijeve, përpunim metalesh dhe druri, përpunim letre dhe shtypshkronja etj.

Një ndër problematikat mjedisore të evidentuara në këtë zonë ka të bëjë me hedhjen pa kriter të mbetjeve industriale, në zona natyrore, lumenj dhe kanale ujore duke dëmtuar ekosistemin e të gjithë zonës dhe duke rrezikuar shëndetin e banorëve përreth. Veç kësaj, hedhja e mbetjeve të rrezikshme si p.sh. mbetjet spitalore, derdhjet e kimikateve përpunuese apo dhe lëndë të tjera ndotëse por lehtësisht të përthithshme nga toka dhe uji, përbëjnë rrezik jo vetëm për banorët përreth por për gjithë konsumatorët e produkteve bujqësore të mbjella në zonat përreth dhe ku kalon uji i ndotur.

Megjithatë 'hot spoti' më problematik për Tiranën mbetet Landfilli i Sharrës, kapaciteti i të cilit tashmë është në limit dhe nuk mund të mbetet e vetnja alternativë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Bazuar në standartet mjedisore të BE-së, të cilat mbeten ndër kushtet kryesore që Shqipëria duhet të plotësojë përpara aderimit në BE, landfillet duhen mbyllur duke u zëvendësuar nga metoda të tjera të përpunimit të mbetjeve, më miqësore për mjedisin.


Për të adresuar këtë problem, në territorin e BT-së do të ngrihet incineratori i djegies së plehrave, i parashikuar të përfundojë brenda vitit 2019. Ky incinerator do të trajtojë mbetjet për gjithë qarkun e Tiranës dhe nëpërmjet djegies së tyre do të prodhojë energji elektrike e cila do të futet në rrjet. Edhe pse jo një zgjidhje optimale për sa i përket standarteve të BE-së, ky incinerator do të zgjidhë një problem aktual lidhur me sistemin e menaxhimit të plehrave. Duke qenë se ndërgjegjësimi i publikut për ndarjen në burim të plehrave, mbetet ende një problematikë që do kërkojë kohën e duhur për të arritur nivelet e dëshiruara. Në këtë mënyrë, incineratori do të ndihmojë në menaxhimin e situatës gjatë tranzicionit prej landfillit të Sharrës në arritjen e nivelit të riciklimin të përcaktuara nga BE.

4.17.5 Ajri

Të dhënat më të fundit mbi cilësinë e ajrit vijnë nga Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2017, të cilat bazohen në matjet e kryera nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në stacione të vendosur përkatësisht pranë Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (Tirana IFBZ), BT-së (Tirana BT) dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (Tirana AKM), Tirana Qendër. Bazuar edhe në direktivën CAFE të BE-së për ajrin janë kryer matje në mënyrë të vazhdueshme për 7 parametra kryesorë ku përfshihen: PM10, NO₂, SO₂, O₃, CO dhe BTEX. Ndotësit kryesorë të ajrit në zonën urbane të Tiranës janë kryesisht pluhurat me diametër 10 dhe 2.5 mikrometër (PM10/PM2.5) që vijnë si pasojë e trafikut të rënduar të automjeteve por gjithashtu kontribut të konsiderueshëm në këtë ndotje përbëjnë edhe emisionet prej djegies së mbeturinave dhe biomasës (p.sh. ngrohja me dru) dhe emisionet e lëshuara nga industria e ndërtimit.

Problematike në këtë aspekt vazhdon të mbetet tejkalimi i normës ditore²⁴ të ndotjes (BE) prej 50 µg/m³ për PM10. Për vitin 2017 raportohet se norma ditore është kaluar me 56% në stacionin Tirana BT dhe 30% në stacionin Tirana AKM. Më tej, problem mbetet dhe numri i lartë i ditëve që e tejkalojnë këtë normë ditore, përkatësisht 64 ditë nga 107 ditë të monitoruara tek stacioni Tirana BT dhe 70 ditë nga 155 ditë të monitoruara tek stacioni Tirana AKM. Veç kësaj, qendra e Tiranës tejkalon edhe vlerat mesatare vjetore të lejuara prej 40 µg/m³ për NO₂, përkatësisht në stacionet Tirana BT dhe Tirana Qendër ku këto norma shkojnë në 49.32 µg/m³ dhe 86.42 µg/m³.

Figura Nr 32: Harta e zonave sipas ndotjes së ajrit



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Zonat me ndotjen më të lartë janë ato ku ka qarkullim të më të madh të automjeteve, kryesisht kryqëzimet dhe unazat. Për rrjedhojë kontribuesi kryesor në ndotjen e ajrit konsiderohet trafiku rrugor dhe përfshin: numrin e lartë të automjeteve në njësinë e kohës; vjetërsinë dhe gjendjen teknike të automjeteve si rezultat i të cilave nuk plotësohen normat e shkarkimit në ajër të tyre; cilësinë e lëndës djegëse; përdorimin e automjeteve me motor pa konvertor analitik; mungesat në sistemin e menaxhimit të trafikut; gjendjen e rrugëve veçanërisht në zonat me urbanizim të vonë dhe ato ndërmjet blloqeve të banimit (si rezultat i amortizimit); mungesën e parkimeve që bëhet shkak për kohën e shtuar të qarkullimit që rezulton me shtimin e emetimeve të PM10. Së fundmi, mungesa e sipërfaqeve të gjelbra ka ndikimin e saj në ndotjen e cilësisë së ajrit sidomos në përqendrimin e pluhurit.

4.17.6 Uji

Rajoni i Tiranës mund të konsiderohet si një zonë e pasur për sa i përket pasurive dhe burimeve ujore që zotëron. Janë rreth 100 liqene në zonën midis Tiranës dhe Durrësit. Ndër më të rëndësishmet që janë ato afër zonës urbane si: Liqeni i Tiranës, Liqeni i Farkës, Liqeni i Kasharit dhe Liqeni i Paskuqanit. Lumi i Lanës që kalon në pjesën jugore të qytetit (drejtimi lindje-perëndim), Lumi i Tiranës në pjesën veriore dhe baseni Ishëm-Erzen janë elementët kryesorë ujorë të Tiranës.

Mungesa e kanaleve të ujrave të larta në zonat e zhvilluara rishtazi në Tiranë ka rritur rrezikun potencial të përhapjes së dherave në rrugët e qytetit. Gjithashtu rrugët në zonat rurale nuk mirëmbahen dhe nuk drenazhohen rregullisht. Rreziku i shkatërrimit të digës së Liqenit të Tiranës vjen nga kalimi i ujit mbi kurorë si rezultat i mungesës së një shkarkuesi sipërfaqësor si dhe mos funksionimi i portave. Projektimi i

gabuar i kolektorëve kryesor i ka dhënë zgjidhje vetëm zonave lokale dhe asnjehere nuk është trajtuar problemi si një sistem ujrash të një rrjedhe natyrore.

Për sa i përket lumenjve, vlerësimi i cilësisë së ujërave të tyre bazohet në tetë parametrat më kryesorë të ndotjes kimike të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE-së. Sipas kësaj Direktive, ujërat e lumenjve klasifikohen në pesë klasa, ku gjendja e moderuar ose klasa e tretë, konsiderohet si klasa me nivelin minimal të pranueshëm të cilësisë së ujërave të lumenjve. Parametrat e matur përfshijnë oksigjenin e tretur, NKO, NBO5, nitritet NO₂, nitratet NO₃, amoniakun NH₄, fosforin total, fosfatet PO₄ dhe lëndën në pezulli. Rezultatet e matjeve për parametrat e mësipërm tregojnë rritjen e ndotjes dhe përkeqësim të cilësisë së ujërave të Lumit të Lanës dhe Lumit të Tiranës pas hyrjes në qytet.

Të dhënat e monitorimit të gjendjes së ujërave nga AKM-ja për vitin 2017 janë të pjesshme dhe për këtë arsye do të merren në konsideratë të dhënat e raportit për vitin 2016.

Sipas këtij raporti, baseni Ishëm – Erzen është baseni më i ndotur në Shqipëri bashkë me atë të Semanit, të cilat klasifikohen në Klasën V – gjendje e keqe. Ndër problematikat kryesore të këtij baseni specifikohen:

- Ulje e shtratit për shkak të erozionit fundor dhe shfrytëzimit të tejskajshëm të inerteve në të gjithë gjatësinë dhe degët e lumenjve
- Erozion anësor i shtratit dhe i tokës bujqësore
- Ulje e nivelit të ujrave nëntokësore në të gjithë pellgun ujëmbajtës të Tiranës dhe dalje e pjesës më të madhe të puseve të ujit jashtë funksionit (Ura e Brarit, Zallherr, Çerkezë, Tapizë, etj).
- Ndotje e fuqishme e shtratit, terracës së shtratit, ujit të rrjedhës dhe vijës bregore
- Kënetizimi i shtrateve në zona të caktuara
- Prishje ose rrezikime të objekteve inxhinjrike, si ura, vepra mbrojtëse në brigje dhe në shtrat vepra të marrjes së uji
- Ndotje inerte dhe urbane në shtrat, ndotje e lartë baktireologjike e ujërave, ndotje estetike, shkatërrim i pejsazhit lumor dhe bimësisë së shtratit, shkatërrim i faunës ujore, etj.
- Ndikim në modifikimin e vijës bregore, erozion në grykëderdhje.
- Shpëlarja e tokave bujqësore (nutrientë dhe pesticide) është më e theksuar për Erzenin, i cili ndërpret me shumë zona rurale ku aktiviteti kryesor është bujqësia.

Gjatë vitit 2017, BT kreu një sërë ndërhyrjesh infrastrukurore në zonat periferike të lumit të Lanës dhe kryesisht Lumit Tirana ku është rehabilituar thuajse i gjithë shtrati i lumit si dhe është në përfundim procesi i zhvendosjes së banesave të pa legalizuara pranë shtratit të lumit të cilat përbëjnë rrezik për jetën e banorëve në periudha rreshjesh të rrëmbyeshme. Njëkohësisht ka nisur edhe gjelbërimin dhe pyllëzimin e sipërfaqes anësore të tij e cila do të jetë pjesë e kurorës së gjelbër të pyllit orbital. Tashmë vëmendja do të përqendrohet në rehabilitimin e plotë të lumit të Erzenit i cili ka rëndësi jo vetëm nga pikpamja bujqësore por edhe turistike. Ndërhyrjet e kryera dhe ato të planifikuara nëpër lumenjtë e Tiranës kanë kanë synuar kryesisht përmirësimin e situatave emergjente me erozionin dhe përmytjet por ka ende nevojë të theksuar për kontroll të rreptë dhe investime në pastrimin e këtyre lumenjve nga agjentët ndotës të cilët rrezikojnë cilësinë e produkteve bujqësore dhe ujërave detarë ku derdhen rrjedhimisht duke rrezikuar shëndetin e qytetarëve.

4.17.7 Ndotja Akustike

Tirana është qyteti më i prekur nga ndotja akustike në Shqipëri për shkak të popullsisë së madhe por edhe trafikut. Sipas raportit të Gjendjes së Mjedisit 2017, nivelet e zhurmës në Tiranë vazhdojnë të mbeten të larta, ditën dhe natën, mesatarisht LAeq/Ditën 66.24 dB (A) dhe LAeq/Natën 56.12 dB (A). Sipas këtij raporti Tirana është ndër qytetet me tejkalimin më të lartë të standartit të OBSH për LAeq/Ditën me rreth 20 %.


Monitorimi i zhurmave në Tiranë ka rinisur në vitin 2014 pas një shkëputje prej dy vjetësh, 2012-2013, gjatë së cilave programi nuk u zbatua kryesisht për mungesa të infrastrukturës përkatëse. Monitorimi i zhurmave në Tiranë kryesisht zhvillohet nga Instituti i Shëndetit Publikn (ISHP) në 15 stacione të qytetit dhe ku rezultatet tregojnë vlera rreth 16-20% më të larta se standarti i BE-së në të gjitha pikat e monitorimit.

Kjo për shkak se kontribuojnë një sërë faktorësh:

- Fluksi i madh i automjeteve. Ky fluks është rrjedhojë e numrit të madh të automjeteve si dhe nga mos respektimi i sinjalistikës në shumicën e kryqëzimeve kryesisht nga këmbësorët të cilët janë kthyer në problem kryesor për shkak dhe të mungesës së gjobave ndaj tyre.
- Mungesa e vendparkimeve të përkohshme apo të përhershme është një tjetër faktor i cili ndikon në rritjen e niveleve të ndotjes nga zhurmat.
- Mungesa e rrugëve dytësore apo terciare, të cilat ulin ndjeshëm trafikun në kryqëzimet kryesore dhe si rrjedhojë uljen e nivelit të zhurmave.
- Gjendja motorike e automjeteve në qarkullim lë shumë për të dëshiruar, mosha e vjetër e tyre sjell uljen e parametrave optimale të certifikatës teknike të automjetit, lidhur me emëtimin e zhurmës.
- Punime ndërtimesh në pika të ndryshme, rrisin artificialisht nivelin e zhurmave urbane.
- Numri ende i ulët i personave që përdorin transportin publik apo bicikletat në raport me popullatën që përdor makinat personale ndikon ndjeshëm në rritjen e nivelit të zhurmave dhe trafikut.

Harta e nivelit të zhurmave për qytetin e Tiranës tregon se vlerat më të larta janë regjistruar përgjatë akseve kryesore rrugore duke klasifikuar kështu trafikun rrugor si burimin kryesor të ndotjes akustike. Këtu përfshihet numri i madh i automjeteve që qarkullojnë në njësinë e kohës, shpejtësia e lartë e lëvizjes, boritë, mungesa e parkimeve që bëhet shkak për kohën e shtuar të lëvizjes.

Figura nr 33: Harta e nivelit të ndotjes akustike në Tiranë



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Për zvogëlimin e impaktit të zhurmës rekomandohet:

- Një planifikim më i mirë urban, mund të ndihmojë në krijimin e zonave ‘Pa-Zhurma’, ku zhurmat nga boritë dhe ndotjes industriale nuk tolerohen.
- Zbatimi në ndërtimin e godinave dhe të rrugëve i standarteve për reduktimin e zhurmës, si kusht themelor për mbrojtjen e shëndetit të popullatës në zonat e dendura urbane.
- Investimi në teknologjitë që synojnë uljen e nivelit të zhurmave përgjatë korridoreve kryesore të trafikut.
- Kontrolli i zbatimit të kufizimit të shpejtësisë brenda qendrave të banuara.
- Të aplikohen që në planifikim e të zbatohen më tej në ndërtim distancat midis rrugëve (sipas klasifikimit të tyre) dhe godinave.
- Sigurimi i brezit mbrojtës të gjelbër dhe hapësirave të mbjella me pemë midis zonave të banuara dhe rrugës kryesore, si një nga masat më eko-miqësore për të reduktuar nivelin e ndotjes.
- Forcimi dhe zbatimi i legjislacionit që rregullon dhe kontrollon ndotjen akustike kërkon një bashkëpunim efektiv të institucioneve në nivel qendror. Në të njëjtën kohë është e nevojshme rritja e kompetencave të BT-së në drejtim të inspektimit në lidhje me zhurmat dhe gjobëvënies rigorozet për rastet kur rënia e burisë pa kriter mund të shmanget.

4.17.8 Ndryshimet Klimatike

Edhe pse e shtrirë në zonën e Mesdheut e cila konsiderohet një ndër zonat me qëndrueshmëri klimatike më të lartë, Shqipëria mbetet një ndër vendet më të prekshme nga ndryshimet klimatike duke përfshirë dhe zonën e Tiranës stinët e së cilës bëhen çdo vit e më të paqëndrueshme. Me një relief fushor në pjesën urbane por e rrethuar nga malet e kodrat e zonave rurale, qyteti i Tiranës gjendet në një gropë ku nivelet e nxehtësisë rriten falë edhe përqendrimit të lartë të gazrave serë dhe mungesës së balancës mes urbanizimit dhe gjelbërimit. Zhvillimi jo i balancuar urban por edhe mungesa e investimeve në infrastrukturën dhe mjedisin rural sjellin një sërë problematikash mes të cilave:

- Reshje të dendura në periudhë të shkurtër të cilat dëmtojnë të mbjellat dhe shkaktojnë dëme ekonomike dhe sociale si në zonat urbane dhe në zonat rurale
- Thatësi të lartë gjatë sezonit veror duke duke rritur probabilitetin e zjarreve nëpër pyje e kullota
- Erozion dhe rrëshqitje dheu
- Dëmtime të infrastrukturave rrugore
- Ulje e biodiversitetit tokësor dhe ujqor për arsye të temperaturave të larta, niveleve më të ulëta të oksigjenit dhe rritjes së agjentëve ndotës
- Shtimi i sëmundjeve respiratore dhe psikike shkaktuar nga i nxehti dhe mungesa e oksigjenit në ajër
- Rritje e infeksioneve dhe virozave si pasojë e shtimit dhe jetëgjatësisë më të lartë të baktereve gjatë sezonit veror, etj.

Në përgjigje të sfidave urbane dhe mjedisore gjithmonë në rritje BT vlerësoi të nevojshëm hartimin e një Plani të Përgjithshëm Vendor i cili u konkretizua me hartimin e PPVB “Tirana 2030” të miratuar në vitin 2016. Nëpërmjet këtij plani BT synon të nxisë një zhvillim urban më të qëndrueshëm e të mirë planifikuar si dhe të orientojë planet e tjera sektoriale që rrjedhojë prej saj në mënyrë që të ndiqet e njëjta linjë zhvillimi.

Përmirësimet e Tiranës në infrastrukturën në nivel bashkiak demonstuan një progres të qëndrueshëm ndaj fenomeneve klimatike gjatë ngjarjeve të fundit të reshjeve të ashpra në fund të vitit 2017. Megjithatë, edhe pse qyteti mund të përballojë stuhitë e forta apo valët më ekstreme të nxehtësisë shoqëruar me periudhat e thatësisë, është e nevojshme të merren masat e duhura të cilat planifikohen për një periudhë më afatgjatë.

Përballë sfidave gjithmonë e më intensive të ndryshimeve klimatike, BT me mbështetjen financiare të BERZH²⁵ hartoi gjatë vitit 2017 Planin e Veprimit “Qyteti i Gjelbër”(PVQGJ) për Tiranën miratuar me VKB në qershor 2018. Ky plan sektorial veprimi mbështetet dhe në planet e miratuara gjatë viteve të fundit nga BT për të qenë në të njëjtën linjë zhvillimi me to dhe ka evidentuar pesë fusha kryesore në drejtim të së cilave duhen kryer investime për përmirësimin e situatës mjedisore të cilat përfshijnë: (I) Lëvizshmërinë e qëndrueshme; (II) Efiçencën energjitike; (III) Hapësirat e gjelbra dhe biodiversitetin (IV) Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve (V) Qëndrueshmëria dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike.

Bazuar në këto 5 fusha prioritare, PVQGJ ka përcaktuar një sërë masash konkrete prioritare dhe sekondare të bazuara në tregues realë dhe të përditësuar të cilët do i vijnë në ndihmë BT-së për përmbushjen e vizionit të saj për një kryeqytet të Gjelbër dhe me standarte mjedisore Evropiane.

²⁵ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Duke patur parasysh streset mjedisore urbane të përditshme të Tiranës të analizuar në sesionet e mësipërme, por dhe duke parë vulnerabilitetin e Tiranës ndaj ndryshimeve klimaterike²⁶, ky plan sektorial përbën një mundësi reale për kthimin e Tiranës në një qytet “eco-friendly” dhe që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme. Veç kësaj, duke patur parasysh se Tirana është motori ekonomik i vendit, ajo është edhe një ndër kontribuuesit kryesorë të nivelit të gazrave serrë të Shqipërisë. Për këtë arsye ajo mbart një peshë të konsiderueshme për të ndihmuar Qeverinë Shqiptare në arritjen e objektivit të saj për reduktimin e nivelit të këtyre gazrave me 11.5% deri në vitin 2030²⁷. Ky plan veprimi do të ndihmojë BT në sigurimin e investimeve të nevojshme për projektet prioritare të infrastrukturës mjedisore dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit të qytetit dhe të qytetarëve. Megjithatë koordinimi i aksioneve të këtij plani me projektet e tjera të Bashkisë përpara fillimit të punimeve është shumë e rëndësishme për të siguruar përdorimin sa më eficient të fondeve të bashkisë dhe shmangien e investimeve të dyfishta duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha aspektet.

5. ANALIZA Së OT

Analiza Së OT është një metodë planifikimi e strukturuar që përdoret gjerësisht për të evidentuar dhe vlerësuar Pikat e Forta (Strengths), Pikat e Dobëta (ë eaknesses), Mundësitë (Opportunities) dhe Rreziqet/Sfidat (Threats) të një projekti, çështjeje, territori, etj.

Gjatë hartimit të kësaj strategjie, kjo metodë u përzgjedh si një instrument mjaft praktik dhe i dobishëm për të analizuar situatën ekzistuese, analizë mbi bazën e të cilës u hartuan qëllimet dhe objektivat strategjikë. Pikat e dobëta dhe Pikat e forta evidentojnë çështje brenda territorit të Bashkisë Tiranë, të cilat mund të adresohen nëpërmjet politikave vendore, ndërsa Mundësitë dhe Sfidat i përkasin aspekteve të jashtme, kontrolli i të cilave mund të kërkojë bashkëpunim ndërvendor apo angazhim të qeverisë qendrore e më gjerë. Në ndihmë të kësaj analize u përdor pasaporta e Tiranës.


²⁶ Është parashikuar që Tirana do të përjetojë një rritje prej 1°C në temperaturat mesatare vjetore deri në vitin 2045, e kombinuar me valë më të gjata dhe më të shpeshta të nxehtësisë - Plani I Përgjithshëm Vendor Tirana 2030.

²⁷ Angazhim i marrë nga Qeveria Shqiptare në ‘Marrëveshjen e Parisit për Ndryshimet Klimaterike’, Viti 2016.

PASAPORTA E TIRANËS																
Bashkia/NJA	Popullsia	Nr. Familje	Forcat E punes	Papunesia		Punesimi		Kopshte	Cerdhe	Shkolla	Tregje	Qendra Shendetsore	Ndihma Ekonomike	Kende Lojrash	Qendra Sociale	Numri i bizneseve
				F.	M	F	M									
NJA.1	51264	18064	36,432					6	5	6		1	232	2	1	39549
NJA.2	81195	28709	57,280					5	3	17	1	4	221	5	0	
NJA.3	44397	15612	31,926					6	3	7	1	1	78	2	0	
NJA.4	63792	21680	46,296					6	3	6		1	256	2	1	
NJA.5	85579	30741	61,058					8	3	9	1	2	303	5	0	
NJA.6	76081	25360	54,817	23.6	21.6	39.1	53.7	4	2	9	2	1	400	1	1	
NJA.7	72545	26474	52,306					5	5	7		3	132	4	1	
NJA.8	41421	14751	29,441					3	2	6	1	4	145	0	1	
NJA.9	61876	22821	44,606					2	2	9	1	1	235	3	2	
NJA.10	27804	11013	19,732					1	1	5		1	64	0	0	
NJA.11	65056	21429	47,179					6	4	8	1	1	203	1	1	
Baldushk	5329	1587	3,728	18.8	29.5	11.3	35.5	3	3	10	0	1	234	0	0	52
Bërzhitë	5891	1826	4,154	18.1	18.2	20.8	44.7	4	4	10	0	1	274	0	0	108
Dajt	21218	6365	14,969	36.6	26.7	25.2	46.2	5	5	16	0	1	183	1	0	813
Kashar	17894	5250	26,549	37.2	27.4	26.6	48.8	8	8	12	0	1	424	1	0	3352
Ndroq	37373	11285	6,608	35	19.0	18.1	55.2	3	3	10	0	1	164	0	0	136
Petrelë	9356	2571	4,664	52.1	35.8	10.8	46.1	5	5	12	0	1	95	1	0	133
Pejë	6587	1878	4,054	20.3	13.5	23.5	62.5	3	3	8	0	1	58	0	0	133
Farkë	5855	1658	12,506	33.1	29.2	29.7	49.6	4	4	4	0	1	129	0	0	971
Shëngjergj	2594	984	1,747	40.9	39.8	9.7	24.9	1	1	7	0	1	279	0	0	18
Vaqarr	10423	2849	7,180	36.8	29.5	17.1	49.1	5	5	10	0	1	163	1	0	445
Zall Bastar	5337	1840	3,585	6.1	5.9	59.9	84.9	3	3	19	0	1	504	0	0	13
Zall Herr	11973	3480	8,166	58.3	50.8	6.5	27.9	5	5	7	0	1	180	0	0	129
Krrabë	3062	1517	2,197	60.3	50.4	13.1	28.6	2	2	2	0	1	130	1	0	60

Kjo analizë është fokusuar në fushat prioritare dhe që do të kenë fokus të veçantë në pesë vitet e ardhshme.

KUADRI EKONOMIK



KUADRI SOCIAL




ZHVILLIMI RURAL



TURIZMI



INFRASTRUKTURA RRUGORE DHE TRANSPORTI



INFRASTRUKTURA ARSIMORE



FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM



MBETJET DHE PASTRIMI I QYTETIT



MJEDISI



6. QEVERISJA VENDORE DHE FINANCAT PUBLIKE

6.1 DECENTRALIZIMI DHE FUNKSIONET VENDORE

Ligji nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” zyrtarizoi procesin e decentralizimit dhe reformës territoriale. Ky ligj pasoi me ndryshimet përkatëse të ligjit nr. 8654 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës” si dhe ligji nr. 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” të cilët u shoqëruan me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Funksionet që ndryshuan si pasojë e kësaj reforme dhe struktura e re e qeverisjes vendore shpjegohet si më poshtë:

Funksionet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Tiranë

Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) ushtrojnë funksione dhe kompetenca. Ligji i ri nr. 139/2015, në të cilin rishikohet në themel baza e funksioneve dhe kompetencave të njësive vendore, kategorizon dy tipe funksionesh: funksione të veta dhe funksione të deleguara, duke suprimuar ndarjen në funksione të përbashkëta. Gjithashtu krijohet për herë të parë koncepti i “decentralizimit asimetrik” të funksioneve dhe kompetencave. Funksionet e deleguara u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore me ligj ose me marrëveshje. Në çdo rast delegimi i funksioneve shoqërohet nga transferta specifike e qeverisjes qendrore për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve. NJVV bazohet në këto parime për ushtrimin e funksioneve të saj:

- Rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi.
- Ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, qeverisja qendrore mund të vendosë standarde dhe norma specifike të përgjithshme, me qëllim ruajtjen e interesave kombëtare dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.
- Në rastet kur NJVV nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare.
- Administrojnë ushtrimin e funksioneve të deleguara, sipas legjislacionit në fuqi.
- Kur NJVV ushtrojnë funksionet e deleguara, qeverisja qendrore siguron mjete dhe burime financiare të mjaftueshme për të ushtruar këto funksione në mënyrën dhe në atë nivel ose standard, i cili është përcaktuar me ligj.

Funksionet e veta

Ligji nr. 139/2015 përcakton funksionet e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore si funksione që janë përgjegjësi vetëm e njësive të pushtetit vendor si dhe financimi i tyre bëhet nga pushteti vendor. Funksionet ekskluzivë për të cilat njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritet investimi, shërbimi, administrimi dhe rregullatorë në këtë ligj janë ndarë janë në varësi të fushës së shërbimit: (i) infrastrukturën dhe shërbimet publike; (ii) shërbimet sociale; (iii) kulturën, sportin dhe shërbimet argëtuese; (iv) mbrojtjen e mjedisit; (v) bujqësinë, zhvillimin rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit; (vi) zhvillimin ekonomik vendor; si dhe (vii) sigurinë publike.

Me anë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, 61 bashkive u janë transferuar 6 funksione të reja ekskluzive. Decentralizimi i këtyre funksioneve është bërë me qëllim që shërbimi i këtyre funksioneve të jetë më afër qytetarëve.

Këto funksione janë si më poshtë:

- Personeli mbështetës i arsimit parashkollor dhe parauniversitar. Ligji i ri “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton NJQV si administrator dhe manaxher të gjithë sistemit të arsimit parashkollor, (kopshte dhe çerdhe), duke përfshirë edhe emërimin dhe shkarkimin e personelit mësimdhënës. Përsa i përket arsimit parauniversitar, funksioni kufizohet vetëm me emërimin e stafit mbështetës.
- Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave. Ligji i ri nr.139/2015 gjithashtu përcakton transferimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore (bashkitë). Gjithashtu, transferohet në bashki edhe menaxhimi i institucioneve që shërbejnë për këtë funksion. Përgjegjësitë shtesë përfshijnë: (i) krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural; (ii) administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të burimeve; (iii) Krijimin dhe administrimin e skemave të granteve lokale për bujqësi dhe zhvillim rural, të financuara nga buxheti lokal dhe / ose bashkë-financuar me palët e treta, duke garantuar akses të balancuar.
- Mirëmbajtja e rrugëve rurale. Me reformën territoriale dhe përfshirjen e NJA-ve rurale lindi nevoja për një kategorizim të ri të rrugëve të përcaktuara si rrugë rurale me ndarjen e vjetër administrative dhe që tani janë bërë pjesë e një bashkie të vetme.
- Administrimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Bazuar në ligjin e ri 139/2015 bashkitë tashmë janë kompetente edhe për, mirëmbajtjen dhe administrimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Kjo infrastrukturë do të transferohet në pronësi të tyre. Në sistemet e mëdha, Bashkitë/Organizata e përdoruesve të Ujit do të jenë përgjegjës për kanalet e ujitjes sekondare dhe terciare dhe për kanalet e kullimit terciarë.
- Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Në bazë të ligjit të ri “Për Vetëqeverisjen Vendore”, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe administrimi i strukturave përkatëse, do të jetë një funksion ekskluziv i 61 bashkive të krijuara pas Reformës Administrative Territoriale (RAT). Kjo do të thotë se bashkitë do të jenë përgjegjëse për të garantuar funksionimin e njësisë të Policisë të Mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit në të gjithë territorin e tyre.
- Administrimi i disa qendrave sociale nga Bashkitë. Ligji i ri "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton një numër të konsiderueshëm kompetencash të reja për bashkitë në fushën e shërbimeve sociale. Sipas këtij ligji, bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të mëposhtme: (i) krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për të varfërit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit, etj; (ii) ndërtimin dhe manaxhimin e apartamenteve për banim social, në mënyrën e parashikuar me ligj; (iii) ndërtimin dhe manaxhimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale; (iv) krijimin e një fondi për financimin e shërbimeve sociale në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqënie sociale, siç përcaktohet me ligj.

Funksionet e deleguara

Neni 30 i ligjit nr. 139/2015 trajton funksionet dhe kompetencat e deleguara. Kjo është një pjesë shumë delikate jo vetëm e ligjit por edhe e marrëdhënieve të pushtetit qendror dhe atij vendor, aq më tepër tani që funksionet e përbashkëta (funksionet që kryheshin edhe nga pushteti qendror edhe nga ai vendor) janë suprimuar. Nga ky nen del qartë fakti që këto funksione mund të jenë ose jo të detyrueshme. Në qoftë se ato janë të detyrueshme duhet të jenë të përcaktuara si të tilla shprehimisht me ligj. Ligji që i delegon një funksion bashkive duhet të përcaktojë edhe fondet e nevojshme për kryerjen e këtij funksioni dhe mënyrën se si do të disbursohen këto fonde në llogari të bashkisë.


Në rastin e funksioneve të deleguara jo të detyrueshme duhet të kemi një marrëveshje të dyanshme mes institucionit përkatës të pushtetit qendror dhe bashkisë. Gjithashtu institucionet qendrore mund të autorizojnë bashkinë dhe/ose qarkun të ushtrojnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar. Në

këtë nen nuk janë dhënë në mënyrë specifike se cilat janë funksionet e deleguara duke e bërë këtë nen të përgjithshëm. Funksionet e deleguara do të përcaktohen në ligje të veçanta (të detyrueshme) dhe në marrëveshje përkatëse (të padetyrueshme). Në çdo rast, qeverisja qendrore u garanton njësisve të vetëqeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara. Bashkia ose qarku, me nismën e tyre, mund të përdori edhe burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve e të kompetencave të deleguara, me synim për ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit në interes të qytetarëve. Një nga funksionet që është konsideruar deri tani dhe që do vazhdojë të konsiderohet edhe me ligjin e ri nr. 139/2015 si funksion i deleguar është funksioni i gjendjes civile.

Struktura e Bashkisë Tiranë

BT, është e organizuar në 10 drejtori të përgjithëshme të cilat mbulojnë dhe ushtrojnë të gjitha funksionet dhe kompetencat e BT-së të përmendura më sipër. Organigrama shtjelluese e drejtorive dhe nëndarjeve të tyre parasite si më poshtë:

Figura Nr 34: Organigrama e Bashkisë Tiranë



6.2 TREGUESIT EKONOMIKË DHE FINANCIARË TË BASHKISË TIRANË

Treguesit ekonomikë dhe financiarë të BT-së për periudhën 2011 – 2017 janë bazuar në tavanet e rishikuara të Projekt Buxheteve Afatmesme (PBA) përkatëse si edhe në kërkesat buxhetore të rishikuara për të njëjtën periudhë. Parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë bazuar në: Paketat fiskale të çdo viti

- Shpërndarjen e burimeve në përputhje me prioritetet e zhvillimit të qytetit, të përcaktuara në programin e Kryetarit
- Prioritetet e qytetarëve të identifikuar nga konsultat paraprake me komunitetin e NJA-ve
- Analiza e kostove të shërbimeve për çdo program buxhetor.

Tabela Nr 27: Treguesit ekonomike dhe financiarë të Bashkisë Tiranë (2012 - 2017)


	E m ë r t i m i	Realizimi 2012	Realizimi 2013	Realizimi 2014	Realizimi 2015	REALIZIMI 2016	Realizimi viti 2017
I	Të ardhura të taksueshme	2,520,393,730	2,888,529,419	3,199,001,519	2,586,001,303	4,545,040,355	6,918,773,554
1	Takse mbi pasurinë e paluajtshme	470,933,202	454,888,646	756,756,097	812,156,476	1,473,382,834	1,674,435,576
a	Familjarët	13,765,827	14,174,707	29,918,994	16,879,527	116,857,519	216,542,796
b	Subjektet Tregtare	457,167,375	440,713,939	726,837,103	795,276,949	1,356,525,315	1,457,892,780
2	Taksa mbi biznesin e vogel/Tatimi I thjeshtuar mbi fitimin e BV	827,765,270	843,098,519	614,587,151	708,247,686	274,693,674	137,752,837
3	Taksa e fjetjes në hotel	46,329,950	39,845,616	42,060,817	50,480,613	67,327,716	83,170,711
4	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	245,071,462	624,719,373	1,004,842,547	128,325,090	1,234,029,324	3,334,882,679
5	Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	274,687,877	296,049,524	260,109,009	325,790,581	366,078,762	299,940,349
6	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	320,249,987	279,468,676	229,126,388	269,085,695	280,082,106	285,325,027
7	Taksa për zënien e hapësirave publike	58,758,781	56,894,544	60,465,809	65,713,463	x	x
a	Me platforma betoni,kangjella.	39,779,381	38,360,999	42,739,645	56,996,158	x	x
b	Në tregjet publike	18,979,400	18,533,545	17,726,164	8,717,305	x	x
8	Taksa e tabelës	264,762,861	241,190,949	227,080,832	225,377,938	309,949,842	345,930,032
a	Tabelë identifikuese	3,495,455	3,587,992	4,224,923	4,409,354	958,442	419,267
b	Tabelë reklamuese	261,267,406	237,602,957	222,855,909	220,968,584	308,991,400	345,510,765
9	Taksa e perkoheshme e lojrave te fatit dhe kazinove	x	52,373,572	3,972,869	823,761	x	x
10	Taksa e gjelber	11,834,340	x	x	x	x	x
11	Taksa mbi token bujqesore	x	x	x	x	6717317	22,667,724
12	Taksa mbi truallin	x	x	x	x	36828390	52,741,453
13	Taksa e perkoheshme per infrastrukturen Arsimore	x	x	x	x	495,950,390	681,927,166
a	Familjarët	x	x	x	x	141,429,000	266,244,300
b	Subjektet Tregtare	x	x	x	x	354,521,390	415,682,866
II	Te ardhura jo tatimore	1,150,751,002	1,187,966,989	1,368,395,337	1,444,395,163	3,047,319,394	3,628,338,686
1	Tarifat	x	930,881,558	1,112,002,014	1,104,823,723	2,260,300,366	2,756,891,336
a	Tarifa e pastrimit	775,944,605	755,099,878	809,739,138	831,665,045	1,609,195,127	1,715,479,675
a.1	Familjarët	324,127,250	337,189,756	339,808,610	353,205,579	680,162,260	660,070,341
a.2	Subjektet Tregtare	451,817,355	400,343,963	454,537,234	459,777,566	929,032,867	1,055,409,334
	- për çdo tavolinë	0	17,566,159	15,393,294	18,681,900	x	338,295,014
b	Tarifa e parkimit	78,011,313	76,242,781	67,899,565	71,628,038	181,453,163	130,494,493
b.1	Parkim me kontratë	63,209,299	65,800,917	54,716,345	53,843,438	86,188,103	207,800,521
b.2	Parkim me bileta	14,802,014	10,441,864	13,183,220	17,784,600	95,265,060	164,000,000
c	Dhenie e licencave, leje, autorizime, dokumenta, etj	x	99,538,899	234,363,311	2,658	x	164,000,000
d	Tarifë për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	20,032,879	x	x	x	186913234	188,375,674
e	Tarifa Vendore (NJA)	x	x	x	201527982	x	x
f	Tarifa për zënien e hapësirave publike	x	x	x	x	280,234,642	345,627,823
f.1	Me platforma betoni,kangjella.	x	x	x	x	240,508,637	299,144,616
f.2	Në tregjet publike	x	x	x	x	39,726,005	46,483,207
g	Tarifa e sherbimit veterinar	x	x	x	x	x	1,037,750
h	Tarifa sherbimi te MZSH	x	x	x	x	x	4,075,400
2	Te ardhura te tjera	127,585,312	96,985,130	82,489,157	166,534,894	622,447,473	692,737,757
a	Qera ndertese	44,772,041	55,546,868	30,443,044	26,580,063	48,961,839	56,497,368
b	Qera trualli	6,700,072	2,082,142	55,701	3,264,039	3,675,723	5,360,002
c	Te tjera	62,673,502	38,484,656	44,309,197	122,213,306	291,014,365	558,902,830
d	Nga institucionet e varesise	13,439,697	871,464	7,681,216	14,477,487	2,287,514	71,977,557
3	Pagesa	149,176,893	160,100,301	173,904,166	173,036,546	164,571,555	178,709,593
a	Te prinderve per kopshtet e femijeve	94,409,475	101,877,220	111,113,175	114,242,018	103,679,539	112,529,983
b	Te prinderve per cerdhet e femijeve	52,330,135	53,245,045	59,051,069	55,788,948	55,787,021	60,432,581
c	Konviktet e Shkollave te Mesme	2,437,283	4,978,036	3,739,922	3,005,580	5,104,995	5,747,030
III	Sponsor dhe Donator	68,746,498	18,548,834	x	x	x	x
IV	Gjodat	141,428,985	99,172,737	123,416,400	151,703,243	276508033	x
b	Gjoda të Kont.Territorit, Pol.Bashkiake etj	82,975,067	40,213,324	49,207,809	66,212,342	x	x
c	Gjoda të Drejtorisë së Përgjithshme të TVendore	58,453,918	58,959,413	74,208,591	85,490,901	x	x
	TOTALI	3,881,320,214	4,194,217,979	4,690,813,256	4,182,099,708	7,592,359,749	10,547,112,240

6.2.1 Analiza e trendit të të ardhurave

Objektivi i analizës së të ardhurave për pesë vitet e kaluara, është të identifikojë burimet kryesore të ardhurave të BT-së dhe trendet e tyre në të kaluarën. Analiza e të ardhurave të kaluara mbulon periudhën nga 2011 – 2017.

Dy kategoritë kryesore janë të ardhurat e veta dhe transfertat nga buxheti i shtetit që së bashku japin të ardhurat në total të BT-së në një vit specifik. Ky grupim bën të mundur të analizohen ndryshimet në të ardhurat në total të mbledhura në vitin specifik, pa ndikimin e të ardhurave të mbetura nga viti i mëparshëm.

Grafiku Nr 23: Struktura e burimeve të të ardhurave të BT-së (2012-2017)



Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Manaxhimit Financiar


Të ardhurat e veta ndër vite kanë ardhur duke u rritur, kështu për vitin 2017 të ardhurat e veta zunë 85% të buxhetit e shoqëruar kjo me uljen e transfertave të pakushtëzuara në 15%, për të njëjtin vit, çka tregon një mirëadministrim të të ardhurave nga vetë BT.

Transfertat e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të NJVV-ve, por reflektohen në dokumentat e realizimit të buxheteve si fonde të administruara. Funksione të deleguara janë;

- Shërbimi i gjendjes civile
- Qendrat e Regjistrimit të Bizneseve
- Përkrahja Sociale

Struktura e të ardhurave përbehet nga të ardhurat e taksueshme, të ardhurat jo tatimore dhe gjoba, donacione etj.

Grafiku Nr 24: Ndryshimet në strukturën e të ardhurave të veta të BT-së



Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Në analizën e strukturës së të ardhurave vihet re përgjatë periudhës 2011 – 2017 që peshën kryesore në gjenerimin e të ardhurave të BT-së e mbajnë të ardhurat e taksueshme të cilat vitin e fundit janë rritur ndjeshëm. Kjo rritje i dedikohet një sërë elementësh:

- Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse &tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve;

Të ardhurat e taksueshme

Burimi kryesor i të ardhurave të veta vjen nga taksat dhe për vitin 2017 ato kanë kontribuar me 65% në totalin e të ardhurave të veta. Gjatë viteve 2015 dhe 2017 taksat kanë arritur nivelet maksimale të arkëtimit, veçanërisht për kategorinë biznes. Për këtë kategori, kjo e ardhur është 164% më e lartë se në vitin 2015 dhe 175% krahasuar me vitin 2012.

Ndryshimet ligjore të fund-vitit 2015 në sistemin fiskal, nga njëra anë, lehtësuan biznesin dhe, nga ana tjetër, ndihmuan në rregullimin dhe normalizimin e situatës në shumë sektorë të ekonomisë vendore. Këto ndryshime, njëkohësisht, rritën të ardhurat e Bashkisë Tiranë, duke bërë mundur ofrimin e më shumë shërbimeve me një cilësi më të lartë.

Gjatë vitit 2016, paketës fiskale i janë bërë disa ndryshime të cilat kanë pasur synimin e vetëm që të lehtësojnë edhe më shumë barrën për biznesin. Kështu, përmes VKB nr. 8, datë 11.03.2016, “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2016 ‘Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës’”, pas konsultimeve të shumta me biznesin, u ndryshua zonimi sa i përket tarifës për zënien e hapësirës publike. Zona A, e cila ka edhe nivelin më të lartë të kësaj tarife, u ngushtua duke u përqëndruar në rrugët kryesore dhe në qendër. Po në kuadër të dialogut me biznesin, pas kërkesave të tyre, u përjashtuan nga detyrimi për të paguar taksën e përkohëshme mbi infrastrukturën arsimore të gjitha NIPT-et sekondare.

Gjithashtu, përmes VKB nr. 34, datë 23.05.2016, “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2016 Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” u përjashtuan të gjitha bizneset e reja nga detyrimi për të paguar taksat dhe tarifave vendore për një periudhë 3 mujore nga krijimi i tyre. Kjo masë i ndihmon të gjitha bizneset e reja që të rriten më shpejt pasi u jep mundësinë që të konsolidohen njëherë në treg e pastaj të paguajnë taksat.

Një masë shumë e rëndësishme për lehtësimin e bizneseve ka të bëjë me thjeshtimin e procedurave të DPTTV-së për të gjitha bizneset që operojnë në Tiranë. Për 6 procedurat kryesore të DPTTV u përgjysmuan dokumentet që u kërkoeshin bizneseve dhe u përgjysmuan, gjithashtu, edhe afati kohor i realizimit të këtyre procedurave.

Tabela Nr 28: Taksat vendore për periudhën 2012-2017

Emërtimi	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Takse mbi pasurinë e paluajtshme	470,933,202	454,888,646	756,756,097	812,156,476	1,473,382,834	1,674,435,576
Taksa mbi biznesin e vogël/Tatimi I thjeshtuar mbi fitimin e BV	827,765,270	843,098,519	614,587,151	708,247,686	274,693,674	137,752,837
Taksa e fjetjes në hotel	46,329,950	39,845,616	42,060,817	50,480,613	67,327,716	83,170,711
Taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndertimet e reja	245,071,462	624,719,373	1,004,842,547	128,325,090	1,234,029,324	3,334,882,679
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	274,687,877	296,049,524	260,109,009	325,790,581	366,078,762	299,940,349
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	320,249,987	279,468,676	229,126,388	269,085,695	280,082,106	285,325,027
Taksa për zënie dhe hapësirave publike	58,758,781	56,894,544	60,465,809	65,713,463	x	x
Taksa e tabelës	264,762,861	241,190,949	227,080,832	225,377,938	309,949,842	345,930,032
Taksa e perkoheshme e lojrave të fatit dhe kazinove	x	52,373,572	3,972,869	823,761	x	x
Taksa e gjelber	11,834,340	x	x	x	x	x
Taksa mbi token bujqesore	x	x	x	x	6717317	22,667,724
Taksa mbi truallin	x	x	x	x	36828390	52,741,453
Taksa e perkoheshme për infrastrukturen Arsimore	x	x	x	x	495,950,390	681,927,166
Të ardhura të taksueshme	2,520,393,730	2,888,529,419	3,199,001,519	2,586,001,303	4,545,040,355	6,918,773,554

Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Për vitin 2017 influencën më të madhe e kanë pasur taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja duke kontribuar me 48% në totalin e të ardhurave, ndjekur nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme që për të njëjtin vit ka kontribuar me 24% dhe taksat e perkoheshme për infrastrukturën arsimore që ka kontribuar me 10%. Të ardhurat nga kjo taksë e perkoheshme do të përdoren me qëllim për të cilën është vendosur, për rikonstruksionin e objekteve arsimore, shkolla e kopshte si dhe të infrastrukturës arsimore të BT-së, e cila e ka të domosdoshme ndërtimin e shkollave e kopshteve të reja por dhe ndërhyrjet për rikonstruksionin e atyre ekzistuese.

BT planifikon që në 2018 të ardhurat nga taksat e tarifave të arrijnë në 13 miliardë lekë, apo rreth 96 milionë euro, më një rritje prej 9.4% me bazë vjetore. Duke përfshirë dhe transfertat e pakushtëzuara nga buxheti qendror dhe fondet e mbartuara, buxheti i Tiranës në total parashikohet të arrijë në një nivel rekord prej 16.3 miliardë lekë, me një rritje prej gati 11% me bazë vjetore.

Të ardhurat jo tatimore

Të ardhurat nga tarifave vendore përbëjnë 34% të të ardhurave në total. Tarifave potenciale në BT janë ajo e pastrimit e cila ka pësuar ndryshime vitet e fundit kjo lidhur me zgjerimin ndjeshëm të territorit nën administrim të BT-së, dhe nevojës për më shumë kapacitete njerëzore dhe logjistike për të mbuluar gjithë territorin me këtë shërbim.

Tabela nr 29: Të dhëna mbi tarfat e Bashkisë Tiranë 2012 - 2017

Emërtimi	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Te ardhura jo tatimore	1,150,751,002	1,187,966,989	1,368,395,337	1,444,395,163	3,047,319,394	3,628,338,686
I						
1 Tarifat	873,988,797	930,881,558	1,112,002,014	1,104,823,723	2,260,300,366	2,756,891,336
2 Tarifa e pastrimit	775,944,605	755,099,878	809,739,138	831,665,045	1,609,195,127	1,715,479,675
3 Tarifa e parkimit	78,011,313	76,242,781	67,899,565	71,628,038	181,453,163	130,494,493
4 Dhenie e licencave, leje, autorizime, dokumenta, etj	x	99,538,899	234,363,311	2,658	x	164,000,000
5 Tarifë për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	20,032,879	x	x	x	186913234	188,375,674
6 Tarifa Vendore (NJA)	x	x	x	201527982	x	x
7 Tarifa për zënien e hapësirave publike	x	x	x	x	280,234,642	345,627,823
8 Tarifa e shërbimit veterinarë	x	x	x	x	x	1,037,750
9 Tarifa shërbimi të MZSH	x	x	x	x	x	4,075,400
II Te ardhura të tjera dhe pagesa	276,762,205	257,085,431	256,393,323	339,571,440	787,019,028	871,447,350

Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Manaxhimit Financiar

Të ardhurat nga tarifa e pastrimit zënë pjesën më të madhe të të ardhurave jo tatimore (47%) në vitin 2017. Gjithashtu faktor vendimtar për rritjen e kësaj të ardhure është rritja e numrit të taksapaguesve rrjedhojë e reformës administrativo-territoriale, riorganizimi i strukturave mbledhëse dhe arkëtimi i një pjese të madhe të tërësisht borxhi i trashëguar, që UKT sh.a i detyrohet BT-së për arkëtime të munguara në vite përpara vitit 2015.

Programet buxhetore

Ligji nr.139/2015, Për Vetëqeverisjen Vendore, rregullon organizimin dhe funksionimin e njësisve të qeverisjes vendore. Në strukturat buxhetore të programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin si edhe në funksionet që ushtron aktualisht BT, programet e zhvillimit të qytetit janë:

- Shërbimet publike vendore
- Manaxhimi i rrugëve dhe transportit publik
- Arsimi para-universitar dhe edukimi
- Kujdesi social
- Strehimi dhe planifikimi i territorit
- Zhvillimi ekonomik dhe punësimi
- Kultura dhe turizmi
- Zhvillimi i rinisë dhe sportit planifikimi, menaxhimi dhe administrimi
- Rendi dhe mbrojtja civile

Programi përmban të gjithë aktivitetet e lidhur me një fushë koherente të politikës. Ai përfshin zhvillimin edhe zbatimin e politikës. Çdo program është i veçantë nga të gjitha programet e tjera. Programet përkufizohen në terma të politikës që ato zhvillojnë dhe zbatojnë, dhe jo të funksioneve.

Buxhetimi me programe ndryshon nga metoda tradicionale e buxhetit me zëra përsa i përket përgatitjes, rishikimit dhe paraqitjes së buxhetit. Një buxhet me programe fokusohet në rezultatet e pritura të shërbimeve dhe aktiviteve që janë kryer. Pra, buxhetimi me programe identifikon produktet dhe rezultatet e parashikuara të investimeve.

Buxhetimi me programe ka ndihmuar në përgatitjen e një sistemi më të mirë të raportimit mbi zbatimin e buxhetit, ka përmirësuar cilësinë e menaxhimit financiar në sektorë të caktuar si dhe ka lehtësuar procesin e vendim-marrjes.

Hapat në zhvillimin e një buxheti me programe janë:

- Përgatitja e një kalendari buxhetor
- Përcaktimi i roleve në përgatitjen e buxhetit

- Përcaktimi i programeve bazuar në sektorët apo politikat më të rëndësishme të qeverisjes
- Vendosja e qëllimeve
- Vendosja e objektivave
- Përcaktimi i produkteve
- Përgatitja e kërkesave buxhetore të programit
- Rishikimi i buxhetit
- Ngritja e rolit të qytetarëve
- Përgatitja e dokumentit të buxhetit
- Miratimi i buxhetit
- Ekzekutimi dhe monitorimi i buxhetit


PBA është një instrument për rishikimin e politikës, i cili synon integrimin e programit të Kryetarit në politika vendore dhe konkretizimin e tyre në plane shpenzimesh.

6.2.2 Analiza e trendit të shpenzimeve

Shpenzimet e aparatit të BT-së janë planifikuar duke u bazuar në programet kryesore të PBA -së të cilat pasqyrojnë funksionet kryesore si: arsimi parauniversitar, infrastruktura rrugore dhe transporti, shërbimet e shumta publike, kujdesi social, etj. Funksionet ekskluzive financohen nga të ardhurat e BT-së si dhe nga transfertat e pakushtëzuara. Funksionet e deleguara financohen tërësisht nga grantet e përcaktuara në buxhetin e Qeverisë qendrore.


Sipas grafikut më poshtë, shpenzimet e BT-së kanë ardhur gjithmonë e në rritje, diçka më se e natyrshme për kryeqytetin e një vendi në zhvillim. Nga ana tjetër, vihet re në mënyrë të dukshme ndikimi që ka patur reforma administrative territoriale dhe mirëadministrimi i buxhetit dhe shpenzimeve. Gjatë vitit buxheti është rritur me rreth 27% krahasuar me vitin 2016.

Grafiku Nr 25: Trendi i shpenzimeve në Bashkinë Tiranë



Sipas PBA-ve, gjatë viteve 2011 – 2015 ka patur një konsistencë në vazhdueshmërinë e 10 programeve të lidhura me funksionet kryesore të BT-së, megjithëse pesha e tyre specifike ka pësuar luhatje nga viti në vit në bazë të prioriteteve sipas periudhave. Ndërkohë, pas vitit 2015 paralelisht me reformën administrative territoriale që shtoi kompetencat dhe funksionet, u shtua edhe numri i PBA-ve.

Grafiku Nr 26: Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore kryesore 2012-2017



Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Buxhetit


Siq shihet nga grafiku zëri i infrastrukturës rrugore ka një rritje të qendrueshme gjate vitit 2017, që tregon rëndësinë që i është dhënë nga BT. Trendi në rritje ndër këto programe është edhe për arsimin, dhe për shërbimet publike dhe kujdesin social. Nisur nga fakti që këto programe mbulojnë funksionet më të rëndësishme të BT-së, përqindja që kanë zënë ndër vite në buxhet ka qenë më e madhe. Edhe për vitet e ardhshme këto programe do të kenë fokusin kryesor edhe pse pas reformës administrative territoriale sipërfaqja që mbulon tashmë BT është 25 herë më e madhe.

Programet e tjera kanë zënë një peshë më të vogël, jo se janë më pak të rëndësishme por sepse një pjesë e mirë e tyre janë funksione të deleguara dhe shpenzimet për to vijnë nga grante të kushtëzuara dhe për shumicën prej tyre Bashkia ka kompetencë shpërndarjen e fondeve apo marrjen e aplikimeve e cila kryhet mbi një kuadër ligjor të paracaktuar.

Në vitin 2017 u shtuan edhe 4 programe të tjera, përkatësisht ato të: Mbrojtjes së Mjedisit (e cila nuk pati projekte të përkthyer në shpenzime konkrete), Mbrojtjen nga Zjarri, Ujitjen dhe Kullimin dhe Administrimin e pyjeve. Këto programe përfaqësojnë kompetencat e reja të BT-së të cilat që këtej e tutje do jenë gjithmonë pjesë e buxhetit. Investimet në këto programe kanë qenë fillimisht mjaft minimale, jo për shkak të priorititetit të ulët të tyre por për arsye se kanë ende nevojë për analiza të mirëfillta të gjëndjes aktuale për të përcaktuar më pas nevojat strategjike për investime.

Sipas dy kategorive kryesore (operative dhe kapitale), shpenzimet kapitale për vitin 2017 janë rritur me rreth 200% krahasuar me vitin 2012 dhe 53% krahasuar me vitin 2016. Ndërkohë që nga buxheti i 2017 mbi 30% e shpenzimeve kanë shkuar për investime. Pjesa më e madhe e investimeve ka shkuar gjithmonë në drejtim të shërbimeve publike dhe infrastrukturës rrugore e transportit, ndërsa për vitin 2017 55% e shpenzimeve kapitale shkoi për infrastrukturën rrugore dhe 23% për shërbimet publike.

Grafiku Nr 27: Trendi i shpenzimeve sipas kategorive kryesore 2012 – 2017 (%)



Burimi: Bashkia Tiranë, Drejtoria e Buxhetit

Siç vihet re nga grafiku gjatë periudhës 2015 – 2017, iu është dhënë më shumë rëndësi investimeve (rritje me 38%) me dhe janë reduktuar shpenzimet operative (rënie me 30%). ndërsa shpenzimet e personelit kanë pësuar një rritje të lehtë (me 11%), si rrjedhojë e zgjerimit të territorit dhe nevojës së qytetarëve për të marrë shërbimet afër vendbanimit.

7. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

7.1 VIZIONI I BASHKISË TIRANË

Zhvillimi i bazuar mbi pikat e forta dhe procesin e vizionimit është shumë më avantazhues sesa një plan zhvillimi bazuar mbi probleme të cilat fokusojnë vëmendjen drejt zgjidhjes duke humbur panoramën e përgjithshme. Për këtë arsye BT ka përcaktuar fillimisht një vizion për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të saj.

Vizioni ynë për pesë vitet e ardhshme kërkon kthimin e Tiranës në një qëndër të integruar më së miri në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Evropian, në një nyjë intermodale më konkurruese në hapësirën Ballkanike që synon barazi në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Konsolidimi dhe rigjenerimi urban, rritja e aksesit në arsim, i shoqëruar me një sistem të balancuar të shpërndarjes së transportit publik, me një përdorim më të zgjuar të ekosistemit urban dhe rural për të grantuar një zhvillim të qëndrueshëm do të jenë prioritetet e ardhshme të punës së BT-së.

Misioni ynë bazohet në vlerat e udhëheqjes dhe në një administratë vendore efiçente dhe efektive nëpërmjet të cilave BT mbështet dhe siguron një cilësi të lartë të jetesës për të gjithë qytetarët duke garantuar standarte bashkëkohore në ofrimin e shërbimeve, mjedis të shëndetshëm, vlera të larta të bashkëjetesës komunitare dhe një ndjenjë të pronësisë/zotërimit mes banorëve mbi të mirat publike duke krijuar barazi dhe drejtësi shoqërore për të gjithë.

Ky vizion nënkupton:

- Garantimin e zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes forcimit të pozicionit të Tiranës si nje lidhëse në rajon
- Zhvillim të balancuar urban që përmirëson infrastrukturën përmes krijimit të pesë poliçendrave urbane si një vlerë e shtuar ekonomike dhe kulturore.
- Lehtësimin e aksesit në arsim për të gjithë për të ofruar një infrastrukturë arsimore me standarte europiane dhe që të mirëpresë të gjitha grupet e shoqërisë, duke garantuar siguri dhe barazi, si edhe një infrastrukturë akomoduese (rezidencat studentore) me standarde për studentët.
- Planifikimi të territorit dhe përmirësimi të shërbimeve publike si shtylla kryesore të zhvillimit ekonomik dhe mirëqënies sociale.

7.2 OBJEKTIVAT, PROGRAMET DHE INDIKATORËT E STRATEGJISË

Objektivat strategjike të përcaktuara nga ky dokument lidhen ngushtë me një ose më shumë programe buxhetore sipas funksioneve që ka BT. Në këtë mënyrë, objektivat strategjike përbëjnë Politikën e secilit Program, e cila më pas detajohet përmes një sërë objektivash vjetorë dhe produktesh/aktivitetesh. Me rëndësi është që vizioni dhe qëllimet strategjike që synohen të përmbushen në një periudhë afatmesme.

Ndërkohë pjesë e rëndësishme e SZHQBT 2018 -2022 është edhe identifikimi i projekteve/aktiviteteve në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike dhe në përputhje me PBA-në. Kjo metodologji synon të përmirësojë manaxhimin financiar të BT-së në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike dhe vizionit të përcaktuar nga ky dokument. Gjithashtu kjo qasje lehtëson identifikimin e strukturave përgjegjëse dhe indikatorëve për secilin projekt, krijon besueshmëri te qytetarët apo donatorët potencial, duke pohuar që financimet e këtyre projekteve janë pjesë e një skeme zhvillimi gjithëpërfshirëse për BT. Për më tepër, lidhja në këtë mënyrë e SZHQBT-së me PBA-në lehtëson mekanizmat monitorues dhe vlerësues, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien në funksion të një qeverisjeje të mirë. Për të gjitha objektivat është hartuar një Plan Veprimi që parashikon ndjekjen dhe kontrollin e përmbushjes së qëllimit të strategjisë.

Objektivi Strategjik 1: Tirana Policentrike, rivitalizim urban që harmonizon infrastrukturën, shërbimet publike dhe nxit zhvillimin ekonomik

Me reformën administrative territoriale BT tashmë përfshin një territor me një sipërfaqe rreth 25 herë më të madh dhe heterogjen. Me një qendër të konsoliduar, të rrahur nga trafiku, me periferi të përhapura gjeografikisht dhe kaotike, me mbi 800,000 banorë që frekuentojnë të vetmen qendër të pajisur me shërbime kanë nxitur BT-ne në projektimin e një sistemi policentrik që bazohet jo vetëm në praninë e disa epiçendrave urbane, me orientim ekonomik dhe shoqëror por edhe me ndërveprim dhe ndërvarësi që lindin prej tyre.

Dinamikat policentrike të ardhshme janë përcaktuar duke marrë në konsideratë praninë e sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë, karakteristikat e veçanta shoqërore dhe sociale dhe profilet aktuale të zhvillimit. Këto përbëjnë nyjat e strukturës së re policentrike të qytetit me anë të së cilës kërkohet të kapërcehet dyzimi qendër-periferi si dhe të mundësohet shpërndarja thellësisht hierarkike e vlerave tregtare.

Krahas funksioneve kryesore për çdo pol është parashikuar përmirësimi i shërbimeve bazike shkolla, çerdhe, kopshte, infrastrukturë rrugore, parqe, qendra komunitare dhe kulturore, etj. Për secilin pol është parashikuar një kuotë ndërtimi në konvencion apo subvencion me shërbimet kryesore në mënyrë që të kthehen në zona të pëlqyeshme në çdo orë të ditës.

Për secilin pol janë parashikuar projektet dhe indikatorët që do të çojnë drejt krijimit të identiteveve, që parashikohen të arrihen gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm. Projektet që parashikohen të zbatohen për krijimin dhe funksionimin e pesë poleve urbane urbane do të realizohen në tre shkallë:

- ❖ **Policentrizëm në shkallë urbane.** Në këtë fazë në vëmendje do të jenë rehabilitimi dhe mobilimi urban që përfshin infrastrukturën e rrjeteve inxhinjrike, rrjetit rrugor, hapësirave publike, sipërfaqeve të gjelbra, ndriçim etj
- ❖ **Policentrizëm në shkallë lokale.** Fokusi në këtë fazë do të jetë mbi furnizimin me shërbime publike i epiqendrave dhe zonave përreth. Këtu përfshihen ndërtim/rehabilitim i shkollave, çerdheve dhe kopshteve, tregjeve publike, qendrave sociale, kënde lojrash, terrene sportive etj
- ❖ **Policentrizëm në shkallë territoriale.** Në këtë fazë do themelohen institucione/partneritet me komunitetin apo aktorë të tjerë të përfshirë që do të krijojnë tipare të dallueshme sipas karakterit të çdo poli. Aktiviteti apo fizionomia që do të kenë këto institucione do të krijojnë identitetin e përcaktuar nga kjo Strategji për pesë epiqendrat e synuara. Më poshtë tabela e objektivave specifike, programeve, projekteve, indikatorëve dhe rezultatat e pritshme në fund të 5-vjeçarit për Tiranën Policentrike.

RIVITALIZIM URBAN QË HARMONIZON INFRASTRUKTURËN, SHËRBIMET PUBLIKE DHE NXIT ZHVILLIMIN EKONOMIK (TIRANA POLICENTRIKE)

Objektiva të përgjithshme	Objektiva specifike	Projektet	Indikatorë të lidhur me monitorimin dhe raportin	Rezultatet
RIVITALIZIM URBAN QË HARMONIZON INFRASTRUKTURËN, SHËRBIMET PUBLIKE DHE NXIT ZHVILLIMIN EKONOMIK.	Poli Kombinat (Qendër Urbane me karakter kreativ, artistik dhe mjeshtror)	1. Hartimi i një Plani të Detajuar Vendor 2. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore të zonës 3. Rivitalizim i sheshit Garibaldi dhe godinave përreth sheshit 4. Mbulimi me shërbime publike i polit 5. Krijimi i Creative Hub, një hapësirë e dedikuar mjeshtrëve 6. BID Kombinat, një partneritet publik privat për një mjedis fizik të përmirësuar dhe më shumë mundësi biznesi	1. Plan i Detajuar Vendor i hartuar 2. Ndërtimi i rrugëve në zonat përreth sheshit Garibaldi 3. 4 godina të rikualifikuara dhe një shesh 4. - 12 kënde lojrash për fëmijë - Rikonstruktimi i 5 shkollave, 1 kopshti dhe 1 çerdhe 5. - 1 galeri për ekspozimin e punimeve artistike dhe artizanale - 1 hapësirë e dedikuar për projekte kulturore sociale 6. - Marrëveshje me 20 biznese partnere në BID - Një agjenci për mirëmbajtjen e BID	* Risi urbane, rikonceptim i strukturës së zhvillimit të qendrushëm të qytetit * 5 Zona atraktive për qytetet dhe turistët, për nga karakteristikat dhe identitetet e tyre * Infrastrukturë e përmirësuar dhe me shumë shërbime publike * Rritja e investimeve me 20% të përhithura nga këto zona * Rritja e numrit të bizneseve dhe të punësuarve * Jetë komunitare më aktive * Kalendare specifike të aktiviteteve kulturore, sociale dhe argëtuese
	Polit Kinostudio (Qendër Urbane me karakter artistik dhe kinematografik)	1. Hartimi i një Plani të Detajuar Vendor 2. Rivitalizim i sheshit ekzistues 3. Mbulimi me shërbime publike i polit 4. Krijimi i KinoPark, një qendër me hapësira të dedikuara sipas moshave për zhvillimin e aktiviteteve kinematografike dhe ekspozimin e veprave artistike 5. TID Kinostudio	1. Plan i Detajuar Vendor i hartuar 2. Shesh i rikualifikuar me hapësira për të gjitha moshat 3. - Rikonstruktimi i 2 shkollave - Ndërtimi i 5 kënde lojrash për fëmijë 4. - Një hapësirë e dedikuar për aktivitetet kinematografike - Një kinema/teatër - Një ekspozitë e historisë së Kinematografisë Shqiptare 5. 20 biznese përfituese nga skemat e mbështetjes	
	Poli Bulevardit Verior të Tiranës, Promovimi i zhvillimit të qendrushëm	1. Përmirësimi i infrastrukturës së zonës së re për zhvillim 2. Transport Publik efikas dhe lidhja Veri-Jug me linja transporti publik të gjelbër 3. Krijimi i hapësirave publike të përshtatshme për intensitetin e zhvillimit që pritet të ketë zona 4. Rivitalizimi i shinave të trenit si korridor i lëvizjes së gjelbër që lidh Bulevardin verior me Laprakën. 5. Rivitalizimi i Lumit të Tiranës 6. Dizajni urban i shesheve dhe ndërtimi i tyre 7. Dizajni dhe krijimi i hapësirave të gjelbra 8. Mbulimi me shërbime publike i polit 9. Ndërtim objekteve publike	1. - Bulevardi i ri gjërësi 70m & gjatësi 1.6km (korsi biçikletash) - 76.8 ha blloqe urbane - 45 njësi strukturore - 8 profile rrugore me gjërësi të ndryshme - 400,000 m2 hapësira publike - 8m2/person hapësira e gjelbër 2. Lidhja Veri-Jug me linja të transportit publik 3. - Intesiteti i ndërtimit 2.9 - Sipërfaqe totale e ndërtimit 558.500 m2 4. - Unaza Veriore 5. - River Park 24.8 ha - River lido 23.750 m2 6. - Ndërtimi i 4 shesheve publike (3.1 ha) 7. - Ndërtimi i 2 parqeve liqenore 8. - Rikonstruksion i një kopshti dhe 5 shkollave, - Ndërtimi i 2 shkollave të reja - Ndërtimi i 6 kënde lojrash 9. - Godina e Bashkisë Tiranë - Biblioteka, galeri artesh, Opera, qendra kulturore - Ngritja e një Development Trust nga ana e BT-së që të fokusohet në zbatimin e masterplanit	
	Poli Laprakë (Qendër Urbane me karakter sportiv, edukativ dhe rekreativ.)	1. Hartimi i një Plani të Detajuar Vendor 2. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore 3. Realizimi i një shiriti të kompensimit të gjelbër përgjatë hekurudhës (rjeti i ciklizmit) 4. Mbulimi me shërbime publike 5. Krijimi i disa qendrave rekreativo-sportive, për aktivitete sportive. 6. Incentivimi/mbështetja e bizneseve me karakter edukativ sportiv	1. Plan i Detajuar Vendor i hartuar 2. - Zgjerim dhe rikonstruksion i rrjetit rrugor - Pedonale dhe sheshe të rikualifikuara 3. Pista e ciklizmit 4. - Rikonstruktimi i 4 shkollave dhe ndërtimi i 3 shkollave të reja - Ndërtimi i 6 kënde lojrash për fëmijë 5. Park sportiv 6. 20 biznese të incetivuar	
	Poli Farkë-Qyteti Studenti (Qendër Urbane me karakter rekreativ natyror dhe turistik)	1. Hartimi i një Plani të Detajuar Vendor 2. Infrastruktura në kufirin jugor të zonës (autostrada e re) dhe lidhja me Qytetin Studenti 3. Krijimi i disa zonave të gjelbra publike për jetën kolektive, parku rekreativ i Farkës i lidhur me anë të trotuareve dhe korsive të biçikletave. 4. Ndërtimi i një kompleksi sportiv të hapur (fusha futboll, basket, voley). 5. Krijimi i një zone për lojrat ujore 6. Krijimi i një biblioteke në natyrë 7. Mbulimi me shërbime publike i polit	1. Plan i Detajuar Vendor i hartuar 2. - Infrastruktura e përmirësuar e rrugëve - Pista e ciklizmit - park 3. Një piknik - park 4. Një kompleks sportiv funksional 5. Një hapësirë e dedikuar për lojrat ujore 6. Një bibliotekë 2 -katëshe me xhama në natyrë 7. - Rikonstruksion i 2 kopshteve dhe 3 shkollave - Ndërtimi i 3 shkollave të reja - Ndërtimi i 4 kënde lojrash - 20 Biznese të mbështetura financiarisht që do të ndihmojnë në zhvillimin e zonës	

Objektivi Strategjik 2: Arsimi për të gjithë

Rritja e kompetencave të NJQV-ve në vazhden e reformës së decentralizimit të funksioneve ka sjellë ndër të tjera rritjen e përgjegjësive të NJQV-ve kundrejt sektorëve prioritarë, siç është edhe ai i arsimit. Vizioni i BT-së në drejtim të sektorit të arsimit synon ofrimin e një infrastrukture moderne të institucioneve arsimore, që bazohet në plotësimin e nevojave dhe interesave të nxënësve në Tiranë, për të garantuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, sigurimit të standardeve dhe aksesit më të lartë nga të gjithë grupet shoqërore në të gjithë territorin, si dhe kthimin e institucioneve arsimore në qendra të rëndësishme komunitare.

Politikat e BT-së për arsimin udhëhiqen pikërisht nga ky kuadër strategjik dhe për këtë arsye përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës arsimore si dhe krijimi i infrastrukturave të reja do të vazhdojë të jetë në për 5 vitet e ardhshme. Gjithashtu BT i ka dhënë prioritet më shumë se kurrë rritjes së aksesueshmërisë arsimore për grupet e pa favorizuara si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në zona të thella rurale dhe ata me ndihmë ekonomike duke iu përmbajtur vizionit të saj dhe atij kombëtar. E fundit por jo më pak e rëndësishme, BT synon të nxisë shfrytëzimin maksimal të hapësirave të këtyre objekteve në funksion të edukimit dhe ndërveprimit të komunitetit nëpërmjet programit “Shkolla si Qendra Komunitare”.

Objektivi Specifik 1 : Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor.

Për arritjen e këtij objektivi është propozuar ndjekja e dy programeve. Programi i parë ka të bëjë me ngritjen e infrastrukturës së re arsimore, ku për llogaritjen e nevojave të qytetit për shkolla dhe kopshte në vitet e ardhshme u krye një Studim i Detajuar Fizibiliteti, miratuar në KB në nëntor të vitit 2016. Ndërsa nevoja për ngritjen e çerdheve të reja është evidentuar nga Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHFEF) bazuar në fluksin e kërkesave dhe mangësitë në zonat e ndryshme të Tiranës. Programi i dytë konsiston në rikonstruksionin e infrastrukturës arsimore ekzistuese për përmirësimin e kushteve mësimore dhe për këtë është krijuar një sistem pikëzimi për të nxjerrë ndërhyrjet prioritare gjatë 5 viteve në vazhdim.

Nga analiza e kryer mbi nevojat për ndërhyrje në rehabilitimin e infrastrukturave ekzistuese arsimore rezulton se gjatë pesë vjeçarit të ardhshëm duhet të shihen me prioritet 54 institucione arsimore. Për të kryer këto investime në mënyrë sa më të balancuar përgjatë viteve është vendosur që thuajse çdo vit të ndërhyhet në rreth 11 institucione të identifikuara bazuar në një sistem pikëzimi të përgatitur posaçërisht për këtë objektiv.

Tabela Nr 30: Plani i veprimit për Ndërtimin dhe Rikonstruktimin e institucioneve arsimore në BT

PLANI I VEPRIMIT ARSIMI PER TE GJITHE					
PROGRAMI	2018	2019	2020	2021	2022
Infrastrukturë e re sipas standardeve (ndërtime të reja me PPP)	8 çerdhe				
	7 kopshte				
	10 shkolla 9-vjeçare				
	7 shkolla të mesme				
Infrastrukturë ekzistuese e përmirësuar	Çerdhe Nr 61 (NJA7)	Kopshti Nr 40 (NJA 2)	Shk Skënder Çaçi (NJA 8)	Shk 100 Vjetori (Kashar)	Shk 1 Qershori (NJA 6)
	Çerdhe Nr 8 (NJA 10)	Kopshti Nr 41 (NJA 2)	Shk Kushtrim I Lirisë (NJA 1)	Shk Haxhi Korra (Zall Herr)	Shk 26 Nwntori (NJA 5)
	Kopshti Nr 43 (NJA 7)	Kopshti Nr 35 (NJA 8)	Shk 28 Nëntori (NJA 11)	Shk Myslym Keta (NJA 6)	Shk Xhezmi Delli (NJA 3)
	Kopshti Nr 34 (NJA 6)	Kopshti Nr 3 (NJA 9)	Shk Partizani (NJA 8)	Shk Ramazan Jarani (NJA 4)	Shk. Qemal Ataturk (NJA 2)
	Kopshti Shkozë (NJA 1)	Kopshti Farkë 1	Shk Hasan Prishtina (NJA 3)	Shk Bajram Curri (NJA 4)	Shk. Sandwr Prosi (NJA 2)
	Kopshti Ndroq	Kopshti Farkë2	Shk Besnik Sykja (NJA 5)	Shk At Zef Pëllumbi (NJA 5)	Shk. Androkli Kostallari (NJA 1)
	Kopshti Pezë	Shk Sami Frashëri (NJA 9)	Shk Misto Mame (NJA 8)	Shk Lidhja e Prizrenit (NJA 9)	Shk. Skwnder Luarasi (NJA 11)
	Shk. Edith Durham (NJA 5)	Shk Kongresi I Manastirit (NJA 6)	Shk Pjetër Budi (NJA 7)	Shk Kol Jakova (NJA 11)	Shk Aleks Buda (NJA 11)
	Shk Shyqyri Peza (NJA 6)	Shk Musine Kokalari (NJA 6)	Shk Kostandin Kristoforidhi (NJA 10)	Shk 7 Marsi (NJA 9)	Shk Osman Myderizi (NJA 2)
	Shk Qazim Turdiu (NJA 9)	Shk Lasgush Poradeci (NJA 6)	Shk Kasem Shima (Kashar)	Shk e Mesme e Bashkuar (Zall Herr)	Shk Arben Broci (NJA 7)
	Shk 17 Shkurti Dajt	Shk Jeronim de Rada (NJA 9)	Shk 17 Shkurti (Dajt vartëse)	Shk Avni Rustemi (NJA 10)	Shk Kongresi I Lushnjës (NJA 3)
		Shk M. K. Ataturk (Zall Herr)			

Ndarja e punimeve për rehabilitimin e tyre sipas viteve është bërë nëpërmjet një skeme, e cila ka marrë në konsideratë këta elemente: (i) llojin e objektit (shkollë, kopsht apo çerdhe), (ii) vitin e rikonstruksionit të fundit, (iii) numrin/ kapacitetin e nxënësve për çdo shkollë, (iv) njësinë administrative (urbane apo rurale) dhe (v) kërkesat sipas nevojave specifike në objekte të ardhura nga NJA, qytetarë etj.

Për sa i përket shkollave urbane, fillimisht është kryer një sistem pikëzimi bazuar në dy tregues: Vitin e fundit të ndërtimit dhe kapacitetin e shkollës. Pikët më të larta i kanë marrë ato shkolla të cilat kanë më shumë nxënës dhe që viti i fundit i rikonstruksionit ka qenë më i hershëm. Pra ky sistem pikëzimi është bërë në mënyrë të tillë që prioritet të jenë ato ndërhyrje nga të cilat përfitojnë sa më shumë nxënës dhe ato shkolla të cilat janë në gjendje më emergjente.

Për sa i përket shkollave dhe kopshteve në zonat rurale, prioritizimi i ndërhyrjeve është bërë duke parë kërkesat më emergjente të ardhura nga drejtorët e shkollave, Administratorët e NJA-ve dhe nga DPPP.

Për sa i përket kopshteve dhe çerdheve në zonën urbane, pjesa më e madhe e tyre janë rehabilituar gjatë dy viteve të fundit falë edhe nismës “Adopto një Çerdhe” e cila u aplikua më pas edhe në disa kopshte. Si pasojë, numri i mbetur i atyre që kanë ende nevojë për ndërhyrje ishte shumë i vogël, prandaj nuk u pa e nevojshme vendosja e një sistemi pikëzimi. Megjithatë, për arsye të moshës së vogël dhe delikate të frekuentuesve u vendos që këtyre objekteve të përfundohen brenda dy viteve të para.

Objektivi specifik 2. Rritja e aksesit dhe gjithëpërfshirjes në arsimin parauniversitar.

Janë propozuar dy programe: Infrastruktura PAK dhe shkollat si Qendra Komunitare.

Lidhur me infrastrukturën PAK janë marrë në konsideratë numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara sipas NJA-ve urbane dhe rëndësi më të madhe i është dhënë NJA-ve ku numri i këtyre fëmijëve që frekuentojnë shkollën është më i madh. Nga këto të dhëna rezulton se NJA 4, 5 dhe 6 kanë nevojë imediate për instalimin e infrastrukturës PAK në 22 shkolla.

Lidhur me shkollat si Qendra Komunitare, rezultojnë se në territorin e BT-së iu është dhënë statusi Qendra Komunitare 25 shkollave. Në zonën rurale janë 8 (4 shkolla të mesme dhe 4 shkolla 9-vjeçare, ndërsa në zonën urbane janë 17 shkolla (8 shkolla 9-vjeçare dhe 9 shkolla të mesme (Tabela Nr 25). Objektivi ynë për vitin e parë do të jetë funksionimi i plotë i tyre si Qendra Komunitare dhe në vitet në vazhdim do të vihen në funksionim edhe 40 shkolla të tjera në zonën urbane dhe rurale.

Tabela Nr 31 : Shkollat si Qendra Komunitare

Njësitë Administrative	Shkolla 9-vjeçare	Shkolla të mesme
NJA 1	Androkli Kostallari 1, Androkli Kostallari 2	Abdulla Keta
NJA 2		Ismail Qemali, Sandër Prosi
NJA 3	Niket Dardani	
NJA 4	Bajram Curri, Pal Engjelli, Gjon Buzuku	A.Z Cajupi
NJA 5		Petro Nini Luarasi
NJA 6		Myslym Keta
NJA 7		
NJA 8	Shkolla e Kuqe	Partizani
NJA 9		Sami Frashëri
NJA 10		Qemal Stafa
NJA 11	Kol Jakova	
PETRELË		Ibrahim Hasmema
KASHAR	Mëzez-Kodër, Katund i Ri	Sadik Staveleci
FARKË		Shkolla e mesme e bashkuar Farkë
BALDUSHK		Feti Vogli
YZBERISHT	Shkolla 9-vjeçare Yzberisht	
YRSHEK	Shkolla 9-vjeçare Yrshek	

Objektivi Specifik 3: Përmirësimi i kushteve të rezidencave studentore universitare

Për arritjen e këtij objektivi janë propozuar një sërë ndërhyrjesh nëpërmjet 3 programeve:

Infrastruktura e re sipas standarteve në Qytetin Studenti, i referohet ndërtimit të 11 godinave të reja akomoduese që do të shtojnë kapacitetin mikpritës të këtij qyteti. Gjithashtu në këtë program parashikohet hartimi i një përmirësimi të kushteve infrastrukturore të banesave për të siguruar ambiente sa më komode dhe brenda standarteve për të gjithë studentët e Tiranës.

Aktualisht Bashkia e Tiranës ka përfunduar rikonstruksionin e 2 prej godinave të Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2 falë financimeve nga qeveria gjermane, ndërkohë që dy konvikte të tjera janë në proces përfundimi duke përmirësuar si përfundim kushtet e jetesës për mbi 600 studentë. Rikonstruksioni i këtyre godinave ka përfshirë gjithashtu masa të efikasitetit të energjisë duke kontribuar në avancimin e hapave të Bashkisë Tiranë për një qytet të qëndrueshëm.

Ky objektivi parashikon një sërë projektesh që do të kenë fokus përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës së konvikteve, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet e qëndrimit të tyre.

Investime strategjike do të fillojnë në godinat me emergjente dhe që kanë një fluks të madh studentësh. Këto investime do të përqendrohen tek:

- Rikonstruksioni i plotë i godinave, bazuar në prioritizimin e tyre
- Ndërhyrje në sistemin e furnizimit me ujë dhe energji elektrike, sistemi ngrohës (ristrukturim i kaldajave dhe sistemeve të furnizimit me ujë, sistemet sanitare dhe kalimi nga përdorimi i solarit në naftë)
- Investim në sistemin e shërbimit profesional të lavanterisë
- Krijimi i bibliotekave studentore
- Dixhitalizimi i arkivës dhe krijimi i një sistemi elektronik të akomodimit dhe regjistrimit të studentëve
- Hidroizolimi i tarracave
- Rehabilitimi/ndërtimi i ambienteve sportive
- Kanalizime,
- Mobilimi dhe arredimi i brendshëm
- Krijimi dhe mobilimi i hapësirave të përbashkëta (salla leximi etj)
- Përmirësimi dhe mobilimi urban për hapësirat jashtë godinave.

Veç këtyre godinave, ndërhyrjet e parashikuara për 5-vjecarin të përfshijnë dhe godinat e Rezidencës Universitare Nr. 1, më specifikisht: Rikonstruksioni i godinës nr. 6 i cili është në proces dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2019. Ndërkohë, 9 godina të tjera janë në proces projektimi dhe do të rikonstruktohen kryesisht falë mbështetjes së donatorëve dhe qeverisë.

ARSIM PËR TË GJITHË

Objektiva të përgjithshme	Objektivat Specifike	Programe	Projektet	Indikatorë të lidhur me monitorimin dhe raportin	Rezultatet
ARSIM PËR TË GJITHË	Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor	Infrastrukturë e re sipas standarteve	1. Projektimi dhe ndërtimi i 17 shkollave dhe 10 kopshteve të reja (me PPP) 2. Ndërtimi i 4 kopshteve të reja (përveç atyre me PPP) si dhe 8 cerdheve të reja brenda vitit 2022	1. - 10 shkolla të reja 9-vjecare me kopshte të integruara - 7 shkolla të mesme të reja, sipas standarteve, 2. - 4 kopshteve të reja (përveç atyre me PPP) - 1.6 cerdhe në vit deri në vitin 2022.	* Shterimi i mësimi me 2 turne në çdo shkollë publike të arsimit parauniversitar në Tiranë * Mbulim më i mirë i hapësirave urbane me shkolla dhe aksesueshmëri më e lartë * Përmirësim i cilësisë së procesit mesimor * Përmirësim i rezultateve shkollore të nxënësve * Mbulim më i madh i kërkesës për kopshte dhe cerdhe sipas standartit * Akses më i lehtë dhe gjithëpërfshirje e lartë e fëmijëve në cerdhe dhe kopshte pranë tyre
		Infrastrukturë ekzistuese e përmirësuar	1. Rehabilitim i plotë / i pjesshëm i 43 shkollave 2. Rehabilitimi i 11 kopshteve (4 rurale) 3. Studim dhe zbatim i masave kundër zjarrit në shkollat publike 4. Vendosja e kamerave të sigurisë në çdo shkollë të Tiranës.	1. 8 shkolla të rehabilituara çdo vit deri në vitin 2022 2. 100% i kopshteve dhe cerdheve të të rikonstruara 3. - Studim i përfunduar - Vendosja e masave për mbrojtjen nga zjarri në 100% të shkollave publike të Tiranës 4. 100% e shkollave publike të Tiranës të pajisura me kamera sigurie në ambientet e jashtme	* Përmirësim i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor * Përmirësim i rezultateve arsimore të nxënësve * Rritja e sigurisë së nxënësve dhe mësuesve
	Rritja e Aksesit dhe gjithëpërfshirjes në Arsimin Parauniversitar	Rritja e aksesueshmërisë për grupet e pafavorizuara	1. Ngritja e faciliteteve për PAK në të gjitha shkollat e NJA-ve 4, 5 dhe 6 (të cilat kanë dhe nr më të lartë të fëmijëve PAK) 2. Studim mbi nevojat specifike për infrastrukturë të PAK në shkollat e NJA-ve të tjera të Tiranës 3. Studim për rritjen e aksesit në infrastrukturën arsimore në zonat rurale	1. 22 shkolla ekzistuese në njësite 4-5-6 të rehabilituara me strukturën PAK 2. Identifikimi shkollave që kanë nevojë për ketë strukturë PAK 3. Përfundimi i studimit dhe përgatitja e kalendarit të ndërhyrjeve	* Akses më i lartë në arsim i PAK si dhe nxënësve banues në zona të thella rurale të Tiranës. * Institucione arsimore lehtësisht të aksesueshme për të gjitha kategoritë sociale
		Shkollat si qendra komunitare	1. Pilotimi i programit në të paktën 10 shkolla të Tiranës (5 në qendër dhe 5 në periferi të zhvillimit) 2. Përfshirja në këtë program e 50 shkollave të tjera parauniversitare të Tiranës 3. Pilotimi i programit në një zonë rurale - më konkretisht në Shëngjergj	1. - 10 shkolla të para të hapura si qendra komunitare - 100 individë të punësuar brenda 2018-2019 2. - 50 shkolla parauniversitare deri 2022 - 500 individë të punësuar brenda vitit 2022 3. - Shkolla komunitare në Shëngjergj	* Komunitet më i konsoliduar dhe bashkëpunues * Familje më të lidhura me njëra tjetrën dhe të përfshira në një jetë komunitare aktive * Përmirësim i jetës sociale në lagjet e Tiranës
	Përmirësimi i kushteve të rezidencave studentore universitare	Infrastrukturë e re sipas standarteve	1. Masterplani i Qytit Studenti, 11 rezidenca të reja 2. Studim fizibiliteti për ndërtimin e një godine të re ku të përqendrohen të gjitha konviktet e shkollave të mesme profesionale	1. 11 rezidenca të reja studentore me një sipërfaqe ndërtimi 49.500 m2 2. Studim fizibiliteti i përfunduar	* Përmirësimi i jetës studentore jashtë ambienteve arsimore me impakt të ndjeshëm në gjendjen psikologjike, sociale dhe shoqërore
		Infrastrukture e përmirësuar	1. Rehabilitimi i 27 rezidencave studentore në Qytin studentit 2. Rehabilitimi i 4 godinave të Sha :Trajtimi I studenteve nr 2” fakulteti mjeksise dhe inxhinjerna 3. Rehabilitimi i 4 godinave të Sha :Trajtimi I studenteve nr 2” dhe I objekteve të shërbimit	4. Përfundimi e rehabilitimit rezidencave studentore 27 objekte 2. Përfundimi e rehabilitimit të rezidencave studentore (4 objekte) 3. Përfundimi e rehabilitimit të rezidencave studentore (4 objekte dhe mensa)	* Përmirësimi i performancës akademike të studenteve * Eliminimi i veshësive nga kushtet e qendrimit dhe fokusimi në mesimnxenie * Rritje e kapacitetit mikpritës në rezidencat studentore * Objekte shërbimi dhe sportive funksionale dhe me standarte
		Infrastrukturë e re/e përmirësuar shërbimesh	1. Rezidenca studentore nr 1 (mense/librari, një qender sportive dhe media, 3 hotele) 2. Dixhitalizimi i arkivës dhe krijimi i një sistemi elektronik të akomodimit dhe regjistrimit të studentëve	1. 5 struktura të reja shërbimi në qytetin studentit 2. Sistem dixhital funksional i arkives dhe regjistrimi I studenteve në rezidenca	

Objektivi Strategjik 3. Garantimi i Zhvillimit të Qendrueshëm të Ekonomisë

Ekonomia e Tiranës në përgjithësi ka qenë dhe vazhdon të jetë e ushqyer nga sektorët e shërbimeve, tregtisë, ndërtimit dhe transportit. Si sektorët me prurjet më të mëdha të të ardhurave gëzojnë vëmendjen më të madhe dhe të vazhdueshme si nga pushteti vendor edhe nga ai qendror. Por tashmë, sipërfaqja e shumëfishuar e BT-së me 13 NJA-të rurale dhe kompetencat e reja që i kanë kaluar BT-së, evidentojnë nevojën për ti kushtuar vëmendje më të lartë zhvillimit të qendrueshëm të ekonomisë.

Qëllimi është të krijohen modele të qëndrueshme në tre aspektet/kolonat e veprimtarisë njerëzore: ekonomike, sociale dhe ekologjike. Zhvillimit i qendrueshëm i ekonomisë nënkupton gjetjen e një ekuilibri koherent dhe një harmonie afatgjatë në mes të këtyre tre kolonave. Kjo çështje ndërsektoriale do të jetë sfida e 5-vjeçarit të ardhshëm për BT, që duhet të marrë në konsideratë këto aspekte në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe duhet të përfshijë domosdoshmërisht pjesëmarrjen e vazhdueshme të të gjitha palëve të interesuara (qytetarët, bizneset, shoqatat, etj) si formë e suksesshme e demokracisë pjesëmarrëse.

Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë është një proces transformimi në të cilin shfrytëzimi i burimeve natyrore, përzgjedhja e investimeve, orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale realizohen duke garantuar qëndrueshmëri në të ardhmen, propozohen këto objektiva për përmbushjen e kësaj sfide:

Objektivi specifik 1: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset. Për këtë objektiv janë propozuar dy programe:

1. *Rritja e cilësisë së shërbimeve* vendore që ka në fokus rritjen e eficiencës së ofrimit të shërbimeve duke siguruar uljen e burokracisë, reduktimin e kostove, dokumentacionit dhe kohës për marrjen e një shërbimi nga qytetarët dhe bizneset
2. *Infrastruktura dhe rrjetet e tregtisë*, që përfshin investime infrastrukturore në sistemin e ujitjes dhe kullimit, përdorimin me eficiencë të aseteve publike dhe në regjistrimin e pronave (AMTP) . Vëmendje të veçantë do i kushtohet forcimit dhe eficiencës së rrjetit të tregtisë, nëpërmjet krijimit të komponentëve që i mungojnë aktualisht këtij rrjet si edhe mbulimit të territorit të BT-së me tregje.

Objektivi specifik 2: Mbështetje financiare dhe incentiva fiskale për bizneset. Ky objektiv do të përmbushet nga dy programe të rëndësishme.

1. *Lehtësia e aksesit në financë*. Program që parashikon krijimin e instrumentave të domosdoshëm për bizneset që operojnë në territorin e BT-së, për të lehtësuar aksesin në institucionet që ofrojnë ndihma financiare dhe konsulenca për hapjen dhe zhvillimin e tipologjive të ndryshme të bizneseve. Në fokus të veçantë do të jenë start-up e bizneseve sociale nga kategoritë gra, të rinj dhe shtresa të tjera të marginalizuara të shoqërisë.

2. *Incentiva fiskale*. Ky program parashikon hartimin e dy paketave fiskale favorizuese, njëra me fokus tek femerët dhe tjetra për bizneset. Lehtësimet nga barra tatimore për këto dy kategori kanë për qëllim nxitjen dhe zgjerimin e aktiviteteve që ata ushtrojnë në fushat respektive, duke lehtësuar aksesin në tregje dhe duke rritur punësimin dhe vetëpunësimin.

Objektivi specifik 3: Rritja e konkurrueshmërisë dhe thithja e investimeve të huaja. Ky objektivi përban 4 programet më sfiduese për BT në 5-vjeçarin e ardhshëm.

1. *Zona ekonomike dhe Klasterat*. Në këtë program parashikohet krijimi i një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, në të cilën Bashkia do të ketë rolin e zhvilluesit të kësaj zone duke përmbushur kriteret e legjislacionit në fuqi. Krijimi dhe funksionimi i kësaj Zone (TEDA Kashar), ka si qëllim krijimin e një territori të veçantë me një regjim fiskal dhe doganor tepër lehtësues për ushtrimin e aktivitetit ekonomik dhe që nxit investimet, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e të ardhurave, përshpejtimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, futjen e teknologjisë së përparuar dhe përshpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe kapitaleve. Gjithashtu parashikohet edhe një projekt tjetër që ka si qëllim evidentimin dhe krijimin e Klasterave të mirrëfilltë sipas skemave më të sukseshme në rajon dhe Europë.

2. *Ekonomitë kreative dhe të kohës së lirë*. Ky program parashikon një gamë të gjerë projektesh që kanë si qëllim: (i) krijimin e një Qendre Artizanësh (atelie), për të prodhuar dhe ekspozuar prodhimet artizanale duke dhënë një vlerë të shtuar të këtyre produkteve dhe duke siguruar marketimin dhe promovimin e tyre në tregje, (ii) krijimin dhe funksionimin e inkubatorëve të biznesit duke mbështetur financiarisht dhe me konsulencë bizneset e reja për një periudhë kohore, për të lehtësuar hyrjen e tyre në tregje, (iii) TIK Piramida, një projekt ambicioz i BT që ka si qëllim krijimin e një mjedisi ku ndërveprojnë të rinjë duke përdorur teknologjinë më të mirë, nga profesionistë të fushës dhe ku ndërlidhet më së miri teknologjia dhe arti dhe (iv) një sërë projektesh të tjera me fokus zhvillimin e mëtejshëm të zonave rurale (infrastrukturë dhe inovacion) për rritjen e konsumit dhe qarkullimit të parasë në këto zona

3. *Nxitja e punësimit dhe vetëpunësimit*. Ky program ka në fokus projekte që do të rrisin bashkëpunimin ndërmjet BT-së dhe Universiteteve, duke forcuar rolin e BT-së si ndërmjetëse dhe duke garantuar forca pune më të kualifikuara, rritje kapacitetesh duke përmirësuar situatën e punësimit.

4. *Nxitja e Ekonomisë së Gjelbër*. Ky program projektton nxitjen e zhvillimit të një ekonomie të ndershme dhe në mbrojtje të mjedisit. Hartimi i platformës për zhvillimin ekonomik urban dhe rural duke mbështetur biznesi eco-friendly, hartimi i planeve për mbarëshkrimin e pyjeve dhe promovimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale vendase do të jenë projektet që do të zhvillohen për pëmbushjen e këtij programi dhe që do të japin një impakt pozitiv në rritjen e konkurrueshmërisë dhe thithjen e investimeve të huaja.

GARANTIMI I ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM TË EKONOMISË

Objektiva të përgjithshme	Objektiva Specifike	Programe	Projekte	Indikatorë të lidhur me monitorimin dhe raportimin	Rezultatet
GARANTIMI I ZHVILLIMIT TE QENDRUESHEM TE EKONOMISE	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset	Shërbimet vendore	<ol style="list-style-type: none"> One Stop Shop për biznesin dhe qytetarin Më shumë shërbime elektronike : E-Albania, e government Ndërlidhja e bazave të të dhënave kombëtare me ato vendore Dixhitalizimi i proceseve dhe procedurave administrative të institucioneve Krijimi i regjistrat të fermerëve për 12 NJA (Baldushk e ka krijuar) Tirana HUB – Portali ekonomik 	<ol style="list-style-type: none"> - numri i qytetarëve të paraqitur në sportelet e BT-së Qendër, QLT - numri i qytetarëve nga kontaktet online dhe korespondenca zyrtare - numri i ankesave nga aplikacioni mobil "Tirana lme". - numri i afshimeve të publikuara në shtetad - Akces online për marrje vërtetimi detyrimesh - Informacion online mbi detyrimet - Kontroll tatimor on line - Ndërkërkje/zhgjidhje online e ankesave/kërkesave - Lidhje on line me DPT, QKB, ZRRPP, OSHE, NUK, DPSHTRR - Lidhje online me Bankat e nivelit II - Lidhje online me agjentët tatimorë - Digjitalizimi i dosjeve ekzistuese të reja - Marrje dhe ndryshim online i pasqend-ëve - Kontroll online i dosjeve dhe dokumentacionit - Regjistër funksional i fermerëve të BT-së - Numri i vizitorëve të portalit 	<ul style="list-style-type: none"> * Më shumë lehtësi dhe akses në marrjen e shërbimeve nga qytetarët dhe biznesi * Ujje e burokracive, kosotos, dokumentave dhe kohës së harkuar për marrjen e shërbimeve ujje e informalletit * Rritje e efikasitetit së nëpunësve të BT për ofrimin e shërbimeve ngaj qytetarit dhe bizneseve * Ujja e informalletit mbi të dhënat e fermerëve që operojnë në territorin e BT-së. * Informacion më I plotë lidhur me fermerët dhe zonat ku ata operojnë për t'u ofruar më shumë mundësi për rritjen dhe zhvillimin e aktivitetit të tyre. * Orientimi i investimeve vendore, qëndrore apo edhe ato të huaja drejt fushave apo sektorëve më me potencial për zhvillim të mëtejshëm sipas zonave. * Krijimi i një kanali komunikimi mes investitorëve, sipërmarrësve dhe BT;
		Infrastruktura dhe rrjetet e tregtisë	<ol style="list-style-type: none"> Azhomimi i kufijve të pronave në 13 NJA rurale dhe regjistrimi i AMTP-ve të tokave bujqësore Përmirësimi i sistemit të ujtitjes dhe kullimit në BT Hartëzimi dhe promovimi i aseteve të lira të BT, per tu perdorur nga bizneset kundrejt lehtësirave fiskale ose normale të ulla të qirasë. Ngrija dhe funksionimi i një agregatori (pikë grumbullimi/tregëtimi) në territorin e BT Studim mbi vlerësimin e nevojës për tregje në territorin e BT Hapja dhe funksionimi i tregjeve ditore. 	<ol style="list-style-type: none"> - Azhormim në masën 100% i pronave në 13NJ A rurale - Numri i AMTP-ve të regjistruara në territorin e BT-së - Sipërfaqja e tokave bujqësore të pajisura me sistem vadije - Broshurë informuese lidhur me vendodhjen e aseteve te lira të BT - Numri i bizneseve që përdorin asetet e BT për zhvillimin e aktiviteve të tyre. - Agregator funksional - Numri i fermerëve, tregtarëve dhe bizneseve të përfshirë në veprimtarinë e agregatorit - Studim i përfunduar mbi nevojat e qytetarëve për tregje - 3 tregje të reja publike - 200 tregtarë ambulantë të formalizuar - Numri i tregjeve ditore funksionale në BT - 50 tregtarë ambulantë në tregjet ditore 	<ul style="list-style-type: none"> * Garantimi i sigurisë së titujve të pronësisë * Më shumë mundësi për fermerët për të përfutur nga skemat e financimit në fushën e bujqësisë * Minimizimi i barrierave shtetërore që kanë ngritur çështjet e pronësisë për investitorët vendas dhe të huaj * Ujje e ndjeshme e transaksioneve informale në tregun e pasurive të paluajtshme * Sistem ujtitës dhe kullues funksional dhe cilësor * Më shumë sipërfaqe e ujtit dhe më pak prodhimi e dëmtuar * Efikasitet më e lartë në ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore e biegtorale * Zinxhir ushqimor më funksional dhe i mirëkoordinuar. * Rritja e konkurrenshërisë në sektorin e tregëtimit të produkteve bujqësore lokale * Rritja e ekonomisë vendore
	Mbështetja financiare dhe incentivat fiskale për bizneset	Lehtësia e aksesit në financë	<ol style="list-style-type: none"> Skema financiare (grante) për mbështetjen e start up-ve për bizneset sociale (gratë, të rinjtë, etj) Studim dhe paketa informative lidhur me institucionet financiare që ofrojnë mbështetje financiare për bizneset e reja dhe ekzistuese 	<ol style="list-style-type: none"> - 150- 230 biznese të reja ose të mbështetura financiarisht - Rreth 500 të vetë/punësuar Studim dhe paketa informative të përfunduar me bazë vjetore për Situatin e kreditimit dhe aksesit në financim 	<ul style="list-style-type: none"> * Më shumë informacione dhe mundësi për të hapur apo zhvilluar biznesin * Rritje e numrit të punësuarve dhe vetëpunësuarve * Rritja e konkurrenshërisë së tregje
		Incentiva fiskale për biznesin	<ol style="list-style-type: none"> Krijimi i paketave fiskale favorizuese për fermerët Krijimi i paketave fiskale favorizuese për bizneset sociale/start up-e 	<ol style="list-style-type: none"> - Numri i taksave apo tarifave të reduktuara apo të përjashtuara nga paketa për fermerët - Numri i fermerëve përfitues - Numri i taksave dhe tarifave të reduktuara apo përjashtuara nga paketa për bizneset - Numri i bizneseve përfituese nga paketa 	<ul style="list-style-type: none"> * Nxjtja e fermerëve për të zhvilluar dhe zgjeruar aktivitetet e tyre * Nxjtja e bizneseve sociale për të hapur dhe zhvilluar aktivitetin e tyre * Rritja e numrit të vetëpunësuarve
	Rritja e konkurrenshërisë dhe thithja e investimeve të huaja	Zonat ekonomike dhe clusterat	<ol style="list-style-type: none"> TEDA – Zona Teknologjike e Zhvillimit Ekonomik Evidentimi dhe krijimi i mirëfilltë I possible clusters 	<ol style="list-style-type: none"> - Shpallja e ZTZHE dhe e BT-së si zhvilluese e saj - Nr. Investitorëve vendas dhe të huaj - Nr. i të punësuarve - Studim i përfunduar për clusterat aktuale dhe të mundshme në Tiranë - 4 klastera të reja në territorin e BT-së - Numri i bizneseve sipas fushës e veprimtarisë ekonomike të përfshira në to 	<ol style="list-style-type: none"> Rritje e konkurrenshërisë së rajont Tiranë-Durrës Rritje e investimeve të huaja me Promovim i zhvillimit rajonal dhe i lidhjeve të ekonomisë me tregjet ndërkombëtare etj. Përmirësim i klimës së biznesit në qytetin e Tiranës
		Ekonomitë kreative dhe të kohës së lirë	<ol style="list-style-type: none"> Qendra e Artizanatit Inkubatorët për biznesin , TIK (Piramida) 	<ol style="list-style-type: none"> - 1 qendër artizanat në qytetin e Tiranës - 10 - 20 artizanë të angazhuar në qendër - Numri i inkubatorëve të krijuar në qytet - 100 sipërmarrës të trajnuar dhe mentoruar - 10.000 m2 hapësirë për aktivitetet kreative - 150 të punësuar - 2000 të rinj të angazhuar 	<ul style="list-style-type: none"> * Krijimi i Qendrës së Artizanëve në Tiranë (atelic) e cila do të jetë një ambient i dedikuar për prodhimin, ekspozimin dhe tregtimin e produkteve artizanale për qytetin e Tiranës. * Vlerë e situar e produkteve artizanale * Transferimi i njohurive tek brezat e ardhshëm për të siguruar vazhdimësinë e kësaj industrie * Marketim i suksesshëm për promovimin e produkteve artizanale në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare * Mbështetja e një sërë aktivitetesh start-up për një Periudhë 1 vjetore për të qenë të qendrushëm në treg * Një aset më shumë, një mjedis ku ndërveprojnë të rinjtë ku ndërlidhet më së miri teknologjia dhe arti
			<ol style="list-style-type: none"> Hapja dhe vendosja e sinjalistikës për të paktën 300 Km Shtigjesh për Hiking, Cycling, etc. Krijimi i hartave të mëdha turistike të stacionuara në hyrjet kryesore të çdo njësie për të orientuar Turistët në lidhje me zonën BRANDING OF TIRANA. Regjistri City Tax, krijimi i bazës së të dhënave vendore mbi njësitë akomoduese në territorin e BT-së 	<ol style="list-style-type: none"> 300 km shtigje të reja të hapura, të evidentuara me koordinata dhe të hedhura në portalin Tirana lme Outdoor Krijimi i 13 hartave të mëdha turistike prej druri , nga 1 për çdo njësi brenda vitit 2018 Krijimi i BRANDIT lme online e marketimit të Tiranës sipas këuj brandi Regjistri City Tax funksional 	<ul style="list-style-type: none"> * Rritja e numrit të turistëve të aventurës në këto zona * Rritja e konsumit dhe qarkullimit të lekut në bizneset e këtyre zonave * Zhvillim i mëtejshëm i njësjve rurale. * Shtimi I një burimi statistikor për numrin e turistëve në Tiranë dhe njësjve akomoduese.
		Nxjtja e punësimit dhe vetë-punësimit	<ol style="list-style-type: none"> Rritja e rolit të BT-së si ndërmjetësuere midis biznesit dhe punëkërkuetit Projekte konkrete për rritjen e bashkëpunimit me universitetet për më shumë mundësi punësimi për studentët Trajnime, ngritje kapacitetesh sipas llojit të biznesit. 	<ol style="list-style-type: none"> 500 të punësuar nga ndërmjetësimi 500 studentë përfitojnë nga programet e bashkëpunimit 500 të trajnuar 	<ul style="list-style-type: none"> * Rritje e kapaciteteve të bizneseve/studentëve * Forcë pune e kualifikuar * Lehtësi në të bërit biznes * Rritje e konkurrenshërisë * Rritje e punësimit dhe vetëpunësimit
		Nxjtja e Ekonomisë Green	<ol style="list-style-type: none"> Hartimi i Platformës për zhvillimin e qendrushëm të ekonomisë vendore 2019-2022 Hartimi i 6 planeve për mbarshtësimin e pyjeve Promovimi i bizneseve Eko-Friendly dhe orientimi i bizneseve aktuale që duan të kthehen në biznese green Markimi i produkteve bujqësore – Identifikimi i produkteve tipike 	<ol style="list-style-type: none"> Platformë e miratuar për zhvillimin ekonomik urban dhe rural Plani i mbarshtësimi të 6 ekonomive pyjore Nr. Bizneseve që përdorin teknologji të pastra mjedisore Identifikimi dhe markimi i produkteve tipike tradicionalisht të prodhuara në zonën e Tiranës. 	<ul style="list-style-type: none"> * Kuađer ekonomik i mirëpërcaktuar me objektiva dhe projekte në fushën e zhvillimit ekonomik * Manaxhim dhe mirëadministrim i fondit pyjor në pronësi të BT-së * Nxjtja e fermerëve për të prodhuar produkte tipike te zonës, të cilat tashmë janë të kërkuara nga konsumatorët *Përmirësim i cilësisë së produkteve dhe përmirësim i ambalazhimit dhe procesit të ruajtjes së produkteve *Më shumë mundësi për fermerët për diversifikimin e produkteve të tyre duke sjellë produkte të reja në treg dhe produkte organike

Objektivi Strategjik 4. Tirana për të gjithë

Vizioni i BT-së për vitet e ardhshme e vë theksin në zhvillimin e një qyteti gjithëpërfshirës, i cili është në funksion të qytetarëve dhe garanton një zhvillim të integruar ekonomik, social dhe territorial duke rritur mirëqënien e qytetit.

Tirana për të gjithë shpaloset si një politikë që synon përmbushjen e këtij vizioni dhe që ka në fokus rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe rritjen e aksesueshmërisë së tij nga të gjithë. Nëpërmjet objektivave specifike të strategjisë, synohet përmirësimi i një sërë elementesh problematike me të cilët përballlet sot Tirana si: mungesa e hapësirave të gjelbërta dhe rekreative, zhvillimi i pakontrolluar urban dhe infrastrukturë e vjetëruar rrugore dhe e godinave, transporti publik jo eficient, mungesa e teknologjive inovative në transport, mungesa e hapësirave për biçikleta, trafiku i rënduar, mungesa e bashkëveprimit dhe bashkëpunimit me komunitetin, etj. Ky prioritet është parashikuar të përmbushet nëpërmjet programeve dhe projekteve të mëposhtme:

Objektiv Specifik 1. Nxitja e mobilitetit alternativ dhe të qëndrueshëm për rritjen e aksesueshmërisë është një objektivi që synohet të përmbushet nëpërmjet dy programeve:

1. Zgjerimi i rrjetit minimal dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese të këtij rrjeti. Ky program synon të zbatohet një sërë projektesh për zgjerimin e korsive të dedikuara për biçikleta në rrjetin rrugor kryesor, duke mbështetur një lëvizje alternative në qytet. Kjo do të zvogëlojë kohën e udhëtimit të përdoruesve të biçikletave, duke ofruar shpejtësi dhe siguri. Projektet e propozuara do të zhvillojnë një rrjet minimal të nevojshëm për funksionimin dhe stimulimin e përdorimit të biçikletave në rrugët unazore si dhe korridoret kryesore radiale që lidhin periferitë në qendër të qytetit. Ajo gjithashtu do të lidhin zonat urbane me rrethinat, kodra dhe parqe rekreative për t'i bërë ato zona të aksesueshme me biçikletë.

2. Përmirësimi i shërbimit të operatorëve në këtë fushë dhe fushata ndërgjegjëse për përdorimin e biçikletave. Ky program përfshin projekte që synojnë shtimin e pikave rent të biçikletave, dhe projekte për promovimin e përdorimit përmes mekanizmave sensibilizues.

Objektiv specifik 2. Rritja e kapacitetit të parkimit në Zonën qendrore të Biznesit (ZQB) dhe përdorimin eficient të hapësirave ekzistuese. Mungesa e hapësirave të parkimit është një nga problemet më serioze me të cilat përballlet Tirana sot. Për këtë qëllim, BT është e angazhuar në disa projekte që do të përmirësojnë situatën e parkimit në qytet. Projektet kanë fokus përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimit me pagesë për zonat e parkimit, manaxhim më të mirë të shesheve të parkimit dhe parkimeve nënëtokësore. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe infrastrukturës së parkimeve të rezidentëve.

Objektiv Specifik 3. Shtimi i hapësirave të gjelbra fokusohet në rritjen e cilësisë së jetës, transformimit të qëndrueshëm dhe krijimit të hapësirave atraktive dhe natyrale. Katër janë projektet që parashikohen:

1. Pylli Orbital, një brez i gjelbër përreth zonës urbane që do të shërbejë si një kufi natyral ndaj rritjes urbane. Ky pyll do të lidhë parqet ekzistuese periurbane, zonat bujqësore, zonat pyjore, zonat rreth liqeneve. Zbatimi i këtij projekti është ndarë në tre faza (me nga 5 vite secila), me monitorim të përkohshëm dhe që parashikon mbjelljen e rreth dy milion pemë.
2. Central Park, me një sipërfaqe 6 herë më të madhe se Parku Rinia, do të jetë një nga pjesët më kreative të qytetit, i ngjashëm me parqet më moderne të Evropës. Ky projekt është pjesë e Central Tirana MasterPlan (Grimshaë) dhe do të jetë një mushkëri e re për Tiranën duke ndikuar pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

3. Fasadat e gjelbera është një projekt që parashikon përzgjedhjen e një kategorie të caktuar ndërtesash (psh shkolla, çerdhe, ose ndërtesat e një segmenti të caktuar rrugor) për të aplikuar këtë projekt.
4. Urat e biodiversitetit. Ky program ka si qëllim lidhjen e sistemit urban me atë periurban. Një nga instrumentat që do të përmbushë këtë qëllim është lidhja e gjelbër ndërmjet barrierave ekologjike si psh autostradat. Një prej tyre është autostrada Tiranë Elbasan ndan qytetin dhe Parkun e Liqenit nga Metrobosco dhe sistemi bujqësor në pjesën jug-perëndimore. Kështu ndërtimi i dy urave të biodiversitetit do të realizojë (i) lidhjen ekologjike ndërmjet lidhësve të gjelbër të qytetit dhe Metrobosco dhe (ii) lidhjen ndërmjet Metrobosco dhe Parku i Liqenit.


Objektiv Specifik 4. Transportit publik me efijence të lartë mbi 5 km. Ky program si prioritet siguron e një sistemi transporti të sigurt, të pastër dhe miqësor ndaj mjedisit. Edhe ky program parashikon një sërë projektsh që kanë për qëllim:

1. Zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit egzistues infrastrukturor të transportit publik. Zhvillimi i korsive të dedikuara për autobusët në rrjetin rrugor, synon t'i japë transportit publik përparësi mbi automjetet private në rrugët kryesore radiale dhe unazore. Projekti i korsive të dedikuara për autobusët do të sigurojë shpejtësi, mundësi për të planifikuar oraret e mbërritjes dhe nisjes dhe duke zvogëluar kohën e pritjes për udhëtarët dhe duke e bërë transportin publik më tërheqës.
2. Rinovimi dhe shtimi i flotës së transportit publik. Rinovimi i autobusave diesel me ata elektrik për udhetime mbi 5 km, synon ofrimin e një shërbimi cilësor, frekuencë të shpejtë, uljen e emëtimit të dioksidit të karbonit.
3. Sistemi i informacionit të pasagjerëve, përfshin biletimin elektronik si dhe shpërndarjen e informacionit në kohë reale nëpërmjet smartphone si dhe gjurmimin e lëvizjes së autobusëve me synim rritjen e efikasitetit të shërbimit në transportin publik.

Objektiv Specifik 5. Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve. Tre janë projektet kryesore që përfshin ky program:

1. Rehabilitimi i blloqeve të banimit. Projekti ka në fokus përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të banimit ku përfshihen rehabilitimi i infrastrukturës së rrugëve të lagjeve, vendosja e ndriçimit rrugor, sistemi i parkimit dhe i ujësjellës-kanalizimeve, si edhe krijimi i xhepave të gjelbër. Ky projekt u hartua duke u nisur nga analiza e situatës aktuale.

Figura Nr 35: Harta e Blloqeve të Banimit




Për përcaktimin e blloqeve që do të rehabilitohen u hartua një sistem pikëzimi që mori në konsideratë sipërfaqen e blloqeve të banimit dhe intesitetin e ndërtimit (intesitetin aktual dhe atë të parashikuar në PPVBT). Në këtë sistem nuk u përfshinë blloqet e banimit të rehabilituar 10 vjeçarin e fundit, rreth 25 blloqe. Për 3 vitet e para janë përcaktuar të rehabilitohen 12 blloqe në vit dhe nga 13 blloqe për 2 vitet e fundit.

Tabela Nr 32: Plani i Veprimit për Rehabilitimin e Bllloqeve të Banimit`

PLANI I VEPRIMIT					
TIRANA PER TE GJITHE / REHABILITIMI I BLLLOQEVE TE BANIMIT					
PROGRAMI	2018	2019	2020	2021	2022
Rehabilitimi i Bllloqeve të banimit	Blloku 21	Blloku 15	Blloku 82	Blloku 88	Blloku 78
	Blloku 12	Blloku 32	Blloku 84	Blloku 48	Blloku 28
	Blloku 20	Blloku 43	Blloku 64 NJA 5	Blloku 70	Blloku 39
	Blloku 23	Blloku 44	Blloku 68	Blloku 71	Blloku 50
	Blloku 19	Blloku 55	Blloku 74	Blloku 73	Blloku 60
	Blloku 16	Blloku 66	Blloku 90	Blloku 80	Blloku 27
	Blloku 24	Blloku 9	Blloku 38	Blloku 81	Blloku 31
	Blloku 26	Blloku 18	Blloku 56	Blloku 83	Blloku 72
	Blloku 33	Blloku 35	Blloku 57	Blloku 87	Blloku 85
	Blloku 36	Blloku 37	Blloku 64	Blloku 76	Blloku 89
	Blloku 47	Blloku 58	Blloku 69	Blloku 94	Blloku 92
	Blloku 10	Blloku 67	Blloku 75	Blloku 62	Blloku 96
				Blloku 65	Blloku 93

- Nxitja e bashkëpunimit efektiv mes BT-së dhe qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve në bashkëpronësi. Ky projekt nëpërmjet një skeme fondesh të vëna në dispozicion nga BT, iu mundëson banorëve të lagjeve të ndryshme (bashkëpronarët e ambjenteve të banimit) të kryeqytetit, të organizohen së bashku nën udhëheqjen e Administratorëve për të përfituar bashkë-financim për projekte infrastrukturore të cilat adresojnë një problem të caktuar në komunitetin e tyre. Projekti nuk synon vetëm me përmirësimin e ambjenteve të përbashkëta por edhe ndryshimin e mentalitetit të bashkëpunimit mes qytetarëve dhe institucioneve publike.
- Më shumë hapësira rekreative në qytet. Projekti ka në fokus shtimin e hapësirave çlodhëse dhe argëtuese sidomos për fëmijët. Për përcaktimin e nevojës për kënde lojrash u morrën në konsiderate numri i këndeve të lojrave aktuale që ka çdo NJA urbane, si edhe të dhënat demografike për numrin e fëmijve (grupmosha 3 – 15 vjeç) sipas NJA duke marrë në konsideratë edhe projeksionin e popullsisë. Mbi bazën e këtyre dy elementëve u përcaktua numri i këndeve të nevojshë në zonën urbane.

Figura Nr 35: Harta e Këndeve të lojrave



Burimi: Bashkia Tiranë

Objektiv Specifik 6. Sistem i përmirësuar i manaxhimit të mbetjeve në BT. Ky program ka si qëllim rritjen e cilësisë së manaxhimit të mbetjeve. Për këtë qëllim janë parashikuar disa projekte që synojnë

- rritjen e numrit të vendgrumbullimeve tokësore dhe nëntokësore në pikat më të nxehta,
- monitorimin e shërbimit nëpërmjet vendosjes së sensorëve në kontienierë.
- Shtrirjen e sensibilizimit dhe realizimit të diferencimit të mbetjeve (dy rryma) në të gjithë territorin e Tiranës urbane.

Objektivi specifik 7. Furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijshëm. Në pesë vitet e ardhshme UKT - Tiranë, ka projektuar një sërë ndërhyrjesh me qëllim furnizimin me ujë të pijshëm, 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë dhe pa ndërprerje, për të gjithë klientët ekzistues dhe të rinj në zonën e re të shërbimit të BT-së. Plani i Biznesit i UKT synon:

- të sigurojë grumbullimin, trajtimin dhe largimin cilësor të ujërave të ndotura për të mbrojtur shëndetin publik dhe në përputhje me rregulloret kombëtare për mjedisin.
- të sigurojë një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe të mirë ku nxitet komunikimi, bashkëpunimi, trajnimi dhe kompensimi për arritjet individuale të stafit.
- të përmirësojë vazhdimisht performancën për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe për të qenë në gjendje të mbulojë nevojat për investime të reja dhe rinovime të aseteve në kohën e duhur.

Objektiv Specifik 8 Përmirësimi i shërbimit të varrezave publike. Mirëorganizimi i shërbimit të varrezave publike si shërbim i detyrueshem ndaj qytetarve parashikon sigurimin e hapësirës së nevojshme për këtë shërbim, përmirësimin e infrastrukturës dhe gjithashtu vënien në funksion të varrezave murale.

TIRANA PËR TË GJITHË,QYTET I AKSESUESHËM DHE GJITHPËRFSHIRËS

Objektiva të përgjithshme	Objektivat Specifike	Programe	Projektet	Indikatorë të lidhur me monitorimin dhe raportin	Rezultatet
TIRANA PËR TË GJITHË,QYTET I AKSESUESHËM DHE GJITHPËRFSHIRËS	Nxitja e çiklizmit për udhëtime nën 5 km (MINIMUM GRID)	Zgjerim i rrjetit minimal dhe përmirësim i infrastrukturës së këtij rrjeti	1. Rruga e Durrësit (reduktimi në 3 korsi për makina dhe shfrytëzimi i kësaj hapësire për dy korsi të dedikuara biçikletash) 2. Korsi të dedikuara në Rrugën Dibrës 3. Rehabilitim dhe rimobilim i trotuareve përgjatë Lana River duke krijuar hapësirën e nevojshme për korsi biçikletash me dy kahe 4. Korsi të dedikuara përgjatë Bulevardit të Ri 5. Korsi të dedikuara në Unazën e 3-të 6. Korsi e dedikuar (në kah të kundërt) në Rr. Myslym Shyri 7. Rritja e cilësisë dhe sinjalistikës të korsisë së biçikletave në Rr. e Kavajës	20-25 km korsi e dedikuar për biçikleta	*Përmirësim i cilësisë së jetës së qytetarëve *Rritja e cilësisë së ajrit *Përmirësim i lëvizshmërisë dhe ulja e trafikut *Siguri rrugore
		Përmirësim i shërbimit (ecovolis) si edhe ndërgjegjësim i qytetarëve për përdorimin e bicikletave	1. Shtimi i vend-parkimeve për biçikleta 2. Shtimi i pikave Rent - për biçikleta 3. Promovimi i përdorimit të biçikletave 4. Mobike	1. 200 vendparkime të reja për biçikleta 2. 30 pika Rent të reja - për biçikleta 3. Fushata sensibilizuese 4. - 4000 biçikleta në dispozicion - numri i përdoruesve	
	Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës (ZBQ)	Shërbimi dhe infrastruktura e parkimit në Tiranë	1. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të parkimit publik me pagesë në rrugë, sheshe, mbi dhe nëntokë. 2. Diversifikimi i mënyrave të pagesës së parkimit në sheshe 3. Rritja e hapësirave publike për administrim parkimi me pagesë, 4. Ndërtimi i shesheve të reja mbi tokë 5. Përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të dedikuara "Vetëm për rezident"	1. Kalimi i inspektoreve nga vjelës të të ardhurave në kontrollues 2. Digitalizimi i mënyrës së pagesës së parkimit 3. - Shtimi i 2600 vende parkimi me pagesë - Rreth 35.000 m2 të dedikuar për parkim 4. Pajisja me sinjalistikën e plotë horizontale në zonat e parkimit për rezident	* Reduktimi i trafikut dhe rritja e lëvizshmërisë në qytet * Përmirësim i cilësisë së ajrit * Reduktimi i parkimit në rrugë për të lehtësuar qarkullimin në arteriet kryesore të qytetit
	Shtimi i hapësirave të gjelbra	Pylli Orbital (sipas fazës së parashikuar)	Hartimi i segmenteve që përvijojnë perimetrin e Pyllit Orbital dhe mbjellja e bimësisë	760 mijë fidanë dekorativ dhe frutore të mbjellë në 5 vjecarin e ardhshëm (150 mijë /vit)	*Kontroll i shtrirjes urbane *Përmirësim i cilësisë së ajrit *Përmirësimi i biodiversitetit
		Central Park	Hartmi dhe Zbatimi i Central Park në Bulevardin e Ri.	7 ha hapësirë e gjelbër.	
		Fasadat e gjelbra	Përzgjedhja e një kategorie ndërtesash (shkolla, institucione publike, apo ndërtesa një segmenti të caktuar rrugë etj)	6 fasada të gjelbëra	
		Urat e biodiversitetit	1. Ura që lidh korridoret e gjelbra të qytetit me Pyllin Orbital 2. Ura që lidh Pyllin Orbital me Parkun e Madh të Liqenit	Dy ura të biodiversitetit	
	Transport publik me eficientë të lartë mbi 5 Km	Zgjerim dhe përmirësim i rrjetit egzistues dhe infrastrukturës të TP	1. Shtimi i linjave rreth-qytetase 2. Përmirësimi i rrjetit të autobusave për të lidhur nyjet me densitet të lartë	1. Numri i linjave të shtuara 2. Numri i km korsi e dedikuar për transportin publik	* Mbulimi me TP i territorit të BT * Rritja e aksesueshmërisë dhe ndërvëprimit mes zonave urbane dhe rurale * Reduktimi i hendekut ekonomik-social
		Rinovim dhe shtim i flotës së TP	Autobuzat elektrik	1. Numri i autobusëve elektrikënë flotën e TP 2. % e numrit të pasagjerëve që përdorin TP	* Reduktimi i CO2 * Rritja e cilësisë së ajrit * Ulja ndotjes Akustike
		Sistemi i informacionit të pasagjerëve	1. Biletimi elektronik 2. Vendosije GPS 3. Aplikacioni BUS	1. Pajisja me biletim elektronik i flotës së TP 2. Gjurmim në kohë reale për çdo linjë 3. Numri i përdoruesve të Aplikacionit-Bus	* Transport cilësor dhe i shpejtë për qytetarët * Ulja e informalitetit * Informacion në kohë reale për qytetarët. * Përmirësimi i Monitorimit të TP
Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve	Rehabilitimin e blloqeve të banimit	Rikualifikimi i Infrastrukturës urbane në blloqet e banimit	250 blloqe banimi të rikualifikuara		
	Më shumë hapësira rekreative në qytet	Ndërtimi/rehabilitimi kënde lojrash	71 kënde lojrash të reja	* Më shumë sipërfaqe e gjelbër në blloqet e banimit * Infrastrukturë e përmirësuar e rrjeteve dhe rrugëve * Hapësirë publike e kthyer tek qytetarët * Më shumë hapësirë clodhëse, argëtuese, sportive * Rritje e bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe komunitetit	
	Nxitja e bashkëpunimit efektiv midis BT dhe komuniteti për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve në bashkpronësi.	Projekte në Bashkëfinancim me komunitetin.	60 projekte (fondi i komuniteteve)		
Sistem i përmirësuar i manaxhimit të mbetjeve në BT	Shtirje e shërbimit dhe konsolidimi i tij në territorin e BT-së	1. Ndërtimi i vendgrumbullimeve nëntokësore në pikat me impakt më të madh 2. Monitorimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve nëpërmjet aktivizimit të sensorëve fundor në konteineret publik 3. Identifikimi dhe plotësimin i hartës ekzistuese të vendgrumbullimeve me stacione vendgrumbullimi shtesë	* Numri i vendgrumbullimeve nëntokësore * Numri i kontienereve me sensor fundor * Numri i vendgrumbullimeve shtesë	* Rritja e cilësisë së shërbimit të manaxhimit të mbetjeve * Sigurim i informacionit nga konteinerët në lidhje me tejmbushjet, zjarret, spostimin e pa autorizuar të tyre si dhe grabitjet * Zbulje e mbingarkimit të konteinerëve si dhe organizim më i mire i shërbimit për grumbullimin e ndarë të mbetjeve	

TIRANA PËR TË GJITHË, QYTET I AKSESUESHËM DHE GJITHPËRFSHIRËS

Objektiva të përgjithshme	Objektivat Specifike	Programe	Projektet	Indikatorë të lidhur me monitorimin dhe raportin	Rezultatet
TIRANA PËR TË GJITHË, QYTET I AKSESUESHËM DHE GJITHPËRFSHIRËS	Furnizimi i qendrushëm i qytetit me ujë të pijshëm	Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm	Investime dhe rehabilitim/zgjerim i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm	Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë me 10.3% (nga 85% në 95.3%)	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruar nga shoqëria; • Ulja e humbjeve të ujit si dhe kostove për prodhimin e tij • Rritja e kohës së furnizimit të popullsisë me ujë • Përmirësimi i marrëdhënieve ekonomike me konsumatorët
		Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të ndotura	1. Zgjerim i kanaleve nëntokësore dalëse për eliminimin e ujrave të ndotura që derdhen në Lana 2. Nisja dhe vënia në funksionim të plotë të Impiantit më të madh të trajtimit të ujrave të ndotura	1. Rritja e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve me 5.4% (nga 78.1 në 83.5) në zonën e re të UKT 2. Impiant funksional	
		Uji pa të ardhura	* Krijimi i një sistemi që mat me saktësi prodhimin, transmetimin, depozitimin dhe furnizimin për cdo konsumator * Krijimi i një programi për identifikimin e lidhjeve të paligjshme, humbjet teknike etj	Reduktimi i ujit pa të ardhura për të gjithë zonën e UKT me 27.6% nga 67.6% në 40%)	
		Arketimet nga përdorimi i ujit të pijshëm	* Fushatë ndërgjegjësimi publik për politikën dhe rëndësinë e qendrushmërisë financiare që ka UKT * Zbatimi i marrëveshjeve për pagesat e prapambetura për familjarët	Rritja e nivelit të arkëtimit me 12.1% nga (79.9% në 92%)	
		Qendrushmëria Financiare e UKT-së	Projekte për rritjen e shitjeve të ujit, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes, rritje arkëtimesh, tarifave e reja etj	Arrija e qendrushmërisë financiare që UKT të mbulojë 100% detyrimet e saj	
		Monitorimi e shërbimit të UKT	Instalimi, zbatimi dhe monitorimi i sistemit SCADA	Arrija e shërbimit pa ndërprerje me presion të vazhdueshëm (24/7) në ish zonën e UKT	
	Rritja e cilësisë së shërbimit të varrezave publike	Varrezat publike dhe Murale Sharrë dhe Turfinë	1. Zgjerimi i hapësirës së varrezave publike në Sharrë dhe Turfinë 2. Vënia në funksionim/ndërtimi i varrezave murale	* Për 5 vitet e ardhshme zgjerimi i varrezave publike me 12.4 ha (sharra 3.6 ha dhe Tufina me 8.8ha) * Funksionimi i varrezave murale (lirimi i 1.3 ha)	<ul style="list-style-type: none"> * Zgjidhja e problematikes disa vjeçare lidhur me hapësirën e varrezave publike * Infrastruktura e përmirësuar

Objektivi Strategjik 5. Forcimi i Qeverisjes së Mirë dhe Respektimi i të Drejtave të Qytetarëve

Qeverisja e mirë përbën ndër kushtet thelbësore që duhet të plotësojë një shtet demokratik dhe sidomos aspirues për tu integruar në BE. Qeverisja e mirë fillon në nivel vendor dhe të njëjtat parime të qeverisjes së mirë, aplikohen edhe në nivel qendror. Këto parime janë shprehur qartë në Kartën Europiane të vetëqeverisjes vendore, të cilën Shqipëria është angazhuar ta zbatojë. Bazuar edhe tek parimi i subsidiariteti, përgjegjësitë publike duhet të ushtrohen nga autoritetet të cilat janë më pranë qytetarëve. Autoritetet e QV-ve janë në pozicionin më të mirë dhe më të informuar për të ndërmarrë veprime të suksesshme në nivel vendor dhe rajonal. Kjo nënkupton jo vetëm pushtet vendor por edhe përgjegjësi vendore.

BT ka përcaktuar si prioritet të sa forcimin e qeverisjes së mirë dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve. Për të realizuar këtë prioritet të rëndësishëm, SZHQBT ka evidentuar tre pika kryesore ku BT duhet të fokusohet gjatë pesë viteve të ardhshme dhe në vazhdim të cilat janë

Objektivi Specifik 1. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel vendor – ky objektivi specifik ka për qëllim funksionimin me eficiencë të lartë të sistemit të zhvillimit të kapaciteteve dhe burimeve njerëzore të administratës së BT-së në koordinim me planet dhe objektivat strategjike të institucionit me synimin e vetëm, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.

Objektivi Specifik 2. Sigurimi i një qeverisjeje transparente dhe rritja e llogaridhënies – Ky objektivi specifik ka për qëllim garantimin e një qeverisjeje të mirë të orientuar drejt qytetarëve. Vendimarrja vendore do të jetë gjithpëfshirëse dhe transparente dhe me pjesëmarrje të balancuar gjinore. Llogaridhënia në nivel vendor do të nxitet edhe nëpërmjet zbatimit të sistemeve të menaxhimit të performancës, që do të jenë instrumente objektive në transparencën dhe llogaridhënien e njësive të qeverisjes vendore.

Objektivi Specifik 3. Forcimi i financave vendore. - ky objektivi specifik ka për qëllim garantimin e një menaxhimi financiar të shëndoshë në BT. Praktikën më të mira të menaxhimit financiar në nivelin do të shoqërohen me rritjen e llogaridhënies dhe kontrollin financiar për të shmangur abuzimet dhe korrupsionin në nivel vendor.

FORCIMI I QEVERISJES SË MIRË DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

Objektiva të përgjithshme	Objektivat Specifike	Programe	Projektet	Indikatorë të lidhur me monitorimin dhe raportin	Rezultatet
FORCIMI I QEVERISJES SË MIRË DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE	Sigurimi i një qeverisjeje transparente dhe rritja e llogaridhënies	Përmirësimi i raportimit tek qytetarëve dhe përfshirja e qytetarëve në vendimarrjet e BT	1. Përmirësimi portalit Tirana ime (raporto) 2. Transparenca e Bashkisë Tiranë (e përvitshme) ku bazuar në anketimin e qytetarëve të matet perceptimi i tyre lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara si edhe një broshurë lidhur me mënyrën e administrimit të të ardhurave nga qeverisja vendore.	*Numri i qytetarëve që perdorin Tirana Ime * Bashkia publikon "Transparenca e Bashkisë Tiranë" çdo vit.	* Ngritja e një rrjeti të mirë komunikimi me qytetarët për projektet dhe punët e bashkisë * Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje * Informimi sa më i plotë i qytetarëve për punët e bashkisë * Politika më të mira vendore të cilat reflektojnë mendimin e qytetarëve
	Forcimi i financave vendore	Rritja e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave dhe kontrolli financiar	Kordinimi i kontrolleve në terren të bizneseve nga institucionet vendore (DPTTV, AMK, Policia Bashkiake etj) si edhe me ato qendrore (Drejtoria e përgjithshme e tatimeve AKU, etj)	* Rritja e % se mbledhjes se te ardhurave * % e mbulimit me kontroll te territorit	* Klimë miqsore me bizneset * Rriten të ardhurat dhe rrjedhimisht investimet e Bashkisë
		Reduktimi i shpenzimeve administrative të bashkisë	Studim mbi hapësirat ku Bashkia mund të reduktojë shpenzimet e saj operacionale	* Studimi i hartuar 100% * Reduktimi i shpenzimeve administrative me 20%	* Reduktohen shpenzimet e Bashkisë
Rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në BT	Ngritja e nje sistemi te pershtatshem (module) trajnimi per administraten e BT	1. Krijimi i një sistemi elektronik për vlerësimin e performancës dhe mbledhja në mënyre elektronike e nevojave për trajnim nga stafi, çdo gjatësi muaj; 2. Krijimi i një platforme e-learning dhe një e-library 3. Manaxhimi dixhital i projekteve strategjike dhe planeve te punes	1. Sistemi e-performance evaluation i krijuar 100%; 2. Platforma e-learning dhe e-library krijuar 100% 3. 48 drejtori perdorin per raportim programin	*Mbledhja në mënyrë sistematike dhe periodike e nevojave për trajnim sipas rekomandimeve nga zyrtarët raportues dhe kërkesave të stafit; *Ofrimi i shërbimit të trajnimit një numri më të madh punonjësish, me mënyra alternative (online) dhe me kosto të ulët * Rritja e efikasitetit të planifikimit dhe raportimit në BT, duke siguruar koordinim dhe monitorim në përbushjen e objektivave strategjike	

8. MONITORIMI DHE ZBATIMI I STRATEGJISË

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit kërkon përpjekje të përkushtuara, ekspertizë, aftësi, vlerësim dhe manaxhim të mirë. Ky proces konsiderohet si një nga më të rëndësishmit gjatë periudhës së zbatimit të një dokumenti strategjik, pasi shpesh devijimet nga përbushja e objektivave të SZHQBT 2018-2022. Me qëllim që të sigurohet monitorim dhe raportim cilësor dhe i dobishëm, sidomos për strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm, është e nevojshme që të përcaktohet sa më poshtë vijon:

- ❖ Procesi i qartë i raportimit dhe i monitorimit me përgjegjësitë dhe kalendarin;
- ❖ Modelet dhe instrumentet që do të përdoren për monitorimin
- ❖ Kapaciteti i strukturave kryesore dhe pjesëmarrëse.

Procesi i qartë i monitorimit dhe raportimit është i nevojshëm për të informuar pjesëmarrësit për përgjegjësitë e tyre dhe për t'u mundësuar atyre që të përgatiten për të gjitha angazhimet duke u bazuar në një kalendar të përcaktuar më parë.

Modelet dhe instrumentet janë të nevojshme për rrjetin e komunikimit mes strukturave dhe për të garantuar se paraqitja e informacionit është e pajtueshme dhe e lehtë për t'u konsoliduar. Udhëzimet se si të plotësohen modelet duhet të jenë të përgatitura në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Përveç modeleve për elementë si objektivat do të jenë të nevojshme edhe sqarimet, sidomos në rastet kur vërehen vonesa apo mangësi për të detajuar elementët që sjellin devijime serioze. Informacioni i prodhuar përmes sistemeve të monitorimit dhe të raportimit mund të përdoret brenda BT-së për të marrë vendime, dhe jashtë saj për të siguruar transparencë për publikun e gjerë.

Kapaciteti i strukturave për të prodhuar informacion cilësor dhe për të konsoliduar informacionin është shumë i rëndësishëm. Duhet përpjekje dhe aftësi për të prodhuar informacion raportimi të mirë të bazuar në analiza dhe të mbështetur nga prova. Praktika në sektorin publik tregon se shumë shpesh raportimi i informacionit fokusohet në veprimet e përditshme rutinore më shumë sesa në analizën e arritjeve. Kapaciteti mund të përmirësohet përmes udhëzimeve, trajnimit dhe praktikës.

Sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit i propozuar përbëhet nga dy nivele.

Niveli i parë lidhet me monitorimin e projekteve duke ndjekur me vëmendje arritjen e indikatorëve të përcaktuar. Ky proces do të realizohet nga strukturat përgjegjëse brenda dhe në varësi të BT-së. Raportet e monitorimit të këtyre strukturave do të dërgohen tek struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe jetësimin e prioriteteve në BT. Periodiciteti i monitorimit është vendosur bazuar në specifikat që ka çdo projekt.

Niveli i dytë lidhet me vlerësimin e përbushjes së objektivave dhe rezultateve të pritshme. Ky vlerësim do të realizohet çdo fund viti, ku nëpërmjet analizës së raporteve të monitorimit do të vlerësohet masa e përbushjes së objektivave, krahasimi I masës së arritjeve me masën e parashikuar, si edhe në raste të vecanta do të propozohen edhe ndryshime në projekte, kohëzgjatje, afate, fonde etj.

Monitorimi i SZHQBT është fazë shumë e rëndësishme dhe matësi më i mirë i suksesit në zbatueshmërinë e saj. Në do ta fillojmë nga procedurat administrative për të siguruar raporte mbi zbatimin e projekteve të ndryshme; pastaj gradualisht do të përmirësojmë cilësinë e informacionit të krijuar gjatë procesit dhe përfundimisht ky informacion do të përdoret në sistemin e vendimmarrjes. Përgjegjës për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e SZHQBT është Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimin të Prioriteteve (DPSJP) që do të monitorojë procesin e përbushjes

së objektivave dhe do të vlerësojë dhe raportojë lidhur me këtë proces. Bazuar në kalendarin e monitorimit të strategjisë çdo vit do të përgatiten vlerësimet dhe do të raportohet tek Kryetari lidhur me ecurinë e punës për përmbushjen e objektivave strategjike. Në varësi të ecurisë së punës mund të propozohen edhe rishikime të objektivave strategjik. Në varësi të specifikave që kanë monitorim/raportimi i projekteve do të kryehet në periudha 3 – 6 mujore. Raportet do ti dërgohen DPSJP sipas afateve të përcaktuara. Vëmendje të veçantë i është kushtuar indikatorëve si sinjalizues të ecurisë së punës.

Tabela Nr 33: Agjentët monitorues dhe indikatorët e raportimit

GARANTIMI I ZHVILLIMIT TË QENDRUESHEM TË EKONOMISË

OBJEKTIVA SPECIFIKE	PROJEKTE	TREGUESI I PERFORMANCËS	AUTORIT ETI PËRGJEGJËS	FREKUENCA E RAPORTIMIT	VLERA E OBJEKTIVIT 5-VJECAR	KOHË ZGJATJA
Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset	One Stop Shop për biznesin dhe qytetarin	- numri i qytetareve të paraqitur në sportelet e BT-së - numri i qytetarëve nga kontaktet online dhe korespondenca zyrtare - numri i ankesave nga aplikacioni mobile "Tirana Ime" - numri i afishimeve të publikuara në standat	DPTTV, DPMPJ	6 MUJORE	- x qytetarëve/bizneseve -x qytetarëve/bizneseve -100% e ankesave të qytetarëve/bizneseve -100% e afishimeve	2019
	Më shumë shërbime elektronike : E-Albania, e government	- numri i qytetareve dhe bizneseve që aksesojne online - Numri i ankesave dhe kërkesave të zgjidhura	DPTTV	6 MUJORE	- x qytetarëve/bizneseve -100% ndjekje/zgjidhje online e ankesave	2020
	Ndërlidhja e bazave të të dhënave kombëtare me ato vendore	- numri i lidhjeve me institucione qendrore dhe te pavarura on line	DPTTV	6 MUJORE	-X lidhje online me institucionet	
	Dixhitalizimi i proceseve dhe procedurave administrative të institucioneve	- Nr i dosjeve të digitalizuara ekzistuese/të reja - Nr i procedurave online	DPTTV	6 MUJORE	-100% digitalizimi i dosjeve -100% e procedurave online	2022
	Krijimi i regjistrit të fermerëve për 12 NJA (Baldushk e ka krijuar)	-Regjistër funksional i fermerëve të BT-së	DPPSZHE	VJETORE	- 1 regjistër funksional	2022
	Tirana HUB – Portali ekonomik	-Numri i vizitorëve të portalit	DPPSZHE	VJETORE	-x vizitorë	2018
	Azhornimi i kufijve të pronave në 13 NJA rurale dhe regjistrimi i AMTP-ve të tokave bujqësore	- Nr i pronave të azhornuara në 13NJA rurale - Numri i AMTPV të regjistruara	DPPSZHE	6 MUJORE	-x prona të azhornuara -X (AMTP)	2022
	Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit në BT	- Sipërfaqja e pajisur me sistem vaditje	DPN2	VJETORE	- x ha e vaditur	2022

	Hartëzimi dhe promovimi i aseteve të lira të BT, per tu perdorur nga bizneset kundrejt lehtësirave fiskale ose normave të ulta të qirasë.	- Broshurë informuese lidhur me vendodhjen e aseteve te lira të BT - Numri i bizneseve që përdorin asetet e BT per zhvillimin e aktiviteteve të tyre.	DPJAL DPPSZHE	VJETORE	-1 broshure e përvitshme - X biznese	2022
	Ngritja dhe funksionimi i një agregatori (pikë grumbullimi/tregëtimi) në territorin e BT	- Agregator funksional - Numri i fermerëve, tregtarëve dhe bizneseve të përfshirë në veprimtarinë e agregatorit	DPPSZHE	VJETORE	- 1 agregator - X fermerë - X tregtarë	2020
	Studim mbi vlerësimin e nevojës për tregje në territorin e BT	- Studim i përfunduar	DPPSZHE	VJETORE	-100%	2019
	Hapja dhe funksionimi i tregjeve ditore.	-Numri i tregje të reja publike -Numri i tregtarëveambulantë -Numri i tregjeve ditore -Numri i tregtarëve ambulantë në tregjet ditore	DPPSZHE	VJETORE	-3 tregje publike -200 tregtarë ambulantë -5 tregje ditore -50 tregtarë ambulantë në tregje ditore	2020
Mbështetja financiare dhe incentivat fiskale për bizneset	Skema financiare (grante) për mbështetjen e start up-ve për bizneset sociale (gratë, të rinjtë, etj)	- Numri i bizneseve të reja ose të mbështetura financiarisht -Numri i të vetë/punësuarve	DPPSZHE DPSHS	VJETORE	- 150-230 biznese të reja - 500 të vetë/punësuar	2022
	Studim dhe paketa informative lidhur me institucionet financiare që ofrojnë mbështetje financiare për bizneset e reja dhe ekzistuese	-Numri i paketave informative të përfunduara	DPPSZHE	9 MUJORE	-X paketa informuese	2022
	Krijimi i paketave fiskale favorizuese për fermerët	-Numri i taksave apo tarifave të reduktuara apo të përjashtuara nga paketa për fermerët -Numri i fermerëve përfitues	DPPSZHE	9 MUJORE	- X taksa/tarifa - X fermerë	2020
	Krijimi i paketave fiskale favorizuese për bizneset sociale/start up-e (përjashtime për kategori të vecanta)	-Numri i taksave dhe tarifave të reduktuara apo përjashtuara nga paketa për bizneset -Numri i bizneseve përfituese nga paketa	DPPSZHE	9 MUJORE	- X taksa/tarifa - X biznese	2020
Rritja e konkurrueshmërisë dhe	TEDA – Zona Teknologjike e Zhvillimit Ekonomik	-Shpallja e ZTZHE dhe e BT-së si zhvilluese e saj -Nr. investitorëve të huaj -Nr i IHD që do të operojnë në TEDA -Nr. i të punësuarve	DPPSZHE	VJETORE	- 100% - X investitorë vendas - X investitorë të huaj - X të punësuar	2022

thithja e investimeve të huaja	Evidentimi dhe krijimi i mirëfilltë i Klasterave	- Studim i përfunduar për clusterat aktuale dhe të mundshme në Tiranë - Numri i klasterave të reja - Numri i bizneseve të përfshira në to	DPPSZHE	VJETORE	-100% -4 klastera -X boznese të përfshira	2022
	Qendra e Artizanatit	- Numri i Qendrave të artizanatit - Numri i artizanëve në qendër	DPPSZHE DPPQ	VJETORE	- 1 qendër artizanati - 10-20 artizanë	2019
	Inkubatorët për biznesin	- Numri i inkubatorëve të krijuar në qytet - Numri i sipërmarrësve të trajnuar dhe mentoruar	DPPQ, DPPSZHE	VJETORE	- X inkubatorë - 100 sipërmarrës	2022
	TIK (Piramida)	- sipërfaqja e vënë në dispozicion (ha) - numri i të punësuarve - numri i të rinjve të përfshirë	DPPSZHE	VJETORE	- 10.000 m2 hapësirë për aktivitete kreative - 150 të punësuar - 2000 të rinj të angazhuar	2019
	Hapja dhe vendosja e sinjalistikës për të paktën 300 Km Shtigjesh për Hiking, Cycling, etc.	- numri i km shtigje	DPPQ DPN2	VJETORE	- 300 km shtigje të reja	2021
	Krijimi i hartave të mëdha turistike të stacionuara në hyrjet kryesore të cdo njësie për të orientuar Turistët në lidhje me zonën	Numri i hartave të mëdha turistike	DPZHT DPPQ	VJETORE	- 13 harta të mëdha turistike	2019
	BRANDING OF TIRANA	- numri i brandeve	DPPQ	VJETORE	- 1 Brand Tirana	2020
	Regjistri City Tax, krijimi i bazës së të dhënave vendore mbi njësitë akomoduese në territorin e BT-së	- numri i regjistrave	DPPQ DPTTV	6 MUJORE	- 1 regjistër 100% funksional	2019
	Rritja e rolit të BT-së si ndërmjetësuese midis biznesit dhe punëkërkuarit	-Numri i të ndërmjetësuarve	DPSHS	6 MUJORE	-500 të ndërmjetësuar	2022
	Projekte konkrete për rritjen e bashkëpunimit me universitetet për më shumë mundësi punësimi për studentët	- Numër universitetesh të përfshira në program - Numër studentësh të përfshirë në program	DPSHS	6 MUJORE	- X universitete - 500 studentë	2022
Trajnime, ngritje kapacitetesh sipas llojit të	- Numri i individëve/bizneseve	DPSHS	6 MUJORE	- 500 individë të trajnuar	2022	

	biznesit,		DPPSZHE			
	Hartimi i Platformës për zhvillimin e qendrueshëm të ekonomisë vendore 2019-2022	- Platformë e miratuar për zhvillimin ekonomik urban dhe rural	DPPSZHE	VJETORE	- 100%	2019
	Hartimi i 6 planeve për mbarështimin e pyjeve	- Numri i planeve	DPPSZHE	VJETORE	- 6 plane të miratuar	2020
	Promovimi i bizneseve Eko-Freindly dhe orientimi i bizneseve aktuale që duan të kthehen në biznese green	Numri i bizneseve	DPPSZHE	9 MUJORE	- x biznese të trajnuar dhe promovuar	2022
	Markimi i produkteve bujqësore – Identifikimi i produkteve tipike	Nr. Bizneseve që përdorin teknologji të pastra mjedisore (që parandalojnë ndotjen)	DPPSZHE	VJETORE	- X biznese	2020

ARSIMI PËR TË GJITHË

OBJEKTIVA PECIFIKE	PROJEKTE	TREGUESI I PERFORMANCËS	AUTORITET I PËRGJEGJËS	FREKUENCA E RAPORTIMI	VLERA E OBJEKTIVIT 5-VJECAR	KOHË ZGJATJA
Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor	Projektimi dhe ndërtimi i 17 shkollave dhe 10 kopshteve të reja (me PPP)	- Numri i shkollave të reja 9-vjecare - Numri i shkollave të mesme të reja,	DPZHT DPPP	6 MUJORE	-10 shkolla -7 shkolla të mesme	2021
	Ndërtimi i 4 kopshteve të reja (përveç atyre me PPP) si dhe 8 çerdheve të reja brenda vitit 2022	- Numri i kopshteve të reja (përveç atyre me PPP) - Numri i çerdheve të reja.	DPZHT DPPP	6 MUJORE	- 4 kopshteve të reja (përveç atyre me PPP) - 1.6 çerdhe në vit deri në vitin 2022.	2021
	Rehabilitim i plotë / i pjesshëm i 43 shkollave	Numri i shkollave të rehabilituara	DPN3 DPPP	6 MUJORE	- 43 shkolla të rehabilituara	2021
	Rehabilitimi i 11 kopshteve (4 rurale)	Numri i kopshteve të rikonstruara	DPN3 DPPP	6 MUJORE	- 11 kopshte të rikonstruara	2021
	Studim dhe zbatim i masave kundër zjarrit në shkollat publike	Numri i shkollave me masa kundër zjarrit	DPN3 EC MZSH	6 MUJORE	-100% vendosja e masave	2021
	Vendosja e Kamerave të sigurisë në çdo shkollë të Tiranës.	Numri i shkollave të pajisuar me kamera	DPN3	6 MUJORE	-100% e shkollave me kamera	2021
Rritja e aksesit dhe gjithpërfshirjes në arsimin parauniversitar	Ngritja e faciliteteve për PAK në të gjitha shkollat e NJA-ve 4, 5 dhe 6 (të cilat kanë dhe nr më të lartë të femijëve PAK)	Numri i shkollave me strukturën PAK në NJA 4-5-6	DPPP DPNr3	VJETORE	- 22 shkolla eksistuese	2022
	Studim mbi nevojat specifike për infrastrukturë të PAK në shkollat e NJA-ve të tjera të Tiranës	Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për këtë strukturë PAK	DPPP DPN3	VJETORE	- 100% studim i hartuar	2022

	Studim për rritjen e aksesit në infrastrukturën arsimore në zonat rurale	Përfundimi i studimit dhe përgatitja e kalendarit të ndërhyrjeve	DPSHS DPN3	VJETORE	- 100% studim i hartuar	2022
	Pilotimi i programit në të paktën 10 shkolla të Tiranës (5 në qendër dhe 5 në polet e reja të zhvillimit)	- Numri i shkollave të hapura si qendra komunitare - Numri të punësuarve	DPSHS DPN3	VJETORE	-10 shkolla të para të hapura si qendra komunitare -100 individë të punësuar brenda 2018-2019	2022
	Përfshirja në këtë program e 50 shkollave të tjera parauniversitare të Tiranës	- Numri i shkollave si qendra komunitare - Numri i të punësuarve	DPSHS DPN3	VJETORE	- 50 shkolla - 500 individë të punësuar	2022
	Pilotimi i programit në një zonë rurale -më konkretisht në Shëngjergj	- Numri i shkollave si qendra komunitare	DPSHS DPN3	VJETORE	- 3 shkolla si qendra komunitare në Shëngjergj	2022
Përmirësimi i kushteve të rezidencave studentore universitare	Rehabilitimi i infrastrukturës së konvikteve (sisteme furnizimi uje, energji, ngrohje kanalizim, ujesjelles, hidroizolim etj)	- Numri i rezidencave studentore	DPPP DPNr3	VJETORE	- Te gjitha godinat e rehabilituara	2022
	Dixhitalizimi i arkivës dhe krijimi i një sistemi elektronik të akomodimit dhe regjistrimit të studentëve	- Sistem elektronik	DPPP DPNr3	VJETORE	- sistem funksional - arkive dixhitale	2019
	Krijimi i bibliotekave studentore, krijimi dhe mobilimi i hapësirave kreative	- numri i bibliotekave - numri i hapësirave kreative	DPPP DPNr3	VJETORE	- biblioteka funksionale - hapësira kreative	2022

TIRANA PËR TË GJITHË, QYTET I AKSESUESHËM DHE GJITHPËRFSHIRËS

OBJEKTIVA PECIFIKE	PROJEKTE	TREGUESI I PERFORMANCËS	AUTORITETI PËRGJEGJËS	FREKUENCA E RAPORTIMI	VLERA E OBJEKTIVIT 5-VJECAR	KOHË ZGJATJA
NXITJA E CIKLIZMIT PËR UDHËTIME NË 5 KM (MINIMUM GRID)	Rruga e Durrësit (Reduktimi në 3 korsi për makina dhe shfrytëzimi i kësaj hapësire për dy korsi të dedikuara biçikletash)	- km korsi e dedikuar për biçikleta	DPPP	6 MUJORE	25 km korsi	2019
	Korsi të dedikuara në Rrugën Dibrës		DPPP	VJETORE		2018
	Rehabilitim dhe rimobilim i trotuareve përgjatë Lana River duke krijuar hapësirën e nevojshme për korsi biçikletash me dy kahe		DPPP	VJETORE		2018
	Korsi të dedikuara përgjatë Bulevardit të Ri		DPPP	6 MUJORE		2022
	Korsi të dedikuara në Unazën e 3-të		DPPP	6 MUJORE		2020

	Korsi e dedikuar (në kah të kundërt) në Rr. Myslym Shyri		DPPP	6 MUJORE		2020
	Rritja e cilësisë dhe sinjalistikës të korsisë së biçikletave në Rr. e Kavajës		DPPP	6 MUJORE		2019
	Shtimi i vend-parkimeve për biçikleta	Numri i vendparkime të reja për biçikleta	DPPP DPN2	6 MUJORE	-200 vendparkime të për biçikleta	2022
	Shtimi i pikave Rent- për biçikleta	Numri i pikave Rent të reja- për biçikleta	DPPP	6 MUJORE	-30 pika Rent të reja për biçikleta	2022
	Promovimi i përdorimit të biçikletave	Fushata sensibilizuese	DPPQ DPPJ	VJETORE	-100% realizimi I fushatës sensibilizuese	2022
	Mobike	Numri i përdoruesve	DPPSZHE	VJETORE	- 4000 përdorues	2020
Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës (ZBQ)	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të parkimit publik me pagesë në rrugë, sheshe, mbi dhe nën tokë.	- numri i përdoruesve të parkimit publik me pagesë	ATP DPN2	6 MUJORE	- X përdorues	2022
	Diversifikimi i mënyrave të pageses së parkimit në sheshe	- Numri i përdoruesve që përdorin metodat e reja digitale	ATP	VJETORE	- X përdorues	2022
	Rritja e hapësirave publike për administrim parkimi me pagesë,	Numri i vendparkimeve të shtuara	ATP	6 MUJORE	-2600 vende parkimi të reja	2022
	Ndërtimi i shesheve të reja mbi tokë	Numri i shesheve të parkimit	ATP	6 MUJORE	- rreth 35.000 m2 të dedikuar për parkim	2022
	Përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të dedikuara “Vetëm për rezident”, duke i pajisur me sinjalistikën e plotë horizontale	-numri i vendparkimeve të pajisura me sinjalistikë	ATP	6 MUJORE	- 100% pjesja me sinjalistikën e duhur	2022
SHTIMI I HAPËSIRAVE TË GJELBRA	Pylli Orbital (sipas fazës së parashikuar)	- numri i fidanëve të mbjellë	APR	6 MUJORE	- 760,000 fidanë	2022
	Zhvillimi i Central Park në Bulevardin e Ri	- park funksional	APR	6 MUJORE	- 7 ha hapësirë e gjelbër.	2021
	Fasadat e gjelbra	-numri i institucioneve me fasada të	APR	VJETORE	- 6 fasada të gjelbëra	2022

		gjelbra				
	Urat e biodiversitetit	Numri i urave të biodiversitetit	APR DPPP	VJETORE	- 2 ura	2019
TRANSPORT PUBLIK ME EFICIENCË TË LARTË MBI 5 KM	Shtimi i linjave rreth-qytetase	Numri i linjave të shtuara`	DPPP	VJETORE	- X linja	2020
	Përmirësimi i rrjetit të autobusave për të lidhur nyjet me densitet të lartë	Numri i km korsi e dedikuar për transportin publik	DPPP	VJETORE	- X km korsi	2022
	Autobuzat elektrik	- Numri i autobusëve elektrikë në flotën e TP - % e numrit të pasagjerëve që përdorin TP	DPPP	VJETORE	- X autobusë - X %	2020
	Biletimi elektronik	- numri i autobuseve me biletim elektronik	DPPP	VJETORE	- X autobusë	2020
	Vendosje GPS	-numri i autobusëve me GPS	DPPP	VJETORE	- autobusë me gps	2021
	Aplikacioni BUS	-Numri i përdoruesve të Aplikacionit-Bus	DPPP	6 MUJORE	- X	2021
PËRMIRËSIMI I JETËS SË QYTETARËVE	Rikualifikimi i Infrastrukturës urbane në blloqet e banimit	- Numri i blloqeve të banimi të rikualifikuara	DPPP	6 MUJORE	-250 blloqe	2022
	Ndërtimi/rehabilitimi kënde lojrash	- Numri i këndeve të lojrave të reja	APR DPPP	6 MUJORE	-71 kënde	2022
	Projekte në Bashkëfinancim me komunitetin.	- numri i projekteve	DPOBA&EC	6 MUJORE	- 50 projekte	2022
SISTEM I PËRMIRËSUAR I MANAXHIMIT TË MBETJEVE NË BT	Ndërtimi i vendgrumbullimeve nëntoksore në pikat me impakt më të madh	Numri i vendgrumbullimeve nëntokësore	DPPP Eco Tirana	6 MUJORE	- X	2022
	Monitorimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve nëpërmjet aktivizimit të sensorëve fundor në konteineret publik	Numri i kontieniereve me sensor fundor	DPPP	6 MUJORE	- X	2022

			Eco Tirana			
	Identifikimi dhe plotësimin i hartës ekzistuese të vendgrumbullimeve me stacione vendgrumbullimi shtesë	Numri i vendgrumbullimeve shtesë	DPPP Eco Tirana	VJETORE	- X	2022
FURNIZIMI I QËNDRUESHË M ME UJË TË PIJSHËM	Investime dhe rehabilitim/zgjerim i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm	- % e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë	UKT	6 MUJORE	- 95.3%	2022
	Zgjerim i kanaleve nëntokësore dalëse për eliminimin e ujrave të ndotura që derdhen në Lana	- % e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve në zonën e re të UKT	UKT	6 MUJORE	- 83.5%	2022
	Nisja dhe vënia në funksionim të plotë të Impiantit më të madh të trajtimit të ujrave të ndotura	- Impiant funksional	UKT	6 MUJORE	- 100%	2022
	Krijimi i një sistemi që mat me saktësi prodhimin, transmetimin, depozitimin dhe furnizimin për cdo konsumator	- % e ujit pa të ardhura për të gjithë zonën e UKT	UKT	6 MUJORE	- 40%	2022
	Krijimi i një programi për identifikimin e lidhjeve të paligjshme, humbjet teknike etj		UKT	6 MUJORE		2022
	Fushatë ndërgjegjësimi publik për politikën dhe rëndësinë e qendrueshmërisë financiare që ka UKT	- % e nivelit të arkëtimeve me 12.1% nga (79.9% në 92%)	UKT	6 MUJORE	- 92%	2022
	Zbatimi i marrëveshjeve për pagesat e prapambetura për familjarët		UKT	6 MUJORE		2022
	Projekte për rritjen e shitjeve të ujit, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes, rritje arkëtimeve, tarifave e reja etj	- % e mbulimit të detyrimeve nga UKT	UKT	6 MUJORE	- 100%	2022
	Instalimi, zbatimi dhe monitorimi i sistemit SCADA	- Shërbim pa ndërprerje me presion të vazhdueshëm (24/7) në ish zonën e UKT	UKT	6 MUJORE	- 100%	2022
RRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMIT TË VARREZAVE PUBLIKE	Zgjerimi i hapësirës së varrezave publike në Sharrë dhe Tufinë	- Sipërfaqja e parcelave të varrezave (ha)	ASHF	6 MUJORE	- 12.4 ha më shumë	2022
	Vënia në funksionim/ndërtimi i varrezave murale	-Funksionimi i varrezave murale (lirimi i 1.3 ha)	ASHF	VJETORE	- 100%	201

**RIVITALIZIM URBAN QË HARMONIZON INFRASTRUKTURËN, SHËRBIMET PUBLIKE DHE NXIT ZHVILLIMIN
EKONOMIK**

OBJEKTIVA PECIALIFIKE	PROJEKTE	TREGUESI I PERFORMANCËS	AUTORITETI PËRGJEGJËS	FREKUENCA E RAPORTIMI	VLERA E OBJEKTIVIT 5-VJECAR	KOHË ZGJATJA
Poli Kombinat (Qendër Urbane me karakter kreativ, aristik dhe mjeshtëror)	Hartimi i një Plani të Detajuar Vendor	Plan i Detajuar vendor i hartuar	DPPZHT	VJETORE	- 100%	2019
	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore të zonës	- numri i km rrugë - numri i shesheve	DPPZHT DPZHE DPPQ	6 MUJORE	-x km rrugë - x sheshe	2019
	Rivitalizim i sheshit Garibaldi dhe godinave përreth sheshit	Numri i godinave	DPPZHT	VJETORE	- 4 godina	2020
	Mbulimi me shërbime publike i polit	- numri i këndeve të lojrave - numri i shkollave, kopshteve dhe cerdheve	DPPZHT DPPP	VJETORE	- 12 kënde lojrash - 5 shkolla, 1 kopshti dhe 1 cerdhe	2022
	Krijimi i një Creative Hub/platformë, hapësirë e dedikuar mjeshtërive	- Galeri për ekspozimin e punimeve artistike dhe artizanale -Hapësirë e dedikuar për projekte kulturore sociale	DPPP	VJETORE	- 1 galeri - 1 hapësirë e dedikuar për projekte kulturne	2021
	BID Kombinat, një partneritet publik privat për një mjedis fizik të përmirësuar dhe më shumë mundësi biznesi- modeli i Pazarit i Ri	- Marrëveshje me biznese partnere në BID - Agjenci për mirëmbajtjen e BID	DPPSZHE	6 MUJORE	- 20 biznese - 1 agjensi	2022
Polit Kinostudio (Qendër Urbane me karakter artistik dhe kinamto grafik)	Hartimi i një Plani të Detajuar Vendor	-Plan i Detajuar Vendor i hartuar	DPPZHT	VJETORE	- 100%	2020
	Rivitalizim i sheshit ekzistues	-Shesh i rikualifikuar me hapësira për të gjitha moshat	DPPP	6 MUJORE	- 100%	2019
	Mbulimi me shërbime publike i polit	- Numri i shkollave - Numri i këndeve të lojrave për fëmijë	DPPP DPPSZHE	VJETORE	- 2 shkolla - 5 kënde lojrash	2022

	Krijimi i KinoPark, një qendre me hapësira të dedikuara sipas moshave për zhvillimin e aktiviteteve kinematografike dhe ekspozimin e veprave artistike	- Një hapësirë e dedikuar për fëmijët dhe aktivitetet kinematografike - Një kinema/teatër - Një ekspozitë e historisë së Kinematografisë Shqiptare	DPPSZHE DPPZHT DPPP	VJETORE	- 100% - 100% - 100%	2022
	TID Kinostudio	- Biznese përfituese nga skemat e mbështetjes	DPPSZHE	6 MUJORE	- 20 biznese	2022
Poli Bulevardi I Ri promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm	Përmirësimi I Infrastrukturës së zonës së re për zhvillim	- Numri i blloqeve të banimit - Numri i njësive strukturore - numri i profileve rrugore - sipërfaqja (ha) e hapësirës publike - numri i m2/person i hapësirës së gjelbër	DPPP DPPSZHE	VJETORE	- 76.8 ha blloqe urbane - 45 njësi strukturore - 8 profile rrugore me gjërësi të ndryshme - 400.000 m2 hapësira publike - 8m2/person hapësira e gjelbër	2022
	Transport Publik efikas dhe lidhja Veri-Jug me linja transporti publik të gjelbër	-numri i linjave të TP	DPP	6 MUJORE	- X linja	2021
	Krijimi i hapësirave publike të përshatshme për intensitetin e zhvillimit që pritet të ketë zona	- Intesiteti i ndërtimit - Sipërfaqe totale e ndërtimit (m2)	DPPZHT DPPSZHE	VJETORE	- 2.9 km - 558.500 m2	2021
	- Rivitalizimi i shinave të trenit si korridor i lëvizjes së gjelbër që lidh Bulevardin verior me Laprakën. - Rivitalizimi i Lumit të Tiranës	- numri i km të korridorit - River Park (ha) - River lido (m2)	DPPP DPPP	6 MUJORE VJETORE	- x km - 24.8 ha - 23.750 m2	2022 2021
	Dizajni urban i shesheve dhe ndërtimi i tyre	- Numri i shesheve publike	DPPP	VJETORE	- 4 sheshe publike	2021
	Dizajni dhe zbatimi i hapësirave të gjelbra	- Numri i parqeve liqenore	APR	6 MUJORE	- 2 parqe liqenore	2022

	Mbulimi me shërbime publike i polit	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i shkollave, kopshteve të rikonstruktuar - Numri i shkollave të reja - Numri i këndeve të lojrave 	DPPP	VJETORE	<ul style="list-style-type: none"> - 1 kopshësht dhe 5 shkolla - 2 shkolla të reja - 6 kënde lojrash 	2022
	Ndërtim objektsh publike	<ul style="list-style-type: none"> - Godina e Bashkisë Tiranë - Bibloteka, galeri artesh, Opera, qendra kulturore - Ngritja e një development trust nga ana e Bashkisë Tiranë që të fokusohet në zbatimin e masterplanit 	DPPP DPPSZHE	VJETORE	<ul style="list-style-type: none"> - 100% - X - 100% 	2022
Poli Laprakë (Qendër Urbane me karakter sportiv, edukativ dhe rekreativ.)	Hartimi i një Plani të Detajuar Vendor	- Plan i Detajuar Vendor i hartuar	DPPP	9 MUJORE	- 100%	2020
	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore	<ul style="list-style-type: none"> - Zgjerim dhe rikonstruktison i rrjetit rrugor - Pedonale dhe sheshe të rikualifikuar 	DPPP	VJETORE	<ul style="list-style-type: none"> - 100% - 100% 	2021
	Realizimi i një shiriti të kompensimit të gjelbër përgjatë hekurudhës (rrjet i ciklizmit	- Pista e ciklizmit	DPPP DPN2	6 MUJORE	- 100%	2019
	Mbulimi me shërbime publike	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i shkollave të rikonstruktura - Numri i shkollave të reja - Ndërtimi i këndeve të lojrave 	DPPP	VJETORE	<ul style="list-style-type: none"> - 4 shkolla - 3 shkollave - 6 kënde lojrash 	2022
	Krijimi i disa qendrave rekreativo-sportive, për aktivitete sportive.	- Park sportiv	APR	6 MUJORE	- 100%	2020
	Incentivimi/mbështetja e bizneseve me karakter edukativ sportiv	- Biznese të incetivuar	DPPSZHE	6 MUJORE	- 20 biznese	2022

Poli Farkë-Qyteti Studenti (Qendër Urbane me karakter rekreativnatyror dhe turistik)	Hartimi i një Plani të Detajuar Vendor	-Plan i Detajuar Vendor i hartuar	DPPZHT	VJETORE	- 100%	2020
	Infrastruktura në kufirin jugor të zonës (autostrada e re) dhe lidhja me Qytetin Studenti	- Ndërtimi i sistemeve të rrugëve - Pista e ciklizmit	DPPP	VJETORE	- 100% - 100%	2020
	Krijimi i disa zonave të gjelbra publike për jetën kolektive, parku rekreativ i Farkës i lidhur me anë të trotuareve dhe korsive të bicikletave.	- Një park piknik	APR	VJETORE	- 100%	2019
	Ndërtimi i komplekseve sportive të hapura (fusha futbollit, basket, voley).	- Numri i komplekseve sportive	APR	VJETORE	-1 kompleks sportiv	2020
	Krijimi i një zone për lojrat ujore	- Një hapësirë e dedikuar për mbledhjen e varkave, lojrave të ndryshme ujore, paragliding, motorra uji, etj	APR	VJETORE	- 100%	2019
	Krijimi i një biblioteke në natyrë	- Një bibliotekë 2 -katëshe me xhama në natyrë	APR	9 MUJORE	- 100%	2021
	Mbulimi me shërbime publike i polit	- Numri i kopshteve dhe shkollave të rikonstruara - Numri i shkollave të reja - Numri i këndeve të lojrave - Numri i bizneseve të mbështetura	DPPP DPPSZHE	VJETORE	- 2 kopshte dhe 3 shkolla - 3 shkollave të reja - 4 kënde lojrash - 20 biznese	2022

FORCIMI I QEVERISJES SË MIRË DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

OBJEKTIVA PECIFIKE	PROJEKTE	TREGUESI I PERFORMANCËS	AUTORITETI PËRGJEGJËS	FREKUENCA E RAPORTIMI	VLERA E OBJEKTIVIT 5-VJECAR	KOHË ZGJATJA
Përmirësimi i raportimit tek qytetarëve dhe përfshirja e qytetarëve në vendimarrjet e BT	Përmirësimi portalit Tirana ime (raporto)	- Numri i qytetarëve qe perdorin Tirana Ime	DPKMPJ	6 MUJORE	- x përdorues	2019
	Transparenca e Bashkisë Tiranë (e përvitshme)	- Publikime "Transparenca e Bashkisë Tiranë" cdo vit.	DPPZHT	VJETORE	- 5 publikime	2022
Rritja e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave dhe kontrolli financiar	Kordinimi i kontroleve në terren të bizneseve nga insttucionet vendore me ato qendrore	- % se mbledhjes se te ardhurave	DPTTV	VJETORE	-20%	2022
Reduktimi i shpenzimeve administrative të bashkisë	Studim mbi hapësirat ku Bashkia mund të reduktojë shpenzimet e saj operationale	- Studimi i hartuar - % e reduktimit të shpenzimeve administrative	DPMF	VJETORE	- 100% - 20%	2020
Ngritja e nje sistemi te pershtatshem (module) trajnimi per administraten e BT	Krijimi i një sistemi elektronik për vlerësimin e performancës dhe mbledhja në mënyre elektronike e nevojave për trajnim nga stafi, çdo gjashtë muaj;	- Sistemi e-performance evaluation i krijuar	DPPSBNJ	6 MUJORE	- 100%	2019
	Krijimi i një platforme e-learning dhe një e-library	- Platforma e-learning dhe e-library krijuar	DPPSBNJ	6 MUJORE	- 100%	2020
	Manaxhimi dixhital i projekteve strategjike dhe planeve te punes	- numri i përdoruesve	DPPSBNJ	6 MUJORE	- 48 drejtori	2022

Tabela Nr 34: Plani i Veprimit i SZHQBT 2018 -2022

OBJEKTIVAT/PROJEKTE	2018	2019	2020	2021	2022
IRANA POLICENTRIKE, RIVITALIZIM URBAN QË HARMONIZON INFRASTRUKTURËN, SHËRBIMET PUBLIKE DHE NXIT ZHVILLIMIN EKONOMIK					
Poli Kombinat; Qendër urbane me karakter kreativ, aristik dhe mjeshtëror					
Hartimi i një plani të detajuar vendor					
Përmirësimi i infrastrukturës rrugore të zonës					
Rivitalizim i sheshit Garibaldi dhe godinave përreth sheshit					
Mbulimi me shërbime publike I polit					
Krijimi i Creative Hub, një hapësirë e dedikuar mjeshtërive					
BiD Kombinat, një partneritet publik privat për një mjedis fizik të përmirësuar dhe më shumë mundësi biznesi					
Poli Kinostudio; Qendër urbane me karakter artistik dhe kinamtoçrafik					
Hartimi i një plani të detajuar vendor					
Rivitalizimi i sheshit ekzistues					
Mbulimi me shërbime publike I polit					
Krijimi i KinoPark, një qendër me hapësira të dedikuara sipas moshave për zhvillimin e aktiviteteve kinematografike dhe ekspozimin e veprave artistike					
TID Kinostudio					
Poli Bulevardit Verior të Tiranës, Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm					
Përmirësimi i infrastrukturës së zonës së re për zhvillim					
Transport Publik efikas dhe lidhja Veri-Jug me linja transporti publik të gjelbër					
Krijimi i hapësirave publike të përshtatshme për intensitetin e zhvillimit që pritet të ketë zona					
Rivitalizimi i shinave të trenit si korridor i lëvizjes së gjelbër që lidh Bulevardin Verior me Laprakën					
Rivitalizimi i lumit të Tiranës					
Dizajni urban i shesheve dhe ndërtimi i tyre					
Dizajni dhe krijimi i hapësirave të gjelbra					
Mbulimi me shërbime publike i polit					
Ndërtim objektesh publike					
Poli Laprakë; Qendër urbane me karakter sportiv, edukativ dhe rekreativ					
Hartimi i Planit të detajuar vendor					
Përmirësimi i infrastrukturës rrugore					
Realizimi i një shiriti të kompensimit të gjelbër përgjatë hekurudhës (rrjeti i çiklizmit)					
Mbulimi me shërbime publike					
Krijimi i disa qendrave rekreativo-sportive, për aktivitete sportive					
Incentivimi/mbështetja e bizneseve me karakter edukativ sportiv					
Poli Farkë - Qyteti Studenti; Qendër urbane me karakter rekreativ natyror dhe turistik					
Hartimi i një plani të detajuar vendor					
Infrastruktura në kufirin jugor të zonës (autostrada e re) dhe lidhja me Qytetin Studenti					
Krijimi i disa zonave të gjelbra publike për jetën kolektive, parku rekreativ i Farkës i lidhur me anë të trotuareve dhe korsive të biçikletave.					
Ndërtimi i një kompleksi sportiv të hapur (fusha futbollit, basket, voley).					
Krijimi i një zone për lojrat ujore					
Krijimi i një biblioteke në natyrë					
Mbulimi me shërbime publike I polit					

2. TIRANA PËR TË GJITHË, QYTET I AKSESUESHËM DHE GJITHPËRFSHIRËS

Nxitja e çiklizmit për udhëtime nën 5 km (MINIMUM GRID)					
1. Rruga e Durrësit (reduktimi në 3 korsi për makina dhe shfrytëzimi i kësaj hapësire për dy korsi të dedikuara biçikletash)					
2. Korsi të dedikuara në Rrugën Dibrës					
3. Rehabilitim dhe rimobilim i trotuareve përgjatë Lumit Lana duke krijuar hapësirën e nevojshme për korsi biçikletash me dy kahe					
4. Korsi të dedikuara përgjatë Bulevardit të Ri					
5. Korsi të dedikuara në Unazën e 3-të					
6. Korsi e dedikuar (në kah të kundërt) në Rr. Myslym Shyri					
7. Rritja e cilësisë dhe sinjalistikës të korsisë së biçikletave në Rr. e Kavajës					
8. Shtimi i vend-parkimeve për biçikleta					
9. Shtimi i pikave Rent - për biçikleta					
10. Promovimi i përdorimit të biçikletave					
11. Mobike					
Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës (ZBQ)					
1. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të parkimit publik me pagesë në rrugë, sheshe, mbi dhe nëntokë.					
2. Diversifikimi i mënyrave të pageses së parkimit në sheshe					
3. Rritja e hapësirave publike për administrim parkimi me pagesë,					
4. Ndërtimi i shesheve të reja mbi tokë					
5. Përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të dedikuara “Vetëm për rezident”					
Shtimi i hapësirave të gjelbra					
Pylli Orbital (sipas fazës së parashikuar)					
Central Park					
Fasadat e gjelbra					
Urat e biodiversitetit (2)					
Transport publik me eficiencë të lartë mbi 5 km					
1. Shtimi i linjave qytetëse dhe rreth-qytetase					
2. Përmirësimi i rrjetit të autobusave për të lidhur nyjet me densitet të lartë					
3. Autobuzat elektrikë					
4. Biletimi elektronik					
5. Vendosje GPS					
6. Aplikacioni BUS					
Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve					
1. Rehabilitimin i infrastrukturës së blloqeve të banimit					
2. Ndërtim dhe rehabilitim i këndeve të lojrave					
3. Fondi i komuniteteve					
Sistem i përmirësuar i manaxhimit të mbetjeve në BT					
1. Ndërtimi i vendgrumbullimeve nëntoksore në pikat me impakt më të madh					
2. Monitorimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve nëpërmjet aktivizimit të sensorëve fundor në konteineret publik					
3. Identifikimi dhe plotësimin i hartës ekzistuese të vendgrumbullimeve me stacione vendgrumbullimi shtesë					
Furnizimi i qendrueshëm i qytetit me ujë të pijshëm					
1. Investime dhe rehabilitim/zgjerim i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm					
2. Zgjerim i kanaleve nëntokësore dalëse për eliminimin e ujrave të ndotura që derdhen në Lana					
3. Nisja dhe vënia në funksionim të plotë të Impiantit më të madh të trajtimit të ujrave të ndotura					
4. Fushatë ndërgjegjësimi publik për politikën dhe rëndësinë e qendrueshmërisë financiare që ka UKT					
5. Zbatimi i marrëveshjeve për pagesat e prapambetura për familjarët					
6. Instalimi, zbatimi dhe monitorimi i sistemit SCADA					
7. Projekte për rritjen e shitjeve të ujit, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes, rritje arkëtimesh, tarifave e reja etj					
Rritja e cilësisë së shërbimit të varrezave publike					
1. Zgjerimi i hapësirës së varrezave publike në Sharrë dhe Tufinë					
2. Vënia në funksionim/ndërtimi i varrezave murale					

3. ARSIMI PER TË GJITHË

Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor					
Infrastrukturë e re sipas standarteve					
Infrastrukturë ekzistuese e përmirësuar					
Rritja e aksesit dhe gjithpërfshirjes në Arsimin Parauniversitar					
Rritja e aksesueshmërisë për grupet e pafavorizuara					
Shkollat si qendra komunitare					
Përmirësimi i kushteve të rezidencave studentore universitare					
Rehabilitimi i infrastrukturës së konvikteve (sisteme furnizimi uje, energji, ngrohje kanalizim, ujesjelles, hidroizolim etj)					
Dixhitalizimi i arkivës dhe krijimi i një sistemi elektronik të akomodimit dhe regjistrimit të studentëve					
Krijimi i bibliotekave studentore, krijimi dhe mobilimi i hapësirave kreative					

5. GARANTIMI I ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM TË EKONOMISË

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset				
1. One Stop Shop për biznesin dhe qytetarin				
2. Më shumë shërbime elektronike : E-Albania, e government				
3. Ndërlidhja e bazave të të dhënave kombëtare me ato vendore				
4. Dixhitalizimi i proceseve dhe procedurave administrative të institucioneve				
5. Krijimi i regjistrit të fermerëve për 12 NJA (Baldushk e ka krijuar)				
6. Tirana HUB – Portali ekonomik				
7. Azhurnimi i kufijve të pronave në 13 NJA rurale dhe regjistrimi i AMTP-ve të tokave bujqësore				
8. Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit në BT				
9. Hartëzimi dhe promovimi i aseteve të lira të BT, për tu përdorur nga bizneset kundrejt lehtësirave fiskale ose normave të ulta të qirasë.				
10. Ngritja dhe funksionimi i një agregatori (pikë grumbullimi/tregëtimi) në territorin e BT				
11. Studim mbi vlerësimin e nevojës për tregje në territorin e BT				
12. Hapja dhe funksionimi i tregjeve ditore.				
Mbështetja financiare dhe incentivat fiskale për bizneset				
1. Skema financiare (grante) për mbështetjen e start up-ve për bizneset sociale (gratë, të rinjtë, etj)				
2. Studim dhe paketa informative lidhur me institucionet financiare që ofrojnë mbështetje financiare për bizneset e reja dhe ekzistuese				
3. Krijimi i paketave fiskale favorizuese për fermerët				
4. Krijimi i paketave fiskale favorizuese për bizneset sociale/start up-e				
Rritja e konkurrueshmërisë dhe thithja e investimeve të huaja				
1. TEDA – Zona Teknologjike e Zhvillimit Ekonomik				
2. Evidentimi dhe krijimi i mirëfilltë i klasterave të mundshëm				
3. Qendra e Artizanatit				
4. Inkubatorët për biznesin ,				
5. TIK (Piramida)				
6. Hapja dhe vendosja e signalistikës për të paktën 300 Km Shtrigësh për Hiking- Cycling, etc.				
7. Krijimi i hartave të media turistikë të stacionuara në hyrjet kryesore të çdo qyteze për të orientuar Turistët në lidhje me zonën				
8. BRANDING OF TIRANA.				
9. Regjistri City Tax, krijimi i bazës së të dhënave vendore mbi njësitë akomoduese në territorin e BT-së				
10. Rritja e rolit të BT-së si ndërmjetësuese midis biznesit dhe punëkërkuessit				
11. Projekte konkrete për rritjen e bashkëpunimit me universitetet për më shumë mundësi punësimi për studentët				
12. Trajnime, ngritje kapacitetesh sipas llojit të biznesit,				
13. Hartimi i Platformës për zhvillimin e qendrueshëm të ekonomisë vendore 2019-2022				
14. Hartimi i 6 planeve për mbarështimin e pyjeve				
15. Promovimi i bizneseve Eko-Freindly dhe orientimi i bizneseve aktuale që duan të kthehen në biznese green				
16. Markimi i produkteve bujqësore – Identifikimi i produkteve tipike				

6. FORCIMI I QEVERISJES SË MIRË DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

Sigurimi i një qeverisjeje transparente dhe rritja e llogaridhënies					
1. Përmirësimi portalit Tirana ime (raporto)					
2. Transparenca e Bashkisë Tiranë (e përvitshme)					
Forcimi i financave vendore					
Kordinimi i kontroleve në terren të bizneseve nga insttucionet vendore me ato qendrore					
Reduktimi i shpenzimeve administrative të bashkisë					
Rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në BT					
1. Krijimi i një sistemi elektronik për vlerësimin e performancës dhe mbledhja në mënyrë elektronike e nevojave për trajnim					
2. Krijimi i një platforme e-learning dhe një e-library					
3. Manaxhimi dixhital i projekteve strategjike dhe planeve të punës					

Tabela Nr 35. Kalendari i Vlerësimit dhe Monitorimit

OBJEKTIVAT	2018				2019				2020				2021				2022			
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
1. TIRANA POLICENTRIKE																				
Poli Kombinat; Qendër urbane me karakter kreativ, aristik dhe mjeshtëror																				
Hartimi i një plani të detajuar vendor				X				X												
Përmirësimi i infrastrukturës rrugore të zonës				X		X		X												
Rivitalizimi i sheshit Garibaldi dhe godinave përreth sheshit								X				X								
Mbulimi me shërbime publike I polit				X				X				X				X				X
Krijimi i Creative Hub, njw hapswirw e dedikuar mjeshtwriw												X				X				
BiD Kombinat, një partneritet publik privat për një mjedis fizik të përmirësuar dhe mw shumw mundësi biznesi														X		X		X		X
Poli Kinostudio; Qendër urbane me karkter artistik dhe kinamtoqrafik																				
Hartimi i një plani të detajuar vendor								X				X								
Rivitalizimi i sheshit ekzistues						X		X												
Mbulimi me shërbime publike I polit				X				X				X				X				X
Mbulimi me shërbime publike I polit për hapësira të dedikuara sipas moshave për zhvillimin e aktiviteteve kinematografike dhe ekspozimin e veprave artistike																X				X
TID Kinostudio																		X		X
Poli Bulevardit Verior të Tiranës, Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm																				
Përmirësimi i infrastrukturës së zonës së re për zhvillim				X				X				X				X				X
Transport Publik efikas dhe lidhja Veri-Jug me linja trasporti publik të gjelbër										X		X		X		X				
Krijimi i hapësirave publike të përshtatshme për intensitetin e zhvillimit që pritet të ketë zona								X				X				X				
Rivitalizimi i shinave të trenit si korridor i lëvizjes së gjelbër që lidh Bulevardin Verior me Laprakën																X		X		X
Rivitalizimi i lumit tw Tiranës												X				X				
Dizajni urban i shesheve dhe ndërtimi i tyre								X				X				X				
Dizajni dhe krijimi i hapësirave të gjelbra						X		X		X		X		X		X		X		X
Mbulimi me shërbime publike i polit				X				X				X				X				X
Ndërtim objektesh publike								X				X				X				X
Poli Laprakë; Qendër urbane me karakter sportiv, edukativ dhe rekreativ																				
Hartimi i Planit të detajuar vendor							X				X									
Përmirësimi i infrastrukturës rrugore								X				X				X				
Realizimi i një shiriti të kompensimit të gjelbër përgjatë hekurudhës (rrjeti i çiklizmit)						X		X												
Mbulimi me shërbime publike				X				X				X				X				X
Krijimi i disa qendrave rekreativo-sportive, për aktivitete sportive							X				X									
Incentivimi/mbështetja e bizneseve me karakter edukativ sportiv										X				X				X		X
Poli Farkë - Qyteti Studenti; Qendër urbane me karakter rekreativ natyror dhe turistik																				
Hartimi i një plani të detajuar vendor								X				X								
Infrastruktura në kufirin jugor të zonës (autostrada e re) dhe lidhja me Qytetin Studenti				X				X				X								
Krijimi i disa zonave të gjelbra publike për jetën kolektive, parku rekreativ i Farkës i lidhur me anë të trotuareve dhe korsive të biçikletave.				X				X												
Ndërtimi i një kompleksi sportiv të hapur (fusha futbollit, basket, voley).								X				X								
Krijimi i një zone për lojrat ujore				X				X												
Krijimi i një biblioteke në natyrë											X				X					
Mbulimi me shërbime publike I polit				X				X				X				X				X

2. ARSIMI PER TE GJITHE	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor																				
Infrastrukturë e re sipas standarteve					X		X		X		X		X		X					
Infrastrukturë ekzistuese e përmirësuar			X		X		X		X		X		X		X		X		X	
Rritja e aksesit dhe gjithpërfshirjes në Arsimin Parauniversitar																				
Rritja e aksesueshmërisë për grupet e pafavorizuara			X		X		X		X		X		X		X		X		X	
Shkollat si qendra komunitare			X		X		X		X		X		X		X		X		X	
Përmirësimi i kushteve të rezidencave studentore universitare																				
Rehabilitimi i infrastrukturës së konvikteve (sisteme furnizimi uje, energji, ngrohje kanalizim, ujesjelles, hidroizolim etj)			X		X		X		X		X		X		X		X		X	
Dixhitalizimi i arkivës dhe krijimi i një sistemi elektronik të akomodimit dhe regjistrimit të studentëve			X		X		X													
Krijimi i bibliotekave studentore, krijimi dhe mobilimi i hapësirave kreative			X				X				X				X					X

